Edukata Islame

Revistë shkencore, kulturore islame tremujore
Viti XLVIII nr. 114 / 2018

Boton: **Kryesia e Bashkësisë Islame e Kosovës**

Kryeredaktor:
Sabri Bajgora

Redaksia:
Dr. Abdulla Hamiti, Mr. Adnan Simnica, Ahmet Sadriu,
Dr. Fahrush Rexhepi, Kasim Gërguri, Dr. Sadik Mehmeti, Vedat Sahiti

email: **edukataislame@bislame.net**

Përkthimi i rezymeve:
Gjuhë angleze: Fisnik Gruda
Gjuhë arabe: Besim Mehmeti

Ballina:
Bashkim Mehani

Redaktor teknik & Operator kompjuterik:
Nuhi Simnica

Shtypi:
"Mozaiku" - Podujevë

Tirazhi: 500

Edukata Islame

Revistë shkencore, kulturore islame tremujore
Viti XLVIII nr. 114 / 2018

Prishtinë
2018

PAÇ BEKIMIN E ALLAHUT, USHTRI E KOSOVËS!

Më 14 dhjetor 2018, Kuvendi i Kosovës në seancë të veçantë plenare, ku morën pjesë të gjitha subjektet politike të vendit, përveç "Listës Serbe", miratoi bazën ligjore me të cilën FSK-së i jepen kompetenca shtesë, me të cilat edhe praktikisht shndërrohet në Forcë të Armatosur, respektivisht Ushtri, duke bërë kështu realitet një projekt dhe ëndërr të kamotshme të popullit të Kosovës, ideal të një sërë atdhetarëve të shquar ndër breza, amanet të dëshmorëve, vullnet të çlirimtarëve e mbi të gjitha, jetësim të një të drejte të mohuar deri tash, për shtetin dhe popullin e Kosovës.

Themelimi i Ushtrisë së Kosovës, përveçqë është një e drejtë e shteteve dhe kombeve të lira, për ne do të thotë edhe akt drejt finalizimit të shtetësisë së Kosovës, akt që forcon identitetin tonë shtetëror, kombëtar e qytetar. Krijimi i ushtrisë së Kosovës, në një të ardhme të afërt, përveçqë do të jetë garant i sovranitetit dhe integritetit të vendit tonë, si dhe të popujve që jetojnë në Kosovë, do të krijojë edhe mundësi për një ambient të qetë e të sigurt për të gjithë. E themi këtë, ngase është dëshmuar në realitet se pavarësia e Kosovës tashmë e ka stabilizuar tërë rajonin, ndërsa tash, Ushtria e Kosovës, do jetë faktor që do të kontribuojë në ruajtjen e stabilitetit, të paqes e të sigurisë, jo vetëm për rajonin por edhe më gjerë.

Ushtria e Kosovës, do të jetë ushtri profesionale, shumë etnike dhe e ndërtuar nën kujdesin dhe mbështetjen e ushtrive të vendeve demokratike. Populli ynë, është popull paqësor, dhe asnjëherë gjatë historisë nuk ka atakuar fqinjët, por është detyruar që të bëjë luftë mbrojtëse, luftë në mbrojtje të popullatës, kulturës, trashëgimisë dhe territoreve të veta, mbi të gjitha, luftë në mbrojtje të qenies së tij. E tillë do të jetë edhe ushtria e

Kosovës, e cila nuk do paraqesë kërcënim për askënd, por do të jetë e preokupuar vetëm me mbrojtjen e sovranitetit dhe integritetit të vendit.

S'ka dyshim së miratimi i ligjeve për Ushtrinë, është akti më i rëndësishëm për Kosovën pas aktit të Shpalljes së pavarësisë së vendit. Gëzon fakti se Ushtria e Kosovës, në këtë rrugëtim, u përkrah dhe u mbështet nga miqtë dhe aleatët tanë më besnikë, të cilët e përkrahën dhe mbështetën pavarësinë e Kosovës. për çka do t'u jemi gjithmonë mirënjohës dhe falënderues.

Shikuar nga aspekti fetar, themelimi i Ushtrisë, apo i Forcave të Armatosura, nuk është thjesht vetëm një detyrim shoqëror, por mbi të gjitha, është edhe një detyrim fetar, sepse, në mungesë të sigurisë, nuk mund të zhvillohej lirshëm as jeta fetare. Pikërisht, për këtë arsye, feja sigurinë e konsideron si begatinë më të madhe që ka një shoqëri njerëzore. Muhamedi a.s. ka thënë: *"Kush gdhin duke qenë i sigurt (personalisht dhe familjarisht), i shëndetshëm fizikisht dhe duke pasur furnizimin ditor, ai llogaritet sikur t'i jetë dhënë e tërë dynjaja."*

Po ashtu, i Dërguari i Allahut ka thënë: *"Dy sy nuk do t'i djegë zjarri i Xhehenemit: syrin që qan nga frika e Zotit dhe syrin që kalon natën duke ruajtur në rrugën e Zotit."*

Pra, Zoti i Plotfuqishëm, do t'i dallojë me mëshirën e Vet, besimtarin e devotshëm dhe ushtarin besnik. I pari sepse e kalon natën duke adhuruar Zotin dhe duke qarë nga frikërespekti për Të, ndërsa i dyti sepse rrezikon jetën e vet, që t'u ofrojë siguri të tjerëve, andaj edhe meriton këtë gradë të lartë te Ai.

Me themelimin e Ushtrisë së Kosovës, Ne, qytetarët, pa dallim etnie a përkatësie fetare, do të ndihemi më të sigurt dhe më të qetë, sepse tash kemi ushtrinë tonë, e cila na ruan dhe kujdeset për ne, andaj e kemi për detyrim fetar që të mos kursehemi nga lutjet tona drejtuar Allahut të Lartmadhërishëm që ta ruajë vendin dhe popullin tonë, të na begatojë me mirësi e siguri, ta ruajë dhe ta forcojë Ushtrinë tonë, dhe t'i begatojë gjithë ata ushtarë me shëndet, forcë, kurajë, guxim e gatishmëri, për të qenë gjithmonë në ruajtje dhe shërbim të vendit dhe popullit të tyre!

Zoti e begatoftë Ushtrinë e Kosovës!

Zoti e begatoftë me të mira vendin dhe popullin tonë!

Sabri Bajgora
Kryeredaktor
Dhjetor, 2018

Sabri BAJGORA

VEHBE ZUHAJLI DHE TEFSIRI I TIJ "ET-TEFSIRU-L MUNIR"

Abstrakt

Vehbe Zuhajli i takon plejadës së dijetarëve bashkëkohorë, të cilët lanë gjurmë të pashlyeshme në lëmin e shkencave fetare. Ishte një dijetar i gjithanshëm, sidomos në fushën e fikhut, usuli fikhut dhe tefsirit. Megjithatë, ai nuk ngeli prapa as në shkencat e tjera islame, duke shfaqur kështu afinitetin e tij prej një dijetari të gjithanshëm. Një kontribut kolosal, madje, të pakrahasueshëm me shumicën e bashkëkohanikëve të tij, ai e dha edhe në sferën e tefsirit. Ai shkroi tre tefsire, të cilët sot e kësaj dite vazhdojnë të ribotohen në të katër anët e botës islame: *Et-Tefsiru-l Munir* - (32 vëllime)*; Et-Tefsiru-l Vesit* - (3 vëllime) dhe *Et-Tefsiru-l Vexhiz* në margjina të Kuranit fisnik - (1 vëllim).

Tefsiri i tij *"Et-Tefsiru-l Munir",* pa dyshim bën pjesë në mesin e tefsireve më të pranuara bashkëkohore, sepse përfshinë tërë brumin e kësaj shkence, si në metodën e komentimit tradicional, ashtu edhe atë racional. Stili dhe metodologjia e ndjekur në këtë tefsir, e ka bërë këtë vepër, të pëlqyeshme si nga masat e gjera, po ashtu edhe nga ato intelektuale e akademike.

Ai gërshetoi në të njohuritë e tij të thella fetare, dhe si fryt i tërë këtij përkushtimi intelektual, doli ky tefsir i mirënjohur, i cili edhe për shumë kohë, do të jetë materie studimi në katedrat e tefsirit të shumë fakulteteve të shkencave kuranore, anembanë botës islame.

Fjalët kyçe: *Vehbe Zuhajli, Et-Tefsiru-l Munir, tefsir, fikh, Damask, etj.*

Biografi e shkurtër

Vehbe Zuhajli u lind në Dejr Atije, një fshat në periferi të Damaskut, në vitin 1932 e.r./1352 h. Ai rrjedh nga një familje e devotshme, që shquhej për përkushtim ndaj fesë islame. Babai i tij e orientoi në mësimet e fesë qysh nga vegjëlia, sepse edhe vetë ishte hafëz i Kuranit dhe dëshironte që edhe te fëmijët e tij ta mbillte këtë dashuri ndaj Librit të Allahut. Zuhajli qysh në moshën e re arriti gradën e hafëzit, gjë që i hapi rrugë për thellim të mëtutjeshëm të njohurive fetare.

Pasi përfundoi shkollimin fillor në vendlindje, ai në moshën 14 vjeçare, përkatësisht në vitin 1946, u shpërngul në Damask, për të vazhduar shkollimin e mëtutjeshëm. Pas përfundimit të shkollimit të mesëm në vitin 1952, ia mësyu Egjiptit, për t'u pajisur me dije nga dijetarët më të mëdhenj të botës islame.

Ai në të njëjtën kohë regjistroi disa fakultete, dy në Universitetin e *Az'harit,* atë të Sheriatit dhe të Gjuhës Arabe, sikur edhe Fakultetin Juridik në Universitetin *Ajnu Shems*. Ai e përfundoi Fakultetin e Sheriatit në vitin 1956, atë të Gjuhës Arabe në vitin 1957, e në të njëjtin vit e përfundoi edhe Fakultetin Juridik në Universitetin *Ajnu Shems*.

- Në vitin 1959, ai përfundoi magjistraturën në *Universitetin e Kajros* në degën e Sheriatit Islam, ndërkohë që doktoratën e përfundoi në po këtë Universitet, në vitin 1963.[1]

[1] Muhamed Arif Ahmed Farië, *Menhexh Vehbe ez Zuhajli fi tefsirihi li-l Kurani-l Kerim Et-Tefsiru-l Munir,* Aman, 1998, f. 16; Shih edhe: http://www.alukah.net/culture/0/1721/#ixzz5Wa69Ajle

Pas përfundimit të doktoratës, në vitin 1963, u emërua mësimdhënës në Universitetin e Damaskut, në Fakultetin e Sheriatit, derisa arriti në gradat më të larta shkencore.

- Për dy vjet, 1972-74, ligjëroi në Universitetin e Bengazit të Libisë, në Fakultetin e Sheriatit, e pastaj sërish u kthye në Universitetin e Damaskut.[2]

- Prej vitit 1984-1989, ligjëroi në Universitetin e *El-Ajni* të Emirateve të Bashkuara Arabe, gjatë së cilës kohë, e përfundoi veprën e tij më të madhe jetësore: *"Et-Tefsiru-l Munir"*.

Pas kthimit nga Emiratet e Bashkuara Arabe, u angazhua sërish në Universitetin e Damaskut, në Fakultetin e Sheriatit, deri në pensionim, në vitin 1997. Por, duke parë nevojën e madhe për kalibrin e një dijetari sikur Zuhajli, udhëheqësit e këtij Universiteti ia vazhduan mundësinë e ligjërimit edhe për pesë vjet të tjera pas pensionimit, në programet e doktoraturës. Ky aktivitet nuk pushoi deri pak muaj para vdekjes së tij.

- Në vitet 1989-1990, ligjëroi "derse" të Ramazanit në Katar dhe në Kuvajt.

- Në vitet 1990-91, ishte ligjërues në Fakultetin e Sheriatit në Universitetin e Jordanisë, në studimet post-diplomike.

- Ishte edhe profesor vizitor në Universitetin e Hartumit dhe në atë të Um Durman, në Sudan, në vitet (1992-97), e një kohë ishte ligjërues edhe në Qendrën për Studime të Sigurisë dhe të Trajnimeve në Riad.

- Në vitet 1997-2000, ligjëroi fikhun krahasimtar në Universitetin e Kuvajtit,

- Në vitin 2001, ligjëroi në Institutin e Lartë të Shkencave Juridike në Dubai,

- Ndërsa në vitet 2000-2008, në Universitetin e Sharikas, ligjëroi fikhun krahasimtar, në programin e doktoraturës.

[2] Muhamed Ali Ajazi, *El-Mufessirune, hajatihim ve menhexhihim,* Teheran, 1386 h., vëll. III, ff. 1190-1197.

Gjatë jetës së tij akademike, dr. Vehbe Zuhajli, ushtroi detyra me rëndësi si:

- Në vitin 1967 u emërua prodekan në Fakultetin e Sheriatit në Universitetin e Damaskut, po në këtë vit, u emërua edhe dekan i këtij fakulteti, deri në vitin 1970.

- Gjatë kohës sa ishte në Emirate, ai përveç që ishte shef i katedrës së Sheriatit në këtë fakultet, njëkohësisht ushtroi edhe detyrën e dekanit për disa vite me radhë.

- Pas kthimit nga Emiratet, u emërua drejtor i Katedrës së Fikhut dhe Usulit, në Fakultetin e Sheriatit pranë Universitetit të Damaskut, etj.

- Përveç këtyre pozitave ta larta administrative, dr. Zuhajli ishte anëtar i shumë Akademive të Shkencave dhe Qendrave hulumtuese me renome, në botën islame, anëtar i Akademisë mbretërore për hulumtime në qytetërimin islam të Jordanisë, anëtar dhe këshilltar i përhershëm i *Mexhmeal Fikh-el Islami* në Mekë, në Indi dhe Sudan, pastaj kryeredaktor dhe anëtar redaksie i shumë revistave të njohura islame etj.

- Mori pjesë në mbi 40 Konferenca Shkencore anembanë botës islame, me hulumtime dhe kumtesa shkencore.

Pas një jetë të bujshme të kaluar në shërbim të fjalës së Allahut, duke lënë pas vetes një trashëgimi madhështore të diturisë, të përjetësuar me botimin e mbi 80 veprave, të cilat edhe për një kohë të gjatë, do të mbesin burime kryesore në fikh, tefsir dhe në shkencat e tjera, i mbylli sytë, për t'ia dorëzuar shpirtin e tij fisnik, Krijuesit Fuqiplotë. Vdiq në Damask, më 8 gusht të vitit 2015, ndërsa u varros në vendlindjen e tij Dejr Atije.[3]

[3] Muhamed Ibrahim Hasen Hamd, *Ez-Zuhajli ve xhuhudihi en-nahvije fi kitabihi "Et-Tefsiru-l Munir" - Dirasetun vasfije tahlilije"*, Gazë - Palestinë, 2016, f. 18.19; Shih edhe Ahmed bin Mahmud ed-Dahin, *Vehbe ez-Zuhajli – el alimu, el fekihu, el mufessiru* - https://www.alukah.net/culture/0/1721/

Mësuesit e Vehbe Zuhajlit

Dr. Vehbe Zuhajli mori mësime nga shumë dijetarë të kohës, ndër të cilët do të veçonim:

Nga mësuesit e tij në Damask:

1. Mahmud Jasin, njëri nga themeluesit e Shoqatës: *"Xhem'ijetu-n-Nehda el edebije",* pastaj të asaj *"Xhem'ijjetu-l Ulema"* etj., nga i cili mori mësime në shkencat e hadithit.
2. Hasen esh-Shetti, njëri prej fukahave më të mëdhenj të fikhut hanbelij, sidomos në shkencën e *feraidit*, i cili ishte drejtor i parë i Fakultetit të Sheriatit në Damask.
3. Mahmud er-Rrenkusi, dijetar i devotshëm, dhe drejtor i Institucionit *"Daru-l hadith el eshrefije",* njëkohësisht edhe kryetar i Ligës së Dijetarëve, nga i cili mësoi në shkencën e akaidit dhe kelamit.
4. Muhamed Hashim el Hatib er-Rrifai, hatib i xhamisë së Emevitëve në Damask, nga i cili mësoi fikhun e medhhebit shafij, dhe nga i cili u ndikua për qasjen e vlerësimit të kritereve të sakta të Islamit.
5. Lutfi el Fejjumi, jurist i famshëm në fikhun hanbelij, nga i cili Zuhajli mësoi shkencën e usuli fikhut dhe shkencën e terminologjisë së hadithit.
6. Ahmed es-Semmak, në Texhvid.
7. Hamdi Xhuvejxhati, në shkencat e leximit të Kuranit.
8. Salih el Farfuri - themelues i Institutit *"Xhem'ijjetu-l Fet'hu-l Islami"* dhe i Medreseve, të cilat janë aktive edhe sot e kësaj dite, e në të cilat janë shkolluar një numër i madh imamësh nga Kosova, Maqedonia dhe Shqipëria. Nga ky dijetar mësoi shkencat e gjuhës arabe.
9. Abdurrezak el Humusi, myfti i Sirisë në vitet 1963-1969, nga i cili mësoi fikhun.
10. Hasan Habenneke el-Mejdani - njëri prej dijetarëve të rrallë të Damaskut, themeluesit të disa shkollave dhe shoqatave islame, i cili ishte njëkohësisht edhe një prej themeluesve të Ligës Botërore Islame me seli në Mekë (Rrabita-s), nga i cili mori mësime në tefsir. Hasen Habenneke edhe vetë është autor i tefsirit të njohur 15 vëllimesh *"Mearixhu-t-tefekkuri ve dekaiku-t-tedebburi"*, në të cilin ka ndjekur kronologjinë e zbritjes, e jo të radhitjes në Mus'haf.

Nga mësuesit e tij në Kajro:

1. Shejh Muhamed Ebu Zehre, pa dyshim njërit prej figurave më emblematike të shekullit XX, në shumë prej shkencave, si në fikh, në tefsir, i cili është autor i tefsirit të mirënjohur: *"Zehretu-t-Tefasir",* me 10 vëllime, ku ka komentuar deri në ajetin 74 të sures *En-Neml;*
2. Shejhul Az'har Mahmud Sheltut, ndër fukahatë më të njohur të kohës së tij dhe themelues i Institucionit të lartë për hulumtime islame: *"Mexhmeu-l Buhuth el Islamije";*
3. Shejhul Az'har - dr. Abdurrahman Taxh, një hulumtues i madh islam;
4. Isa Mennun - dekan i Fakulteteve të Sheriatit dhe të Usuli Dinit, nga i cili mësoi në fikhun krahasimtar;
5. Xhadurrabb Ramadan, në fikh të shafinjve;
6. Mahmud Abdu-d-Daim në fikh të shafinjve;
7. Mustafa Abdulhalik në usuli fikh;
8. Abdulgani Abdulhalik po ashtu në usuli fikh; dhe
9. Muhamed Ali el Hafif, njëri prej kadive dhe dijetarëve më të mëdhenj të Egjiptit në lëmin e fikhut, i cili ka lënë pas vetes me dhjetëra libra në lëmin e fikhut dhe usuli fikhut.

Dr. Vehbe Zuhajli, në memoaret e tij, kurrë nuk kishte harruar të përmendte me respekt mësuesit e tij, duke thënë: *"Nga dijetarët e Egjiptit mora diturinë, kurse nga dijetarët e Shamit mësova si ta vë në punë diturinë time duke e shoqëruar atë me dëlirësi shpirtërore."*[4]

[4] http://www.alukah.net/culture/0/1721/#ixzz5Wa69Ajle

Nxënësit e Vehbe Zuhajlit

Pasi u pajis me dituri e njohuri të shumta, dhe u inkuadrua fuqishëm në mësimdhënie në institucionet me kredibile islame nëpër botën arabe dhe islame, pa dyshim që gjurmët e dijes së tij, u përcollën te një numër i madh studentësh dhe nxënësish të tij, ndër të cilët do të veçonim:

1. Dr. Muhamed ez Zuhajli, vëllai i tij më i vogël;
2. Muhamed Faruk Hamade;
3. Muhamed Neim Jasin;
4. Abduletif Farfuri;
5. Abdusettar Ebu Guddeh;
6. Muhammed Ebu Lejl;
7. Abduselam el Ibadi, e shumë të tjerë.[5]

Veprat e tij të shkruara

Dr. Vehbe Zuhajli, konsiderohet si njëri ndër dijetarët më produktiv në lëmin e fjalës së shkruar në kohën tonë. Ai shkroi mbi 85[6] vepra kolosale, disa vëllimshme, sidomos në lëmin e fikut dhe të shkencave të tij.

Ai përveç në shkencën e fikhut, shkroi në lëmi të shumta fetare, në tefsir, në hadith, në akaid, gjuhë arabe etj. Ne këtu, në pamundësinë për të përmendur të gjitha veprat e tij, do të mjaftohemi me disa kryesore prej tyre.[7]

Në lëmin e tefsirit:

1. *Et-Tefsiru-l Munir - (16 vëllime),* për të cilin do të bëjmë fjalë më vonë;
2. *Et-Tefsiru-l Vesit - (3 vëllime;*
3. *Et-Tefsiru-l Vexhiz në margjina të Kuranit Fisnik - (1 vëllim);*
4. *El-Insanu fi-l Kuran;*
5. *El-Kissatu-l Kuranijeti – hidajetun ve bejanun;*
6. *El-I'xhazu-l Ilmij fi-l Kuran, etj.*

[5] http://darfikr.com/article نبذة-عن-السيرة-الذاتية-للدكتور-وهبة-مصطفى-الزحيلي-رحمه-الله

[6] https://syrianoor.net/article/214

[7] www.howiyapress.com/10290-2/

Në lëmin e hadithit:

1. *Tahkik "Xhamiu-l Ulumi vel Hikem"* të Imam Ibën Rexheb el Hanbeli;
2. *Tahkik "Muhtesaru-l Envar fi shemailin-n-nebijji-l muhtar"* të Imam Begaviut;
3. *Fikhu-s Sunneti-n-nebevijjeti;*
4. *El-Mustafa min ehadithi-l Mustafa;*
5. *Tahrixhu-l ehadith "Tuhfetu-l fukahai"* nga Imam Samerkandi;
6. *Es-Sunnetu-n-nebevijjetu esh-sherifetu - hakikatuha ve mekanetuha inde-l muslimin;*
7. *Kiraetun ve davabitun fi fehmi-l hadithi-n-nebevijj, etj.*

Në lëmin e akaidit:

1. *Usulu-l Iman vel Islam;*
2. *Usulu-t-takribi bëjnë-l medhahibi-l-Islamijje;*
3. *Nidhamu-l Islam fi-l Akideti.*

Në lëmin e sires dhe historisë islame:

1. *Shemaili-l Mustafa s.a.v.s.;*
2. *Menhexhu-d-da'veti fi-s-sireti-n-nebevijjeti.*

Në lëmin në fikhut dhe usuli fikhut:

Dr. Vehbe Zuhajli kontributin më të madh e dha në lëmin e fikhut dhe shkencave të tij, me se, me plot të drejtë u radhit në mesin e dijetarëve më të mëdhenj të kësaj fushe në botën islame. Janë të shumta veprat e këtij dijetari në këtë sferë, por në do të përmendim disa prej tyre:

1. *Fikhu-l Islami ve edil-letuhu;*
2. *El-Vexhiz fi-l Fikhi-l Islami;*
3. *El-Fikhu-l Islami ve uslubihi-l-xhedid;*
4. *El-Fikhu-l hanefijji el mujesser;*
5. *El-Fikhu-l malikiji el mujesser;*
6. *El-Fikh-u-shafi'ijji el mujesser;*
7. *El-Fikhu-l hanbelijji el mujesser bi edil-letihi ve tatbikatihi el-muasare;*

8. En-Nususu-l fikhije el muhtare bi takdim ve ta'lik ve tahlil;
9. El-Alakat ed-duvelije fi-l Islam;
10. Usulu-l fikhi-l islami;
11. El-Vesit fi Usuli-l fikhi-l islami;
12. El-Vexhiz fi Usuli-l fikhil islami;
13. Tarih teshriu-l islami;
14. Fikhu-n-nikah;
15. Ukudu-z-zevaxh;
16. El-Ukubat esh-sher'ijeh;
17. Atharu-l harb fi-l fikhi-l islami;
18. Hukmu-l harbi fi-l Islam ve hasaisuha el insanije,[8] dhe shumë vepra të tjera nga kjo fushë.

Në lëmin e ahlakut:
1. Ahlaku-l muslim ve alakatuhu bi-l Halik;
2. Ahlaku-l muslim ve alakatuhu bi-l muxhtema'ë;
3. Ahlaku-l muslim ve alakatuhu bi-n-nefsi ve-l kevni, etj.

Në lëmin e monografisë dhe historisë islame:
1. El-Halifetu-rr-rrashid el adil-Omer bin Abdulaziz;
2. Seid bin Mesejjeb - sejjidu-t-tabi'in;
3. Usame bin Zejd;
4. El-Imam es- Sujuti;
5. El-Muxheddid Xhemalud-din el Afgani ve islahatihi fi-l alemi-l islami etj.

Libra me tematika bashkëkohore:
1. Mevsuatu-l fikhi-l islami ve-l kadaja el muasare;
2. Kadaja el fikh ve-l fikr el-muasir;
3. Vesatijetu-l Islam ve semahatihi;
4. El-Alemu-l Islami fi muvaxheheti-t-tehaddijat el garbije;
5. Hakku-l hurrijjeti fi-l alem;
6. El-Islamu ve-l usulu-l hadareti-l insanijeti,[9] *etj.*

[8] *El-Mufessirune, hajatihim ve menhexhihim,* vëll. III, ff. 1191.
[9] Për më gjerësisht shih: http://www.feqhweb.com/vb/t21809.html#ixzz5WdstGE4k

Librat e shkruara për Vehbe Zuhajlin rreth jetës dhe veprës së tij

Rreth personalitetit të dr. Vehbe Zuhajlit janë shkruar me dhjetëra libra si dhe artikuj shkencorë nëpër revista të ndryshme, anekënd botës islame. Në këto libra është shtjelluar deri në detaje metodologjia e tij e punës, mendimet, qasjet e tij ndaj shumë prej problemeve bashkëkohore etj. Zakonisht, biografitë e dijetarëve të mëdhenj, shkruhen pas vdekjes së tij, por një gjë e tillë nuk kishte ndodhur edhe me të. Fatmirësisht, në të gjallë të tij, janë shkruar me dhjetëra libra e vepra që flasin për jetën, veprat dhe metodologjinë e punës, qoftë në sferën e fikhut dhe të shkencave të tij, qoftë të tefsirit, për të cilin segment, do të bëjmë fjalë në vazhdim. Sa për ilustrim do të përmendim disa prej këtyre veprave që janë shkruar për Zuhajlin:

- Mr. Muhamed Arif Ahmed Fari *"Menhexh Vehbe Zuhajli fi tefsirihi li-l Kurani-l Kerim",* (1998).[10]
- Dr. Muhamed Seid Ramadan el Buti,*"Ta'rif ixhmali li tefsiri-l Munir"* – (artikull në revistën "Nehxhul Islam, nr. 45, Damask, 1991).
- Dr. Muhamed Uxhaxh el Hatib,*"Advaun ala mesireti-l ustadh ed-duktur Vehbe Zuhajli"*, (2003).
- Dr. Bediu Sejjid el-Lehham, *"Vehbe Zuhajli – El-Alimu el fekihu el mufessiru"*, (2001)
- Dr. Muhamed ed-Dessuki, *"Duktur Zuhajli kema areftuhu"*, (2003).
- Dr. Abdulla Hana, *"Nuz'hetun mea shejh Vehbe Zuhajli ve muktetafat min intaxhihi-l fikrij",* (2003).
- Abdulbasit el Kassab, *"El-Alim el muxhahid el muhlis",* (2003).
- Dr. Muhamed Zuhajli, *"Esh-Shekik el murebbi vel ustadh el ethir",* (2003).
- Dr. Abdulaziz el-Hajjat, *"El-Ustadh Vehbe Zuhajli-dirasetun fi kitabihi el alakat ed-duvelije",* (2003).
- Dr. Ahmed Ratib Hammush, *"Siretu-l ustadh ed-duktur Vehbe Zuhajli fi a'ëmalihi",* (2003).

[10] *El-Mufessirune, hajatihim ve menhexhihim,* vëll. III, f. 1197

- Dr. Halife Babekr el Hasen, *"Devru-l ustadh ed-duktur Vehbe Zuhajli fi hidmeti Usulil Fikhil Islami"*, (2003).
- Dr. Muhamed Tahir el Mensuri, *"Ed-Duktur Vehbe Zuhajli ve is'hamihi fi teshri'i-l islami ed-duvelij"*, (2003).[11]
- Muhamed Ibrahim Hasen Hamd, *"Ez-Zuhajli ve xhuhudihi en-nahvije fi kitabihi "Et-Tefsirul Munir" - Dirasetun vasfije tahlilije"*, 2016.

Ka edhe shumë libra të tjerë që janë shkruar për kontributin e dr. Vehbe Zuhajlit në shkencat islame, por për hir të hapësirës, u mjaftuam vetëm me kaq.

Vlerësimet e dijetarëve për Vehbe Zuhajlin

Allahu i Madhërishëm, i kishte dhuruar Vehbe Zuhajlit dituri të gjerë, por mbi të gjitha modestinë. Të gjithë ata që e kanë njohur Zuhajlin, qoftë mësuesit, qoftë nxënësit, e sidomos kolegët e tij, kanë folur për të me fjalët më të zgjedhura.

Ai shquhej me kulturën dhe mirësjelljen ndaj çdokujt. Ishte shumë i shoqërueshëm dhe në shoqërimin e tij, secili e ndjente veten mirë.

Ishte këshilluesi më i mirë për studentët dhe nxënësit e tij dhe kurrë nuk hezitonte t'i shoqëronte ata në evente të ndryshme.

Nuk shquhej për mendjemadhësi para të tjerëve, por e respektonte çdonjërin, sipas meritës.

Nuk ishte fanatik në medh'heb dhe në asnjë rast nuk ka folur keq për ndonjërin prej mësuesve të tij, përkundrazi, për ta fliste gjithnjë më dashuri e respekt, ndonëse edhe vetë ishte bërë një prej dijetarëve më të mëdhenj të botës islame.

Ishte njeri i principeve dhe në asnjë moment nuk dëshironte ta kalonte kohën kot, pa ndonjë aktivitet. Ai në një rast e kishte potencuar këtë çështje, kur kishte thënë: *"Sekreti i suksesit në jetë është mbajtja e lidhjeve tua me Allahun xh.sh."*, duke iu referuar gjithmonë ajetit 282, të sures *El-*

[11] Dr. Bediu-Sejjid el-Lehham, *Vehbe Zuhejli - El-Alimu el fekihu el mufessiru*, Damask, 2001, f.10; Shih edhe:
https://www.naseemalsham.com/ar/Pages.php?page=readTragm&pg_id=54251

Bekare: ***"Keni dronë e Allahut, e Allahu ju mëson** (ju dhuron dituri të jashtëzakonshme)"*

- **Shejh Sadik Habenneke,** njëri prej mësuesve të tij, e pastaj edhe kolegë i tij, për Zuhajlin thotë: *"Vërtet, shejh Vehbe Zuhajli, Allahu e ruajtë dhe ia shtoftë edhe më tej mirësitë e Tij, në zemrën time ka një vend të posaçëm. Ai e meriton këtë pozitë, sepse është modest, është në rrugë të drejtë, pa asnjë devijim. Ai ndjek rrugën e diturisë dhe punon me sinqeritet. Nga duart e tij janë shkruar shumë libra të mirë e të dobishëm."*[12]

- **Dr. Kerim Raxhih,** shejhu i kurrave të Shamit për të thotë: *"U trondita nga ky lajm i dhimbshëm (i vdekjes së tij). Ai ishte dijetar shumë bindës në argumentim, e njëkohësisht edhe shumë i devotshëm. Ai e thoshte hakun-të vërtetën pa hezituar, duke mos qenë asnjëherë dyfytyrësh në sjelljet e tij. Ishte një personalitet që ngjallte admirim, shquhej me një krenari të pashoqe dhe kurrë nuk iu nënshtrua asnjë pushtetari apo të pasuri, duke llogaritur se pozita në dije, ishte mbi të gjitha pozitat dhe privilegjet e kësaj bote"*.

- Dijetari bashkëkohor **dr. Aid el Karni,** thotë: *"E kam njohur nga takimet dhe Konferencat e shumta. Ishte vërtet një dijetar i thellë, ishte krenar për dashurinë që ushqente ndaj të gjithë myslimanëve. Askujt nuk ia mendonte të keqen."*

- Me po të njëjtat pietete, flet edhe dijetari tjetër bashkëkohor **dr. Selman el Avde** kur thotë: *"E kam njohur si autor, pastaj shpeshherë kam ndenjur e biseduar me të edhe nëpër emisione. Vërtet ishte një enciklopedi e gjallë. Ishte i qetë nga natyra, xheloz dhe skajshmërish i kujdesshëm për ymetin islam. O Allah, ngrite lart pozitën-gradën e tij në Xhenet."*[13]

Shpërblimet dhe dekoratat

Aktiviteti i gjithanshëm i dr. Vehbe Zuhajlit në shkencat islame, bëri që ai të fitonte respektin e botës islame, gjithandej. Ai kudo që shkoi dhe ligjëroi në botën arabe dhe islame pas vetes la gjurmë të pashlyeshme, me sjelljet dhe modestinë prej një dijetari. Pikërisht puna e tij kaq e frytshme,

[12] http://www.alukah.net/culture/0/1721/#ixzz5Wa69Ajle

[13] http://articles.islamweb.net/Media/index.php?page=article&lang=A&id=206125

bënë që ai të nderohej gjatë jetës së tij me disa mirënjohje dhe dekorata të larta. Në vitin 2003, Shtëpia Botuese *"Daru-l Fikri"* në Damask, i ndau mirënjohje për kontribut jetësor.

Në vitin 1995, nga Republika Islamike e Iranit, ky tefsir është përzgjedhur si libri i vitit, ku autori është nderuar me një shpërblim dhe dekoratë.

Po ashtu, në vitin 2005, presidenti sudanez Umer el Beshir, e nderoi me dekoratën për kontributin e tij jetësor në lëmin e studimeve islame, ndërkohë që po të njëjtin vit, presidenti sudanez e kishte dekoruar edhe me medaljen më të lartë shtetërore për njerëzit me merita të veçanta.[14]

Në vitin 2008, Qeveria e Malajzisë ia ndau shpërblimin *"Personaliteti më i dalluar islam"*, në një ceremoni madhështore që u mbajt në kryeqytetin administrative në Putraxhaja. Shpërblimin ia dorëzoi vetë hirësia e tij, Sulltan Mu'tesim bilah el Haxh Abdulhalim Muadh-dham Shah.[15]

Karakteristikat e tefsirit "Et-Tefsiru-l Munir"

Dr. Vehbe Zuhajli, ashtu siç theksuam më lartë, është autor i tre tefsireve[16]: *Et-Tefsiru-l Munir* - (16 vëllime, apo 32 pjesë)*;* të cilin e shkroi për studiuesit dhe dijetarët që dëshirojnë të thellohen më tepër në shkencën e tefsirit; *Et-Tefsiru-l Vesit*[17] - (3 vëllime), të cilin e shkroi për një shtresë mesatare të intelektualëve dhe *Et-Tefsiru-l Vexhiz*[18] në margjina të Kuranit fisnik - (1 vëllim), të cilin e shkroi për të gjitha shtresat e shoqërisë myslimane.

Sa i përket tefsirit të tij: *"Et-Tefsiru-l Munir"*, ky tefsir me plot të drejtë llogaritet si një ndër tefsiret më madhështorë të shkruar ndonjëherë në botën islame, jo vetëm për shkak të vëllimit, po edhe për shkak të për-

---

[14] *Ez-Zuhajli ve xhuhudihi en-nahvije fi kitabihi "Et-Tefsiru-l Munir" - Dirasetun vasfije tahlilije"*, f. 18.19.

[15] Po aty, f.19: Shih edhe: https://www.kuna.net.kw/articleDetails.aspx?id=1963608&language=ar

[16] Zuhajli, me rastin e përpilimit të tre tefsireve, ka ndjekur shembullin e dijetarit të madh Vahidij en-Nejsaburi, i cili po ashtu ka të shkruar tre tefsire: *Tefsiru-l Vesit, Tefsiru-l Besit* dhe *Tefsiru-l Vexhiz.*

[17] Dr. Vehbe Zuhajli, *Et-Tefsiru-l Vesit*, Damask-Bejrut, 2001.

[18] Dr. Vehbe Zuhajli, *Et-Tefsiru-l Vexhiz*, Damask-Bejrut, 1996.

mbajtjes. Ky është një tefsir me 10.278 faqe komentim, të ndarë në 30 xhuza, po aq sa ka xhuza edhe Kurani. Pas përfundimit të tefsirit, në bashkëpunim me shtëpinë botuese *"Darul Fikri"*, ka shkruar edhe dy vëllime të tjera, prej 1316 faqesh, vetëm për përmbajtjen, për hadithet, emrat e personave, librat e cituar etj, si ndihmesë për hulumtuesit dhe studiuesit shkencorë, që i bie të jenë gjithsej 11.594 faqe, e që përfundimisht, e radhit ndër tefsiret më të vëllimshëm të shkruar ndonjëherë.

Emërtimi i tij në origjinal është paksa më i gjatë: *"Et-Tefsiru-l Munir fi-l akideti ve-sh-sheriati ve-l menhexh"*, por në qarqet shkencore njihet më shumë me emërtimin e shkurtuar: *"Et-Tefsiru-l Munir"*

Botimi i parë i këtij tefsiri ka qenë në vitin 1991, në Bejrut.

Ky tefsir, përveç në gjuhën arabe, tashmë është përkthyer edhe në gjuhën turke dhe atë malajziane.[19]

Gjatë shtjellimit të pikave kryesore të këtij tefsiri, jemi mbështetur në botimin e dhjetë të tij, të botuar në Damask, në vitin 2009.

Disa vërejtje dhe kritika të studiuesve ndaj tefsirit të Zuhajlit

Studiuesit që u morën me vlerësimin e tefsiri të Zuhajlit, kanë dhënë disa vërejtje të vogla, të cilat sipas mendimit tim janë normale, sepse i përkryer është vetëm Allahu xh.sh. Një prej këtyre vërejtjeve është ndarja tematike e ajeteve, të cilën, sipas tyre, dr. Zuhajli nuk e ka përfillur në çdo rast, sepse f.v. një njësi të tillë tematike e ka bërë vetëm me një ajet, si f.v., me ajetin 41 të sures *Et-Tevbe"*[20] Një gjë të tillë e ka përsëritur edhe në disa raste të tjera, si f.v. me rastin e komentimit të ajetit 20 të sures *"Junus"*:etj.[21]

Sipas mendimit tonë, kjo nuk mund t'i llogaritet as si dobësi e as si lëshim, përveçse si dëshirë e autorit, që një çështjeje të caktuar, t'i jap prioritet dhe hapësirë më të bollshme gjatë komentimit.

---

[19] http://darfikr.com/article/التفسير-المنير-في-العقيدة-والشريعة-والمنهج-للدكتور-وهبة-الزحيلي-رحمه-الله

[20] *Et-Tefsiru-l Munir*, vëll. X, f. 575; Shih edhe: *Et-Tefsiru-l Munir li-z-Zuhajli - Dirase ve takvim*, revista *"Xhamiatu-n-nexhah li-l ebhath el ulum el insanije*, nr. 27 (10). f. 2051.

[21] *Et-Tefsiru-l Munir*, vëll. XI, f. 145; Shih edhe: *Et-Tefsiru-l Munir li-z-Zuhajli - Dirase ve takvim*, revista *"Xhamiatu-n-nexhah li-l ebhath el ulum el insanije*, nr. 27 (10). f. 2051.

Ndërkohë, nga kritikat e tjera që i janë bërë këtij tefsiri, të cilat po ashtu mund të merren paksa me rezerva, është fakti se sipas tyre, Zuhajli ka sjellë disa transmetime të dobëta rreth shkaqeve të zbritjes të ajeteve, ndonëse në parathënien e shkruar nga vetë Zuhajli, ai ishte zotuar se nuk do të përdorte asnjë transmetim të dobët rreth shkaqeve të zbritjes, ndërkohë që gjatë komentimit, ai disa herë sjell transmetime të tilla. Një rast të tillë e kemi te komentimi i ajetit të 14-të, të sures *El-Bekare*, ku ai cek një shkak tepër të dobët për zbritjen e këtij ajeti. Mufesirët më të mëdhenj si Taberiu, Ebu Hajjani, Ibën Kethiri, Kurtubiu etj, as që kanë denjuar ta cekin si transmetim, ndërkohë që Shevkaniu, Alusiu e të tjerë e kanë cekur, por në fund kanë treguar për dobësinë evidente të tij. Sa për të qenë korrekt ndaj Zuhajlit, në fund të pasuesit, edhe vetë ai e cek thënien e Imam Sujutiut se ky isnad është shumë i dobët, por megjithatë nga disa "kritikë" i zihet për të madhe, vetëm pse e ka cekur![22]

Disa nga vërejtjet e tjera në adresë të këtij tefsiri janë, se Zuhajli, kur ka cekur mendimet e dijetarëve rreth një dispozite juridike, në disa raste nuk i ka përmendur fare burimet apo librat e këtyre dijetarëve. Pastaj nuk i ka kushtuar një vëmendje të posaçme, isnadeve të haditheve, të cilat i ka transmetuar dhe i ka sjellë si dëshmi për argumentim.

Në tefsirin e tij mund ta hasen edhe pjesë të huazuara nga mufessirët para tij, por Zuhajli nuk i ka cekur burimet me të cilat është shërbyer!

Dhe në fund, Zuhajli nuk i ka komentuar në mënyrë më të detajuar disa nga të arriturat e fundit shkencore, të cilat gjejnë mbështetje në ajetet që flasin për mrekullinë kuranore, ndonëse ky shekull në të cilin po jetojmë, është shekull i shkencës dhe i rizbulimit të fesë në përgjithësi.[23]

Të gjitha këto "vërejtje" apo kritika në adresë të Zuhajlit, janë pothuajse pa ndonjë peshë të veçantë, sepse është shumë e natyrshme, që "lëshime" të tilla të ndodhin dhe janë hasur edhe në tefsiret e mëhershëm, andaj, në asnjë mënyrë, nuk mund ta zbehin vlerën e pakontestueshme të tij, në mesin e kësaj trashëgimie të madhe islame nëpër botë.

---

[22] *Et-Tefsiru-l Munir*, vëll. I, f. 94.

[23] *Menhexh Vehbe ez-Zuhajli fi tefsirihi lil Kurani-l Kerim Et-Tefsiru-l Munir*,ff. 276-277.

Veprat me të cilat është shërbyer Vehbe Zuhajli në "Et-Tefsiru-l Munir"

Një mufessir i kalibrit të Zuhajlit, mbase edhe vetë, ka pasur kapacitet intelektual të bëjë interpretimin e Kuranit famëlartë, por i stolisur me petkun e modestisë, ai nuk heziton për asnjë moment të përmendë me emra, mufesirët para tij, teksa citon mendime të tyre rreth një çështjeje të caktuar gjatë komentimit të ajeteve.

Ai vetë në parathënie[24] i cek me emra veprat me të cilat është shërbyer gjatë shkrimit të tefsirit të tij. Nga shfletimi i këtij tefsiri, vërejmë emrat e këtyre tefsireve që i ka përdorur si referenca, Vehbe Zuhajli si:

Nga tefsiret tradicionale:

1. *Xhamiu-l Bejan* nga Taberiu, me 77 referenca;
2. *Tefsiri i Ibën Kethirit*, me 224 referenca;
3. *Fet'hu-l Kadir* të Shevkanit, me 2 referenca;
4. *El Muharreru-l vexhiz* nga Ibni Atije el Endelusi, me 2 referenca;
5. *El-Xhevahiru-l Hisan* të Thealebiut.

Nga tefsiret racionale:

1. *Mefatihu-l Gajb* të Fahru Rraziut, me 393 referenca;
2. *El-Bahru-l Muhit* të Ebu Hajjan el Endelusit, me 133 referenca;
3. *Garaibu-l Kuran ve regaibu-l Furkan* të Nejsaburit, me 28 referenca;
4. *Ruhu-l Meani* të Alusit, me 26 referenca;
5. *Tefsirin e Bejdaviut*, me 7 referenca;
6. *Medariku-t-Tenzil* të Nesefiut;
7. *Tefsiru-l Xhelalejn;*
8. *Tefsirin e Hazinit*, me 1 referencë;
9. *Irshadu-l akli-s-selim* i Ebu Su'udit, me 1 referencë, etj.
10. *El-Keshaf*, i Zemahsheriut, të cilin e shfrytëzoi më tepër në aspektin gjuhësor dhe të retorikës, duke e cituar 155 herë si referencë.

[24] *Et-Tefsiru-l Munir*, vëll. I, ff.13-14.

Përveç këtyre tefsireve, ai është shërbyer edhe me tefsire që njihen si *tefsire juridike*, ndër to:

1. *Ahkamu-l Kuran* të Xhessasit, me 97 referenca;
2. *Ahkamu-l Kuran* të Ibën Arabiut, me 131 referenca;
3. *El-Xhamiu li Ahkami-l Kuran* nga Kurtubiu, me 380 referenca.

Kurse nga *tefsiret bashkëkohore* është shërbyer me këto tefsire:

1. *Tefsiru-l Menar* nga Muhamed Reshid Rida, me 26 referenca;
2. *El-Xhevahiru fi Tefsiri-l Kuran* nga Tantavi Xhevheriu;
3. *Tefsirin e Meragiut,* me 9 referenca; dhe
4. *Fi Dhilali-l Kuran* nga Sejjid Kutbit.

Zuhajli, ashtu siç theksuam më parë, ka përdorur si burim referencash edhe libra që flasin për *shkaqet e zbritjes* si:

1. *Esbabu-n-nuzul* të Vahidiut me 82 referenca;
2. *Lubabu-n-nukul* të Sujutiut me 14 referenca.

Përveç këtyre veprave, ai ka përdorur si referenca edhe libra nga shkenca e kiraeteve si:

1. *En-Neshr fi-l kira'atil ashr* – nga Ibën Xhezeriu;

Nga librat e gramatikës, sintaksës dhe morfologjisë ka përdorur veprën:

1. *El-Bejan fi I'ërabi-l Kuran* nga Ebil Berekat el Enbari.

Ndërsa nga librat e *sires* i ka përdorur:

1. *Siren e Ibën Hishamit,* me 4 referenca;
2. *El-Bidaje ve-n-Nihaje* të Ibën Kethirit, me 5 referenca;
3. *Kisasu-l Enbija* të Abdulvehhab Hal-lafit, me 11 referenca, etj.[25]

[25] *Menhexh Vehbe ez-Zuhajli fi tefsirihi li-l Kurani-l Kerim - Et-Tefsiru-l Munir*, ff. 32-44.

Metodologjia e ndjekur nga Vehbe Zuhajli në Et-Tefsiru-l Munir"

Nga vetë emërtimi i këtij tefsiri, *"Et-Tefsiru-l Munir fi-l akideti vesh-sheriati vel menhexh"*, lehtësisht mund të dallojmë metodologjinë e punës së Zuhajlit në këtë tefsir. Ai e konsideron tefsirin e tij gjithëpërfshirës, duke gërshetuar aspektin akaidologjik, sqarimin e dispozitave juridike, çështje bashkëkohore, aspekte politike, sociale dhe edukative[26] etj. Siç do të shohim nga shembujt që do t'i sjellim në këtë punim, shihet qartë se Zuhajli në këtë tefsir ka ndjekur metodologjinë tradicionale të komentimit, të shoqëruar me atë racionale, duke gërshetuar kështu, suksesshëm, që të dyja metodologjitë, në çka besojmë se ia ka arritur plotësisht qëllimit të tij.

Ai ishte shumë i vëmendshëm që të përcillte rivajete nga i Dërguari i Allahut, nga sahabët dhe tabi'inët. Njëkohësisht, i kushtoi vëmendje të posaçme shkencës së kiraeteve, të cilën siç duket e ka zotëruar mjaft mirë, duke e pasuar komentimin e tij me përmendjen e shkaqeve të zbritjes, të ajeteve në të cilat mund të ketë *nasih* dhe *mensuh*[27], pastaj përmendte aspekte akaidologjike, juridike dhe historike etj. Tërë kjo reflekton për kulturën dhe njohuritë e thella të Zuhajlit, për çka meriton të falënderohet, që na ka sjellë një brumë të tillë të diturive në tefsirin e tij.[28]

Ai në parathënien e tefsirit të tij, ka sqaruar për motivet dhe synimet që e kanë shtyrë t'i rreket komentimit të Kuranit kur thotë: *"Qëllimi im parësor në përpilimin e këtij tefsiri ishte lidhja e çdo myslimani me librin e Allahut, me një lidhje të fortë shkencore, sepse Kurani fisnik është kushtetutë për njerëzit në përgjithësi, por për myslimanët në veçanti. Për këtë arsye, nuk jam ndalur në sqarim të ngushtë dhe sipërfaqësor të dispozitave juridike, por kam dëshiruar t'i sqaroj këto dispozita nga ajetet kuranore në kuptimin e zgjeruar, i cili kuptim është shumë më i thellë në të kuptuar, dhe i cili përfshin akaid-besim, moral-edukatë, program-me-*

[26] Mensur Ebu Zineh, *Et-Tefsiru-l Munir li-z-Zuhajli- Dirase ve takvim*, studim i botuar në revistën *"Xhamiatu-n-nexhah li-l ebhath el el ulum el insanije*, nr. 27 (10). Jermuk-Jordani, 2013, f. 2045.

[27] Ajete deroguese dhe të deroguara (shfuqizuese dhe të shfuqizuara)

[28] *Menhexh Vehbe ez-Zuhajli fi tefsirihi li-l Kurani-l Kerim Et-Tefsiru-l Munir*,f. 49.

todologji dhe sjellje. Islami i cili thërret në besim ose mendim që gjallëron zemrën dhe mendjen, e zgjon njeriun nga iluzionet e injorancës dhe mitologjisë, duke e çliruar atë nga adhurimi i idhujve, për ta orientuar drejt Krijuesit të vetëm-Allahut xh.sh. Ky Kuran, që thërret në ligjin e drejtësisë, të së vërtetës, të mëshirës së përgjithshme ndaj njerëzimit, po ashtu thërret në një program të shëndoshë për jetën, për të menduarit dhe për sjelljet tona në përgjithësi. Ky Kuran thërret që ta vrojtojmë në mënyrë të gjithanshme këtë gjithësi-ekzistencë, për t'i sqaruar raportet dhe lidhjet e njeriut me Allahun e Madhërishëm, me gjithësinë dhe me jetën në përgjithësi."[29]

Në lidhje me metodologjinë e ndjekur në këtë tefsir, mendojmë se vlerësimin më meritor e ka dhënë vetë autori në parathënie teksa sqaron e thotë: *"Edhe njëherë dua të potencoj, se metodologjia ime e ndjekur në këtë tefsir është bashkimi në mes tefsirit tradicional dhe atij racional".*[30]

Rreth kësaj metodologjie Imam Vehbe Zuhajli vazhdon e thotë: "Metodologjia ime hulumtuese në këtë studim mund të përkufizohet në sa vijon:

1. *Ndarja e ajeteve kuranore në njësi tematike, me emërtime të qarta;*
2. *Sqarim i përgjithshëm se çfarë përmban çdo sure;*
3. *Sqarim i aspektit të terminologjisë gjuhësore;*
4. *Cekja e shkaqeve të zbritjes, duke përzgjedhur transmetimet më të sakta dhe lënien mënjanë të atyre të dobëta, duke ndriçuar me këtë rast shumë prej rrëfimeve pejgamberike dhe të ngjarjeve më madhështore të Islamit si beteja e Bedrit, ajo e Uhudit etj., të cilat i kam përcjellë nga librat më afirmative të Sires;*
5. *Komentimi dhe sqarim i thukët;*
6. *Dispozitat, urtësitë dhe porositë që nxirren nga ai grup ajetesh;*
7. *Aspekti retorik dhe gramatikor i ajeteve kuranore, të cilët do ta ndihmojnë lexuesin në sqarimin e kuptimeve, larg terminologjive të komplikuara,* etj.[31]

[29] *Et-Tefsiru-l Munir*, vëll. I, f. 9-10.
[30] *Et-Tefsiru-l Munir,* vëll. I, f. 6.
[31] *Et-Tefsiru-l Munir*, vëll. I, f. 12.

Dr. Vehbe Zuhajli, vazhdon më tutje duke sqaruar segmente të metodologjisë që do të përdorte si shtesë në këtë tefsir, duke thënë: *"Do të jem i vëmendshëm që t'i përkushtohem, për aq sa mundem, edhe tefsirit tematik, duke sjellë shumë prej ajeteve kuranore që flasin për tematika të ndryshme si xhihadi, dispozitat e trashëgimisë, të martesës, të kamatës dhe alkoolit. Po ashtu do të sqaroj, sapo të më jepet rasti i parë ngjarjet e pejgamberëve si Ademi, Nuhu, Ibrahimi a.s. dhe të tjerë, pastaj rrëfimin e Musait a.s. me Faraonin"* etj.[32]

Ndërkohë, ne, për të qenë sa më korrekt dhe besnik, në përcjelljen e amanetit shkencor, do të sjellim metodologjinë dhe mënyrën e komentimit të dr. Vehbe Zuhajlit, në formë të shkurtuar, duke marrë për bazë një sure të shkurtër të Kuranit famëlartë, të cilën ai e ka komentuar, më saktësisht suren *"En-Nasr"*:

Vehbe Zuhajli që në fillim shënon se kjo sure është zbritje medinase dhe ka gjithsej 3 ajete.

Pas kësaj flet për **"arsyen e emërtimit"** të kësaj sureje me emrin *"En-Nasr"* dhe thotë:*"Kjo sure është quajtur "En-Nasr", për shkak se ka filluar me përmendjen e fjalës 'En-Nasr', qysh në ajetin e parë të saj, që nënkupton çlirimin më të madh, fitoren, ngadhënjimin madhështorë, i cili njihet edhe si çlirim i çlirimeve (fitorja më e madhe ndër fitoret), e që ndërlidhet me çlirimin e Mekës fisnike."*

Zuhajli, ashtu siç ka vepruar rëndom, në të gjitha rastet, kur një sure ka edhe një emërtim të dytë, të tretë apo edhe më shumë, shënon se: *"Kjo sure në mesin e dijetarëve njihet edhe me emërtimin: "Suretu Tevdi'ë"*, apo *"Surja e lamtumirës"*.

Pas kësaj fillon nënkapitullin tjetër: **"Lidhja e kësaj sureje me atë paraprake",** në këtë rast, me suren *"El-Kafirun"*, dhe thotë: *"Pasi që Allahu në fund të sures paraprake, në njoftoi se feja në të cilën fton i Dërguari i Allahut, ndryshon plotësisht nga feja e jobesimtarëve, e njoftoi atë se "feja" e tyre do të zhduket, kurse feja e tij do të lartësohet dhe do të ngadhënjejë, në kohën e çlirimit apo ngadhënjimit të madh. Feja e tij, do të bëhet feja e shumicës dhe kjo nënkupton mirësinë e Allahut ndaj të Dërguarit të Tij, duke e fuqizuar me fitore e çlirim dhe përhapje të*

[32] Po aty, vëll. I, f. 13.

Islamit, si dhe hyrjen e njerëzve në fenë e Allahut, turma-turma. Po ashtu, thekson Zuhajli, *në këtë sure ka shenjë se të Dërguarit të Allahut i është afruar exheli (vdekja) i tij."*

Pas kësaj, Zuhajli flet në pika të shkurtra, se **"Çfarë përmban kjo sure"** nga tematikat dhe thotë: *"Kjo sure që konsiderohet medinase, me unanimitet të dijetarëve, jep shenjë-dëfton për çlirimin e Mekës dhe nga-dhënjimin e Pejgamberit a.s. ndaj idhujtarëve, si dhe për përhapjen e Islamit në krejt Siujdhesën Arabike. Kjo nënkupton mposhtjen e errësirës së idhujtarisë-shirkut dhe njëkohësisht njoftim alegorik se i është afruar fundi i jetës së të Dërguarit a.s., prandaj e urdhëron që ta madhërojë Allahun, ta falënderojë dhe të bjerë isftigfar."*

Në vazhdim, Zuhajli, flet për **"Vlerën e kësaj sureje",** dhe sjell disa hadithe nga i Dërguari i Allahut apo edhe fjalë të sahabëve, për të dëshmuar apo argumentuar për vlerën dhe rëndësinë e saj. Ai përcjell në këtë rast një transmetim nga Ibën Abasi, i cili e kishte pyetur Ibën Utben: *"A e di se cila sure ka zbritur e fundit, komplet, nga Kurani?"*, në çka ai i qe përgjigjur surja: *"Idha xhae nasrullahi vel fet'h"*, kurse Ibën Abasi i kishte thënë: *"E the të vërtetën"*.

Zuhajli gjatë komentimit të sureve, ka sjellë një apo më shumë transmetime të tilla për vlerën e sureve, duke u përpjekur të klasifikonte transmetimet e vërteta nga ato të dobëta.

Pas këtij nëntitulli, vjen sqarimi për **"Shkakun e zbritjes"** së sures në fjalë dhe sjell një transmetim nga Buhariu dhe të tjerët, e këta nga Ibën Abasi, i cili tregon se një ditë Omeri r.a. i kishte tubuar veteranët e Bedrit në një ndejë dhe i kishte pyetur për komentin e kësaj sureje. Ata kishin dhënë një version të tyre, kurse Ibën Abasi, ndonëse i njomë në moshë, kishte thënë se kjo sure e tregon exhelin (vdekjen) e Resulullahit s.a.v.s., mendim të cilin pastaj e kishte përkrahur edhe vetë Omeri r.a.

Pastaj në vazhdim të komentimit, ai i cek dy mendime të dijetarëve se kur ka zbritur saktësisht kjo sure, njëri që thotë se ka zbritur para çlirimit të Mekës, si premtim i Allahut ndaj të Dërguarit të Vet dhe i dyti që thotë se kjo sure ka zbritur 70 ditë para vdekjes së Resulullahit s.a.v.s., dhe për këtë arsye njihet edhe me emrin "*Surja e lamtumirës (Et-Tevdië)"*.

Pas përfundimit të këtyre nëntitujve, ai fillon me **"Komentim të zgjeruar",** duke dhënë në këtë rast edhe një titull për temën *"Çlirimi i Mekës"*. Në këtë rast i kemi tri ajete, apo suren si tërësi që shtjellon segmente të çlirimit të Mekës, si ngjarje kulminante e asaj kohe.

Zuhajli, së pari u qaset këtyre ajeteve nga **"Aspekti i analizës gramatikore",** për të vazhduar me **"Aspektin retorik",** që synojnë ajetet e kësaj sureje. Pas kësaj sqaron **"Kuptimet e fjalëve"** në mënyrë të mrekullueshme dhe të qartë, për të hyrë më në fund në komentim të thukët e gjithëpërfshirës, për secilin ajet veç e veç. Zaten, këtu shihet afiniteti i këtij dijetari të madh, i cili komentimin e bën me një stil të shkëlqyeshëm dhe të lehtë, për ta kuptuar lexuesit apo studiuesit, pa përdorur fjalë të mëdha me alegori dhe me shumëkuptimësi.

Pasi e përmbyll komentimin e tërësishëm të sures, në radhë vjen ajka e tërë kësaj, në kapitullin: **"Porosia-urtësia dispozitive e këtyre ajeteve"** ku ndër të tjera radhit të gjitha urtësitë dhe porositë që mund të nxirren nga ajete e kësaj sureje, qofshin ato edhe dispozita juridike. Sa për ilustrim, do ta sjellim vetëm njërën prej këtyre urtësive, ku ai thotë: *"Allahu xh.sh. këtë mirësi të madhe (çlirimin e Mekës) e përcolli me një mirësi tjetër edhe më të madhe, hyrjen e fiseve arabe në fenë e Allahut, turma-turma..."*[33]

Aspekti akaidologjik në tefsirin e Vehbe Zuhajlit

Vehbe Zuhajli në tefsirin e tij, ndoqi rrugën *e Ehli Sunetit dhe Xhematit*[34] nga aspekti akaidologjik, duke qenë parimor në këtë drejtim, pa treguar asnjë dozë fanatizmi medhhebor apo ideologjik.

Vetë emërtimi i tefsirit të tij: *"Et-Tefsiru-l Munir fi-l akideti ve-shsheriati vel menhexh",* tregon se ai në të, ia ka kushtuar një pjesë të konsiderueshme edhe aspektit akaidologjik. Sa për të ilustruar edhe këtë segment të rëndësishëm të tefsirit të Zuhajlit, ne do të sjellim disa shembuj praktikë, për të konfirmuar parimet dhe idetë e tij akaidologjike.

---

[33] Për më gjerësisht, shih: *Et-Tefsiru-l Munir*, vëll. XXX, surja *En-Nasr*, ff. 846-854.

[34] Ehli Suneti dhe Xhemati ne aspektin akaidologjik konsiderohen Esh'arinjtë dhe Maturidinjtë.

Një rast, ku ai e shpreh mendimin e vet në aspektin akaidologjik është gjatë komentimit të ajeteve *1-2* të sures *"Ibrahim": **"Elif Lâm Râ. Këtë Libër ta kemi shpallur ty** (o Muhamed), **për t'i nxjerrë njerëzit, me lejen e Zotit të tyre, nga errësira në dritë, në rrugën e të Plotfuqishmit, të Denjit për çdo lavd, Allahut, të Cilit i përket gjithçka që gjendet në qiej dhe në Tokë...",*** thotë: *"Të Allahut janë çka ka në qiej e në Tokë, qoftë mbret, rob, gjë e shpikur apo e krijuar. Kjo argumenton se Allahu i Madhërishëm, nuk kufizohet në asnjë mënyrë me anë-drejtim të lartësisë, sepse çdo gjë mbi ty, llogaritet qiell. E meqë çdo gjë që është në qiej është pronë dhe është nën sundimin e Tij, atëherë Ai është i zhveshur nga të pozicionuarit lart, në anë apo drejtim"*[35]

Dr. Vehbe Zuhajli edhe kur komenton ajetet në të cilat përmenden cilësi ngjasuese të Allahut xh.sh., me krijesat, mban qëndrim të rreptë, ndaj ngjasuesve dhe antropomorfistëve, duke mbrojtur fuqishëm parimet e Ehli Sunetit dhe duke e zhveshur Allahun nga çdo shëmbëllim a përngjasim. Një gjë të tillë e shohim derisa e komenton ajetin e 10 të sures *"El-Fet'h"*: ***"Dora e Allahut është mbi duart e tyre!"***, ku ai fillimisht, besatimin dhënë Resulullahit s.a.v.s. në Hudejbije, për të luftuar kundër kurejshëve, e komenton si besatim dhënë Allahut xh.sh. Ai vazhdon e thotë: *"Allahu është shumë mirë i informuar për realitetin e besatimit të tyre dhe për këtë i ka shpërblyer me të mira. Andaj, Dora e Tij (Bujaria e Tij) në shpërblim është shumë më e madhe, sesa përmbushja nga ana e tyre e detyrimeve fetare; bamirësia e Tij, duke i udhëzuar në rrugën e drejtë është shumë më e madhe sesa vetë bindja dhe dëgjueshmëria e tyre ndaj Allahut; mirësitë e Allahut ndaj tyre janë më të mëdha në krahasim me aktin e besatimit të tyre; edhe fuqia e Allahut dhe ndihma e Tij, është mbi fuqinë dhe ndihmën e tyre."*

Fare në fund, Zuhajli e përkufizon tërë këtë çështje me sa vijon: *"Qëndrimi i "selefit", (kënaqësia e Allahut qoftë mbi ata) është: Besimi në kuptimin tekstual-sipërfaqësor të asaj që quhet "Dorë" e Allahut, duke besuar fuqishëm se i Lartëmadhërishmi është i pastër dhe i zhveshur nga çdo lloj përngjasimi apo shëmbëllimi me krijesat, me cilësitë e trupave, apo pohimin e gjymtyrëve (organeve) për Të. Ata thonë: Me të vërtetë,*

[35] *Et-Tefsirul-Munir*, vëll. XIII, f. 222.

njohja e realitetit të "Dorës", është pjesë e njohjes së vetë Qenies, e njeriu, nuk ka mundësi (ta kuptojë) një gjë të tillë. Prandaj, për sa i përket njohjes së realitetit të Qenies së Allahut, më prioritare është autorizimi i dijes tek Allahu i Lartësuar (për këtë çështje), duke besuar me plot bindje në çdo gjë që ka ardhur në Kuran dhe në Sunet (rreth kësaj). Ndërsa qëndrimi i dijetarëve të mëvonshëm "helefit", është se, këtu, "Dora" duhet të sqarohet dhe të kuptohet si forcë, fuqi, ngadhënjim apo mirësi, nga aspekti metaforik (alegorik) i asaj që është synuar."[36]

Dhe në fund, do ta sjellim edhe shembullin e tretë, kur ai e komenton ajetin e 16-të, të kaptinës "El-Mulk": ***"A jeni të sigurt prej Atij që është në qiell...",*** dhe thotë: *"Ngjasuesit nëpërmjet këtij ajeti kanë argumentuar se Allahu ka (zë) vend dhe ai është qielli, por Rraziu u është përgjigjur të tillëve se nuk ka mundësi që ky ajet të komentohet vetëm tekstualisht apo nga kuptimi i jashtëm, sipas pajtimit unanim të dijetarëve myslimanë. Të "vendosurit" e Allahut në qiell, nënkupton se ky qiell duhet ta përthekojë (rrethojë) Atë nga të gjitha anët, kështu që në këtë rast Allahu do të mbetet më "i vogël" se qielli, e dihet se qielli është shumë më i vogël sesa Arshi, e kjo nënkupton se Allahu duhet të jetë më i vogël se Arshi, dhe natyrisht një gjë e tillë është e pamundur për Allahut, sipas unanimitetit të myslimanëve, aq ma parë kur dihet se Arshi është krijesa më e madhe në qiell e në tokë... Prandaj, këtë ajet nuk duhet kuptuar tekstualisht dhe sipërfaqësisht, por duhet sqaruar e komentuar sipas te'vilit, e kjo nënkupton këtë domethënie të ajetit:* ***"A jeni të sigurt prej*** *(pushtetit, sundimit dhe fuqisë së)* ***Atij që është në qiell...".*** *Qëllimi i përmendjes së qiellit, këtu është për madhërim dhe shfaqje të fuqisë e të pushtetit absolut të Tij, ashtu siç ka ardhur në Kuran:* ***"Ai është Allahu*** *(i adhuruar)* ***në qiell e në tokë",*** *ndërkohë që dihet se një gjë, është e pamundur të jetë njëkohësisht në dy vende!"*[37]

[36] *Et-Tefsirul-Munir*, vëll. XXVI, ff. 490-491.
[37] *Et-Tefsiru-l-Munir*, vëll XXIX, f. 29.

Çështje të jurisprudencës (fikhut) në tefsirin e Vehbe Zuhajlit

Ndonëse nga një pjesë e madhe e analistëve, tefsiri i Zuhajlit karakterizohet më shumë si tefsir edukativo-social, megjithatë, ai pos tjerash, në këtë tefsir, një hapësirë të mjaftueshme ia ka kushtuar edhe shtjellimit të dispozitave juridike të fikhut dhe të usuli fikhut.

Ndonëse Zuhajli i takonte shkollës juridike hanefite, ai në asnjë rast, nuk e ka shfaqur ndonjë anim a fanatizëm në këtë medhheb, gjatë komentimit të ajeteve dispozita. Madje, këtë mos animin të tij në ndonjërin prej medhhebeve, qoftë juridik, qoftë akaidologjik, e shpreh në parathënie kur thotë: *"Në tërë atë që e kam shkruar, jam përpjekur që asnjëherë të mos bie nën ndikimin e ndonjë ideologjie, medhhebi (juridik) apo akaidologjik, apo të ndonjë ideologjie të mëhershme, por prijësi im që më udhëheq, është vetëm e vërteta në të cilën udhëzon Kurani fisnik, në përputhje me natyrën e gjuhës arabe, terminologjinë sheriatike, duke sqaruar mendimet e dijetarëve dhe tefsirologëve, me përgjegjësi, me përpikëri dhe larg çdo fanatizmi."*[38]

Në këtë tefsir, kur ka sqaruar disa ajete nga aspekti juridik, është mbështetur në veprën e Xhessasit: *"Ahkamul-Kuran"*, si dhe në tefsirin e Kurtubit, që i përkiste medhhebit malikij. Ky fakt, tregon më së miri, se Vehbe Zuhajli nuk ishte fare i ngarkuar në baza medhhebore, por lirisht mund të themi se metodologjia e tij në shtjellimin dhe komentimin e ajeteve të dispozitave ka qenë metoda krahasimtare në mes medhhebeve juridike.

Aspekti juridik në këtë tefsir, është një prej pikave më të ndritshme, sepse Zuhajli, ishte një prej dijetarëve më të mëdhenj të botës islame në lëmin e fikhut, për çka dëshmojnë mbi 30 vepra të shkruara në këtë lëmi. Madje, ai në parathënien e tefsirit të tij, thotë: *"Nuk kisha guxim t'i hyj punës në këtë tefsir, përveç pasi që përfundova dy vepra apo enciklopedi të mëdha: "Usul el fikh el islami" në 2 vëllime dhe "El-Fikhu-l Islami ve edil-letuhu" në 11 vëllime."*[39]

---

[38] *Et-Tefsiru-l-Munir*, vëll. I, f. 11

[39] *Et-Tefsirul-Munir*, vëll. I, f. 14; .Shih edhe: *Ez-Zuhejli ve xhuhudihi en-nahvije fi kitabihi "Et-Tefsirul-Munir" - Dirasetun vasfije tahlilije"*, f. 21.

Zuhajli në tefsirin e tij nuk i ka shtjelluar të gjitha çështjet e fikhut, sepse një gjë të tillë e ka shtjelluar deri në detajet më të imta, në librat e tij të shkruara në lëmin e fikhut, por i ka komentuar më sipërfaqësisht, duke përzgjedhur mendimet më të pranuara nga të gjitha shkollat juridike, në bazë të argumenteve.

F.v., një shembull të tillë e kemi gjatë komentimit të ajetit 108, të sures *"Et-Tevbe"*: ***"Aty ka njerëz që duan të pastrohen, e Allahu i do të pastrit."***

Zuhajli, fillimisht i sjell argumentet e fukahave, rreth qëllimit të synuar me fjalën "pastrim", nëse pastrimi këtu nënkupton pastrimin fizik të rrobave dhe trupit, i cili nuk mund të arrihet ndryshe veçse me abdest, larje apo tejemum, ose me ujë, pas kryerjes së nevojës së madhe, apo nënkuptohet pastrimi shpirtëror, që nënkupton pastrimin nga gjynahet. Pas paraqitjes së këtyre mendimeve, Zuhajli thotë: *"Kuptimi i të pastruarit fizik është mendim i shumicës dërmuese të mufesirëve"*, e pastaj i cek edhe tre mendimet e fukahave rreth heqjes së papastërtisë:

1. *Largimi i papastërtisë është farz sipas Imam Shafiut, Imam Ahmedit dhe Imam Malikut, andaj nuk lejohet falja e namazit me rrobë të ndyrë.*
2. *Nëse papastërtia në rrobë është sa sipërfaqja e një dërhemi (monedhe metalike e asaj kohe), ai namaz duhet të përsëritet. Ky është mendimi i Imam Ebu Hanifes dhe i Imam Jusufit,* dhe
3. *Largimi i papastërtisë nga rrobat dhe nga trupi është sunet e jo farz. Ky është një mendim tjetër i Imam Malikut dhe pasuesve të tij.*

Krejt në fund, Zuhajli e përmend edhe mendimin e Kurtubiut i cili ka thënë se mendimi i parë është më i sakti, që tërthorazi nënkupton se edhe Zuhajli e përkrah atë mendim.[40]

Sa për ilustrim, do të sjellim edhe një shembull tjetër të shtjellimit të një çështjeje, për të cilën fukahatë kanë mendime të ndara. Fjala është për faljen e namazit të xhumasë në ditën e Bajramit: nëse duhet të falet edhe xhumaja, apo mjafton vetëm hytbja e Bajramit për atë ditë. Zuhajli thotë: "Xhumaja, duhet të falet patjetër, në ditën e parë të Bajramit, duke ku-

[40] *Et-Tefsirul-Munir*, vëll. XI, f. 52.

ndërshtuar kështu mendimin e Imam Ahmedit i cili ka thënë: *"Nëse i bie të bashkohen në një ditë Bajrami dhe xhumaja, atëherë falja e namazit të xhumasë si farz, bie, për shkak se hytbja e Bajramit i ka paraprirë asaj të xhumasë..."* Zuhajli, mendimin e Othmanit r.a. në të cilin është mbështetur Imam Ahmedi, e quan si mendim të vetmuar të tij."[41]

Qëndrimi i Vehbe Zuhajlit ndaj israilieteve

Ashtu siç është e njohur në shkencën e tefsirit, me emërtimin "israiliate" nënkuptohen të gjitha ato rrëfime hebreje, që nëpërmjet rrugëve të ndryshme të transmetimeve, kanë depërtuar nëpër librat e tefsirit. Natyrisht, pjesa dërmuese e këtyre transmetimeve janë të shpifura, e shumë pak prej tyre të besueshme. Në lidhje me këto transmetime, dijetarët kanë dhënë mendimet e tyre, por shumë pak prej tyre i kanë rezistuar kërshërisë për të mos i përmendur fare ato, të paktën edhe në mënyrë kritike.

Sa i përket Zuhajlit, ky ka një qëndrim të matur dhe të kujdesshëm ndaj këtyre transmetimeve hebreje, ndonëse në disa raste gjatë komentimit të disa ajeteve, sjell disa israiliate si dëshmi. F. v., një prej këtyre israiliateve, e sjell kur e komenton ajetin e 54-të, të sures *El-A'raf*: ***"Vërtet, Zoti juaj, Allahu është Ai që krijoi qiejt dhe tokën brenda gjashtë ditësh, pastaj qëndroi mbi Arshin..."***
dhe thotë: *"Allahu na ka njoftuar se Ai është Krijues i Gjithësisë, apo i krejt botëve, i qiejve dhe i shtatë tokave, dhe krejt çka ka në mes tyre, për gjashtë ditë, përveç të shtunës. Tërësia e tërë krijimit u përmbyll në ditën e xhuma, në të cilën u krijua edhe Ademi a.s., ndërkohë që ditën e shtatë, apo të shtunë, nuk pati krijim. Kjo ditë u quajt "Es-Sebt", që do të thotë shkëputje, ndërprerje, dhe tërë kjo që e thamë, vjen vetëm nga lajmet israilite"*[42] Në vazhdim të komentimit të këtij ajeti, Vehbe Zuhajli sqaron shkëlqyeshëm kuptimin e vërtetë, duke thënë se *"ajo që së pari mund të na vjen ndërmend është se këto ditë të krijimit, i ngjasojnë ditëve të javës që ne i kemi në këtë dynja. Por atëherë, nuk kishte diell, dhe as këto gjëra*

[41] *Et-Tefsirul-Munir*, vëll. XXVIII, f. 583.
[42] *Et-Tefsiru-l Munir*, vëll. VIII. f. 597. Shih edhe: *Menhexh Vehbe ez-Zuhejli fi tefsirihi lil Kuranil Kerim - Et-Tefsiru-l Munir,* f. 96.

të krijuara (ditët tona të javës, plotësim yni S.B.), *që erdhën në ekzistencë, pas krijimit të Tokës."* Për ta përforcuar tërë këtë, ai sjell mendimin e Muxhahidit dhe të Ahmed ibën Hanbelit se, *"çdo ditë* (nga ditët e krijimit, plotësim yni S.B.)*, është e barasvlershme me njëmijë vjet",* ashtu siç ka thënë Allahu xh.sh.: ***"... Një ditë te Zoti yt është sa njëmijë vet, si llogaritni ju." -*** *(El-Haxh-xh, 47).* Ndërsa sa i përket Ditës së Gjykimit, Allahu e përshkruan kështu gjatësinë kohore të saj: ***"Atje ngjiten engjëjt dhe shpirti*** *(Xhibrili)* ***në një ditë që zgjatë pesëdhjetë mijë vjet."*** *- (El-Mearixh, 4).*[43]

Për ta ilustruar sa më mirë qëndrimin e tij korrekt ndaj israiliateve dhe transmetuesve të tyre, do të sjellim edhe një shembull tjetër, kur e komenton ajetin e 107-të, të kaptinës *El-A'raf: **"Ai** (Musai)* ***e hodhi shkopin e vet, kur ja, u shfaq gjarpër i vërtetë.",*** dhe thotë: *"Nuk ka kurrfarë nevoje të lëshohemi në përshkrimin e gjarprit, të shkopit apo të dorës, më tepër se ç'kanë përshkruar ajetet kuranore, sepse për asnjë prej këtyre transmetimeve, nuk kemi një varg të besueshëm përcjellës, por që të gjitha janë rrëfime israiliate, të cilat i kanë ndërfutur* (në librat e tefsirit, vër. jonë S.B.) *disa njerëz të pandërgjegjshëm dhe aspak të përpiktë si hebreu Ka'b el Ahbari, dhe Vehb ibën Munebbihu, që ishte me prejardhje persiane.*[44] Pas këtyre fjalëve, Zuhajli thotë: *"Dihet mirë se nxitja e fitneve dhe turbullirave politike në fillim të përhapjes së Islamit, ka zanafillën te grupacioni sebeist (ithtarët dhe përkrahësit e ideve të çifutit, Abdullah ibn Sebe'e), si dhe disa grupacioneve persiane, të cilët kishin hyrë në Islam, me qëllim që ta shkatërronin atë përbrenda. Gjatë kësaj kohe u vra Omeri r.a. nga persiani Ebu Luëlue, i cili ishte dërguar si atentator i kamufluar dhe ishte pjesëtar i një grupi sekret nga Persia, ndërkohë që Othmani r.a. u vra nga ithtarët e Abdullah ibn Sebe'es."*[45]

Këta dy shembuj i sollëm sa për të dëshmuar qëndrimin e drejtë dhe korrekt ndaj dukurisë së israiliateve nga Vehbe Zuhajli, të cilat rrëfime, në të shumtën e rasteve janë të pabaza dhe i kanë rënduar pa të drejtë shumë prej veprave të tefsirit, si në të kaluarën, e fatkeqësisht disa prej

---

[43] *Et-Tefsiru-l Munir*, vëll. VIII, f. 598.

[44] *Et-Tefsirul-Munir*, vëll. IX, f. 40. Shih edhe: *Menhexh Vehbe ez-Zuhejli fi tefsirihi lil Kuranil Kerim Et-Tefsirul-Munir,* f. 96.

[45] *Et-Tefsirul-Munir*, vëll. IX, f. 40.

tyre edhe sot. Mund të konstatojmë, se vetëm në këto dy dekadat e fundit, ka filluar një frymë e re, që mëton t'i largojë përfundimisht nga tefsiri, këto rrëfime të trilluara, legjenda dhe mitologji, që në asnjë mënyrë nuk përkojnë e as nuk janë të denja, të jenë pjesë e komentimeve të Kuranit famëlartë. Neve na mjafton sqarimi i vetë Kuranit me Kuran, për ngjarjet e shtjelluara në të si dhe hadithet e Resulullahit s.a.v.s., që kanë ardhur si përforcim dhe detajizim të ndonjë prej këtyre rrëfimeve kuranore.

***

Përfundim

Dr. Vehbe Zuhajli, ishte ndër dijetarët e rrallë të kësaj kohe, që kontributin e punës së tij e shfaqi në lëmenj të ndryshëm të shkencave islame. Ai ishte një fekih-jurist me nam i kohës sonë, duke lënë pas vetes vepra të mëdha të fikhut dhe të usuli fikhut, të cilat sot e kësaj dite, vazhdojnë të jenë burime të pazëvendësueshme të literaturës shkencore, nëpër shumë katedra të fikhut të fakulteteve dhe universiteteve të botës islame. Përveç kësaj, ai është prej dijetarëve të rrallë në botën islame, që pas vetes la edhe tre tefsire madhështorë, si dëshmi e dhuntisë së dijes, që ia kishte dhuruar Allahu xh.sh. Tefsiri i tij *"Et-Tefsiru-l Munir"*, pa dyshim do të mbetet për një kohë të gjatë, si një prej burimeve parësore të shkencës së tefsirit, sepse stili i të shkruarit dhe metodologjia e ndjekur në të, nga Zuhajli, e bëjnë atë të kapshëm për të gjitha masat intelektuale.

Shpresoj që në të ardhmen, edhe te ne në trojet shqiptare, nga studiuesit-studentët në master dhe doktoraturë të fakulteteve islame, do të bëhen përpjekje që figura e dr. Vehbe Zuhajlit, po edhe e mufesirëve të tjerë, të ndriçohen dhe kontributi i tyre kolosal në lëmin e fjalës së shkruar, t'i ofrohet edhe lexuesit shqiptar. Mendoj se ky amanet dhe borxh ndaj tyre, duhet të përmbushet e jetësohet edhe nga ne shqiptarët!

Literatura:

- Dr.Vehbe Zuhajli , *Et-Tefsiru-l Munir*, Damask 2009.
- Dr. Vehbe Zuhajli, *Et-Tefsiru-l Vesit*, Damask-Bejrut, 2001.
- Dr. Vehbe Zuhajli, *Et-Tefsiru-l Vexhiz*, Damask-Bejrut, 1996.
- Muhamed Arif Ahmed Fari, *Menhexh Vehbe ez-Zuhajli fi tefsirihi li-l Kuranil Kerim - Et-Tefsiru-l Munir*, Aman, 1998.
- Muhamed Ali Ajazi, *El-Mufessirune, hajatihim ve menhexhihim*, Teheran, 1386 h.
- Muhamed Ibrahim Hasen Hamd, *Ez-Zuhajli ve xhuhudihi en-nahvije fi kitabihi "Et-Tefsirul Munir" - Dirasetun vasfije tahlilije*, Gazë - Palestinë, 2016.
- Dr. Bediu-Sejjid el-Lehham, *Vehbe Zuhajli - El-Alimu el fekihu el mufessiru*, Damask, 2001,
- Mensur Ebu Zineh, *Et-Tefsiru-l Munir li-z-Zuhajli - Dirase ve takvim*, revista *"Xhamiatu-n-nexhah li-l ebhath el ulum el insanije*, nr. 27 (10). Jermuk-Jordani, 2013.

Web faqe:

- http://www.alukah.net/culture/0/1721/#ixzz5Wa69Ajle
- http://darfikr.com/article
  نبذة-عن-السيرة-الذاتية-للدكتور-وهبة-مصطفى-الزحيلي-رحمه-الله
- https://syrianoor.net/article/214
- www.howiyapress.com/10290-2/
- http://www.feqhweb.com/vb/t21809.html#ixzz5WdstGE4k
- https://www.naseemalsham.com/ar/Pages.php?page=readTragm&pg_id=54251
- http://articles.islamweb.net/Media/index.php?page=article&lang=A&id=206125
- https://www.kuna.net.kw/articleDetails.aspx?id=1963608&language=ar

Sabri BAJGORA

WAHBAH AL-ZUHAYLI AND HIS TAFSIR AL-MUNIR

(Summary)

Wahbah al-Zuhayli is among the contemporary scholars, who left their mark in the field of religious sciences. He was a universal scholar most distinguished in the areas of Fiqh and Usul al-Fiqh. Nonetheless, he left his mark in other Islamic sciences as well. His greatest contribution was in the area of tafsir. He wrote three tafsirs which continue to be published throughout the Islamic world even nowadays: Tafsir al-Munir (16 volumes), Tafsir al-Waseet (3 volumes) and Tafsir al-Wajeez in the margins of the noble Qur'an (1 volume).

Tafsir al-Munir is without any doubt one of the best contemporary tafsirs, as it contains the whole matter of this science, including the method of traditional commentary as well as the rational one. Its style and methodology have made it likeable not only to the masses but to intellectuals and the academic world as well.

In Tafsir al-Munir, al-Zuhayli showed his deep religious knowledge. Tafsir al-Munir is a result of his intellectual commitment and as such it will continue to be the matter of study in the departments of tafsir of many faculties of Qur'anic studies throughout the world for a very long time to come.

صبري بايغورا

وهبة الزحيلي وتفسيره "التفسير المنير"

(خلاصة البحث)

ينتمي وهبة الزحيلي إلى مجموعة من العلماء المعاصرين الذين تركوا آثاراً لا تُمحى في مجال العلوم الدينية. كان عالماً متعدد الجوانب ، ولا سيما في مجال الفقه وأصول الفقه. ومع ذلك، لم يتخلف في العلوم الإسلامية الأخرى ، وبالتالي برز كعالم فقيه ومفسر. لقد قدم مساهمته العلمية العظيمة، بل لا نظير لها مقارنة لمعظم علمائه المعاصرين في علم التفسي، حيث كتب ثلاثة تفاسير ، والتي حتى يومنا هذا يتم إعادة طباعتها في جميع أنحاء العالم الإسلامي وهي: التفسير المنير ١٦ مجلدا، التفسير الوسيط ٣ مجلدات، والتفسير الوجيز على هوامش القرآن الكريم مجلد واحد.

ولا شك أن تفسيره "التفسير المنير" ينتمي إلى التفسير المعاصر الأكثر قبولا ، لأنه يشمل لُبَّ علم التفسير كله ، سواء في طريقة التفسير بالمأثور و كذلك بالمقعول المقبول. إن الأسلوب والمنهجية البحث في هذا التفسير جعلت هذا العمل، مقبولا ومرغوبا لدى العامة، وكذلك من قبل الأكاديميين والمفكرين.

من خلال صفحات تفسيره نرى لدى الزحيلي المعرفته الدينية العميقة ، وكثمرة كل هذا التفاني الفكري ، جاء هذا التفسير المعروف، والذي سوف يدرس لسنوات عديدة كمادة في فصول التفسير في جميع أنحاء العالم الإسلامي، في أقسام التفسير للعديد من كليات العلوم القرآنية.

Belkasim EL-GALI

NJOHJA E ALLAHUT, SIPAS MATURIDIUT (معرفة الله)*

Ky punim do të fokusohet kryesisht rreth Njohjes së Allahut, sipas Imam Maturidiut, njërit prej themeluesve të Shkollës akaidologjike të Ehli Sunetit.

1. KËNDVËSHTRIMET E NDRYSHME

Çdo kush që dëshiron të hulumtojë argumentet rreth ekzistencës së Krijuesit, detyrimisht duhet të fillojë nga një çështje parësore, e që është: Vërtetimi i ekzistencës së Krijuesit, a është diç e mundshme apo është e pamundshme!? Pastaj, mendja njerëzore, a ka apo nuk ka kapacitete të mjaftueshme për të shkuar deri te njohja e Krijuesit të Lartësuar!? E, nëse njohja nuk mund të vërtetohet nëpërmjet mendjes, atëherë, a është e mundur që një gjë e tillë, të arrihet nëpërmjet "dëgjimit" - argumenteve fetare. Dhe, nëse nuk mund të arrihet vetëm me njërën prej tyre, a ka mundësi që të arrihet, nëpërmjet të dyjave, bashkërisht!?

---

* Pjesë nga libri, Dr. Belkasim El-Gali, *Ebu Mensur El-Maturidij hajatuhu ve arauhu el-akadijjetu*, Daru't-turkij lin-neshri, Tunis, 1989. Dr. Belkasim El-Gali, është një prej studiuesve më eminentë bashkëkohorë të apologjetikës islame.

Rreth kësaj çështje akaidologjike, ekzistojnë pikëpamje e mendime të ndryshme te fraksionet islame dhe te mendimtarët e tyre. Madje, këto divergjenca të tyre, ndonjëherë mund t'i vëresh te i njëjti dijetar, gjersa, në disa libra pohon se njohja e Allahut, është çështje mbi bazën e argumentimit deduktiv (إستدلالية), në disa të tjera konsideron se njohja e të Lartëmadhërishmit është një "nevojë e detyrueshme" (ضرورية). E, përtej kësaj, ka edhe pikëpamje të tjera, që thonë se njohja e Allahut mund të arrihet përmes inspirimit (إلهام), madje disa shkolla të fraksionit shiit, siç janë ismailitët, thonë se njohja e Krijuesit mund të arrihet vetëm mbi bazën e prijësit të tyre (imamit).

1.1. Aspekti logjik mbi njohjen e Allahut

Në krye të këtyre fraksioneve kelamiste qëndrojnë mu'tezilët, të cilët deklarojnë se të gjitha dispozitat e shpalljes së Allahut, mund të vlerësohen vetëm pas njohjes së Allahut, e njohja e Allahut, nuk mund të arrihet ndryshe, veçse me vrojtim logjik (النظر), prandaj, vrojtimi është prej atyre detyrimeve parësore për personin madhor (mukel-lef). Abdu'l Xhebbar, duke e sqaruar këtë çështje, thotë: Nëse dikush të pyet: Cila është ajo, që Allahu ta ka bërë detyrim parësor, thuaj, vrojtimi logjik, që shpie në njohjen e Allahut të Madhërishëm, sepse i Lartëmadhërishmi nuk mund të njihet, si nevojë e detyrueshme, e as përmes shikimit[1], edhe për faktin se sikur "njohja" e Allahut të ishte "nevojë e detyrueshme", atëherë njerëzit nuk do të kishin divergjenca në këtë çështje, siç nuk kanë dallime në asnjërën prej nevojave njerëzore apo aksiomave logjike, si, për shembull, nata është e errët, dita është e ndritshme, pastaj, njëshi është gjysma e dyshit, tërësia është më e madhe se pjesa, etj.

Natyrisht, ka edhe shumë këndvështrime të tjera në nivel të njerëzimit. Përveç atyre që e besojnë Allahun, ka edhe të atillë që e mohojnë ekzistencën e Krijuesit, siç janë natyralistët dhe materialistët, për gjatë periudhave të ndryshme kohore.

Abdu'l Xhebbari, akoma më shumë e sqaron këtë çështje. Ai thotë se sikur njohja e Allahut, të trajtohet si nevojë e detyrueshme (ضرورية), do të

[1] El-Kadi Abdu'l Xhebbar, *Sherhu'l usuli'l hamseti*, fq.39.

ishte e pamundur mohimi i saj nga shpirti, në bazë të një dyshimi të thjeshtë apo dileme, prandaj nuk është e tillë.[2]

Në nën tjetër, mu'tezilët, konsiderojnë se personi madhor (mukel-lef), kur e arrinë pjekurinë logjike, duhet pasur frikë, që mos të anashkalojë vrojtimin logjik. Esenca e kësaj frike, ka të bëjë me atë që e dëgjon ai edhe prej divergjencave të njerëzve, e të cilat, kanë bërë që ata të akuzojnë njëri-tjetrin për devijim prej rrugës së drejtë, duke marrë si referencë traditën dhe imitimin dhe aspekte të tjera nga padija, për sa kohë që nuk kanë të bëjnë asgjë me imanin e drejtë.

Mu'tezilët parashtrojnë pyetjen: A nuk ishte dyshimi prej atyre detyrave parësore, pa të cilin nuk mund të plotësohet vrojtimi? Ata përgjigjen me mohim dhe, konsiderojnë se dyshimi e sfidon të vërtetën, gjersa njeriu e braktisë vrojtimin dhe argumentimin.

Në këtë mënyrë, mutezilët kanë hapëruar tej mase në këtë çështje, duke i besuar arsyes më shumë se sa duhet. Bile, këtë diskurs, më së miri e ka artikuluar, Ebu Hashim El-Xhub-bai, i cili thotë: "Kush nuk e njeh Allahun me argument, ai është mosbesimtar (kafir), sepse e kundërta e njohjes është mosnjohja, e mosnjohja është mosbesim".[3] Ai, sqaron se si mu'tezile ka arritur në polemizime logjike, të cilat kanë bërë që ta konceptojnë Krijuesin sipas kapaciteteve të mendjes dhe kështu, kanë përfunduar në fushën e filozofisë, e që shpesh herë, nuk i janë përmbajtur kuptimeve adekuate që i përkasin madhërisë së Allahut.

1.2. Aspekti tradicional mbi njohjen e Krijuesit

Përballë qëndrimit të mu'tezilëve, që i dhanë hapësirë të tepruar mendjes, vjen qëndrimi i fraksionit *hashvijeh*, të cilët, duke u kapur vetëm për tekstin (Kur'an dhe Hadith), konsiderojnë se "njohja e Allahut", nuk është fare punë për mendjen, sepse hulumtimi i realitetit të Qenies së Krijuesit, është tejkalim i limiteve njerëzore, që i ka vendosur vetë i Dërguari i Allahut, përmes inspirimit, me thënien e tij:

---

[2] El-Kadi Abdu'l Xhebbar, *Sherhu'l usuli'l hamseti*, fq.49.

[3] *Sherhu'l usuli'l hamseti*, fq.49; *El-Muhit bi't-teklif,* fq.30-31.

"Meditoni në krijesat e Allahut, e mos meditoni në vetë Qenien e Allahut, e të shkatërroheni."[4] Çdo shtim tjetër, do të nënkuptonte angazhim të madh e shumë lodhje, për të arritur shumë pak dije. Atëherë, pse kjo përpjekje e kotë, veçanërisht, kur argumentet e shkëlqyera në këtë fushë janë shumë të pakta, pavarësisht se janë si ajo thënia mbi pozitën e arit të pastër kundrejt thesarit të tërësishëm apo e margaritarit kundrejt të tjerëve!?

Ibni Ruzhdi, i ka cilësuar si grupe të humbura, pasiqë të tillët i kanë devijuar synimet e fesë, e cila kërkon prej njeriut fetar, që të bëjë vrojtim dhe meditim në krijesat e Allahut, si dhe soditje në ato. Në lidhje me ata, Ibni Ruzhdi, thotë: Nëse has në ndonjë grup, që nuk i shfrytëzojnë mendjet e tyre për njohjen e ekzistencës së Krijuesit, atëherë, ata nuk janë duke besuar ndryshe, veçse sipas një mënyre që ata vetë e kanë zgjedhur (e pëlqejnë)."[5] Dhe, nuk përjashtohet mundësia, që ajo mënyrë të ketë ngjashmëri me atë të fraksionit *Hashvijeh,* ashtu që, mundësia e njohjes së Allahut përmes dëgjimit, pra ajo që ka ardhur në Kur'an dhe Sunet, nuk lë mundësi për aspekte të tjera. Sipas tyre, imani, qëndron mbi çështjen parësore, e ajo është ekzistenca e Zotit. Prandaj, kur njeriu beson në Allahun, rrjedhimisht beson edhe në tekstet, që flasin për këtë besim apo që japin indikacione, edhe për faktin se vërtetimi i teksteve argumentuese të Kur'anit, në fakt është vërtetim i Krijuesit ashtu siç është pozita e dispozitës në raport me përmbajtjen e saj.

---

[4] Transmeton imam Sujutiu në *El-Fet'hu'l Kebir*. Po ashtu, Taberaniu në *El-Evsat*; Bejhekiu në *Esh-Sha'bu*, me transmetim nga Ibni Umeri, në verzionin:
تَفَكَّرُوا في آلاءِ اللهِ ، و لا تَفَكَّرُوا في اللهِ - "*Meditoni në krijimin e Alahut, e mos meditoni në Allahun!*" Ndërsa, Taberaniu, në *El-Evsat*, nga Ibni Abbasi e transmeton me verzionin:
تفكروا في خلق الله و لا تفكرو في الخالق فإنكم لا تقدرون قدره - "*Meditoni në krijimin e Allahut, e mos meditoni në Allahun, sepse, ju, vërtetë nuk keni mundësi që ta perceptoni madhështinë e Qenies së Tij!*". Këtë hadith e transmetojnë edhe nga Ebu Hurejra, në verzionin:
تفكروا في خلق الله و لا تفكروا في الله - "*Meditoni në krijimtarinë e Alahut, e mos meditoni në Allahun!*"

[5] Ibni Rushd, *Menahixhu'l edil-leti*, fq.11, 135.

1.3. Aspekti harmonizues në mes tradicionales dhe racionales

Disa prej esh'arinjëve janë dakorduar me mu'tezilën në këtë çështje mjaft të rëndësishme, e që është fakti se njohja e Allahut është çështje e mendjes.[6] Is'hak El-Isfirajini, ashtu sikurse edhe shumica e mu'tezilëve, mendon se prej detyrimeve parësore është vrojtimi rreth njohjes së Allahut, ndërsa Ibën Furek dhe El-Xhuvejni, mendojnë se është akti i synimit që shpie në vrojtim.[7] Pjesa dërrmuese e esh'arinjëve, vërtetojnë se njohja e Allahut vërtetohet me shpallje (الشرع), nëpërmjet metodës së argumentimit dhe vrojtimit. El-Kadi El-Bakilaniju, thotë: E para gjë, me të cilën, Allahu i ka obliguar robërit e Tij, është vrojtimi në argumentet e Tij dhe argumentimi i ekzistencës së Tij, duke soditur gjurmët e fuqisë së Tij, sepse, i Lartëmadhërishmi nuk njihet përmes imponimit dhe as që shihet me shqisa, por ekzistenca e Tij, sipas madhështisë së veprimeve të Tij, pra me argumente të qarta dhe të padiskutueshme.[8]

Çështja që e obligon vrojtimin dhe meditimin është vetë përmbajtja e shpalljes, e demonstruar në tekstet e Kur'anit, Sunnetit dhe Ixhmait (konsenzuesit të dijetarëve). Ebu Hamid El-Gazalij, konsideron se shpallja dhe mendja e përforcojnë njëra-tjetrën, ashtu që shpallja është mendje nga ndërveprimi i jashtëm, e mendja është shpallje nga ndërveprimi i brendshëm.[9] Ai, në këtë aspekt, i sjell disa shembuj të lidhjes në mes të shpalljes dhe mendjes, në librat e tij, e ne do t'i përmendim ato që i kemi gjetur në dy librat e tij, "Mearixhu'l kudus" dhe në librin tjetër "Xhevahiru'l Kur'an". Gazaliu thotë: Mendja nuk mund të udhëzohet, përveçse me shpallje, ndërsa shpallja nuk mund të qartësohet, përveçse me mendje. Mendja është sikurse themeli, ndërsa shpallja sikurse ndërtesa, nuk kanë vlerë themelet, gjersa nuk ka ndërtesë dhe, nuk mund të qëndrojë ndërtesa, nëse nuk ka themele. Po ashtu, mendja është sikurse shikimi, e shpallja sikurse rrezja (drita) dhe, nuk do të shfaqej rrezja, gjersa nuk ekziston

---

[6] El-Ixhij, *El-Mevakif*, vëll.3, fq.153; Shih: Sulejman Dunja, *Muhamed Abduhu*, vëll.1, fq.212; Po ashtu shih: Mahmud Kasim, *Menahixhul edil-leti*, fq.11.

[7] Po aty.

[8] El-Bakilanij, *El-Insaf fima jexhibu i'tikaduhu ve la jexhuzu el-xhehlu bihi*, fq. 22.

[9] El-Gazalij, *Mearixhul kudus fi medarixhi marifetin-nufus*, fq.60.

shikimi. Mendja është sikurse kandili, e shpallja sikurse vaji, gjersa nuk ka kandil, as vaji nuk jep dritë.[10]

Gazaliu, që është quajtur edhe "Huxh-xhetul Islam" (Argument i fesë Islame), njohjen e Allahut, e demonstron dhe përmes shembullit të arit të pastër ose squfurit të kuq, në kontekst të njohjes së Qenies së Allahut, njohjes së Cilësive dhe njohjes së Veprimeve të Tij. Këto tri aspekte i sqaron, duke analizuar xhevahirin, i cili është disa llojesh, i kuqërremtë, i errët dhe i verdhë. Ndonjëri prej tyre është më i theksuar se sa tjetri, përafërsish kështu janë edhe këto tri njohjet, e të cilat nuk janë të një kategorie. Pa dyshim, më dominantja e tyre është "njohja e Qenies së Vërtetë", që në këtë rast është xhevahiri i kuqrremtë, pastaj vjen "njohja e Cilësive", që është xhevahiri më i errët, e pastaj vjen "njohja e veprimeve", e që simbolizohet me xhevahirin e verdhë. Prandaj, ashtu sikurse këta xhevahirë, që disa prej tyre janë më madhështorë dhe më dominantë për nga qenësia e tyre, dhe kjo vërehet lehtësisht, ngjashëm është edhe "njohja e Qenies" kundrejt njohjeve të tjera, e që është shumë e limituar për nga aspekti i mundësisë, shumë e vështirë nga aspekti i arritjes dhe shumë e lartë për nga vrojtimi.[11]

Gazaliu i ka radhitur këto tri njohje të Qenies së Allahut, në kuptimin se kanë lidhje logjike, përndryshe njohja e Allahut është mbi të gjitha njohjet e tjera, siç e ka veçuar edhe vetë ai.

Dijetari i njohur, El-Ixhij, e sqaron lidhjen në mes të shpalljes dhe mendjes, kur thotë: Allahu i Madhërishëm te njeriu e ka krijuar mendjen si instinkt dhe dijen si nevojë, pastaj i ka urdhëruar ata, domethënë me shpallje dhe me vrojtim në krijesat e Allahut, me meditimin në atë që e ka krijuar Allahu, për t'i çuar drejt dijes për ekzistencën e Krijuesit absolut, i pa fillim.[12] Kjo është e qartë, tek esha'rinjtë.

[10] Po aty, fq.59.
[11] El-Gazalij, *Xhevahirul Kur'ani*, fq.10.
[12] El-Ixhij, *El-Mevakif,* vëll.1, fq.12.

2. MENDIMI I MATURIDIUT RRETH NJOHJES SË ALLAHUT

Në vazhdim, do ta prezentojmë qëndrimin e Maturidiut në këtë çështje madhore, e cila ka sfiduar mendimin njerëzor dhe i ka polarizuar qasjet.

2.1. Obligueshmëria e vrojtimit

Ebu Mensur El-Maturidiu, mendon se njeriu mund të arrijë deri te njohja e Allahut nëpërmjet mendjes së tij. E pse të mos është e mundur kjo!? A, nuk na ka urdhëruar neve Allahu me të vrojtuar dhe me të menduar!? A, nuk na ka urdhëruar Allahu për të bërë analiza dhe shqyrtime të fenomeneve në gjithësi!? A, nuk na ka motivuar për vrojtim, si një veprim që është pjesë e rrugës së vërtetë!?[13] Në këtë kontekst, Allahu i Lartësuar ka thënë:

"Thuaj: "Shikoni çka ka në qiej dhe në Tokë!" *(Junus, 101)*

Po ashtu, ka thënë:

"Ne do t'u bëjmë atyre të mundshme që të shohin argumentet Tona në horizonte dhe në veten e tyre deri që t'u bëhet e qartë se ai *(Kur'ani)* ***është i vërtetë. A nuk mjfton që Zoti yt është dëshmitar për çdo gjë?"*** *(Fus-silet, 53);*

I Lartëmadhërishmi, thotë:

"A nuk i shikojnë devet se si janë krijuar? Edhe qiellin se si është ngritur lart! Edhe kodrat se si janë venduar!" *(El-Gashijetu, 17-19)*

I Lartëmadhërishmi, thotë:

"Është fakt se në krijimin e qiejve e të tokës, në ndërrimin e natës e të ditës, të anijes që lundron në det, që u sjell dobi njerëzve, në atë shi që e lëshon Allahu prej së larti e me të ngjall tokën pas vdekjes së saj dhe përhapë në te nga çdo lloj gjallese, në qarkullimin e erërave dhe reve të nënshtruara mes qiellit e tokës, *(në të gjitha këto),* ***për një popull që ka mend, ka argumente."*** *(El-Bekare, 164).*

I Lartëmadhërishmi, thotë:

"Po edhe në veten tuaj keni argumente. A nuk jeni kah e shihni?" *(Edh-Dharijat, 21).* Dhe, ky vrojtim në vetë realitetin e njerëzve,

[13] El-Maturidij, *Kitabu-t-Tevhid*, fq.10.

pastaj "meditimi i gjërave të tjera, njohja e sekreteve të tyre, funksionet e tyre, absolutisht shpije në njohjen e Krijuesit dhe Shpikësit të tyre."[14]

2.2. Roli i mendjes në njohjen e Allahut

Duhet thënë se kjo çështje nuk është e lehtë për shpjegim. Shumë prej pretenduesve, me kënaqësi i kanë hyrë trajtimit, por një shumicë e tyre kanë dështuar në këtë problematikë, sepse, vetë preokupimi mbi mendjet është shumë i komplikuar. Të tilla janë synimet dhe tipologjia e njerëzve, po kështu janë llojet e dhimbjes, shkaqet e shumta, që nuk mund të përthekohen, dominimi i dëshirave, kënaqësitë e ndryshme, të cilat i preokupojnë mendjet si dhe i pengojnë ato në arritjen e të vërtetës.[15]

Gjatë këtij teksti, do të mundohemi të parashtrojmë konceptin e Maturidiut mbi mendjen njerëzore dhe si është e mundur që iluzionet, të cilat e përfshijnë me preokupime dhe probleme, arrijnë ta pengojnë që e njëjta të mos shohë qartë? Bile, pikërisht për këtë arsye, njeriu është i nevojshëm për ardhjen e pejgamberëve, si një domosdoshmëri për njohjen e dispozitave të fesë, përfshirë detajet dhe imtësitë e saj. Në fakt, ky është një lehtësim prej Allahut ndaj njerëzve dhe prej favoreve madhështore ndaj tyre. Disa prej mu'tezilëve, janë përafruar me këtë qëndrim gjersa thonë se mendja e njeriut është prej butësisë hyjnore. Përtej kësaj, mbi thënien e Maturidiut se mendja ka aftësi për ta arritur njohjen, që u përmend më lartë, arrijmë në një përfundim tjetër se besimi i imituesit (تقليد) është i pavlefshëm (باطل), prandaj, ai patjetër duhet ta kërkojë argumentin. "Sepse, imitimi në besim, nuk është prej atyre elementeve që njeriu justifikohet për ndonjë kontradiktë të thellë besimore".[16]

Me këtë mendim janë edhe mu'tezilët. Abdu'l Xhebbar, duke e përshkruar imitimin, thotë, se mund të prodhojë besueshmëri kontradiktore, ngase imitimi i atij që thotë për pafillimësinë e trupave, asgjë nuk ka dallim nga imitimi i atij që thotë për krijimin e tyre[17], pasiqë në të dy rastet

[14] El-Maturidij, *Et-Tevhid,* fq.136-153.
[15] Po aty, fq.182-183.
[16] Po aty, fq.1.
[17] El-Kadi Abdul Xhebbar, *El-Mugni*, fq.12,123.

bëhet fjalë për një mosnjohës, që është i kufizuar në ndjekjen dhe imitimin e gjurmëve të tjetrit.

Në fakt, ky është qëndrim i të gjithë maturidinjëve.* Ebu Muin En-Nesefiu[18], thotë se te maturidinjtë nëse dikujt që është i mençur, nuk i ka arritur shpallja, si pasojë edhe nuk e njeh Krijuesin, shtrohet pyetja, a konsiderohet i justifikuar për këtë mosnjohje apo jo!? Tek ne, nuk është i justifikuar, ai është i obliguar që të kërkojë argumentimin, siç e kanë kërkuar banorët e shpellës (ehlu'l kehfi), kur thanë:

"Zoti ynë është Zoti i qiejve e i tokës, nuk adhurojmë ndonjë zot tjetër pos Tij…" *(El-Kehf, 14)*

Apo siç kërkoi argumentim pejgamberi Ibrahim a.s.:

"E kur atë e mbuloi nata, ai e pa një yll e tha: "Ky është Zoti im!" E kur u zhduk ai *(përëndoi)* ***tha: "Unë nuk i dua ata që humbën". Kur e pa hënën të posa lindur, tha: "Ky është Zoti im! e kur përëndoi ajo, tha: Nëse Zoti im nuk më udhëzon, unë do të jem prej njerëzve të humbur!" Kur e pa diellin të lindur, tha: "Ky është Zoti im, ky është i madh!" e kur ai përëndoi, tha: O populli im, unë jam i pastërnga ajo që ju i shoqëroni!" Unë me veten time i drejtohem***

Imitimi (taklidi) është dy llojesh: 1) Taklidi në bazat e besimit islam (أصول الإعتقاد), dhe 2) Taklidi në elementet dytësore të fesë (فروع الشريعة). Gjersa, taklidi në çështjet dytësore të fesë është i lejuar me konsenzues, në anën tjetër, taklidi në bazat e besimit islam, pa dyshim është i nënçmuar, i urrejtur dhe aspak i lavdëruar. Obligohet secili musliman që është në moshën madhore dhe i mençur, që t'i njohë individualisht çështje bazike të fesë dhe nuk i lejohet që nëpërmjet imitimit të mbështetet në tjetrin. Dijetarët çështjet bazike të besimit islam që muslimani është i obliguar t'i besojë, i kanë përmbledhur me një formulë të vetme, e ajo është "gjërat që dihen haptazi se janë domosdoshmëri të besimit" (أَلمعلوم من الدين بالضرورة). Kjo formulë përfshinë *"të gjitha ato çështje që dihen si qeniesore të ardhjes së Muhamedit a.s., që kanë mbështetje në burimet tradicionale, që janë të transmetuara me rrugë tevaturi, që në ekzistencën subjektive të tyre nuk pranojnë kurrfarë interpretimi, që nuk mund të mendohet ekzistimi i ndonjë argumenti që e kundërshton atë dhe, që për ekzistencën parimore të tyre si qenësore të besimit islam, dijetarët nuk kanë diskutuar, ato konsiderohen se janë domosdoshmëri të Fesë, sikurse është besimi në Allahun dhe cilësitë e Tij, besimi në melaikët, pejgamberët, namazi, zekati, ringjallja, ekzistimi i xhenetit dhe xhehenemit, ndalimi i zinasë, i alkoolit, i bixhozit, etj.* (shih: Abdul Kerim Tetan, Muhamed Edib El-Kilanijj, *"Avnu'l muridi lish-sherhi xhevheret'it-tevhidi"* fi akideti Ehli Sunneti ve'l xhemaati, boton Darul Beshair, botimi i dytë, 1999/1419, pa vend botimi vëll. II, fq. 1149 – **përkthyesi).**

[18] Ebu Muin En-Nesefij, *Bahrul Kelam*, El-Mektebetul vatanijjetu, Tunis, numër 9310, fq.6(T).

Atij që krijoi qiejt e tokën, larg besimeve të tjera; unë nuk jam prej atyre që i përshkruajnë shok!" *(El-En'am, 76-79).*

Atëherë, konstatimi i Maturidiut rreth aftësisë së mendjes për njohjen e Allahut dhe arritja deri te besimi në madhështinë e Tij, përmes hulumtimit argumentues, implikon pjesërisht me atë që e kanë deklaruar mutezilët. Në fakt, është një mendim që bazohet në Kur'an, i cili, në shumë vende, ka ftuar për vrojtim dhe meditim, në mënyrë, që njeriu, duke depërtuar në thellësinë e çështjeve, arrinë të njohë ekzistencën e Krijuesit të Madhërishëm, sipas asaj që e kanë artikuluar kelamistët. Por, ajo që e dallon Maturidiun në këtë çështje, janë pikërisht çështja e dispozitave fetare. Sipas tij, dispozitat fetare, nuk mund të vendosen prej dikuj tjetër, përveç se prej Allahut, duke u bazuar në fjalën e të Lartëmadhërishmit:

"…E Ne nuk dënuam askë para se t'ia dërgojmë të dërguarin." *(El-Isra, 15).*

Në fakt, ky qëndrim i Maturidiut, nuk i jep hapësirë të madhe mendjes dhe as nuk e tejkalon aspektin tradicional të ruajtur, por është sintezë që pajton të gjitha këndvështrimet, duke e bërë atë prijatar të një mendimi të qëndrueshëm, të ndërtuar mbi konceptin bazik.

Sakaq, në mes të Ehlu Sunnetit dhe mutezilëve, është zhvilluar një debat mjaft i gjatë rreth ajetit të sipërpërmendur (El-Isra, 15). Mu'tezilët, thonë se fjala "resul" (i dërguar) në këtë ajet, ka për qëllim mendjen e jo dërgimin e pejgamberëve, ose ka për qëllim "nuk dënuam askë, për shkak të lënies së detyrimeve fetare". Një demant të arsyeshëm kundër mu'tezilëve, e ka dhënë dijetari i njohur El-Ixhij, i cili thotë se është mospajtim parimor me qëndrimin e mutezilëve. Sipas tij, nuk është e drejtë që të bartet domethënia e fjalës në atë kuptim, përveçse me ndonjë argument.[19] Po ashtu, i kundërshton, ngase, sipas tij, sikur vrojtimi të obligohej nga vetë mendja, atëherë do të bëhej para dërgimit të dërguarit, pasiqë obligueshmëria e vrojtimit, për nga natyra si akt, nuk ka lidhje me dërgesën e pejgamberëve, por me vetë mendjen, e është fare e qartë se mendja ka ekzistuar edhe para dërgimit të pejgamberit, mirëpo, në këtë rast, obligueshmëria para dërgimit do të determinonte ndëshkimin për lënien e detyrimeve fetare!? Prandaj, ajeti: ***"…E Ne nuk dënuam askë para se t'ia***

[19] El-Ixhij, *El-Mevakif,* vëll.3, fq.155 e tutje.

dërgojmë të dërguarin." *(El-Isra, 15),* e ka mohuar obligueshmërinë me detyrimet fetare para shpalljes (dërgimit të pejgamberit), për ta mohuar edhe pasojën që do të dilte prej kësaj obligueshmërie, e që është dënimi ndaj lënësit të detyrimeve fetare. Kështu që, mohimi i obligueshmërisë para shpalljes, e determinon mohimin e obligueshmërisë mendore dhe mohimi i obligueshmërisë mendore, e determinon mohimin e obligueshmërisë fetare, dhe kjo vërtetohet në fjalën e të Lartëmadhërishmit: ***"…E Ne nuk dënuam askë para se t'ia dërgojmë të dërguarin."*** *(El-Isra, 15).* Që do të thotë se, obligueshmëria me detyrimet fetare ndodhë vetëm prej shpalljes, ngase, obligueshmëria e vrojtimit ndodh përmes shpalljes dhe nuk mund të dihet obligimi për këtë të fundit, përveçse përmes vërtetimit nga shpallja.[20]

Tashëm, u qartësua dallimi esencial në mes Ehlu's-sunnetit dhe mu'-teziles, domethënë, ata janë pajtuar për parimin, por kanë divergjenca në mjete. Njohja e ekzistencës së Allahut përmes mendjes është fakt i pranueshëm për dy grupet, veçse te mu'tezilët, ajo është obligim përmes vetë vrojtimit, ndërsa te ehli sunneti, pra, te esh'arinjtë dhe maturidinjtë është obligim mbi bazën e shpalljes.

2.3. Aspekti natyror mbi njohjen e Allahut

Një çështje tjetër e trajtuar me shumë kujdes, është ajo që e ka trajtuar Maturidiu në tefsirin e tij, derisa e komenton fjalën e Allahut, në ajetin:

"Ata që e thyejnë besën e dhënë Allahut pasiqë është lidhur ajo…" *(El-Bekare, 27).*

Në këtë ajet, Maturidiu thotë se njohja e Allahut, në fakt është shprehje e besës së dhënë para Allahut, e besa e Allahut tek njerëzit është nga dy aspekte:

1) Besa e natyrshme (instinktive), pasiqë, secili njeri, nga vetë natyra e tij e krijuar, është dëshmitar i Njëshmërisë së Allahut të Madhërishëm, sikurse thotë Allahu:

"Po edhe në veten tuaj keni argumente. A nuk jeni kah e shihni?" *(Edh-Dharijat, 21).* Ashtu që, njeriu, nëse i analizon faktet e shum-

[20] El-Bejdavij ve'l Asfehanij: *Tavaliul envar ve sherhuhu metalial endhar*, fq.75.

ta në vetë qenien e vet do të arrijë deri te vetëdija se e ka një Krijues, i cili është Një i vetëm, i pa rival.

2) Besa e shpalljes, përmes dërgimit të pejgamberëve dhe të dërguarëve, paqja e Allahut qoftë mbi të gjithë ata, sikurse thotë Allahu:

***"…Allahu tha: "Unë jamë** (mbrojtës) **me ju!" Në qoftë se falni namazin, e jepni zeqatin, u besoni të dërguarve të Mi…"** (El-Maide, 12).* Po ashtu, thotë Allahu:

***"Dhe kur Allahu mori zotimin nga ata, të cilëve u është dhënë libri"** (Ali Imran, 187).*[21]

Duhet sqaruar, se te Maturidiu, njohja e Allahut nuk është imponuese (إضطرارية) për njeriun, siç paragjykohet shpesh fjala "besë e dhënë" (عهد), që ka ardhur në ajete kur'anore. Por, Maturidiu, me fjalët "besë" (ahd), ose "zotimi natyror" (mithaku'l fitrij), ka për qëllim predispozitat që i ka vendosur Allahu tek njeriu, siç është mendja, përmes së cilës ka mundësi që të vrojtojë kosmosin e Allahut dhe krijesat e Tij, ashtu që ia ka bërë të mundshme atyre argumentet e Krijuesit, duke i ngarkuar në mendjet e tyre, e që i ftojnë njerëzit për vërtetim të ekzistencë së Tij.

Përveç Maturidiut, me këtë këndvështrim konvergjon edhe ajo që e ka thënë Ebu Muin En-Nesefiu. Sipas tij, kush e zgjedh imanin, ai veçse e ka zgjedhur para lindjes së tij, sipas fjalës së Allahut:

***"Përkujto kur Zoti Yt nxori nga shhpina e bijve të Ademit pasardhësit e tyre dhe i bëri dëshmues të vetes së tyre** (duke u thënë): **"A nuk jam Zoti juaj?" Ata thanë: "Po, dëshmuam!"** (El-A'raf, 172).*

në kuptimin se, Allahu i Lartëmadhërishëm, këtë dëshmi (mithak) apo besë, e ka marrë prej të gjithë njerëzve, në periudhën para ardhjes së tyre në këtë botë, siç është thënë prej komentatorëve të Kur'anit[22], dhe ua ka bërë atyre të mundshme që të shohin argumentet e qarta në vetveten e tyre dhe në të gjitha krijesat, siç u sqarua në tekstin e sipërpërmendur të Maturidiut.

Po ashtu, një prej komentatorëve të Kur'anit, që i përket medhhebit maturidij, me rastin e komentimit të ajetit të lartëcekur (El-A'raf, 172), thotë: Ky është një pasqyrim, në kuptimin se Allahu i Lartëmadhërishëm,

[21] El-Maturidij, *Te'vilatu Ehlis-sunneti*, vëll.1, fq. 80.

[22] Ebu'l Berekat Abdullah bin Ahmed En-Nesefij, *Et-Tefsir (Tefsirun-Nesefij)*, vëll.2, fq.85.

ua ka mundësuar njerëzve që t'i shohin argumentet e ekzistencës së Krijuesit dhe të Njëshmërisë së Tij dhe, për këtë kanë dëshmuar mendjet e tyre, të cilën ua ka bërë pjesë të qenies, e përmes të cilës ata e dallojnë atë që është udhëzim dhe atë që çon në humbje dhe, sikur i ka bërë dëshmitarë mbi veten e tyre përfshirë konfirmimin për besim. Domethënë, kur Allahu u është drejtuar atyre: "A nuk jam Zoti juaj?", i bie se ata kanë thënë: Po, gjithësesi, Ti je Zoti ynë, dëshmuam për veten tonë dhe e vërtetuam se je Një i vetëm.[23]

Prandaj, kjo çështje, tashmë është sqaruar plotësisht nga Maturidiu dhe përkrahësit e shkollës së tij tradito-racionale, se njohja e ekzistencës së Allahut të Lartëmadhërishëm, derisa është çështje e argumentueshme (istidlalijjeten), ajo buron mbi idenë instinktive që është e kalitur në shpirtin e njeriut, e që i paraprinë meditimit argumentues.

Dhe, elementin e kësaj ideje, do ta gjesh edhe në filozofinë e huaj, siç e gjejmë te Dekarti, ideator i argumentit ekzistencial, në kontekst të filozofisë, kur thotë: "Me të vërtetë besimi është prezent tek ne, para se të krijohemi dhe, Zoti, kur na ka krijuar, e ka mbjellur këtë ide tek ne, për të qenë shenjë e Krijuesit, e vendosur në krijesën e Vet."[24]

Atëherë, kur kjo çështje themelore është diçka e argumentueshme, sipas Maturidiut, ka bërë që shumë prej kelamistëve të Islamit, të mendojnë se njohja e ekzistencës së Allahut është nevojë dhe intuitë mendore, siç është Gazaliu, i cili thotë: "Me të vërtetë, ekzistenca e Allahut dhe fuqia e Tij, dija e Tij dhe të gjitha cilësitë e Tij, dëshmojnë për Allahun dhe se, çdo gjë që e shohim, ka nevojë për lartëmadhërinë e Tij."[25] Pra, Edhe Gazaliu, i cili është prej specialistëve në parashtrimin e argumenteve rreth ekzistencës së Allahut, në disa libra të tij, konsideron se dija për njohjen e Allahut, nuk mund të evitohet nga shpirti i njeriut, për një arsye apo tjetër, për shkak të skalitjes së saj të plotë në mendjen e lindur, e kjo dëshmon për nevojën e të gjitha krijesave për Krijuesin.

Këtë kontekst e artikulon edhe Shehristani, i cili thotë: Vetë natyrshmëria e njeriut dëshmon se ka nevojë për një Planifikues, i cili është re-

[23] Po aty.
[24] Dr. Uthman Emin, *Et-Teem-mulatu fil felsefeti'l ula lidikarti*, fq.155.
[25] El-Gazalij, *El-Ihjau*, vëll.4, fq. 312.

ferencë e nevojave njerëzore, që është i panevojshëm dhe që njerëzit i drejtohen kur janë në vështirësi. Për këtë arsye, edhe ligjërimi i Kur'anit ka ardhur me këtë metodë, sikurse thotë Allahu i Lartësuar:

***"A është Ai që i përgjigjet nevojtarit** (të ngratit) **kur ai e thërret…"** (En-Neml, 62);*

***Thuaj: "Kush ju shpëton prej errësirave** (trishtuese) **të tokës e të detit…"** (El-En'am, 63)*

***"Ai që e filloi krijimin** (e njeriut) **e pastaj e përsëriti atë** (e ringjall pas vdekjes)…" (En-Neml, 64)*

Zakonisht, natyrshmëria anon kah principi i saj, andaj, Allahu ka dërguar pejgamberë, për t'ua përkujtuar njerëzve:

***"Pra këshillo aty ku këshilla bën dobi."** (El-A'la, 9);*

***"E ti pra, këshillo, se je vetëm përkujtues."** (El-Gashijetu, 21);*

***"Atij i thuani fjalë të buta, ndoshta ai mendohet a frikësohet."** (Ta Ha, 44).*[26]

Pavarësisht këtyre që u thanë më lartë, çështja e ekzistencës së Allahut është diçka e padiskutueshme, sepse ajo është e vërtetë, instinktive dhe e natyrshme te njeriu. Nuk ka krijesë, e që nuk e ka ndjesinë qeniesore se është e krijuar dhe se e ka një Krijues. Kjo gjithësi, në të cilën jetojmë e ka një Urtak, të Plotfuqishëm për çdo gjë. Dhe, kjo ndjesi, ndonjëherë fshihet në momentet e shëndetit dhe lumturisë, por, kur njeriu sprovohet me vështirësi, të cilat e largojnë gjendjen e rrejshme, që e ka mbuluar natyrshmërinë, njeriu kthehet kah Zoti i vet, me lutje dhe i përulur.

E, prej atyre që pajtohen me këtë këndvështrim, e që i përkasin shkollës së "selefinjëve", është Ibni Kajjim El-Xhevzijj, i cili konsideron se: "Nëse njeriu e vështron gjithësinë në tërësinë e saj, përfshirë lartësitë, ultësitë dhe çdo pjesë të saj, do ta gjejë veten e tij dëshmitar të vërtetimit të Krijuesit të saj. Andaj, mohimi apo refuzimi i krijuesit të gjithësisë, krahas faktorit të arsyes dhe natyrshmërisë, është e ngjashme sikur mohimi i dijes, nuk ka dallim në mes tyre, ngase, është më se e ditur se ekzistenca e Krijuesit të Madhërishëm është e shfaqur përballë mendjes dhe natyrshmërisë, më shumë se sa ekzistenca e ditës. E, kush nuk e sheh atë (ekzis-

[26] Esh-Shehristani, *Nihajetu'l akdam*, fq.125.

tencën e Allahut), me dijën dhe natyrshmërinë e tij, atëherë le t'i akuzojë këto të dyjat!?[27]

Në këtë mënyrë, besueshmëria e individëve dhe e gjinisë njerëzore në përgjithësi, në Krijuesin, është e patjetërsueshme, për të cilën, domosdoshmërisht dëshmon e gjitha ajo që e shohim prej gjithësisë. Mbi këtë parim, njohja se Allahu është Krijues, është natyrshmëri në qenien njerëzore. "Natyrshmëri, të cilën Allahu e ka skalitur në këtë gjithësi, e që kjo e fundit dëshmon ekzistimin e saj nga Qenia e Tij, po edhe ndjesinë mbi këtë vërtetë, që del nga thellësitë e saj.[28]

2.4. Aspekti i shijes mbi njohjen e Allahut

Përderisa, Maturidiu, e ndjek rrugën e argumentimit në lidhje me njohjen e Krijuesit, atëherë të shohim se cili është qëndrimi i tij ndaj këndvështrimit sufsit mbi njohjen?

Metoda sufiste mbi njohjen e Allahut, manifestohet nëpërmjet zhveshjes së shpirtit nga të gjitha elementet eshpore, pastrimi i tij nga çdo ndikim i natyrës trupore[29], qëndrimi para Allahut me qëndrim asketor, tërheqja në vetmi dhe përkujtimi i Zotit. Në fund të këtij procesi, shpirti kthjellet, i zbulohen dritat hyjnore, e përmes të cilave e arrinë dijen e veçantë, që është direkt prej Zotit të Gjithësisë, dhe kjo nuk është arritje përmes rrugës mendore apo trashëgimi e qytetërimit njerëzor. Pra, kjo është sa i përket metodës sufiste mbi njohjen e Krijuesit, e që Maturidiu e ka kundërshtuar në kritikën e tij, domethënë e ka kritikuar praktikën e sjelljeve. I ka emërtuar si asket (el-mutekash-shifetu)[30] dhe cilësohen se i kanë ndaluar ato që Allahu i ka lejuar prej mirësive.

Ky qëndrim, më ka bërë shumë kurreshtar për studime të tjera dhe kam arritur të qartësoj, se nuk është vetëm Maturidiu, që e mohon "ilhamin" (inspirimin), si mundësi për njohjen e Allahut. I tillë është edhe Ebu Hafs Umer En-Nesefij (v.537 h.), autor i trajtesës së njohur "El-Akaid", i

[27] Ibn Kajjim El-Xhevzij, *Medarixhus-salikin*, fq.32-33.
[28] Sejjid Kutb, *Fi dhilalil Kur'an*, vëll. 3, fq.668.
[29] Er-Rrazi, *I'tikadatu firekil muslimine vel mushrikine*, fq.72.
[30] El-Maturidij, *Te'vilatu ehlis-sunneti*, vëll.1, fq.109.

cili thotë: Ilhami (inspirimi), nuk është prej shkaqeve të njohjes. Shkaqet e dijes, kufizohen në shqisat e shëndosha, lajmi i saktë dhe mendja.[31]

Atëherë, bëhet e qartë se maturidinjtë, në parim e refuzojnë metodën e sufinjëve mbi njohjen dhe nuk e pëlqejnë atë që quhet zbulim apo hedhje e dritës në zemër, përmes rrugës së përmbysjes. Po ashtu, bëhet e qartë se ky qëndrim dallon prej atij të esh'arinjëve, veçanërisht te Gazaliu, i cili, metodën e sufinjëve, e konsideron si më të mirën mbi njohjen e Allahut.[32]

Nga gjuha arabe:
Orhan Bislimaj

[31] Umer En-Nesefij, *"Metnul akaid"*, fq.108. Taftazaniu e ka shpjeguar fq. 46.
[32] El-Gazalij, *El-Munkidhu mined-dalal*, fq.11.

Belkasim EL-GALI

KNOWING ALLAH ACCORDING TO MATURIDI

(Summary)

All those who want to discuss the arguments for and against the existence of God must first consider whether it is possible to prove the existence of the Creator. Has the human mind the capacity to understand the existence of the Creator? If his existence cannot be proved by the mind is it possible to do so using religious arguments? If it cannot be done using only one of them, can it be achieved using both together?

This paper will mainly focus on this issue – The knowing of Allah according to Maturidi, one of the founders of the Ahl as-Sunnah aqeedah school.

بالقاسم الغالي

معرفة الله وفقا للماتوريدي

(خلاصة البحث)

يجب على أي شخص يريد استكشاف الحجج حول وجود الخالق أن يبدأ بالضرورة من مسألة أساسية ، وهي: إثبات وجود الخالق ، هل هذا ممكن أم هو مستحيل؟ ثم، هل العقل البشري لديه القدرة الكافية لمعرفة الخالق تعالى أم لا؟ وإذا كان لا يمكن التحقق من المعرفة من خلال العقل المنطق ، فهل من الممكن أن يتحقق شيء من هذا القبيل من خلال "الاستماع" – الحجج الدينية. وإذا لم يكن بالإمكان تحقيقه إلا بأحدهما، فهل يمكن تحقيقها، من خلال الاثنين معاً؟

ستركز هذا البحث الورقة بشكل أساسي على هذه القضية – معرفة الله تعالى ، وفقاً لإمام الماتوريدي ، أحد مؤسسي المدرسة العقائدية لأهل السنة .

Ejup HAZIRI

SHPREHJA E OPINIONIT -VËSHTRIM RETROSPEKTIV-

Abstrakt

Shprehja e lirë e opinionit është padyshim një element shumë i rëndësishëm dhe tejet domethënës. Me shprehjen e lirë kemi për qëllim sintagmën *hurrijet err-rre'j*, gjë që nganjëherë dallon nga sintagma *hurrijet el-kavl*, që nënkupton lirinë e fjalës. Nëse i kthehemi traditave të dijetarëve myslimanë, shohim se këto shprehje nganjëherë dalin të ngatërruara. Ata shpeshherë e përdorin termin *hurrijet err-rre'j*, për ta nënkuptuar *hurrijet el-kavl*, për shkak se është më preciz në terminologji dhe besoj është më i njohur si term që nga gjeneratat e hershme, ashtu siç do ta elaborojmë në këtë punim.

Punimi synon të hedh në dritë elemente të rëndësishme që ndërlidhen me lirinë e të shprehurit apo dhënies së opinionit, duke sjellë në retrospektivë shembuj të ndryshëm nga e kaluara e lavdishme, ku opinioni kishte një tretman krejtësisht tjetër, për të ardhur në përfundim se e tashmja e ka ngulfatur tejmase opinionin e mirëfilltë e real.

Fjalët kyçe: *Opinioni, hurrijet err-rre'j, hurrijet el-kavl, retrospektiva, etj.*

Çka nënkupton termi *hurrijet err-rre'j?*

Ky term zakonisht përdoret si frazë për lirinë e fjalës, që është indikacion apo shenjë e opinionit personal, si aspekt tejet i rëndësishëm i lirisë së të shprehurit lirshëm, pa indikacione të jashtme, pa presion dhe pa direktiva.

Dijetarët që janë marrë me këtë çështje, zakonisht lirinë e shprehjes së opinionit e kanë ndarë në disa grupe, ku nganjëherë ndarja është klasifikuar varësisht nga perspektiva e dijetarit. Në përgjithësi ajo si e tillë mbetet në tre grupe: Opinion i mirë (i lavdëruar), opinion i keq (i dëmshëm) dhe opinion i dyshimtë. Këto tri grupe janë determinuese të lirisë së shprehjes së opinionit, por jo edhe përfundimtare, ngase ka të atillë që i kanë dhënë edhe konotacione tjera dhe klasifikime të ndryshme, që ndoshta nuk dallojnë aq shumë nga bërthama e asaj që kam përmendur këtu. Më pas këto tre grupe që paraqesin ajkën e ndarjes, janë klasifikuar në grupe tjera, ku sa për përkujtim opinioni i mirë është ndarë apo është mishëruar me atë që elaboron Kur'ani fisnik, tradita e profetit (sunneti) dhe opinioni i sahabëve (apo edhe gjeneratave tjera), që në kontekstin e fundit ka ndërlidhje të ngushtë me *ixhtihadin,* dhe opinioni këtu është tejet i lidhur me atë që arrihet si rezultat i konsultimit. Edhe grupet tjera kanë ndarje të ndryshme, por që nuk janë tematikë e këtij punimi.

Për t'u rikthyer edhe një herë tek bërthama e temës, *re'ji,* gjegjësisht opinioni është një çështje, apo një fenomen që në çështje të caktuara, s'mund ta gjesh në Kur'an e as në Sunnet. Prandaj konsiderohet opinion nga vet fakti se protagonisti arrin në një rezultat pas një studimi të thellë dhe një hulumtimi individual rreth një çështjeje të caktuar, ku nuk ka ndonjë argument të qartë, por në mungesë të argumentit mund të ketë shenja apo indikacione rreth tij. Por, ndonjëherë ato shenja dhe indikacione, mund ta shtyejnë atë të vijë në më tepër se një konkluzë. Ndoshta mund të jetë e çuditshme për dikë, por juristët shpeshherë i përdorin të njëjtat shenja dhe indikacione, por që konkluza e tyre është e ndryshme nga njëri-tjetri. Kjo varet nga perspektiva personale e të kuptuarit të tekstit dhe shenjave që përcaktojnë epilogun e çështjes.

Shprehja e opinionit nuk nënkupton gjërat që janë të precizuara me tekst apo ato gjëra që u dihet epilogu i tyre. *Re'ji* nënkupton të kundërtën,

ngase në ato gjëra që epilogu i tyre është i qartë dhe argumentet janë të qarta, nuk ka nevojë për *re'j,* ngase aty opinioni është më se i qartë dhe nuk ka nevojë për ndonjë hulumtim individual apo shoqëror. Ta marrim një shembull, fjala bie: "Kryeni namazin...!" Këso urdhrash në Kur'an hasim në shumë vende. Ky realisht nuk ka të bëjë me opinionin, prandaj nuk i lejohet askujt të hulumtojë në këtë pikë, në mënyrë që të sjell një epilog përfundimtar rreth namazit. Assesi, ngase këtu çdo gjë është e qartë, kemi tekstin e prerë që është normativ dhe askujt nuk i lejohet ta komentojë ndryshe veçse si një urdhër që duhet përmbajtur. Por, brenda për brenda namazit ka elemente që në mungesë të tekstit eksplicit, u lejohet përgjegjësve dhe atyre që janë meritor të japin *re'jin* e tyre, gjithnjë në koordinim me indikacionet e mbledhura dhe përpjekjen maksimale për arritje deri te një epilog i caktuar.

Përderisa ka tekste të qarta nga Kur'ani, Suneti apo konsensusi i dijetarëve (Ixhmai), atëherë është totalisht e gabuar dhe e papranuar që dikush ta paraqesë mendimin e tij personal apo opinionin e tij, pa marrë parasysh se ai opinion ka ardhë si pasojë e thellimit personal dhe studimit të çështjes në fjalë. Kur teksti është ekzistues, aty opinioni nuk ka vend. Në mungesë të tekstit kuranor apo profetik atëherë shikohet tek *ixhmai*, gjegjësisht konsensusi i dijetarëve eminentë se çfarë kanë thënë për të. Nëse ka një formulim të tyre që shoqëria islame (ummeti) e ka pranuar, pa kundërshtime, as këtu opinioni i ndokujt nuk ka vlerë. Nëpërkëmbja e opinioneve të gjeneratave të hershme, të cilit ishin shumë afër me burimet e Islamit, është një ide e rrezikshme që kontaminon tërë produktin dhe mundin e gjeneratave të hershme, që ishin më të ngritur dhe më të avancuar në kuptimin e njohjes së mirëfilltë të Islamit në përgjithësi.

Pra, në mungesë të teksteve dhe në mungesë të një konsensusi të dijetarëve paraprak, kur gjenden shkëndija ekzistuese që në fakt mund të jetë vetëm një indikacion e që rezulton në një interpretim të hapur dhe konkluzion të mundshëm, atëherë çështja është e hapur për opinion (re'j).[1] Vërtetësia e opinionit gjykohet gjithmonë nga afërsia e tij me frymën e teksteve. Konsensusi i opinionit (re'jit) pranohet si metodë për t'i dhënë

[1] Kamali, Mohammad Hashim, *Freedom of Expression in Islam*. Ilmiah Publishers, Selangor, Malaysia, 2000. F.61-62.

validitet opinionit dhe vetëm atëherë mund të kemi ixhmain, njëri ndër burimet kryesore të së drejtës Islame.

Para se të flasim në kontekstin e hershëm të juristëve rreth opinionit, më duhet të bëj një interferim me shembuj praktikë se çfarë roli kishte opinioni në kohën e shpalljes dhe pas saj.

Re'ji kishte rol të limituar në kohën e Profetit

Tek gjenerata e hershme, pra ajo e shokëve të të Dërguarit të Allahut, opinioni personal kishte rol të limituar, ngase nuk kishte nevojë për një gjë të tillë, përderisa Kur'ani zbriste herë pas herë dhe varësisht nga konotacioni i rrethanave dhe pyetjeve të tyre. Shto kësaj, se ata në mesin e tyre e kishin të Dërguarin e Allahut dhe ai për çdo çështje i informonte ata. Por, kjo nuk nënkupton se ata ishin një shoqëri që nuk e kishin të zhvilluar edhe opinionin e tyre. Ka raste kur shpallja miratonte opinionin e tyre, sikurse që ka raste tjera kur shpallja proklamonte se opinioni i tyre nuk ishte i drejtë.

Sa për ilustrim, do t'i përmendi dy raste nga Kur'ani që simbolizojnë dy raste specifike, ku i pari ka të bëjë me shokët e të Dërguarit të Allahut rreth prerjes së hurmave apo të lënies së tyre, të fisit Benu-n-Nadiir, ku disa kishin prerë ato e të tjerët (disa nga muhaxhirët) kishin këshilluar që të lihen e të mos prehen ato:

مَا قَطَعْتُمْ مِنْ لِينَةٍ أَوْ تَرَكْتُمُوهَا قَائِمَةً عَلَى أُصُولِهَا فَبِإِذْنِ اللَّهِ وَلِيُخْزِيَ الْفَاسِقِينَ (٥)

***"Ju nuk këputët asnjë nga hurmat e buta** (fidanet) **ose atë e keni lënë të ngritur në rrënjët e tyre, vetëm se me lejen e Allahut e për t'i shtypur kundërshtarët."** (Hashr: 5)*

I Dërguari i Allahut lajmëroi shokët e tij, të cilët ishin të ndarë në mendime, se te dy palët kishin vepruar drejt dhe se veprimi i tyre ishte krahas lejes së Allahut.

Rasti i dytë është rasti kur i Dërguari i Allahut urdhëroi disa prej shokëve të tij të shkonin tek fisi i çifutëve Beni Kurejdha, pas kthimit nga beteja e Ahzabit. Shokët e tij i urdhëroi me këto fjalë: "*Askush nga ju mos*

ta falë namazin e ikindisë, përpos te Beni Kurejdha."[2] Mirëpo ende pa arritur tek vendi, kohës së ikindisë veç iu afrua fundi, prandaj disa e falën namazin përgjatë rrugës, ngase koha veçse po kalonte, e disa tjerë nuk e falën atë, ngase i Dërguari i Allahut i kishte urdhëruar që ta falnin atë në vendin e përmendur. Ata që e falën namazin e ikindisë u arsyetuan se koha e ikindisë veç po kalonte, ndërsa ata që nuk e falën namazin në kohën e tij, por në vendin e Beni Kurejdha, zbatuan në përpikëri fjalët e të Dërguarit të Allahut. Është shumë me rëndësi se i Dërguari i Allahut nuk e qortoi asnjërin grup, përkundrazi miratoi opinionin e të dy palëve. Më e rëndësishme është çështja se si e kuptuan sahabët thënien e të Dërguarit të Allahut dhe përse nuk vepruan të gjithë njësoj? Disa prej tyre nga fjalët e të Dërguarit të Allahut kuptuan se për qëllim është ngutja për të shkuar tek çifutët dhe mosmarrja me asgjë që vonon shkuarjen tek ata. Këta nuk shikuan kontekstin e ndërthurjes së fjalisë, por kuptimin e saj, andaj edhe në bazë të kuptimit falën namazin atëherë kur panë se koha e tij veç është afër mbarimit. Ndërsa të tjerët morën fjalët e të Dërguarit në mënyrë tekstuale, duke mos menduar se kuptimi i saj mund të jetë edhe ndryshe, prandaj edhe namazin e ikindisë nuk e falën gjersa arritën tek vendi i Beni Kurejdha.

Përveç këtyre dy shembujve, ne gjejmë se edhe Kur'ani sjell shembuj të ndryshëm, ndonëse të limituar, se opinioni ishte valid edhe tek gjeneratat tjera, gjegjësisht tek gjeneratat e pejgamberëve paraprakë. Shembull sjell rastin e Davudit dhe Sulejmanin dhe çështjen e njohur të deleve, të cilin e sjellim më tepër në raport me atë se edhe opinionet e të Dërguarve nganjëherë dallonin, varësisht si e shihnin problematikën. Po flasim gjithnjë në raport me fushën ku nuk kishte shpallje. Në kontekstin e këtyre dy pejgamberëve, babë e bir, përgjigjja e djalit, gjegjësisht Sulejmanit ishte e ndryshme me përgjigjen e babait të tij, Davudit. Në Kur'an për këtë thuhet:

[2] Buhariu në Sahih, nr. 894, 3810; Muslimi në Sahih, nr. 3317; Ibni Hibbani në Sahih, nr. 1484.

وَدَاوُودَ وَسُلَيْمَانَ إِذْ يَحْكُمَانِ فِي الْحَرْثِ إِذْ نَفَشَتْ فِيهِ غَنَمُ الْقَوْمِ وَكُنَّا لِحُكْمِهِمْ شَاهِدِينَ فَفَهَّمْنَاهَا سُلَيْمَانَ ۚ وَكُلًّا آتَيْنَا حُكْمًا وَعِلْمًا ۚ وَسَخَّرْنَا مَعَ دَاوُودَ الْجِبَالَ يُسَبِّحْنَ وَالطَّيْرَ ۚ وَكُنَّا فَاعِلِينَ

"(Përkujto) ***Davudin e Sulejmanin kur pleqëronin për çështjen e bimës*** *(mbjelljes)* ***të cilën delet e atij populli e kishin kullotur natën, e Ne ishim përcjellës të gjykimit të tyre. E Sulejmanit Ne ia mësuam atë*** *(përgjigjen e saktë),* ***po secilit*** *(prej tyre)* ***u patëm dhënë urtësi e dije..."*** *(el-Enbija: 78-79)*

Delet e zotëriut kaluan në pronën e një personi dhe kullotën aty gjatë natës dhe aty thuajse shkatërruan bimët (të mbjellat) dhe dy personat në fjalë u gjenden para Davudit a.s. për gjykim. E Davudi a.s. mori vendim në gjykimin e tij që delet t'i jepen pronarit të tokës së dëmtuar. Kur personat dolën jashtë, i takoi Sylejmani që ishte djali i Davudit dhe i pyeti për gjykimin e Davudit. Ata e informuan për gjykimin e Davudit se delet i takojnë pronarit të tokës, si rrjedhojë e dëmtimit që kanë bërë ndaj të mbjellave. Sylejmani u tha atyre: "Jo, nuk është kështu gjykimi! Pronari i të mbjellave i merr delet dhe përfiton prej tyre (prej qumështit të tyre) derisa pronari i deleve ta rregullojë parcelën e të mbjellave." Në të vërtetë ky ishte gjykimi më i drejtë, ndaj edhe Allahu në Kur'anin famëlartë tha:

فَفَهَّمْنَاهَا سُلَيْمَانَ

"E Sulejmanit Ne ia mësuam atë *(përgjigjen e saktë)..." (El-Enbija: 78-79)*

E veçoi Sulejmanin me kuptim të çështjes, por që të dy Allahu i lavdëroi me urtësi (gjykim) e dije. Kjo ngjarje ka një rëndësi të madhe dhe të pakontestueshme, jo vetëm për shkak të rrëfimit të ngjarjes, por më tepër për shkak të mesazhit dhe rezultateve që arrihen nga ngjarja. Kuptimi simbolik i saj shprehet qartë se edhe pse ata të dy ishin babë e bir, që të dy pejgamberë, në çështjet e jetës së përditshme ku nevojitej të reflektohej thellë për nxjerrjen e një dekreti personal, vendimi i nxjerrë dallonte njërin prej tjetrit, ndonëse pyetja ishte e njëjtë, mirëpo përgjigja nga njëritjetri qe e ndryshme. E, mendimi ndryshe, gjegjësisht opinioni i këtyre dy pejgamberëve, i regjistruar në Kur'an, nuk përmendet vetëm si simbolikë e një ndryshimi në të menduar, por më tepër si një koncept që pasqyron

formën e të menduarit dhe vetëdijen njerëzore në realitetin e dukurive, ku pikëpamjet dallojnë, jo në bazë të formulimit të fjalëve, por në bazë të koncepteve.

Gjatë kohës së të Dërguarit të Allahut, për çfarëdo rasti, shokët e tij i drejtoheshin atij, për shkak se atij i zbriste shpallja dhe i vinin përgjigjet për pyetjet që parashtroheshin nga kolektivi i tij. Kurdo që ata kishin polemika, drejtoheshin tek ai. Ai i udhëzonte kah e mira dhe e mbara.[3]

Në sferat ku atij i vinte shpallja, gjithçka bëhej e qartë dhe nuk kishte nevojë për ndonjë mendim tjetër. E në disa çështje të jetës së përditshme, në mungesë të inspirimit hyjnor, ai mblidhte shokët e konsultohej me ta. Konsultimi me ta nxiste mendimin kritik dhe krijonte një ambient të dijes, ku secili jepte mendimin personal në bazë të situatës që e kuptonte, ndonëse disa shquheshin më tepër nga të tjerët për njohje dhe kuptim të thellë, gjë që është e natyrshme.

Janë shumë raste ku në mënyrë eksplicite na shfaqen opinione të ndryshme nga shokët e tij, varësisht nga pozicioni i të kuptuarit të tyre. Prej rasteve të shumta të kësaj sfere, do të shkoqisim disa prej tyre sa për të reflektuar rreth tyre.

Opinionet rreth të zënëve të Bedrit dhe konsultimi në Uhud

Dihet fare mire rreth epilogut të luftës së parë mes myslimanëve dhe jomyslimanëve, ku një numër i kurejshëve ishin zënë rob nga myslimanët. I Dërguari i Allahut u konsultua me shokët e tij se çfarë të vepronte me ta. Pati opinione të ndryshme, ku në përgjithësi dalloheshin mendimi i Ebu Bekrit që pasqyronte një mendim të butë e të mëshirshëm, ngase propozonte shpagim prej tyre, përderisa mendimi tjetër, që vinte nga Omeri, ishte i ashpër dhe i rreptë, sepse parashihte që ata të mbyteshin[4]. I Dërguari i Allahut ishte me mendimin e Ebu Bekrit. Ai gjithnjë shikonte interesin e përgjithshëm të myslimanëve, ndaj edhe mendimi i tij pasqyronte interesin e mbarë myslimanëve. Ata dhanë opinione sepse nuk kishte zbritur shpallja dhe çështja ndërlidhje me një problematikë jetësore me të

[3] Taha Xhabir el-Alevani, *Edebul ihtilaf fil Islam*, bot. V-të, el-Ma'hed el-Alemij lil Fikril Islamij, Virxhinia-SHBA, fq. 33.

[4] Ahmedi në Musned, nr. 203.

cilën nuk ishin ballafaquar më parë, prandaj zakonisht dominuan edhe këto dy opinione, ku më pas shpallja miratoi njërin prej tyre.

Më vonë pasoi edhe lufta e Uhudit që kishte një epilog tjetër nga ajo e Bedrit, madje që nga fillimi me konsultat e ndryshme në Medinë, dallonte shumë nga lufta e Bedrit.

Legjislacioni islam ka vendosur rregulla edhe në çështjet e konsultimit, duke marrë për bazë mendimin e shumicës, por duke pasur respekt e konsideratë edhe ndaj mendimit të pakicës. I Dërguari i Allahut fuqizoi këtë rregull parimor dhe punoi sipas tij, gjatë gjithë jetës së tij, e më pas shembullin e tij e ndoqën edhe shokët besnikë të tij. I Dërguari i Allahut kur kuptoi se kurejshët ishin përgatitur për betejën e Uhudit dhe se ata ia kishin mësyrë Medinës duke iu afruar kodrës Uhud, mblodhi shokët e tij dhe u konsultua me ta se çfarë të bënte, a t'iu dilte atyre apo të qëndronte në Medinë? Opinioni i tij personal ishte të mos dilnin jashtë Medinës, por të qëndronin në të, në fortifikatat e saj, e kur të vinin kurejshët, atëherë këta të luftonin me ta, ndërsa gratë e besimtarëve do të luftonin nga çatitë e shtëpive. Këtë mendim e mbështeti Abdullah ibn Ubejje dhe disa shokë të tij, mirëpo shumica e shokëve të të Dërguarit të Allahut dhanë opinion tjetër dhe ngulën këmbë në të, që të dilnin jashtë Medinës. I Dërguari i Allahut qe i pari që pranoi mendimin e shumicës, duke e bërë atë mendim të zbatueshëm dhe realizues.[5]

Të rinjtë propozuan që të dilnin jashtë Medinës dhe të luftonin me kurejshët, përderisa të moshuarit propozuan që të qëndronte në Medinë. Ai nuk ua imponoi opinionin e vet dhe veproi sipas mendimit të shumicës.

Këto dy ngjarje tregojnë për tolerancën në të menduar, gjë që nuk hasej në ndonjë vend tjetër të asaj kohe. Ndonëse ishte lider i myslimanëve dhe udhëheqës i tyre, ai nuk imponontе mendimin e tij personal, por pyeste shokët e tij se çfarë mendonin rreth problemit në fjalë. Dëgjonte me kujdes mendimet që dilnin nga shokët e tij e më pas edhe vendoste dhe zgjidhte njërin prej tyre, gjithnjë duke peshuar opinionet e ai që ishte më i dobishëm dhe më i arsyeshëm vepronte sipas tij. Kështu ai pasi që

[5] Ebu Amr Jusuf ibn Abdullah En-Nemrij El-Kurtubij, *Ed-Durer fi Ihtisari-l Megazi ves-Sijer*, bot.I-rë, Vizaretu-l Evkaf el-Misrijetu, Kairo-Egjipt, 1415h-1995 m, fq. 154: Ebu-l Kasim Abdurrahman ibn Abdullah ibn Ahmed Suhejli, *Err-Rrevdu-l Unuf*, vëll. III, fq. 245; Udeh, Abdulkadir, *Et-Teshriu-l xhenaij el-Islamij...*,, vëll.I, fq. 33.

dëgjoi gjykimin e Sa'd ibën Muadhit ndaj fisit Beni Kurejdha, i tha atij: *"Veç i ke gjykuar ata me gjykimin e Zotit."*[6] Ai gjatë konsultimit me sahabët synonte që ata t'i shtonin përpjekjet e tyre në shfaqjen e opinionit të tyre për të ofruar zgjidhje rreth një problemi të caktuar, në fusha që shpallja nuk kishte zbritur dhe nuk kishte ndonjë tekst për të.

Opinioni gjatë halifëve të drejtë

Pas vdekjes së të Dërguarit të Allahut, shpallja kreu misionin dhe për çdo paqartësi apo problematikë, më nuk zbriste Xhibrili që të kumtonte verdiktin, e as nuk ishte i Dërguari t'i informonte dhe t'u jepte përgjigje për çështje të caktuara. Mirëpo, halifët ndoqën metodologjinë e tij dhe për çdo paqartësi pyetnin njerëzit e ditur dhe vlerësonin opinionet e ndryshme të secilit. Kurdo që pikëpamjet e tyre dallonin nga njëra-tjetra, halifi udhëheqës përzgjidhte njërën prej tyre, sipas asaj që e shihte në interes të individit dhe shoqërisë, duke mos e konsideruar opinionin tjetër të panevojshëm, sepse ndodhte që më pas t'i kthehej mendimit apo opinionit të refuzuar.[7] Kështu sa për ilustrim Omer ibën AbdulAzizi, halifi i drejtë emevit, për opinionet e shokëve të Pejgamberit, kishte thënë: "Më mirë për mua[8] janë mendimet e ndryshme të shokëve të Pejgamberit se sa devetë e kuqe[9]" Këto fragmente të shkëputura nga e kaluara e lavdishme pasqyrojnë më së miri koekzistencën e opinionit, gjegjësisht të menduarit ndryshe, si koncept i ngulitur thellë në gjeneratat e hershme, madje që nga koha e të Dërguarit të Allahut, në ato fusha ku lejohet shprehja e opinionit, saqë megjithë ndarjen në mendime, ata vlerësonin lart njëri-tjetrin dhe respekti ndaj njëri-tjetrit ishte maksimal.

---

[6] Muslimi në Sahih, nr. 3314, 3315; Ibni Hibbani në Sahih, nr. 7152; Ahmedi në Musned, nr. 10743.

[7] Ebu Seri' Muhamed Abdulhadi, *Ihtilafus Sahabeh-Esbabuhu ve atharuhu fil filhil islamij*, mektebetu Medbuli, Kairo-Egjipt, fq. 14-16.

[8] Tabekat, vëll. V, fq. 581; cituar sipas Abdurrahman Sujuti, *Ihtilaful Medhahib*, Darul i'tisam, pa vit botimi, fq. 21.

[9] Devetë e kuqe ishin më të mira dhe më të shtrenjta, prandaj kjo fjalë në atë kohë simbolizonte pasurinë më me vlerë që e posedonin arabët dhe më të shtrenjtën. Prandaj, kur kjo shprehje vjen në hadithe, simbolizon pasurinë e çmuar të asaj kohe.

Opinioni tek juristët dhe hadithologët

Në kontekstin e hershëm të dijetarëve, pas gjeneratës së sahabëve, opinioni merr një kahe dhe një përmasë tjetër, por që këtu kemi një ndarje që ndonjëherë gjeneron edhe në urrejtje mes tyre. Këtu paraqiten shkollat juridike si imperativ i kohës dhe shkolla e hadithit, ku secili krijon një metodologji të veçantë nga tjetri. Ata që njiheshin me emrin si hadithologë, i dhanë konotacion negativ opinionit. Madje, në raste të caktuara sulmonin ata që jepnin opinione nga vetja, me theks të veçantë juristët e shkollës hanefite, sepse këta qenë të parët që i dhanë hapësirë opinionit dhe përpjekjes, qoftë individuale apo grupore, për arritjen e një rezultati përfundimtar në raport me problematikën e re të krijuar, e cila nuk gjente zgjidhje në tekstet e shenjta e as në konsensusin e dijetarëve paraprakë. Më vonë, të gjitha shkollat aplikuan atë që hanefitë e kishin aplikuar, si imperativ i kohës dhe si zgjidhje për problematikat e kohës. Mosmarrëveshjet mes hadithologëve dhe juristëve nuk duhet kuptuar si betejë e ndonjë primati apo superioriteti mes tyre. Përkundrazi ato ishin më tepër si çështje orientimi sesa refuzimi ndaj palës tjetër. Hadithologët ishin më tepër të ngarkuar me hadithet sesa me opinionet apo fetvatë. Ata ua mësonin të tjerëve përmbajtjen e fjalëve dhe bartjen e tyre tek gjeneratat e ardhshme. Fetvatë që u adresoheshin atyre shpeshherë nuk ishin në gjendje të përgjigjeshin, sepse shikonin rivajetet e ardhura dhe nëse nuk gjenin, nuk përgjigjeshin. Shpeshherë nëpër tubimet e dijes, kur ishin *fukaha* e *muhaddithë,* kur dikush parashtronte pyetje, sytë gjithnjë drejtoheshin tek fukahatë, ngase ishin kompetentë për përgjigje. Ebu Hanife e kishte vizituar Sulejman ibn A'meshin, i cili ishte haditholog i madh, kur ai po u linte testamentin djemve të tij. Atëherë Ebu Hanifja tha: "Kjo nuk lejohet, sepse i Dërguari i Allahut (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) ka thënë: ***"Allahu i Lartësuar ia ka dhënë të drejtën secilit që e meriton, e nuk ka testament për trashëgimtarin, përveç atëherë kur e lejojnë trashëgimtarët tjerë."***[10] Ai tha: "O ju juristë, ju jeni mjekët, kurse ne jemi

[10] Tirmidhiu në Sunen, nr. 2120, 2121 dhe thotë se hadithi është autentik.

farmacisët."[11] Kjo nuk nënkupton që nuk kishte rivalitet mes tyre në periudha të ndryshme, madje kishte edhe përbuzje dhe nënçmim, por ato më tepër ishin në raste të rralla.

Pra, opinioni gjeti përkrahje, ngase ishte imperativ dhe domosdoshmëri e kohës, e jo pse juristët dëshironin të jepnin opinione nga vetja e tyre. Ishin krijuar shumë problematika dhe tekste që ofronin zgjidhje nuk kishte, prandaj orvatja e tyre për t'u dhënë përgjigje kërkesave të tyre ishte e domosdoshme. Orvatja e tyre ishte në koordinim të plotë me burimet e fesë, ngase vet Kur'ani inkurajon autoritetin konsultativ në çështje të ndryshme, të cilat kanë si objektivë ofrimin e zgjidhjes për masën e gjerë, që pret prej organit kompetent ofrimin e zgjidhjes. Vetëm autoriteti përgjegjës (ulu-l emr) është përgjegjës për konsulta të brendshme, ofrimin e opinioneve dhe përzgjedhjen e njërit opinion si vendimtar në ofrimin e zgjidhjes për problemin në fjalë. Madje, ishte vetë i Dërguari i Allahut që kur dërgoi Muadh ibën Xhebelin në Jemen, e pyeti se me çfarë do të gjykosh, e ai mes tjerash i tha: "Me Kur'an, Sunet dhe me përpjekjet e mia (duke përdorur opinionin si konkluzë)." Kjo e fundit nënkupton që nëse problematika e adresuar nuk gjen tekst në dy burimet themelore, Kuran e sunet, atëherë atij nuk i mbetet gjë tjetër pos t'i shtojë përpjekjet individuale për të arritur deri tek një epilog i mundshëm me probabilitet. Madje, Muadhi ka përdorur tekstualisht termin "re'j-opinion", për të specifikuar autoritetin e tij intelektual karshi gjykimit të çështjeve që mund t'i paraqiten në një vend të huaj, me gjasë dallimi nga Medineja ku jetonte me të Dërguarin e Allahut, ngase secili vend i ka karakteristikat dhe rrethanat e veta.

Në këtë kontekst, vendet Islame dallonin njëri prej tjetrit. Secili kishte karakteristikat e veta. Kishte dallim nga vendi në vend, p.sh. Iraku dallonte nga Shami dhe nga Siujdhesa Arabe. Shami dhe Iraku në këtë kohë ballafaqoheshin me luftëra dhe me problematika të reja, gjë e cila nuk ndodhte në Mekë e Medinë. Prandaj, opinionet e juristëve ishin të ndry-

[11] Alaudin el-Kasani, *Bedai'*, vëll. X, fq. 515. Me këtë fjali nënkuptohet se dijetarët e mëdhenj, sikurse Ebu Hanife janë mjekët që përcaktojnë ilaçin dhe barnat sipas diagnozës, kurse shtresa më e ulët se ata u përngjajnë farmacistëve që japin ilaçe për të sëmurët dhe përcaktojnë udhëzimet e përdorimit të tyre.

shme nga vendi në vend. Le ta sjellim një shembull në mënyrë që të kuptohet më drejtë kjo çështje. Në kohën e Ebu Hanifes u themelua *fikhu-t-takdirij* (i njohur edhe si *iftiradij)*, fikhu që kishte të bënte me pyetjet hipotetike, thënë ndryshe, imagjinimi i gjërave dhe situatave që ende s'kishin ndodhur në shoqëri. Ebu Hanife kishte sajuar rreth 60 mijë situata të tilla. Imam Maliku e kundërshtonte një gjë të tillë, madje ishte kategorik kundër çështjeve hipotetike, e në takimin e tyre, Ebu Hanife e bindi atë se rrethanat në Irak ku ishte qendra e halifetit, kishte bërë që të përgatiteshin për gjëra të tilla, ndonëse të paqena, për dallim nga Medineja ku problemet ishin të pakta, prandaj, ishte e nevojshme një gjë e tillë tek ta. Gjërat që haseshin në Irak, nuk haseshin në Medine, prandaj edhe të menduarit ishte pak më ndryshe, por më vonë edhe në Medinë pranuan një metodologji sikur të hanefive. Ka mendime që i përgjigjen një mjedisi të caktuar, por për një tjetër nuk vlejnë, sikurse që i përgjigjen një kohe të caktuar, por për një kohë tjetër janë të pavlefshme. Vlen të përmendet se Omeri në një vit të caktuar për një rast kishte dhënë një fetva, ndërkohë që për të njëjtin rast, një vit më vonë, kishte dhënë fetva të kundërt. E kur u pyet për një veprim të tillë, ai u përgjigj: "Ajo ka qenë çfarë gjykuam në atë kohë (në bazë të rrethanave dhe njohurive), kurse sot gjykojmë kështu (me rrethanat dhe njohuritë e reja)."[12]

Juristët, sado që kishin opinione të ndryshme njëri me tjetrin, me theks të veçantë mes shkollave juridike, ata kishin respekt për palën tjetër, sado që opinionin e vet e shihnin më të drejtë dhe më të arsyeshëm, por gjithnjë me mundësi gabimi. Ata kur pyeteshin për palën tjetër, flisnin fjalët më të mira që ekzistonin. Madje, jo vetëm kaq, por ata edhe në praktikë, nganjëherë merrnin opinionin e kundërshtarëve, sidomos kur gjendeshin në mesin e tyre, e tëra kjo bëhej në formë të respektit. Le ta ilustrojmë këtë me dy shembuj praktik, në mënyrë që ta jetësojmë në praktikë. Ebu Hanife dhe nxënësit e tij parashihnin se abdesi prishet atëherë kur del gjaku (në sasi më të madhe), e Ebu Jusufi e pa Harun Reshidin

[12] Vizaretul Evkaf vesh-shuun el-Islamijeh, *El-Mevsuatul Fikhijetu el-Kuvejtijetu*, bot. II, Darus-Selasil, Kuvajt, vëll. II, fq. 301.

duke iu bërë atij *hixhame*[13], ai nuk mori abdes dhe u drejtua në namaz. Ebu Jusufi u fal pas tij dhe nuk e përsëriti namazin, ndonëse mendimi i tij parashihte që duhet marrë abdes. Edhe imam Ahmedi e parashihte që një person i tillë duhet të marrë abdes. Një herë e pyetën atë për një njeri që iu ka bërë hixhamja e ai pa marrë abdes ngrihet dhe falet, a ishe falur pas tij? Si të mos falem pas Malikut dhe Seid ibën Musejjebit[14] - u përgjigj Ahmedi.

Imam Shafiu një herë fali namazin e sabahut në xhematin hanefij në njërën nga xhamitë e tyre periferike të Bagdadit, dhe nuk e bëri kunutin. Hanefitë thanë se veprimi i Shafiut ishte respekt për imamin, përderisa shafitë e komentuan se ai në atë kohë ndërroi qasjen e të menduarit rreth kunutit në namazin e sabahut.[15]

Në anën tjetër, hadithologët kishin një qasje tjetër nga juristët. Ata opinionin e lirë e shihnin si të rrezikshëm dhe propagandonin që të braktisej opinioni dhe të mbështeteshin vetëm në tekste. Por, për problematikat e reja nuk kishte tekste as në Kur'an e as në Sunnet. Prandaj, ishte e domosdoshme të shprehej opinioni, në të kundërtën çfarë t'i bënin problematikave shoqërore dhe çfarë zgjidhjesh t'u ofronin njerëzve? Hadithologët nuk mund të dilnin jashtë orbitës së hadithit, dhe shpeshherë akuzonin juristët për përdorim të logjikës dhe shprehjes së opinionit, madje i quanin disa si pasues të opinionit (as'habu-rr rre'j), e me këtë, specifikisht nënkuptonin hanefitë, të cilët krahas teksteve (nusus), i jepnin rëndësi edhe shprehjes së opinionit por edhe analogjisë, kuptohet në ato çështje që nuk kishte tekst, përndryshe në ato që gjendej teksti, aty nuk kishte vend as *ixhtihadi* e as *re'ji*. Madje qenë përhapur fjalë se Ebu Hanife dhe juristët e tij më tepër pasojnë opinionin e tyre të lirë dhe analogjinë se sa tekstet profetike. Ndonëse këto fjalë nuk ishin të vërteta, por që shpeshherë Ebu Hanife xhelozohej për shkak të njohurive dhe kapacitetit të tij intelektual,

---

[13] Hixhami është lëshimi i gjakut me prerje sipërfaqësore të lëkurës. Zakonisht bëhet në venat e qafës dhe shpatulla. Është metodë efikase në shërimin e disa sëmundjeve. Shumë hadithe flasin për të.

[14] Maliku dhe Seid ibën Musejjebi mendonin se hixhamja nuk e prish abdesin. Kjo tregon për respektin e madh që kishte një dijetar ndaj dijetarëve tjerë me mendim tjetër.

[15] Vizaretul Evkaf vesh-shuun el-Islamijeh, *El-Mevsuatul Fikhijetu el-Kuvejtijetu*, vëll. II, fq. 302.

veçanërisht në fikh, dhe thuajse nuk kishte të ngjashëm me të. Kështu për shembull një herë Muhamed ibën Bakiri e pyeti Ebu Hanifen: "A je ti ai që fenë e gjyshit tim (duke aluduar në Pejgamberin a.s.) dhe hadithet e tij, i ke zëvendësuar me analogji (kijas)?"

Pyetja këtu nuk nënkupton se Bakiri kishte një mendim të tillë për të, por fjalët qenë përhapur aq shumë saqë edhe shtresa e ngritur intelektuale shtronte pyetje të tilla. Informata të tilla qarkullonin nga vendi në vend nga qarqe të caktuara, që diskreditonin personalitetin e tij, pa e njohur mirë atë dhe opinionet e tij. Andaj, në këtë kurth kishin rënë edhe një pjesë e dijetarëve, të cilët e gjykuan Ebu Hanifen nga informatat që qarkullonin për të, realisht pa e njohur atë nga afërsia.

Ebu Hanife me qetësi iu përgjigj: "Eja të ulemi dhe të bisedojmë pakëz." Kur janë ulur, ka vazhduar: "Unë do të pyes për tre gjëra, e kur të më përgjigjesh në këto atëherë ti vetë gjyko se a është e vërtetë ajo për të cilën më fajësojnë. Të lutem m'u përgjigj: "Kush është më i dobët mashkulli apo femra?"

"Femra" - është përgjigjur Muhamed el-Bakiri.

"E sa është pjesa (hiseja) që i takon femrës gjatë ndarjes së trashëgimisë?" - pyeti Ebu Hanife.

Imam el-Bakiri iu përgjigj: - "Mashkullit i takon dyfish më tepër sesa femrës."

Atëherë Ebu Hanife i tha: "Këtë që e the ti, e ka thënë edhe gjyshi yt (Pejgamberi a.s.), e po të kisha ndryshuar unë fenë e gjyshit tënd me analogji, atëherë sipas analogjisë do të thosha se femra duhet të trashëgojë pjesën më të madhe, dyfishin e mashkullit, sepse ajo është më e dobët."

Ebu Hanife më pas shtroi pyetjen tjetër: "Cili adhurim është më i vlefshëm: Namazi apo agjërimi?"

Imam el-Bakiri iu përgjigj: - "Namazi është më i vlefshëm."

Ebu Hanife shtoi: "Këtë që e thua ti, njëjtë e ka thënë edhe gjyshi yt (Pejgamberi a.s.), e sikur të veproja me analogji do të thosha se sipas kësaj gruaja kur të pastrohet nga menstruacionet do të duhej që t'i kompensojë namazet që i kanë kaluar gjatë asaj kohe, e jo t'i kompensojë ditët të cilat nuk i ka agjëruar."

Ebu Hanife më pas shtroi edhe pyetjen e tretë: "Cila konsiderohet papastërti më e madhe; urina apo sperma?"

Imam el-Bakiri iu përgjigj: - "Urina është më e papastër."

Ebu Hanife i tha: "E në qoftë se është kështu, atëherë po të kisha dashur ta ndryshoja fenë e gjyshit tënd (Pejgamberit a.s.), do të kisha kërkuar që njerëzit të pastrohen pas urinimit, e të marrin abdest pas daljes së spermës. Mirëpo, unë kërkoj mbrojtjen e Allahut nga ajo që ta ndryshojë fenë e gjyshit tënd me analogji (kijas). Pas këtyre fjalëve imam Muhamed el-Bakiri u ngrit, e përqafoi Ebu Hanifen, e puthi në faqe dhe i bëri respekt të veçantë."[16]

Fjalë sikurse ato që i thamë më lartë, sigurisht se e kishin lënduar tejmase Ebu Hanifen dhe juristët hanefitë, të cilët i jepnin rëndësi hadithit të dobët para analogjisë apo shprehjes së opinionit. E për këtë më së miri shprehet Ebu Hanife, i cili ka thënë: "Marr nga libri i Zotit; e nëse nuk gjej atëherë nga Suneti i Pejgamberit a.s.; e nëse nuk gjej as në libër të Zotit e as në Sunetin e Pejgamberit, marr nga opinionet (mendimet) e sahabëve nga cilido prej tyre dhe lë opinionin e cilitdo prej tyre, e nuk dal jashtë opinioneve të tyre; e nëse çështja përfundon tek Ibrahim Nehaiu, Ibën Sirini, Haseni, Atau, Ibën Musejebi-përmendi edhe tjerë- ata janë njerëz që kanë bërë ixhtihad, prandaj edhe unë bëj ixhtihad ashtu siç ata bënë ixhtihad."[17]

Akuza të tilla kanë ekzistuar edhe në të gjallë të Ebu Hanifes, madje i kishte dëgjuar edhe vetë Ebu Hanifja, për çka edhe kishte deklaruar: "Pasha Allahun, po gënjejnë! Po na shpifin të gjithë ata që thonë se po e preferojmë analogjinë mbi sunnetin! A thua vallë është e nevojshme të merret dhe përdoret analogjia kur kemi tekste të qarta të hadithit?!"[18]

Ndërsa për rastet kur ai dhe shokët e tij e kanë përdorur analogjinë, shprehet: "Ne e kemi përdorur analogjinë vetëm se në domosdoshmëri, dhe atë nëse nuk kemi gjetur asnjë argument nga Kur'ani, Sunneti dhe praktika e sahabëve."

---

[16] Muhamed Ebu Zehre, *Te'rihu-l medhahibi-l islamijje*, daru-l fikri-l arebij, Kairo-Egjipt, f.639-640.

[17] Ebu Bekër Hatib el-Bagdadi, *Te'rihu Bagdad*, v.XV, f.504; Mustafa Sibai, *Es-Sunetu ve mekanetuha fit-teshriil Islamij*, Dar el-Verrak-el-Mektebul Islamij, pa vit botimi, f.438.

[18] Ebu Zehre, f.273; cituar sipas Shefik Kurdiç, Ebu Hanife dhe namazi në medhehbin hanefi, f.67.

Shprehja e opinionit në kohën aktuale

Koha aktuale ka dëshmuar një stagnim të madh të myslimanëve, ku si pasojë e mos funksionimit të *ixhtihadit* të mirëfilltë, ka ardhur deri tek shthurja e opinionit *(re'jit)* dhe degradimi i tij. Nuk ka mbetur institucion i mirëfilltë pa u baltosur dhe sulmuar nga njerëz të pa shkolluar e të paditur, të cilët vrapojnë symbyllur pas ideologjive të dyshimta. Institucionet kredibile që përfaqësojnë myslimanët në të katër anët e botës e kanë humbur efektin përballë grupeve e klaneve të pa-arsimuara e të pashkolluara. Një pjesë e tyre, posa "udhëzohen", braktisin arsimin dhe dijen. Në vend se udhëzimi i tyre t'ua shtojë edhe më shumë ambiciet për lexim dhe ngritje, ata e izolojnë veten dhe mjaftohen me disa broshura. E, në vend se të merren me shkencë dhe me studimin e ndonjë dege të saj, ata lexojnë disa broshura dhe libërtha dhe pastaj mundohen t'ua mësojnë fenë prijësve të dijes dhe hoxhallarëve, të cilët me shumicë kanë studiuar nëpër qendrat e dijes islame. Është mjerim i madh kur sheh të tillët që në vend të përfitimit, merren me seleksionime të hoxhallarëve, duke u treguar të tjerëve se filan hoxha është i dalë nga feja, tjetri ka devijuar, njëri bën të pasohet e tjetri duhet të mohohet. Madje, hartohen edhe lista të ndryshme të hoxhallarëve aktivë dhe sipër tyre shkruhen: "Keferna bikum!" që nënkupton se "ne u kemi mohuar juve (u kemi bërë tekfir)." Madje, këtë sintagmë e shndërrojnë në gjënë kryesore të fesë, ekuivalent me dëshminë e hyrjes në fe, duke deklaruar se së pari duhet mohuar besimin e myslimanëve të "devijuar e të lajthitur", e pastaj duhet pohuar njëshmërinë e Zotit!

Këta janë traumatologët e lajthitur, të cilët pretendojnë se çdo gjë sillet rreth tyre, e të tjerët me shumicë absolute jo vetëm që janë të devijuar, por edhe të dalë edhe nga Islami. E në rrethin e tyre vicioz, mbetën shumë pak persona në mbarë botën që janë në të vërtetën! Të tillët nisen nga premisa të gabuara, ngase për një gabim apo lajthitje të ndokujt, ata nuk ngurojnë ta shpallin heretik, përderisa në shoqërinë islame përgjatë gjithë historikut të saj, mjaftonte një element islam që individi të konsiderohej si mysliman, ndonëse kishte dhjetëra elemente të kundërta. Po ashtu, edhe në kohën kur kishte halifat dhe ndëshkimet bëheshin publike, mjaftonte një dyshim i vogël për ta eliminuar ndëshkimin e paraparë,

ngase ekzistonte një rregull i artë: "Më mirë është që gjykatësi të gabonte në falje se sa në ndëshkim!" Mund të ndodhte që kishte fakte dhe argumente për gabimin e personit të caktuar, mirëpo në ndërkohë paraqitej një dyshim i vogël dhe në vend të ndëshkimit, gjente vend falja.

Të tillët dalin haptazi edhe ndaj librave religjiozë, duke i klasifikuar në libra që meritojnë të digjen dhe në libra që duhet refuzuar. Asnjëri prej tyre nuk ka *background* të pastër islam. Shumica e tyre janë njerëz me të kaluar të keqe. Këta dhe mësuesit e tyre nuk vijnë nga akademitë e njohura të shkencave islame, por vijnë nga kolegje e fakultete që nuk dihet saktë se kush janë themeluesit e tyre. Realisht nuk dihet se kush qëndron pas tyre, por ajo që dihet dhe që shihet është fakti se përveç dëmit dhe trazirave që shkaktojnë në të menduar dhe përçarjes së radhëve të myslimanëve, nuk kanë asnjë mirësi.

Kur shkrimet e Ibën Rushdit nuk u kuptuan drejtë, nga keqkuptimi i tyre, në skenë, dolën njerëz të kësaj kategorie për të cilët jemi duke folur dhe dogjën librat e tij, me pretekstin se ai po sulmonte Islamin. Sa bukur iu përgjigj atyre Ibën Rushdi: "Përkundrazi po e luftoj injorancën tuaj!"

Sa bukur qe shprehur edhe poeti arab i cili tha:

Çfarë dëmi mund t'i bëhet një deti të madh
Nëse një fëmijë hedh një gur në të?

Realisht, jemi në një kohë të trendeve të çuditshme, ku dijetarët e mirëfilltë nuk pasohen dhe shumë pak u dëgjohet zëri i tyre, për shkak të propagandave tjera, ku petroli dhe dollari e kanë bërë të veten, saqë janë instaluar dijetarë që kurrë nuk janë ulur të mësojnë para dijetarëve. Për ta nuk dëshmoi askush se njohin shkencat islame. Mjaftoi një *hashtag* apo një sekuencë ligjërate e shoqëruar me një muzikë melankolike në sfond, dhe ata brenda natës u bënë "të njohur". Nuk ka më filtra dhe dëshmi, por ka vetëm shtypje butoni dhe çuditesh kur sheh veten të nesërmen se u bëre dijetar i madh dhe pas teje ke një masë të zjarrtë. Klikimet e shumta, nga një njeri të panjohur e kthyen në dijetar të shekullit. Po flasim për kohën, ku dija nuk matet e as që vlerësohet para tjerëve, madje nuk ka fare filtrim, mirëpo mjafton një klikim në tastaturë dhe në skenë na paraqi-

tet një dijetar gjigand, i gjithanshëm, i cili është në gjendje të përgjigjet sa në ekonomi, aq edhe në biologji, kimi dhe shkencat tjera, ndonëse për kimi ai nuk ka mësuar më tepër se një gjysmëvjetor apo një vit të plotë, e për ekonomi mund të ketë mësuar gjërat elementare në shkollë të mesme apo në fakultet brenda një viti të caktuar.

Në këso rrethanash, opinioni i mirëfilltë ka humbur efektin e duhur e në vend të tij janë instaluar opinione të dirigjuara nga njerëz të pa profilizuar dhe pa përgatitje akademike. Masa e gjerë, në masë të madhe nuk është në gjendje të bëj dallimin mes atij që ka përgatitje akademike të dëshmuar dhe mes një oratori apo një dijetari të rrjeteve sociale që është ngritur brenda një nate, që ndoshta as në ëndërr s'e kishte besuar se do të bëhej i tillë. Në situata të tilla, sado që opinionet e përgjegjësve të barten, nuk mund ta kenë vlerën që bartin e as që mund ta arrijnë mesazhin e duhur, për shkak se është punuar bukur shumë nga ideologji tjera që opinionet dhe verdiktet fetare që dalin nga njerëz kredibil e të dëshmuar, të shihen si të papranuara, për shkak se -sipas tyre- nuk ndjekin metodologjinë e duhur (sic). Janë ngritur njerëz që mezi kanë mbaruar një fakultet dhe kurrë në jetën e tyre s'janë ulur para dijetarëve për të mësuar e as që dikush prej dijetarëve dëshmoi për diturinë e tyre. Masa e zjarrtë opinionin e tyre e sheh si obligim dhe detyrim, kurse opinionin e përgjegjësve e sheh me skepticizëm. Kjo gjë po ndodh me theks të veçantë tek ato vende që politika i ka baltosur krerët e religjionit dhe se këta të fundit janë plotësisht të varur nga të parët.

Ngulfatja e opinionit në kohën aktuale, zakonisht po ndodh në vendet teokratike, ku sundimtarët të etur për pushtet kanë futur në lojërat e tyre edhe institucionin fetar dhe pjesën dërrmuese të dijetarëve dhe në raste të tilla, dekretet e dijetarëve apo institucionit përgjegjës zakonisht janë në një vijë me atë politik. Shkoqitja e teksteve dhe nxjerrja e tyre nga konteksti, ka bërë që ulemaja shpeshherë të japin dekrete që kanë tërbuar masën e gjerë dhe taborin tjetër të dijetarëve. Dekrete të tilla që shpeshherë janë kritikuar se kanë ardhur si pasojë e ndërhyrjes së qartë të politikës, janë shkruar pikërisht nga politikanët e jo nga dijetarët Madje, në disa vende të botës islame, ku në pushtet janë mbretërit e paprekshëm, janë hartuar enkas me qindra libra që gjykojnë për paprekshmërinë e atij su-

ndimtari despotik. E, në raste të tilla, janë në gjendje për ta shfajësuar mbretin edhe me tekste sheriatike të nxjerra jashtë kontekstit!!!

Në situata të tilla është investuar në formimin e një mendjeje të ngurtë, pa i lënë asaj shumë hapësirë për të menduar e gjykuar rreth gjërave dhe tejkalimit të sfidave dhe është krijuar artificialisht një rrugë e telekomanduar që na tregon se nga të ecim dhe kur duhet të ecim. Madje, qëllimshëm janë krijuar debate të mëdha e të pafundme që prekin kryesisht dy sferat kryesore; atë të besimit dhe jurisprudencës, ku në të parën janë hedhur dyshime të panumërta rreth dijetarëve dhe besimit të tyre, dhe ajo që vlen të potencohet është fakti se kolosët e sferës së besimit me shumicë janë paraqitur të devijuar në besim dhe se rrallëkush ka shpëtuar prej një devijimi të tillë, sipas tyre. E, në fushën e jurisprudencës janë ndezur grindjet dhe konfliktet kundër doktrinave të njohura juridike dhe shpeshherë, ato janë paraqitur si një aksident historik dhe shmangie nga rruga e të parëve. Ironikisht janë paraqitur si aksidente historike ndonëse afërsia e tyre me të parët dhe me vet të Dërguarin e Allahut është vetëm një hap, ndërsa është paraqitur nevojë imediate rreshtimi pas atyre që nuk pasojnë doktrinat e njohura juridike, ani pse mes tyre dhe gjeneratave të para janë plot katërmbëdhjetë shekuj.

Përfundim

Punimi në fjalë tenton të hedhë shkëndija faktesh e argumentesh për vendin e merituar që duhet ta ketë shprehja e opinionit apo verdikti nga personat e autorizuar dhe përgjegjës. Ai si i tillë ka bazë që nga akti më i lartë siç është Kur'ani, pastaj, gjenë praktikë tek i Dërguari i Allahut dhe shokët e tij, që ishin shembull e model për gjeneratat që erdhën pas tyre. Ky rrugëtim pati sfida e peripeci, por vazhdoi rrugën dhe gjeti mënyrën për të depërtuar, me gjithë pengesat e vazhdueshme që shfaqeshin. Sot, me gjithë përparimin dhe avancimin e njeriut dhe lehtësimin e qasjes në dituri të shumta, lirisht mund të themi se e ka humbur efektin e duhur që du-het ta ketë në shoqëri. Kjo shoqëri duhet të orientohet dhe t'i pranojë opinionet që dalin nga njerëzit autoritativë, përgjegjës dhe njohës të rrethanave, e jo t'i refuzojë opinionet e tyre e t'i pranojë opinionet që ofrohen kryesisht përmes rrugicave dhe përmes atyre që nuk janë fare kompetente.

Literatura e konsultuar:

- Kur'ani
- Abdurrahman Sujuti, *Ihtilaful Medhahib*, Darul i'tisam, pa vit botimi.
- Ebu Amr Jusuf ibn Abdullah En-Nemrij El-Kurtubij, *Ed-Durer fi Ihtisari-l Megazi ves-Sijer*, bot.I-rë, Vizaretu-l Evkaf el-Misrijetu, Kairo-Egjipt, 1415h-1995m.
- Ebu Seri' Muhamed Abdulhadi, *Ihtilafus Sahabeh-Esbabuhu ve atharuhu fil filhil islamij*, mektebetu Medbuli, Kairo-Egjipt.
- Muhamed Ebu Zehre, *Te'rihu-l medhahibi-l islamijje*, daru-l fikri-l arebij, Kairo-Egjipt.
- Mohammad Hashim Kamali, *Freedom of Expression in Islam*. Ilmiah Publishers, Selangor, Malaysia, 2000.
- Mustafa Sibai, *Es-Sunetu ve mekanetuha fit-teshriil Islamij*, Dar el-Verrak-el-Mektebul Islamij, pa vit botimi.
- Taha Xhabir el-Alevani, *Edebul ihtilaf fil Islam*, bot. V-të, el-Ma'hed el-Alemij lil Fikril Islamij, Virxhinia-SHBA
- Vizaretul Evkaf vesh-shuun el-Islamijeh, *El-Mevsuatul Fikhijetu el-Kuvejtijetu*, bot. II, Darus-Selasil, Kuvajt

Ejup HAZIRI

FREEDOM OF EXPRESSION

(Summary)

The free expression of views and opinions is without any doubt very important and meaningful. The syntagm hurrijet err-rre'j (meaning freedom of expression) differs from hurrijet el-kavl (freedom of speech). Muslim scholars have often used the term hurrijet err rre'j instead of hurrijet el-kavl as it is more precise and is better known from the past.

This paper aims to shed light on important elements having to do with freedom of expression, retrospecting different examples from the past, when the right to express one's opinions had a different treatment as compared to that today when honesty is supressed.

أيوب حازيري

التعبير عن الرأي – نظرة رجعية

(خلاصة البحث)

إن التعبير الحر عن الرأي هو بلا شك عنصر هام للغاية ومهم للغاية. مع مصطلح حرية التعبير لدينا إننا نقصد تعبير حرية الرأي، والتي تختلف في بعض الأحيان من تعبير بمصطلح حرية القول. إذا بحثنا في تقاليد علماء المسلمين في السابق ، فإننا نرى أن هذين المصطلحين تشتت المفهوم في أحيان كثيرة. وغالبا ما استخدمو مصطلح حرية الرأي ليفهم منه حرية القول، لأنه مصطلح أكثر دقة وأعتقد أشهرها كمصطلح منذ الأجيال المبكرة، وكما سوف نوضح في هذه الورقة .وتهدف هذه الورقة إلى تسليط الضوء على العناصر الهامة المتعلقة بحرية التعبير أو الرأي، و بإحضار في وقت لاحق أمثلة مختلفة من الماضي المجيد، حيث كان للجمهور معاملة مختلفة تماما، من أجل التوصل إلى استنتاج مفاده أن الحاضر قد طغى على رأي حقيقي وواقعي.

Taxhedin BISLIMI

KONCEPTI I FET'HI DUREJNIT MBI AUTORËSINË
Studim krahasimtar në jurisprudencën Islame*

Abstrakt

Me këtë punim kemi për qëllim të shënojmë dhe sqarojmë diç mbi qëndrimin e jurisprudencës islame në lidhje me zbulimet (shpikjet) dhe të drejtën autoriale. Ndër dijetarët e parë bashkëkohorë të cilët studiuan këtë çështje në thellësi dhe që solli prurje dhe sqarime të detajuara për dispozitën e kësaj çështjeje, është dijetari i njohur në botën islame, fikhisti bashkëkohor Dr. Fet'hi Durejni. Në këtë studim Dr. Durejni është bazuar në qëndrimin e dijetarëve të katër medhhebeve dhe, pas një studimi të thukët, të mbështetur mbi bazat juridike të sheriatit islam, përfundoi me dhënien e dispozitës së kësaj çështje, kuptohet sipas mundësisë dhe ixhtihadit të tij. Ne në këtë punim në pika të shkurta do të bëjmë përpjekje të paraqesim konceptin e tij rreth këtij studimi.

Fjalët kyçe: *Durejni, e drejta autoriale, Sheriati etj,*

* Kjo temë ka për bazë librin, *El-Fikhul islami el-mukaren mea-l medhahib*, nga autori Fet'hi Durejni, matbaa tarbin, 1980, Damask, ff. 221-296.

Hyrje

Që në fillim, Dr. Durejni shpjegon arsyet e këtij studimi, duke theksuar se asnjë nga fukahatë e mëhershëm apo imamët e medhhebeve të fikhut, nuk kanë shkoqitur dhe studiuar këtë çështje në mënyrë të bollshme dhe objektive, përveç asaj pak materieje që kemi gjetur nga Imam Karrafi, dijetar nga medhhebit malikij, në librin e tij **"El-Furuk",** porse këto thënie nuk e zbërthejnë dhe nuk e analizojnë këtë çështje në detaje nga të gjitha këndvështrimet, ashtu që e njëjta të formojë një vizion real, preciz dhe të përgjithshëm në lidhje me dispozitën e kësaj çështjeje.

Kjo çështje në shekujt e kaluar nuk ka ekzistuar si fenomen, ashtu siç e shohim dhe e vërejmë ne sot. Por, si rezultat i zhvillimit dhe përparimit të diturive, shkencës, teknologjisë, ndërtimtarisë, ekonomisë etj, dolën në shesh mënyra dhe metoda të shumta për botim dhe publikim. U themeluan shumë shtëpi botuese të cilat merren me botimin dhe shpërndarjen e botimeve të shkruara, për dallim nga e kaluara, kur dituria koleksionohej, shkruhej dhe ruhej në dorëshkrime dhe në kopje të kufizuara. Në anën tjetër, zbulimet shkencore nuk kishin arritur në atë shkallë të zhvillimit ashtu siç janë sot, sepse tashmë këto zbulime, shpikje dhe inovacione gjenden gjithandej në botë, nëpër universitete, qendra kulturore, laboratorë shkencorë dhe fusha të tjera praktike.

Marrë parasysh këto fakte, kësaj teme në këtë kohë ia vlen t'i përkushtohet një hulumtim i veçantë, edhe atë në bazë të asaj që e kërkon interesi, që kjo përpjekje të jetë e gjithanshme, me qëllim që të zbardhet dispozita e kësaj çështje në jetën shkencore, kulturore, ekonomike, pse jo edhe në qytetërimin në përgjithësi.

Sa i përket studiuesve bashkëkohor, të gjitha mendimet dhe shkrimet e tyre në lidhje me këtë çështje nuk mund t'i konsiderojmë si ixhtihad, sepse, ata nuk kanë bërë ndonjë studim shkencor, përveç se kanë bërë disa sqarime dhe komentime të shkurta.

Kjo temë është aktuale në kohën tonë madje dhe në nivel botëror, andaj si e tillë nuk guxon të studiohet përciptazi dhe sipërfaqësisht. Jam i mendimit që këtë çështje duhet ta studiojmë nga disa këndvështrime, në bazë të parimeve dhe rregullave të secilit medhheb dhe në bazë të rregullave të përgjithshme të sheriatit islam. Të gjithë këtë do ta bëjmë duke kërkuar dhe synuar atë që është e drejtë dhe e vërtetë te Allahu i madhërishëm.

1. PËRKUFIZIMI I SHPIKJES EDHE ZBULIMIT

Shpikje dhe zbulim do të thotë: "Vizionet mendore dhe intelektuale nga të cilat zbërthehet dhe zbulohet aftësia mendore dhe talenti i thellë, i cili është në mendjen e një dijetarit, poeti a të ngjashëm me ta, gjëra të cilat ai i ka zbuluar dhe një gjë të tillë para atij askush nuk e ka bërë".

2. PRODUKTI MENDOR I SHPIKUR SIPAS IXHTIHADIT TË MEDHHEBVE NË JURISPRUDENCËN ISLAME, KONSIDEROHET VLERË MATERIALE,

a. Sipas shumicës së juristëve islam nga shkollat juridike malikij, shafiij dhe hanbelij, dobitë vetvetiu konsiderohen pasuri të vlefshme, ngjashëm si pasuritë reale (a'jan), pa ndonjë dallim mes tyre, nëse ligjërisht është i lejuar përdorimi dhe shfrytëzimi i tyre.

Në bazë të kësaj, konstatohet se mbi këto dobi, mund të lidhen kontrata si forma legale përmes së cilave bëhet transferimi i pronësisë, respektivisht, bëhet shkëmbim. Nëse dikush një gjë të tillë e merr me pa të drejtë dhe e përvetëson, sendi i marrë duhet t'i kthehet pronarit të vërtetë, nëse ajo ekziston ashtu siç ka qenë në realitet, e nëse nuk ekziston porse ajo është shkatërruar apo është konsumuar, atëherë duhet garantuar dhe kompensuar. Nga kjo nënkuptohet se dhunuesi bartë përgjegjësi për gjënë e dhunuar. Meqë dobitë konsiderohen pasuri e vlefshme, atëherë mbi këto vlejnë edhe dispozitat e trashëgimisë, do të thotë se këto dobi trashëgohen.

b. Dijetarët e mëhershëm (mutekaddimin) të medhhebit hanefij, janë të mendimit se dobitë shndërrohen në pasuri të vlefshme materiale, pasi që për ato të bëhet kontratë qiraje. Sipas tyre, kjo çështje vërtetohet jashtë normave të përgjithshme, në mënyrë të veçantë (istithnaë). Ajo që e arsyeton këtë dispozitë është interesi i përgjithshëm (maslahatul amme) dhe për shkak se për një gjë të tillë njerëzit kanë nevojë në jetën e tyre të përditshme. Një veprimtari e tillë në mesin e njerëzve është bërë traditë, kurse tradita në këtë rast për burim dhe mbështetje ka interesin (dobinë) dhe nevojën (haxhe), andaj t'i largosh dhe ndalosh njerëzit nga traditat e tyre do të thotë t'i fusësh ata në vështirësi, kurse vështirësia në fenë islame është e ndaluar, Allahu xh.sh. thotë:

وَلَوْ شَاء اللَّهُ لأَعْنَتَكُمْ إِنَّ اللَّهَ عَزِيزٌ حَكِيمٌ

"E sikur të donte Allahu, do t'ju detyronte me punë të vështira** (të rënda). **Vërtet, Allahu është i Plotfuqishëm dhe i Urtë". (El-Bekare, 220). Mirëpo, Allahu xh.sh. nuk deshi që robërit e Tij t'i rëndonte dhe t'i ngarkonte me vepra të rënda e të vështira, Allahu xh.sh. thotë:

وَمَا جَعَلَ عَلَيْكُمْ فِي الدِّينِ مِنْ حَرَجٍ

"Dhe nuk ju obligoi në fe me ndonjë vështirësi". (El-Haxhx, 78).

Në bazë të kësaj që thamë, te këta dijetarë, kontrata është ajo e cila dobitë dhe sendet kuptimore i shndërron në pasuri materiale të vlefshme, sepse këtë e lejon jurisprudenca islame, nga fakti se kjo është përjashtim dhe e veçantë nga parimet dhe rregullat e përgjithshme të sheriatit islam. Sipas juristëve hanefij, që sendi të ketë vlerë materiale sipas sheriatit islam, duhet detyrimisht t'i plotësoj dy kritere, që janë:

- Të jetë pasuri reale (ajni). Kjo do të thotë, që sendi (gjëja) të ketë ekzistencë dhe natyrë materiale, ekzistim të prekshëm me të cilin mund të zotërohet, të kontrollohet dhe të ngel së ekzistuari.
- Të jetë me vlerë (tekavvum). Të jetë i lejuar shfrytëzimi dhe përdorimi i tij sipas sheriatit islam.

c. Dijetarët e mëvonshëm të shkollës juridike hanefite, shkojnë nga ajo se, edhe dobitë kanë vlerë materiale, ashtu siç është qëndrimi i tri shkollave tjera islame. Sipas juristëve të mëvonshëm hanefij, nënkuptohet se çdo send që sipas traditës së njerëzve ka vlerë, ajo realisht ka vlerë, pavarësisht nëse është pasuri reale (ajn), dobi apo e drejtë. Kështu konstatuan juristët hanefij të mëvonshëm duke u mbështetur në *Istihsan,* i cili është njëri nga burimet e sheriati islam, e *Istihsani* është mbështetur mbi traditën e njerëzve dhe në interesin (dobinë) apo në nevojën e tyre. Dijetarët hanefij në literaturën bazë të tyre shprehen se "kur një gjë e tillë është bërë traditë gjatë këmbimit (kontratë me shpërblim), atëherë kjo konsiderohet pasuri".

Konkluzë: Bazuar në këto kritere dhe parime esenciale, nxjerrim këto konkluza.

- Shpikja, zbulimi, përpilimi, autorësia etj, janë dobi me efekte të dukshme dhe të qarta.
- Ato janë fryt i kontributit të elitës së zgjedhur të dijetarëve, të cilët janë shpikës dhe zbulues.
- Shpikjet dhe zbulimet e tilla në mbarë botën kanë vlerë materiale dhe një gjë e tillë nuk mund të injorohet, dhe
- Përmes shpikjeve, zbulimeve, përpilimeve të tilla plotësohen dëshirat dhe nevojat e njerëzve në jetën e përditshme.

Për fund, duke u bazuar në këto fakte, vërtetohet se sipas dijetarëve të katër shkollave juridike islame, kjo konsiderohet vlerë materiale e vlefshme.

3. MBËSHTETJA JURIDIKE E SË DREJTËS SË AUTORËSISË SË ZBULIMIT

E drejta juridike e së drejtës së autorësisë së zbulimit, për bazë ka traditën (urfin) dhe interesin e përgjithshëm (dobinë- maslahatul mursele), që fillimisht ndërlidhet me të drejtën ekskluzive (private-personale) dhe më pas ndërlidhet edhe me të drejtën e përgjithshme (kolektive). Kur Ligjvënësi vërteton ndonjë të drejtë, atë e vërteton në bazë të vendimit, ndërsa vendimi bazohet dhe nxirret nga ndonjë prej burimeve të sheriatit (jurisprudencës) islam, e një ndër këto burime të sheriatit është tradita dhe interesi (dobia- maslahatul mursele).

- Tradita. Sa i përket traditës si fondament për autorësinë e zbulimit, inovacionit, botimeve, përpilimeve etj, kjo është e qartë dhe realitet i pamohueshëm. Kjo nuk ka të bëjë vetëm me botën islame (sheriatin islam), porse kjo është traditë globale botërore. Tradita është burim i formimit të të drejtave, në ato çështje për të cilat nuk ekziston argument tekstual, dhe që tradita e tillë nuk bie ndesh me ndonjë argument tekstual në lidhje me çështjen në fjalë, ose nuk ekziston ndonjë tekst i cili ndalon një gjë të tillë. Argumentet të cilat ekzistojnë në lidhje me këtë çështje, vërtetojnë

se sheriati e kërkon një gjë të tillë, madje këtë e ka bërë peshojë dhe kriter për dallimin dhe vlerësimin midis njerëzve dhe popujve.

- **Interesi** (maslahatul mursele). Interesi sipas juristëve islam është argument legjitim dhe intencë e sheriatit islam. S'ka dyshim se dituria e dobishme është shkak për dobinë e madhe dhe gjithëpërfshirëse, andaj kjo në mënyrë të prerë është qëllimi i ligjvënies, interesat e tilla duhet të jenë bazë për nxjerrjen e dispozitave. Këto dispozita i vërtetojnë të drejtat autoriale personale, personit i cili i ka prodhuar ato, e që është e drejta e dijetarit.

Kurse sa i përket faktit se, ky interes ndërlidhet me të drejtën e përgjithshme (inkluzive - hakkul am), është nga fakti se dituria ndërlidhet me interesin dhe dobinë e përgjithshme, dhe pa dyshim, se jo vetëm një popull ka interes, por nga kjo përfiton dhe ka dobi e tërë njerëzia.

Bazuar në këto fakte, e drejta e autorësisë së shpikësit mbi ato zbulime të cilat i ka shpikur, nuk ngel vetëm e drejtë e tij personale (ekskluzive), në të cilat askush nuk mund të jetë pjesëmarrës, por këto shpikje gërshetohen jo vetëm me të drejtën e përgjithshme të muslimanëve, por edhe me të drejtën e të gjithë njerëzve, e që nënkupton se e drejta e Allahut xh.sh. (hakkull-llah) ekziston dhe gjendet në të gjitha të drejtat personale (individuale).

Realisht, sipas sheriatit islam, interesi (dobia) i cili ndërlidhet me të drejtën e përgjithshme dhe me të drejtën e personale është baza dhe mbështetja e traditës së shëndoshë, nga fakti se njerëzit nga natyrshmëria e tyre nuk bëjnë traditë, por merren me ato sende në të cilat ka dobi dhe janë në interes të tyre, kurse sheriati lejon një gjë të tillë, përderisa ajo nuk bie ndesh me parimet dhe udhëzimet e sheriatit.

Konkluzë:

Në bazë të asaj që thamë deri më tani del se:

- Nëse punën intelektuale dhe rezultatet e asaj pune nuk i konsiderojmë si vlerë materiale, duke qenë në të njëjtën kohë të vetëdijshëm se produkti mendor është vlerë materiale, siç është e drejta e pronësisë mbi sendin e zbuluar, e cila i njihet dijetarit i cili e ka shpikur, atëherë një mospërfillje e tillë shpie në stagnimin dhe heqje dorë nga ana

e dijetarëve që të vazhdojnë rrugëtimin e tyre me shpikje dhe produkte mendore. Natyrisht, një gjë e tillë konsiderohet e ndaluar, sepse kjo llogaritet si shpërfillje, derdhje dhe humbje kot si e interesit të përgjithshëm po ashtu edhe e interesit individual (personal). Dihet fare mirë se humbja dhe shpërfillja e këtyre të drejtave, bie ndesh me dëshirën dhe synimin e vërtetë të ligjvënies.

- Mos llogaritja si vlerë dhe e drejtë materiale (hakkul mali) për autorin, shpikësin etj, bie ndesh me parimin e përgjithshëm të sheriatit islam, parim ky i cili vërteton se *"secili person e gëzon të drejtën e tij të plotë, për frytin e kontributit të tij"*. Vlera dhe haku për kontributin e tij nuk guxon t'i pakësohet e as t'i vonohet, e lëre më t'i mohohet dhe të mos i jepet atij. Mosdhënia e hakut llogaritet prej llojeve të ngrënies së pasurisë dhe të drejtës së tjetrit, pa të drejtë, e kjo me argumente tekstuale të prera, është haram-e ndaluar, kur dihet fakti se, sheriati diturinë e dobishme e konsideron vepër, madje edhe prej veprave më të mira, kurse e drejta e njeriut për veprat e tij është e garantuar në fenë islame.

4. TË DREJTAT AUTORIALE KUNDREJT BOTUESIT DHE SHFRYTËZUESIT

4.1. Kriteri për vlerësimin e dobisë

Vlera e dobisë përcaktohet në bazë të kopjeve për të cilat janë pajtuar botuesi dhe autori, apo, numrin dhe sasinë e fotokopjeve, apo, numrin dhe llojin për të cilat është bërë kontraktimi për ndërtimin apo plasimin e sendeve të shpikura. Kështu që në rast se ato harxhohen (f.v. tirazhi i librave të një botimi), atëherë përsëri rikthehet e drejta e autorësisë (dobisëmenfea) tek autori dhe shpikësi.

Në lidhje me këtë çështje Dr. Durejni konstaton se, llogaritjen e dobive si vepër e shpikur e intelektit, të cilat janë fryt i mendjes shpikëse, kontrata e cila bëhet mbi ato fryte konsiderohet kontratë shitblerjeje e jo kontratë qiraje. Kjo për faktin se blerësi dhe shfrytëzuesi i sendit të blerë, siç është kopja e ndonjë libri apo e ndonjë mjeti tjetër, pavarësisht nëse

ajo është vetë artikulli apo dobia e tij, përcaktohet me sasinë e sendit të shitur apo dobinë e tij, edhe atë në bazë të numrit të kopjeve, kështu që zotimi i blerësit mbi sendin e blerë është zotim pronësie (hijaze mulk) e jo zotim garancie (hijaze emane).

4.2. Lidhjet të cilat i formon shitja e kopjeve dhe sendeve mes botuesit dhe shfrytëzuesit

Lidhjet të cilat i formon kontrata mes botuesit dhe shfrytëzuesit, siç janë pronarët e bibliotekave tregtare dhe ato shkencore dhe të lexuesve në përgjithësi (në shumicën e rasteve), është sasia e dobisë e përkufizuar me vetë kopjen, sepse ai ka pronësuar atë sasi të dobisë, andaj detyrimisht pronëson edhe dobinë (menfaa) dhe e zoton (hijaze) vetë sendin në të cilin qëndron dobia (librin, mjetin etj).

Në bazë të kësaj, blerësi i cili e ka pranuar (ka blerë) nga botuesi nuk e pronëson esencën e dobisë (menfaatu) të cilën e ka në pronësi vetë shpikësi (autori), nga fakti se vetë botuesi nuk pronëson dobinë (të njëjtit iu është pronësuar), por ai pronëson sasi të caktuar, të cilat janë të kufizuara me numrin e kopjeve. Prej dispozitave të vërtetuara në jurisprudencën islame është se, *"Pronari nuk mund t'i pronësojë dikujt tjetër më shumë se sa pronëson ai vetë"*.

Prandaj, nëse botuesit nuk i lejohet që dikujt tjetër t'i pronësojë përveç asaj sasie për të cilën janë marrë vesh, atëherë çdo kontratë pronësie e cila buron nga botuesi dhe e tejkalon sasinë për të cilën janë dakorduar, konsiderohet e kotë (jo ekzistente, nul kontratë) dhe rrjedhimisht e ndaluar (haram), përveç nëse një kontratë të tillë e lejon dhe pajtohet autori (shpikësi), sepse, kjo llogaritet se ai ka qeverisur në pasurinë e tjetrit.

4.3. E drejta e institucioneve

Bibliotekat e universiteteve, të qyteteve, shkollave dhe ngjashëm me to, qendrat kulturore, tregtare etj, fitojnë të drejtën e shfrytëzimit, ngjashëm siç është rasti me personin fizik, dhe atë, qoftë në sasinë e shitjes apo mënyrat e sjelljes (të vepruarit- menaxhimit), por krejt kjo, duhet të jetë brenda kufijve të lejuar.

Këto institucione posedojnë të drejtën që t'ua lejojnë vizituesve të tyre të shfrytëzojnë librat, por shfrytëzimin mund ta bëjë vetëm vizituesi e jo ta marrë librin për dikë tjetër. Këto institucione mund t'i shesin kopjet të cilat i kanë blerë më parë, nëse për ato më nuk kanë nevojë. Por duhet theksuar se këto nuk posedojnë të drejtën e botimit e as të fotokopjimit pa lejen e autorit, qoftë me kompensim apo të.

4.4. Përfitimi nga shpikjet dhe përpilimet e të tjerëve

I lejohet shfrytëzuesit të librit etj, që të përfitojë nga zbulimet dhe përpilimet e të tjerëve, por patjetër, duhet cituar dhe referuar mendimeve të tyre. Përfitimi nga veprat e zbuluara nga të tjerët, fetarisht është e lejuar, por me kusht që të mos cenohet e drejta e autorit, të mos i përvetësohet dhe të mos i shfrytëzohet pa të drejtë, por detyrimisht duhet të përmendet se nga i ka marrë ato ide dhe t'i referohet burimit bazë. Kjo nënkupton se në asnjë mënyrë nuk lejohet plagjiatura, përvetësimi dhe vjedhja e veprës së tjetrit, qoftë pjesërisht, qoftë tërësisht, sepse kjo llogaritet atak mbi kontributin e autorit, ngjashëm me sulmin dhe atakimin ndaj ndonjë sendi material nga pasuria e tij, veprim i cili me argumente të prera është i ndaluar (haram).

4.5. Autori nuk guxon të pengojë të tjerët të shfrytëzojnë zbulimet e tij

Autori nuk posedon të drejtën që t'i ndalojë të tjerët t'i shfrytëzojnë dobitë shkencore nga zbulimet e tij, sepse në këto zbulime gjendet e drejta e Allahut, që nënkupton se, në çdo të drejtë të individit (personit) ekziston edhe e drejta e Allahut xh.sh. (e drejtë e shoqërisë). Mirëpo, autori ka të drejtë ta pengojë dhe ndalojë shfrytëzimin material (financiar) pa të drejtë, nëse ajo bëhet pa lejen e tij, e nëse ai lejon, atëherë është e lejuar. Po ashtu ai ka të drejtë ta pengojë dhe të mos e lejojë plagjiaturën. Përndryshe, nëse ai e ndalon, atëherë kjo konsiderohet fshehje e diturisë, vepër kjo e cila është e ndaluar në fenë islame. Pra, autori nuk ka të drejtë që shoqërisë ta privojë nga kjo e drejtë, porse ky shfrytëzim duhet të jetë në rrafshin shkencor e jo për përfitime materiale dhe financiare.

4.6. Kompensimi duhet të jetë përafërsisht i barabartë

Kompensimi për shpikjen, përpilimin dhe produktet mendore duhet të jetë përafërsisht aq sa e meriton vepra, duhet vlerësuar në bazë të kontributit dhe frytit të zbulimit, me qëllim që në mes shpikjes dhe kompensimit të arrihet një drejtësi e përafërt dhe ekuivalente. Për të qenë vlerësimi më i drejtë dhe i paanshëm është mirë që për vlerësimet e caktuara të formohen komisione nga dijetarë dhe ekspertë për secilën fushë ku kërkohet vlerësimi i zbulimit apo autorësisë.

4.7. Shfrytëzimi i autorësisë nga ana e pasardhësve të autorit

Koha më e gjatë që pasardhësit (trashëgim-marrësit) mund ta shfrytëzojnë të drejtën e autorësisë është gjashtëdhjetë vjet (60) prej vdekjes së autorit. Kjo bëhet në analogji (kijas) me çështjen e kohëzgjatjes së shfrytëzimit më të gjatë në jurisprudencën islame, e kjo është dhënia me qira të gjatë (ixhare tavile) tokën e vakëfit për mbjelljen e pemëve apo për ndërtimtari.

Taxhedin BISLIMI

THE CONCEPT OF FET'HI DUREYN ON AUTHORSHIP
Comparative study on Islamic jurisprudence

(Summary)

In this paper we will discuss the view of Islamic jurisprudence on author's rights. Among the first contemporary scholars to analyze this issue in great depth is Fet'hi Dureyn, a distinguished scholar of the Islamic world, an expert of fiqh.

Dureyni based his analysis on the views of the scholars of the four schools of thought within fiqh. After a thorough study, based on the provisions of the Shariah, he presented his views on the topic through the use of independent reasoning (ijtihad).

In this paper, we will try to present in brief his concept regarding this issue.

تاج الدين بيسلمي

مفهوم فتحي الدريني حول الحقوق المؤلف

(خلاصة البحث)

نهدف بهذه الورقة إلى تحديد وتوضيح عن موقف الفقه الإسلامي فيما يتعلق بالاكتشافات وحقوق المؤلف. من بين أوائل العلماء المعاصرين الذين درسوا هذه المسألة بعمق والذين قدموا تفسيرات مفصلة وتفصيلية لتقديم هذه القضية هو الباحث المعروف في العالم الإسلامي ، الدكتور فتحي الدريني. في هذه الدراسة العميقة ، اعتمد الدكتور فتحي الدريني على مواقف علماء المذاهب الأربعة ، وبعد الدراسة التحليلية مستندا على الأسس الشرعية انتهى إلى حكم في هذه المسألة ، وطبعا حسب فهمه واجتهاده في المسألة، سنحاول تقديم هذا المفهوم في هذه الورقة في نقاط قصيرة جدا.

Bali SADIKU

LIDHJA E THIRRJES SË MUHAMEDIT A.S. ME THIRRJEN E PEJGAMBERËVE PARA TIJ

Abstrakt

Allahu i Madhërishëm i krijoi njerëzit, u dha dhunti të shumta, duke zgjedhur prej tyre pejgamberë, përmes të cilëve sqaroi të vërtetën nga e kota, ndriçoi rrugën e udhëzimit; rrugë të cilën nëse robi e pason ka për të jetuar i lumtur në këtë botë, ndërsa në botën tjetër do të jetë prej fitimtarëve.

Në këtë rrugë thirrën të gjithë pejgamberët e Allahut prej Ademit e deri tek Muhamedi a.s.. Ajo për të cilën udhëzonin këta të gjithë, në esencë është e njëjtë dhe është prej një burimi, andaj kjo më shtyri që të shkruaj disa rreshta rreth kësaj tematike.

Në këtë punim timin kam folur rreth përngjasimit të pejgamberëve në mes vete, në cilësi; në veti dhe tipare personifikuese, rreth përngjasimit të tyre në cilësitë dhe veçoritë pejgamberike, rreth përngjasimin të tyre në bazat sheriatike; në thirrjen e tyre që të besohet vetëm një Zot, si dhe përngjasimin e tyre në esencën e adhurimeve.

Fjalët kyçe: *pejgamberë, shpallje, thirrje.*

HYRJE

Allahu xh.sh. e krijoi njeriun në formën më të mirë, e dalloi me mendje të ndritur dhe qëllime madhështore, e ngarkoi me obligime dhe detyra të cilat e plotësojnë edhe më shumë atë, duke e afruar më afër Tij, që ai t'i realizojë ashtu siç duhet detyrimet e tij ndaj Allahut, dhe sjelljet e tij në raport me krijesat. Allahu xh.sh. nga mesi i njerëzve, zgjodhi disa prej tyre dhe i gradoi në pejgamberë, u dërgoi edhe libra të shenjtë dhe shpallje hyjnore nëpërmjet së cilës i udhëzuan njerëzit dhe xhinnët.

Allahu pasi që e krijoi njeriun e parë Ademin a.s., me të dërgoi edhe shpalljen, duke mos e lënë atë të vetmuar në shtegtimin e tij jetësor. Krijuesi fuqiplotë e dinte mirë sesa ka nevojë njeriu për udhëzimin hyjnor. I Lartmadhërishmi kohë pas kohe dërgoi pejgamberë, kryesisht në bazë të nevojave që paraqiteshin tek popujt e tyre, duke e përmbyllur këtë cikël me dërgimin e vulës së pejgamberëve - Muhamedin a.s. (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin me të!).

Nëse u qasemi argumenteve kuranore dhe haditheve profetike gjejmë se përveç thirrjes së tyre unifikuese për ta njësuar Allahun me adhurim; ka edhe shumë lidhje dhe ngjashmëri të tjera në mes të dërguarve të Zotit, të cilat do t'i shtrojmë shkurtimisht në këtë punim modest, duke e lutur Allahun fuqiplotë për ndihmë dhe suksese.

Allahu xh.sh. në Kuran përmend njëzet e pesë pejgamberë, tetëmbëdhjetë prej tyre i përmend në këto ajete: ***"Ky është argumenti Ynë, të cilin Ne ia dhamë Ibrahimit kundër popullit të tij. Ne ngremë kë të duam në shkallë të lartë. Vërtet, Zoti yt është i Urtë e i Gjithëdijshëm. Ne i dhuruam atij Isakun dhe Jakubin. Që të dy këta i udhëzuam në rrugë të drejtë, ashtu siç patëm udhëzuar më parë Nuhun. Ndër pasardhësit e tij Ne udhëzuam Davudin, Sulejmanin, Ejubin, Jusufin, Musain dhe Harunin. Kështu i shpërblejmë punëmirët. Ne udhëzuam edhe Zekerijanë, Jahjanë, Isanë, Iljazin - të gjithë këta kanë qenë nga njerëzit e mirë. Po ashtu, udhëzuam edhe Ismailin, Eljesain, Junusin dhe Lutin - secilin prej tyre e ngritëm mbi të gjithë njerëzit."*** *(El-Enam: 83-86).*

Ndërsa shtatë të tjerët: Ademin, Idrisin, Hudin, Salihun, Shuajbin, Dhulkiflin dhe Muhamedin, i përmend nëpër ajete të tjera kuranore.

Duhet ditur se pejgamberët e Allahut nuk janë të përcaktuar vetëm në këtë numër, por numri i tyre është shumë më i madh se kaq. Allahu i lartësuar në Kuran thotë: ***"Edhe para teje** (o Muhamed) **Ne kemi nisur të dërguar, për disa prej të cilëve të kemi treguar ty e për disa të tjerë nuk të kemi treguar."** (El-Gafir: 78).*

Në disa hadithe profetike ka ardhur se numri i pejgamberëve *"Nebij"* është njëqind e njëzet e katër mijë (124.000), ndërsa numri i pejgamberëve *"Resul"* është treqind e pesëmbëdhjetë (315).[1]

Kur është fjala te dallimet në mes këtyre dy emërtimeve *Nebijj* dhe *Resul,* dijetarët myslimanë kanë dhënë disa mendime, dhe mendimi më i qëlluar është ky: *Resul* nënkupton pejgamberin e dërguar tek ata të cilët e kundërshtuan urdhrin e Allahut, ashtu që t'ua kumtojë shpalljen e Tij tek ata, ndërsa *Nebij* nënkupton pejgamberin e dërguar te populli besimtar, duke i urdhëruar me sheriatin e pejgamberit para tij.[2]

Përngjasimi i pejgamberëve mes vete në veti dhe tipare personifikuese

Pejgamberët e Allahut janë njerëzit më të zgjedhur nga lloji i racës njerëzore. Allahu i pajisi ata me tipare dhe cilësi të cilat u ndihmuan atyre për ta kumtuar revelatën në formën më të mirë të mundshme..[3]

Pejgamberët e Allahut kishin cilësi të ngjashme mes vete qysh para zbritjes së shpalljes tek ata, e në vijim do t'i përmendim disa prej tyre:

Që të gjithë ishin meshkuj

Allahu xh.sh. në Kuran thotë: ***"Para teje, Ne kemi dërguar vetëm burra nga banorët e qyteteve, të cilët i frymëzuam me shpallje. Vallë! A nuk kanë udhëtuar ata nëpër botë për të parë se si ka qenë fundi i popujve që***

[1] Për më gjersisht rreth këtyre haditheve shih: *Silsiletu el ehadith es-sahiha* (6/358 nr: 2668), *Silsiletu el ehadith ed-daife* të Albanit (13/202 nr: 6090), dhe *Er-Ravdu-l Bessam bi tertibi ve tahrixhi fevaidi temmam* (4/243) të Xhasim Ibn Sulejman ed Devserit.

[2] Shih: *En Nubuvat* të Ibn Tejmijes (2/714-718).

[3] Shih: *El Mufhim lima eshkele min telhis Kitabi Muslim* të Kurtubiut (6/17).

***kanë jetuar para tyre? Pa dyshim, bota tjetër është më e mirë për ata që** (e) **kanë frikë** (Allahun). **Pra, a nuk kuptoni?"** (Jusuf: 109).*

Ibn Kethiri thotë: "Me këtë ajet Allahu i lartësuar na njofton se dërgoi pejgamberët e Tij prej burrave e jo prej grave, dhe ky është qëndrimi i shumicës së dijetarëve siç kuptohet edhe nga konteksti i këtij ajeti fisnik..."[4].

Kishin prejardhje të pastër

Të dërguarit e Allahut kishin prejardhje të pastër e fisnike. Ata ishin njerëz të zgjedhur në çdo aspekt. Është përcjellë nga Ebu Hurejre se kur është pyetur Pejgamberi a.s. se cili është njeriu më fisnik?, ai është përgjigjur: *"Ai i cili është më i devotshmi"*. I thanë: O i Dërguar i Allahut! - Nuk po të pyesim për këtë, atëherë Pejgamberi a.s. u përgjigj: *"Jusufi i dërguari i Allahut, i biri i të dërguarit të Allahut, i biri i të Dërguarit të Allahut, i biri i të Dashurit të Allahut"*[5].

Ndërsa për Muhamedin a.s. Allahu i lartësuar thotë: ***"Tashmë ju ka ardhur një i Dërguar nga gjiri juaj. Atij i vjen rëndë për gjynahet që bëni ju, jua dëshiron të mirën me gjithë zemër që ju të shkoni rrugës së drejtë dhe është i butë e i mëshirshëm me besimtarët."** (Et-Tevbe: 128)*[6].

Shprehja në ajet *"Enfusikum"* është lexuar edhe *"Enfesikum"* me vokalin e shkurtër "fet'ha" mbi shkronjën "*faun*" e që ka kuptimin "Më i zgjedhuri dhe më fisniku nga ju"[7].

Është përcjellë nga Vathileh Ibnu-l Eska'ë el-Lejthi të ketë thënë: E kam dëgjuar Pejgamberin a.s. duke thënë: *"Allahu ka veçuar Kinanen prej bijve të Ismailit, i ka veçuar Kurejshitët prej bijve të Kinane-s, e prej Kurejshitëve ka veçuar bijtë e Hashimit, e më pas, mua më ka veçuar nga ata"*[8].

---

[4] *Tefsiru-l Kurani-l Adhim,* (4/422-423).

[5] Transmeton Buhariu (2/469 nr: 3383), dhe Muslimi (4/1846 nr: 2378).

[6] Shih Komentin e Ibn Atijes rreth këtij ajeti ku potencon se ky ajet tregon prejardhjen e pastër dhe fisnike të Pejgamberit:*El Muharreru-l Vexhiz fi Tefsiri-l Kitabi-l Aziz,* (3/100).

[7] Shih: *El-Bahru-l Muhit* të Ebu Hajjanit (5/533).

[8] Transmeton Muslimi (4/1782 nr: 2276).

Ishin mendjemprehtë dhe me moral të mirë

Në ajetet kuranore dhe në hadithet profetike shfaqen qartë këto virtyte të pejgamberëve të Allahut. Në lidhje me Ibrahimin a.s., Allahu i lartësuar thotë: ***"Në të vërtetë, Ne e udhëzuam Ibrahimin në rrugë të drejtë qysh më parë dhe e njihnim atë*** *(se ishte i aftë për këtë gjë)." (El-Enbijaë: 51).*

Dhe thotë: ***"Vërtet, Ibrahimi ishte i butë, i dhembshur e vazhdimisht i kthyer*** *(tek Allahu)." (Hud: 75).*

Ndërsa për Musanë a.s. citohen fjalët e njërës prej vajzave të Shuajbit a.s. kur ajo i drejtohet babait të saj duke i thënë: ***"O babai im, - tha njëra nga ato të dyja - merre këtë njeri në shërbim! Sigurisht që njerëzit e fortë dhe të besueshëm janë më të mirët, që dikush mund të marrë në shërbim."*** *(El Kasas: 26).* Dhe thotë: ***" O besimtarë, mos u bëni si ata, që e shqetësuan Musanë. Allahu e çliroi atë nga përgojimet e tyre; ai është i nderuar në sytë e Allahut."*** *(El Ahzab: 69).*

Ndërsa e tërë kaptina Jusuf dëshmon për besimin, fuqinë, besnikërinë dhe nderin e tij.

Ndërsa Muhamedi a.s. është i pajisur me të gjitha cilësitë të cilat ishin të pranishme te pejgamberët para tij. Në këtë aludojnë fjalët e Aishes r.a., kur ishte pyetur për moralin e Pejgamberit e ajo kishte thënë: "*Morali i tij ishte Kurani*"[9].

Ibn Kethiri thotë: "Kuptimi i këtij hadithi është se praktikimi i urdhrave të Kuranit dhe përmbajtja ndaj ndalesave ishin mishëruar tek ai. Çfarëdo që urdhërohej në Kuran, e praktikonte dhe çfarëdo që ndalohej në të, i përmbahej. Ibn Kethiri vazhdon e thotë: E potencuam këtë, duke mos harruar gjithnjë edhe moralin e mirë, turpin, fisnikërinë, trimërinë, urtësinë dhe bujarinë që e stoliste personalitetin e tij..."[10]

Për virtytet e Muhamedit a.s. janë shkruar libra të shumtë, prej librave më të njohur që flasin për këto cilësi të tij është libri i imam Tirmidhiut *"Esh-Shemailu-l Muhammedijeh vel hasaisu el Mustafevijeh"*.

[9] Transmeton Muslimi (1/512 nr: 746).

[10] Shih: *Tefsiru-l Kurani-l Adhim* (8/189).

Besnikëria

Prej cilësive me të cilat ishin të pajisur të gjithë pejgamberët e Allahut është edhe besnikëria, ngase nuk mund të paramendohet kumtimi i revelatës në formën e kërkuar pa besnikëri të përpiktë. Allahu në disa ajete të kaptinës *"Esh Shuara"* pasi përmend thirrjen e pejgamberëve drejtuar popujve të tyre përmend fjalët: *" **Në të vërtetë, unë jam një i dërguar i besuar për ju"** (Esh-Shuara: 107, 125, 143, 162, 178).* Dhe për Jusufin a.s. thotë: ***"Mbreti tha: "Ma sillni atë, do ta marr pranë vetes." Pasi bisedoi me të, i tha: "Qysh sot, ti ke pozitë të lartë dhe je i besuar."** (Jusuf: 54).*

Ndërsa Muhamedi a.s. qysh para zbritjes së shpalljes ishte i njohur me ofiqin *"El Emin- Besnik"*[11].

Në hadithin e gjatë të përcjellë nga Ummu Seleme, në të cilin përshkruhet biseda e Xhafer ibn Ebi Talibit me Nexhashiun përmenden edhe fjalët e Xhaferit: *"...Ishim popull injorantë, adhuronim idhujt, hanim të ngordhurat dhe bënim amoralitet. Gjithashtu kishim shkëputur lidhjet farefisnore, nuk e respektonim fqinjin, ndërsa i pasuri e sundonte të varfrin, kështu vazhduam derisa Allahu e dërgoi të dërguarin nga mesi ynë, e dinim prejardhjen e tij, sinqeritetin, besnikërinë dhe nderin e tij..."*[12]

Durimi

Durimi ishte cilësi e pandashme e pejgamberëve të Allahut, ngase ata ishin njerëzit më të sprovuar. Muhamedi a.s. thotë: *"Njerëzit më të sprovuar janë pejgamberët, pastaj njerëzit e mirë...."*[13]

Allahu i Madhërishëm i drejtohet Muhamedit a.s. që t'i merrte si shembull pejgamberët para tij, duke i thënë: ***"Prandaj, ti bëhu i durueshëm** (o Muhamed), **ashtu siç kanë duruar me këmbëngulje të dërguarit e vendosur"** (El-Ahkaf: 35)*[14].

---

[11] Shih: *Siretu ibni Hisham* (1/197).

[12] Transmeton Imam Ahmedi në *El-Musned* (3/263 nr: 1740) me zinxhir transmetimi *'hasen'*-të mirë.

[13] Transmeton Imam Ahmedi në *El-Musned* (3/78 nr: 1481) me zinxhir transmetimi *'hasen'*-të mirë.

[14] Pjesëza "Min" në këtë ajet ka kuptimin e llojit (el-xhins) pra të gjithë pejgamberët që ishin para tij, për më gjerësisht shih: *Levamiu-l Envar* të Sefariinit (2/299).

Në kaptinën *"El-Enbijaë": 85,* thotë: *"(Kujto)* ***Ismailin, Idrizin dhe Dhulkiflin! Të gjithë këta kanë qenë të durueshëm.",*** dhe për Ejubin thotë: ***"Ne e gjetëm atë të durueshëm, rob të mrekullueshëm. Ai kthehej vazhdimisht me pendesë tek Zoti!"*** *(Sad: 44).*

Transmeton Ebu Vaili, nga Abdullah ibn Mesudi se ditën e Hunejnit, Pejgamberi a.s. kishte filluar të ndante plaçkën e luftës, derisa një person iu ankua duke thënë: Nuk ka drejtësi në këtë ndarje! Abdullahu i tha: - Pasha Allahun kam për ta lajmëruar Pejgamberin a.s., erdha tek Pejgamberi a.s. dhe e lajmërova për atë se çfarë pretendonte ai njeri, me të dëgjuar këto fjalë Pejgamberit a.s. iu skuq fytyra dhe tha: *"Kush bën drejtësi nëse nuk mban drejtësi Allahu dhe i Dërguari i Tij! Allahu e mëshiroftë Musanë, ai është munduar (maltretuar) edhe më shumë se kjo, por bënte durim"*[15]

Butësia dhe Mëshira

Butësia dhe Mëshira ishin virtyte të pandara të pejgamberëve të Allahut. Ata ishin të butë ndaj popujve të tyre, të kujdesshëm për udhëzimin e tyre dhe pikëlloheshin shumë për ta. Ne shohim se Nuhi a.s. kishte qëndruar nëntëqind e pesëdhjetë vjet tek populli i tij, gjithnjë duke i ftuar në fenë e Allahut, dhe duke përdorur forma të ndryshme të thirrjes.[16] Allahu i Madhërishëm në lidhje me këtë thotë: ***"Ne e dërguam Nuhun te populli i tij. Ai qëndroi tek ata një mijë pa pesëdhjetë vjet, e megjithatë, ata i përfshiu përmbytja, duke qenë keqbërës."*** *(El Ankebut: 14).*

---

[15] Transmeton Buhariu (2/404 nr: 3150), dhe Muslimi (2/739 nr: 1062).

[16] Allahu në kaptinën (Nuh:5-20) thotë: ***"Ai tha:"O Zoti im, unë vërtet e thirra popullin tim natë e ditë, por thirrja ime edhe më tepër i largoi*** *(nga e vërteta),* ***Sa herë, që i thirrja për t'i falur Ti, ata shtinin gishtërinjtë në veshë dhe mbuloheshin me petkat e tyre, duke këmbëngulur me mendjemadhësi*** *(në mosbesim),* ***Pastaj i thirra me zë të lartë. Më pas ua shpalla edhe botërisht, edhe fshehurazi, e u thashë: "Kërkoni falje nga Zoti juaj, i Cili është Falës i madh, që Ai t'ju dërgojë shi të bollshëm, t'ju shtojë pasurinë dhe fëmijët tuaj dhe të bëjë për ju kopshte e lumenj! Ç'është kështu me ju, që nuk e madhëroni Allahun siç duhet*** *(duke e pasur frikë),* ***ndërkohë që Ai ju ka krijuar në etapa*** *(etapat e embrionit)?* ***A nuk e shihni se si Allahu i ka krijuar shtatë qiejt njëri mbi tjetrin, dhe në ta e ka bërë Hënën dritë, kurse Diellin e ka bërë fener? Allahu ju ka krijuar nga toka, ashtu si bimët, pastaj ju kthen tek ajo dhe prej saj sërish do t'ju nxjerrë. Allahu për ju e ka bërë Tokën shtrojë të gjerë, që të ecni nëpër të, nëpër rrugët e gjera."***

Ndërsa kur Ibrahimi a.s. kuptoi se popullit të Lutit a.s. po u vinte dënimi, u mërzit për ta, dhe filloi të polemizonte me melekët. Këtë ngjarje Allahu xh.sh. e përshkruan në disa ajete kuranore: ***"Pasi i kaloi frika Ibrahimit dhe i erdhi lajmi i gëzuar, ai polemizoi me të dërguarit Tanë për popullin e Lutit. Vërtet, Ibrahimi ishte i butë, i dhembshur e vazhdimisht i kthyer*** *(tek Allahu).* ***"O Ibrahim, shmangu prej kësaj! Me të vërtetë, erdhi urdhri nga Zoti yt dhe ata do t'i gjejë dënimi i pashmangshëm."*** *(Hud: 74-76)*

Butësia dhe Urtësia bënë që njerëzit t'i përgjigjen me të madhe thirrjes së Muhamedit a.s. Allahu i Gjithëmëshirshëm në Kuran thotë: ***"Në sajë të mëshirës së Allahut, u solle butësisht me ta*** *(o Muhamed).* ***Sikur të ishe i ashpër dhe i vrazhdë, ata do të largoheshin prej teje. Prandaj faljua atyre gabimin, kërkoi falje Allahut për ata dhe këshillohu me ata për çështje të ndryshme. Kur të vendosësh për diçka, mbështetu tek Allahu. Vërtet, Allahu i do ata që mbështeten tek Ai."*** *(Ali Imran: 159).*

Transmeton Abdullah ibn Mesudi se Pejgamberi a.s. tregonte për njërin nga pjegamberët para tij, të cilin populli i tij e kishin përgjakur, ndërsa duke e fshirë gjakun nga fytyra e tij thoshte: *"O Allah! Fale popullin tim, ngase ata nuk dinë!"*[17].

Nëse shfletojmë historinë e ndritshme të Resulullahit s.a.v.s., gjejmë se ajo është e mbushur përplot me ngjarje që flasin për mëshirën, urtësinë dhe butësinë e tij, e këtë më së miri e qartëson dëshmia e Allahut për të, i Cili thotë: ***"Dhe Ne nuk të kemi dërguar ty*** *(o Muhamed),* ***veçse si mëshirë për botët."*** *(El-Enbijaë: 107).*

Përngjasimi i pejgamberëve në cilësitë dhe veçoritë pejgamberike

Allahu xh.sh. i veçoi pejgamberët e Tij nga njerëzit e tjerë me disa cilësi përmes të cilave ata ndihmoheshin në kumtimin e shpalljes. Nëpërmjet këtyre cilësive ata dalloheshin nga gënjeshtarët të cilët pretendonin se janë pejgamberë të dërguar. Në vijim po i përmendim disa nga këto cilësi të cilat ishin prezente tek të gjithë pejgamberët:

[17] Transmeton Buhariu (2/499 nr: 3477), dhe Muslimi (3/1417 nr: 1793).

Zbritja e shpalljes tek ta

Është e ditur se pejgamberët e Allahut janë njerëz sikurse edhe njerëzit e tjerë, mirëpo ajo që i dallon dhe i veçon ata nga njerëzit e rëndomtë, është shpallja, e në këtë pajtoheshin të gjithë pejgamberët. Në Kuran thuhet: ***"Thuaj: Unë jam vetëm njeri, sikurse edhe ju, mua më shpallet se vetëm një Zot është Zoti i juaj...."*** *(El-Kehf: 110).*

Pastaj: ***"Ne të frymëzuam ty*** *(o Muhamed)* ***me shpallje, ashtu siç frymëzuam me shpallje Nuhun dhe profetët pas tij; siç frymëzuam me shpallje edhe Ibrahimin, Ismailin, Is'hakun, Jakubin dhe bijtë e tij, Isain, Ejupin, Junusin, Harunin, Sulejmanin dhe Davudin, të cilit i dhamë Zeburin."*** *(En-Nisa: 163)*

Lajmërimi për gjëra të fshehta

Të gjithë pejgamberët e Allahut i lajmëronin popujt e tyre për gjëra të fshehta, të cilat nuk mund të arrihen me mendje, por vetëm përmes shpalljes. Ata i lajmëronin për madhështinë e Allahut, për emrat dhe cilësitë e Tij, me të cilat i Lartmadhërishmi nuk i përngjan askujt, për premtimin dhe kërcënimin e Tij, për varrin; dënimin dhe shpërblimin në të, për shenjat e Kiametit, Ditën e Llogarisë, Xhenetin dhe Xhehenemin e kështu me radhë, andaj lajmërimi për gjëra të fshehta është veçori e pandashme dhe e patjetërsueshme e pejgamberëve të Allahut, gjë e cila i veçon dhe i dallon ata nga gënjeshtarët.[18]

Mrekullitë

Nëse shohim popujt e mëhershëm dhe zhvillimet në kohën e tyre, do të vërejmë se Allahu xh.sh. i dërgonte pejgamberët e Tij me disa mrekulli që ishin të ngjashme për nga natyra, me disa fenomeneve që ishin të përhapura në atë popull. P.sh: Në kohën e Musait, magjia ishte jashtëzakonisht e përhapur. Allahu i gjithëpushtetshëm deshi që mrekullitë e Musait të ishin të asaj natyre, andaj bëri që shkopi i Musait të shndërrohej në gjarpër lëvizës, kurse dora e tij të bëhej e bardhë e të ndriçonte.

Në anën tjetër, te Beni israilët, në kohën e Isait a.s. mjekësia ishte jashtëzakonisht e avancuar, prandaj Isai a.s., u erdhi atyre me mrekulli të

[18] Shih: *Sherh el Asbahanije* nga Ibn Tejmije (ff: 680-683).

tilla që sfiduan mjekësinë e asaj kohe. Ai shëronte disa sëmundje që askush nuk mund t'i shëronte atëbotë, e mbi të gjitha, me lejen e Allahut, i ngjallte të vdekurit, etj.

Allahu xh.sh. në Kuran thotë*: **"Ne i çuam të dërguarit Tanë me prova të qarta dhe bashkë me ta zbritëm Librat** (e shenjtë) **dhe peshoren** (e drejtësisë)**: që njerëzit të veprojnë drejt."** (El-Hadid: 25)*

Nga Ebu Hurejre r.a., përcillet të ketë thënë: E kam dëgjuar Pejgamberin a.s. duke thënë: *"Nuk ka ndonjë pejgamber prej pejgamberëve që Allahu të mos i ketë dhuruar argumente,e të cilave u besuan njerëzit...."*.[19]

Sytë e tyre flenë por jo edhe zemrat

Enes Ibn Maliku r.a. duke treguar për natën e Israsë dhe Miraxhit, atëherë kur erdhën tek Pejgamberi a.s. tre persona, e përshkruan gjendjen e Pejgamberit duke thënë*:*

"I dërguari ishte në gjumë, sytë e tij flinin por jo edhe zemra e tij (ngase ajo nuk fle), e gjithashtu edhe pejgamberët e tjerë, sytë e tyre flenë por jo edhe zemrat e tyre..."[20]. dhe urtësia e saj është që të ndiejnë dhe perceptojnë mirë shpalljen që u vjen në gjumë, duke pasur parasysh se edhe ëndrrat e pejgamberëve janë pjesë prej shpalljes[21].

Pasuria e tyre nuk trashëgohet

Nga Ebu Bekri r.a. përcillet të ketë thënë: E kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut duke thënë:

***"Ne** (pejgamberët) **nuk trashëgohemi, atë** (pasurinë) **çka lëmë pas vetes, mbetet sadakë."**[22]*

Njeriu në këtë botë vrapon pas pasurisë, e grumbullon atë, kujdeset shumë për të, që t'ua trashëgojë atë pasardhësve të vet, kurse pejgamberët duhet të ruhen nga dyshimet dhe shpifjet se ata tubuan pasuri për pasar-

[19] Transmeton Buhariu (4/359 nr: 7274), dhe Muslimi (1/134 nr: 152).
[20] Transmeton Buhariu (2/520 nr: 3570).
[21] Shih: *El Fajdu el Kadir* të el Munavit (5/169).
[22] Transmeton Buhariu (2/386 nr: 3093), dhe Muslimi (3/1380 nr: 1759).

dhësit e tyre. Pikërisht për këtë arsye Allahu xh.sh. bëri që pasuria e tyre të mos trashëgohet, por të mbetet vetëm sadaka[23].

Ata varrosen në vendin në të cilin vdesin

Nga Aishja r.a. përcillet të ketë thënë: "Atë ditë kur vdiq i Dërguari i Allahut, njerëzit nuk dinin se ku ta varrosnin, dhe filloi mospajtimi mes tyre. Atëherë Ebu Bekri tha: E kam dëgjuar Pejgamberin a.s. duke thënë: *"Allahu nuk e bën të vdesë ndonjë pejgamber, vetëmse në vendin ku ai dëshironte të varrosej"* dhe tha:

"Varroseni te vendi i shtratit të tij!"[24]

Allahu ia ka ndaluar Tokës t'i hajë trupat e pejgamberëve

Nga Evs Ibn Evsi përcillet të ketë thënë: Pejgamberi a.s. ka thënë: *"Allahu ia ka ndaluar (ia ka bërë haram) tokës (t'i tresë) trupat e pejgamberëve."*[25]

Janë të gjallë në varrezat e tyre

Transmetohet nga Enesi r.a., se Pejgamberi a.s. ka thënë: *"Pejgamberët janë të gjallë, falen në varrezat e tyre"*[26]. Ky hadith i Muhamedit a.s. ka për qëllim jetën e tyre në varreza, jetë rreth të cilës nuk kemi njohuri, por pa dyshim se ndryshon nga jeta e kësaj bote,[27] ndërsa sa i përket jetës së kësaj bote, të gjithë pejgamberët e Allahut i ka goditur vdekja me përjashtim të Isait a.s. në shenjë të të cilit Allahu i Madhërishëm thotë: *"(I mallkuam ata)* ***për shkak të mosbesimit të tyre*** *(ndaj Isait a.s.),* ***për shkak të shpifjeve të mëdha që thanë kundër Merjemes dhe për fjalët e tyre: "Ne e vramë Mesihun – Isanë, të birin e Merjemes, të dërguarin e Allahut". Por, ata as e vranë, as e kryqëzuan, por ashtu u është dukur. Ata që nuk u paj-***

[23] Shih: *Bedaiu-l Fevaid* të Ibn Kajjimit (3/1168).

[24] Transmeton Tirmidhiu (nr: 1018).

[25] Transmeton Ebu Daudi (1/635 nr: 1047), Nesaiu (nr: 1374), Ibn Maxheh (nr: 1085) hadithi është i vërtetë.

[26] Transmeton Ebu Ja'la në *El-Musned* (6/147 nr: 3425), dhe Temmam në *El-Fevaid* (2/33 nr: 58) me zinxhir transmetimi *sahih*-të vërtetë.

[27] Shih parathënien e dr. Ahmed Atijeh el Gamidij (ff: 56-57) bërë librit *Hajatu-l Enbijaë fi kuburihim* të Imam Bejhekiut.

tuan për çështjen e tij, me siguri që gjenden në dyshim për të. Ata nuk kanë ditur kurrgjë për të, por vetëm se kanë hamendësuar. Ata, në të vërtetë, nuk e kanë vrarë, por, Allahu e ka ngritur pranë Vetes. Allahu është i Plotfuqishëm dhe i Gjithëdijshëm." *(En-Nisaë: 156-158).*

Ngjasimi i pejgamberëve në bazat sheriatike

Pasi që Allahu xh.sh. e krijoi njeriu më formën më të bukur, e dalloi atë nga krijesat e tjera, i dhuroi mendje dhe logjikë, e më pas atë e ndihmoi edhe me anë të shpalljes. E bëri këtë për një qëllim madhor e fisnik, që njeriu të dinte përse u krijua, ngase Allahu xh.sh. nuk e krijoi atë që të sillej vërdallë mbi sipërfaqen e tokës, por e krijoi që ta adhuronte vetëm Atë dhe të largohej nga çdo e keqe dhe ligësi në Tokë. Allahu xh.sh. në Kuran thotë: ***"Unë nuk i krijova xhinnët dhe njerëzit për tjetër pos që të më adhurojnë."*** *(Edh-Dharijat: 56)*

Besimi në Një Zot-në Njëshmërinë e Allahut, ishte porosia e të gjithë pejgamberëve të Tij nëpër kohë e shekuj.

Nëse ndalemi dhe meditojmë rreth disa ajeteve kuranore që flasin për këtë tematikë, gjejmë se ato flasin për këtë formulë në dy forma, atë të përgjithshme dhe në formë të detajuar.

Sa i përket formës së përgjithshme Allahu xh.sh. thotë: ***"Çdo populli Ne i çuam një të dërguar*** *(që u thoshte):* ***"Adhuroni Allahun dhe shmangni idhujt!" Disa prej tyre Allahu i shpuri në rrugë të drejtë e disa e merituan të mbeten në humbje. Andaj, udhëtoni nëpër botë të shihni se si ishte fundi i përgënjeshtruesve!"*** *(En-Nahl: 36),* dhe thotë: ***"Ai ka urdhëruar për ju atë Fe, të cilën ta shpalli ty*** *(o Muhamed)* ***dhe që pati urdhëruar për Nuhun, Ibrahimin, Musanë dhe Isanë, duke thënë: "Qëndroni në fenë e drejtë dhe mos u përçani në të!"*** *(Esh-Shura: 13)*

Ibn Kethiri thotë: "Feja me të cilën janë dërguar të gjithë pejgamberët e Allahut është: Adhurimi ndaj Allahut të vetëm e të pashoq, siç thotë Allahu në Kuran: ***"Ne nuk kemi nisur asnjë të dërguar para teje, që të mos i kemi shpallur se: "S'ka zot tjetër përveç Meje, andaj më adhuroni*** *(vetëm)* ***Mua!"*** *(El-Enbijaë: 25)..."*[28]

[28] Shih: *Tefsiru-l Kurani-l Adhim* (7/194).

Ebu Hurejre thotë: E kam dëgjuar Pejgamberin a.s. duke thënë: *"Pejgamberët e Allahut janë vëllezër prej një babai, nënat i kishin të ndryshme por besimin e njëjtë."*[29]

Pejgamberi a.s. në këtë hadith përmend bazat e fesë në të cilat pajtoheshin të gjithë pejgamberët si: Adhurimin ndaj Allahut të vetëm, besimin në melaiket, librat, pejgamberët dhe Ditën e Fundit Pejgamberi a.s. theksoi se ata ishin vëllezër prej një babai, ndërsa format e adhurimeve mund të ndërrojnë (siç do të shtjellohet më vonë) duke i krahasuar në përngjasim me nënat e tyre të ndryshme, siç ka ardhur në këtë hadith[30].

Ndërsa ajetet që flasin për formën e detajuar, i gjejmë kur Allahu tregon për thirrjet e pejgamberëve drejtuar popujve të tyre veç e veç, dhe porosia e të gjithëve ishte: ***"O Populli im adhuroni Allahun, nuk keni Zot tjetër pos Tij..."*** *(El-A'raf: 59, 65, 73, 85).* Kjo ishte edhe porosia e Ibrahimit dhe Jakubit a.s. drejtuar bijve të tyre, ***"Ibrahimi ua dha këtë porosi fëmijëve të tij; po ashtu edhe Jakubi: "O bijtë e mi! Pa dyshim, Allahu ka zgjedhur për ju fenë e vërtetë, prandaj mos vdisni ndryshe veçse duke qenë myslimanë të nënshtruar ndaj Atij!" A ishit ju të pranishëm kur Jakubit iu afrua vdekja dhe i pyeti të bijtë: "Çfarë do të adhuroni pas meje?" - Ata u përgjigjën: "Ne do të adhurojmë Zotin tënd, që është edhe Zoti i etërve të tu: Ibrahimit, Ismailit dhe Is'hakut, një Zot të vetëm. Ne Atij i nënshtrohemi!"*** *(El-Bekare: 132-133).*

Sa herë që njerëzit devijonin nga rruga e drejtë, Allahu dërgonte tek ata pejgamberë që t'ua vërtetonin atë me të cilën kishte ardhur pejgamberi para tij, dhe t'i drejtonte kah ajo të cilën e do Allahu. Vazhdimësia e mësimeve të pejgamberit të mëhershëm nga ai pasues, është argument se që të gjithë të dërguarit e Allahut, kanë një burim të vetëm hyjnor. Allahu xh.sh. duke folur për Isanë a.s thotë: ***"Dhe*** *(kam ardhur te ju)* ***për t'ju vërtetuar Tevratin, që është para meje..."*** *(Ali Imran: 50),* ndërsa në kaptinën (En-Nisa: 47) ithtarëve të librit u drejtohej duke u thënë*:* ***"O ju, të cilëve ju është dhënë Libri! Besoni atë që kemi zbritur si vërtetues të asaj që keni para duarve tuaja".*** Në bazë të ajeteve paraprake del në pah se njëshmëria e Allahut është feja e të gjithë njerëzimit, prej Ademit e deri tek njeriu më

[29] Transmeton Buhariu (2/489 nr: 3443), dhe Muslimi (4/1837 nr: 2365/145).

[30] Shih: *El-Fajdu-l Kadir*, të Munavit (3/47).

i fundit, dhe duke pasur parasysh këtë kuptim të ajeteve, gjejmë se Allahu xh.sh., rrugën e drejtë dhe të vërtetë, në Kuran vazhdimisht e ka përmendur në numrin njëjës.[31]

Ngjasimi i tyre në esencën e adhurimeve

Përmendëm më lart se të gjithë pejgamberët e Allahut pajtoheshin në bazat e fesë, duke iu dorëzuar dhe nënshtruar plotësisht Allahut. Allahu xh.sh. thotë në Kuran: ***"Ai ka urdhëruar për ju atë Fe, të cilën ta shpalli ty*** *(o Muhamed)* ***dhe që pati urdhëruar për Nuhun, Ibrahimin, Musanë dhe Isanë, duke thënë: "Qëndroni në fenë e drejtë dhe mos u përçani në të!" Por për idhujtarët është e rëndë ajo, në të cilën po i fton ti. Allahu zgjedh për këtë fe kë të dojë dhe udhëzon drejt saj këdo që kthehet tek Ai me pendim."*** *(Esh-Shura: 13).*

Ibn Rexhepi thotë: "Kuptimi i ajetit është se Feja e të gjithë pejgamberëve ishte një, e ajo është Islami i përgjithshëm që në vete ngërthen besimin në Allahun, melaiket e Tij, librat dhe pejgamberët e Tij, dhe Ditën e Fundit, gjithashtu njësimin e Allahut me sinqeritet të plotë ndaj Tij, faljen e namazit, dhënien e zekatit ashtu siç thotë Allahu i lartësuar: ***"Ata, që u ishte dhënë Libri, u përçanë vetëm atëherë, kur u erdhi Dëshmia e qartë. E megjithatë, ata qenë urdhëruar vetëm që të adhuronin Allahun me përkushtim të sinqertë, duke qenë në fenë e pastër*** *(të Ibrahimit),* ***si dhe të falnin namazin e të jepnin zekatin. Kjo është feja e drejtë."*** *(El-Bejjineh: 4-5)."*[32]

Nëse analizojmë ajetet kuranore dhe hadithet profetike, gjejmë se pejgamberët e Allahut në esencë ishin të urdhëruar me pesë shtyllat e Islamit, e në vijim do të përmendim disa nga këto argumente.

Dëshmia për njëshmëri

Më lart përmendëm disa nga argumentet që flasin për thirrjen e pejgamberëve të Allahut drejtuar popujve të tyre *"Adhuroni Allahun, nuk ka zot tjetër pos Tij."*

---

[31] Për më gjerësisht rreth kësaj çështjeje shih: Dr. Bekër Ebu Zejd, *El-Ibtal li nedharijeti-l halti bejne-l edjan* (48-52).

[32] Shih: *Fethu-l Bari* (1/17).

Namazi dhe zekati

Allahu xh.xh. në Kuran thotë: ***"E megjithatë, ata qenë urdhëruar vetëm që të adhuronin Allahun me përkushtim të sinqertë, duke qenë në fenë e pastër*** *(të Ibrahimit),* ***si dhe të falnin namazin e të jepnin zekatin. Kjo është feja e drejtë."*** *(El-Bejjineh: 4-5);*
dhe thotë: ***"Ne i bëmë ata udhëheqës që udhëzonin sipas urdhrit Tonë dhe i frymëzuam që të bënin vepra të mira, të kryenin faljet dhe të jepnin zekatin, dhe ata vetëm Ne na adhuruan."*** *(El-Enbija: 73)*

Gjithashtu Allahu i Madhërishëm përmend lutjen e Ibrahimit a.s. drejtuar Tij kur thotë*:* ***"O Zoti im, bëj që unë dhe pasardhësit e mi të kryejmë përherë namazin! O Zoti ynë, na i prano lutjet!"*** *(Ibrahim: 40).* Ndërsa Ismaili a.s. urdhëronte popullin e tij për namaz dhe zekat ***"Ai e urdhëronte popullin e vet që të falte namazin e të jepte zekatin dhe ishte i mirëpritur te Zoti i vet."*** *(Merjem: 55)*

Agjërimi

Edhe agjërimi ishte detyrim te popujt para nesh, ashtu siç e përshkruan Allahu xh.sh. në Kuran kur besimtarëve u drejtohet duke thënë: ***"O besimtarë! Ju është urdhëruar agjërimi, ashtu siç u ishte urdhëruar edhe atyre para jush, që të mund të ruheni*** *(nga të këqijat)." (El-Bekare: 183).*

Nga Abdullah ibn Amri përcillet të ketë thënë: E kam dëgjuar Pejgamberin a.s. duke thënë*: "Agjërimi më i dashur tek Allahu është agjërimi i Davudit, ai agjëronte një ditë e në ditën tjetër nuk agjëronte..."*[33]

Haxhi

Edhe Haxhi sikur edhe shtyllat e tjera të Islamit ishte obligim i pejgamberëve para Muhamedit a.s. Allahu xh.sh. iu drejtua Ibrahimit a.s. me fjalët: ***"Dhe thirr ndër njerëz për haxhin, se të vijnë ty këmbësorë e edhe kalorës me deve të rraskapitura që vijnë prej rrugëve të largëta."*** *(El-Haxh: 27)*

Nga Ibn Abbasi transmetohet të ketë thënë: *"Nëpër grykën Er-Revha*[34] *kanë kaluar duke shkuar për në Haxh, shtatëdhjetë pejgamberë, të*

[33] Transmeton Buhariu (2/482 nr: 3420), dhe Muslimi (2/812 nr: 1159).

[34] Vend në mes Medinës dhe Bedrit, në një distancë prej shtatëdhjetë km. nga Medina, ku më herët haxhitë kalonin kah ky vend për në Mekë. Shih: *M'uxhem-ul mealim el gjugrafijeh,*të Atik Ibn Gajth el Biladit f. 143), dhe *El-Mealimu-l Ethire* të Muhamed ibn Muhamed Shurrab, f. 131.

veshur me petka prej leshi, dhe shtatëdhjetë pejgamberë janë falur në xhaminë El-Hajf (xhaminë e Minë-s).”[35]

Nga Ibn Abbasi përcillet të ketë thënë: Pejgamberi kaloi kah lugina “El-Ezrek”[36] dhe pyeti*: “Cila është kjo luginë?”,* i thanë: “Lugina El-Ezrek” I Dërguari a.s. tha: *“Sikur po shikoj Musanë (alejhi selam) duke zbritur nga kjo bregore me zërin ngritur lart duke i bërë telbije Allahut”,* pastaj erdhi tek bregorja Hersha[37] dhe tha*: “Cila është kjo bregore?”,* i thanë: “Bregorja Hersha”. I Dërguari a.s. tha: *“Sikur po shikoj Junusin a.s. hipur mbi deve të kuqe e të shëndoshë, kishte veshur një xhybe prej leshi, frenjtë e devesë së tij ishin prej fijeve të palmës, duke i bërë telbije Allahut.”*[38]

Nga tërë ajo që thamë, del në pah se këto adhurime ishin të ligjësuara edhe tek pejgamberët e mëhershëm, ndonëse forma apo koha e realizimit të tyre mund të ndryshonin. Duke pasur parasysh intervalin e largët kohor mes dërgimit të pejgamberëve, dhe duke parë se ajo në të cilën udhëzonin ata, në esencë është e njëjtë dhe ka të njëtin burim të dritës dhe udhëzimit hyjnor.

Kur Vereka ibn Neufeli dëgjoi fjalët e Hatixhes, nënës së besimtarëve, për atë se çfarë i kishte ndodhur Muhamedit a.s. në shpellën Hira kishte thënë: *“Ky është Namusi/ Meleku i cili i kishte zbritur edhe Musait...”*[39]

Gjithashtu edhe Nexhashiu pasi dëgjoi përshkrimin e Xhafer Ibn Ebu Talibit për Islamin dhe leximin e disa ajeteve nga kaptina Merjem, qau me ngashërim dhe tha: *“Vërtet kjo që lexove, dhe ajo që iështë zbritur Isait, kanë një kandil dhe burim të vetëm.”*[40]

---

[35] Transmeton Hakimi në *El-Mustedrek* (2/598), përmes tij Bejhekiu në *Es-Sunen el Kubra* (5/177) hadithi është *hasen- i mirë*.

[36] Vend i cili gjendet pas fshatit Emexh për kah Meka me distancë prej një milje. Shih: *El-Mealimu-l Ethire* f. 27).

[37] Bregore rrugës për në Mekë, afër Mikatit të Xhuhfes. Shih: *El-Mealimu-l Ethire*, f: 294.

[38] Transmeton Muslimi (1/152 nr: 166).

[39] Transmeton Buhariu (1/14 nr:3).

[40] Ibid.

Përfundim

Nga tërë ajo që u tha në këtë punim, nisur nga argumentet kuranore, hadithet profetike, dhe komentet e dijetarëve mund të konkludojmë:

1. Besimi në të gjithë pejgamberët e Allahut është shtyllë prej shtyllave të Imanit.
2. Pejgamberët ishin ndërmjetësues mes Allahut dhe krijesave të Tij.
3. Numri i pejgamberëve të Allahut ishte shumë i madh, prej tyre kishte të dërguar-*nebij*, e prej tyre kishte edhe të dërguar-*resul*.
4. Pejgamberët e Allahut kishin tipare dhe cilësi të ngjashme.
5. Të gjithë pejgamberët e Allahut thirrnin për besim në Allahun Një.
6. Të gjithë pejgamberët e Allahut ishin të obliguar me adhurime, prej tyre: namazin, zekatin, agjërimin dhe haxhin, edhe pse format e adhurimeve dhe kohët e tyre mund të ndryshonin.
7. Uniteti i thirrjes së pejgamberëve është argument se ata frymëzoheshin prej një Burimi të vetëm dhe prej së njëjtës Dritë Hyjnore.

Literatura e konsultuar:

1. *KURANI- përkthimi me komentim në gjuhën shqipe.* Përkthehu dhe komentoi: H. Sherif Ahmeti.
2. *KURANI i madhërishëm*, përktheu kuptimet e tij nga gjuha arabe: prof. Hasan. I. Nahi. Bot: Instituti shqiptar i Mendimit dhe Qytetërimit Islam.
3. *El Muharreru-l vexhiz fi tefsiri-l Kitabi-l Aziz*, Ebu Muhammed Abdul Hakk ibn Galib Ibn Atijeh El Endelusij, recenzoi: Abdusselam Abdushafij Muhammed, bot: Daru-l Kutub el Ilmijeh, Bejrut, 1422 h.
4. *El Bahru-l Muhit fi-t-Tefsir*, Ebu Hajjan, Muhammed Ibn Jusuf Ibn Hajjan el Endelusij, recenzoi: Sidkij Muhammed Xhemil, bot: Daru-l Fikr, Bejrut, 1420 h.-Tefsiru-l Kurani-l Adhim, Ebu-l Fida, Ismail Ibn Umer Ibn Kethir Ed Dimeshkij, recenzoi: Sami Muhammed Selameh, bot: Dar Tajjibah, 1999.

5. *El Xhamiu-s-Sahihu-l Musned min hadithi Resulil-lahi ve sunenihi ve ejamihi*- Sahihu-l Buhari, Ebu Abdullah, Muhamed Ibn Ismail El Buharij, recenzoi. Muhamed Fuad Abdul Bakij, bot: El Mektebetu-s-Selefijeh, Kajro, 1400 h.
6. *Sahihu Muslim*, Ebu-l Husejn, Muslim Ibn el Haxhaxh el Kushejrij en-Nejsaburij, recenzoi: Muhammed Fuad Abdul Bakij,bot: Dar Alem el Kutub, botimi i parë, viti i botimit: 1996.
7. *Sunen Ebi Davud*, Sulejman Ibnu-l Esh'ath es-Sixhistanij el-Ezdij, recenzoi: Izzet Ubejd Deas, bot: Dar el Hadith-Hims, 1969.
8. *Sunenu-t-Tirmidhij*, Muhamed Ibn Isa Ibn Sevrete et Tirmidhij, mbikqyri botimin e tij, Meshhur Hasen Selman, bot: Mektebetu-l Mearif, Rijad.
9. *Sunen en-Nesaij*, Ebu Abdurrahman, Ahmed iben Shuajb Ibn Alij en-Nesaij, mbikqyri botimin e tij, Meshhur Hasen Selman, bot: Mektebetu el Mearif, Rijad.
10. *Sunen Ibn Maxheh*, ebu Abdullah, Muhammed Ibn Jezid el Kazvinij, mbikqyri botimin e tij, Meshhur Hasen Selman, bot: Mektebetu el Mearif, Rijad, botimi i parë.
11. *El Musned*, ebu Abdullah, Ahmed Ibn Muhammed Ibn Hanbel esh Shejbanij, verifikoi hadithet e librit dhe recenzoi, Shuajb Arnauti me bashkëpunëtor, bot: Muesesetu er Risale, Bejrut, 2001.
12. *El-Musned*, Ebu Ja'la, Ahmed Ibn Alij ibnu-l Muthenna et-Temimij, verifikoi hadithet e librit, dhe recenzoi: Husejn Selim Esed, bot: Daru-l Me'mun, Damask, 1984.
13. *El Mustedrek ale-s-Sahihajn*, Ebu Abdilah el Hakim en-Nejsaburij, mbikëqyri botimin e tij, dr. Jusuf el Murashlij, bot: Daru-l Ma'rifeh.
14. *Es-Sunenu-l Kubra*Ebu Bekër Ahmed Ibn Husejn Ibn Alij el Bejhekij, shpërndau: Mektebet Ibn Tejmijeh, Kajro.
15. *El Fevaid*, Ebu-l Kasim, Temmam Ibn Muhammed er-Razij ed Dimeshkij, recenzoi: Hamdij Abdul Mexhid, mektebetu er Rushd, Rijad, botimi i parë, viti i botimit: 1412 h.
16. *Muhtesar esh Shemail el Muhammedijeh*, Muhammed Nasiruddin el Albani, bot: Mektebetu el Mearif, Rijad, 2002.
17. *Silsiletu-l ehadith es-Sahiha*, Muhammed Nasiruddin el Albani, bot: Mektebetu el Mearif, Rijad, viti i botimit: 2002.
18. *Sisiletu-l ehadith ed-Daife,* Muhammed Nasiruddin el Albani, bot: Mektebetu el Mearif, Rijad, 1992.

19. *Er-Ravdu-l Bessam bi tertibi ve tahrixhi fevaidi-t-temmam,* Ebu Sulejman, Xhasim Ibn Sulejman ed-Devserij, bot: Daru-l Beshair el Islamijeh, Bejrut, 1987.
20. *Siretu Ibn Hisham*, Abdul Melik Ibn Hisham el Himjerij el Meafirij, recenzoi: Mustafa es-Seka me bashkëpuntorë, bot: Bab el Halebij, Egjipt, 1955.
21. *Esh Shifa bi tarif hukuki-l Mustafa*, Ebu-l Fadl Ijad el Jahsubij, Dar el Fikr, Bejrut, 1988.
22. *Hajatu-l Enbijai fi kuburihim*, Ebu Bekër, Ahmed Ibn el Husejn el Bejhekij, recenzoi, dr. Ahmed Ibn Atijeh el Gamidij, bot: Mektebetu-l Ulum ve-l Hikem, Medinë, 1993.
23. *En Nubuvat*, Ebu-l Abbas Ahmed Ibn Abdul Halim Ibn Tejmijeh el Harranij, recenzio, dr. Abdul Aziz et Tuvejan, bot; Adva es Selef, Rijad, 2000.
24. *Sherh el Asbahanijeh,*Ebu-l Abbas Ahmed Ibn Abdul Halim Ibn Tejmijeh el Harranij, recenzio, dr. Muhammed Ibn Avdete es Savij, bot: Dar el Minhaxh, Rijad, 1430 h.
25. *Bedai'u el Fevaid,*Ebu Abdullah, Muhammed IbnEbi Bekër Ibn Kajjim el Xhevzijjeh, recenzoi, Alij Imran, bot: Dar Alem el Fevaid, Mekë, 1425 h.
26. *Sherhu-l Akideti-t-Tahavijeh*, Alij Ibn Alij Ibn Muhammed Ebul Izz ed-Dimeshkij, verifikoi hadithet e librit dhe recenzoi: dr. Abdullah Ibn Abdul Muhsin et-Turkij dhe Shuajb el Arnauti, bot: Muesesetu er Risale, Bejrut, 1998.
27. *Levamiu-l envaru-l behijjeh ve sevatiu-l esrar el etherijeh*, Muhammed Ibn Ahmed es-Sefariinij, Bejrut, 1411h.
28. *El Mufhimu lima eshkele min telhis kitabi Muslim*, Ebu Hafs, Umer Ibn Ibrahim el Kurtubij, recenzoi: Muhjiddin Mustu me bashkëpunëtorë, 1428 h.
29. *Fajdu el Kadir*, Abdurreuf Ibn Alij el-Munavij, bot: el Mektebetu et tixharijeh el Kubra, Egjipt, 1356 h.
30. *Mu'xhemu-l mealim el gjugrafijeh fi-s-Sireti-n-Nebevijeh*, Atik Ibn Gajth el Biladij, dar Mekke, Mekke,1982.
31. *El-Mealimu-l ethire fi-s-Sunneti ve-s-Sireh*, Muhammed Ibn Muhammed Ibn Husejn Sherrab, bot: Dar el Kalem, Damask, 1411 h.

Bali SADIKU

THE SIMILARITIES BETWEEN THE CALLING OF MUHAMMAD WITH THAT OF THE PROPHETS BEFORE HIM

(Summary)

Allah the magnificent created man and equipped him with superior characteristics, he chose prophets from among them, through them he told truth from falsehood, illuminated the right path, which, if followed, will grant happiness in this world and guarantee a place among the victorious in the next.

This was the calling of all the prophets of Allah starting from Adam and up to Muhammad. What they advise us in essence is the same and comes from the same source. Consequently, this drove me to write a few words about this topic.

In this paper I have analyzed the similarities between prophets, as far as their personal qualities and characteristics are concerned, their prophetic characteristics, their call to believe in one god, and their similarities in worshiping.

بالي صاديقو

علاقة دعوة محمد صلى الله عليه وسلم بدعوات الأنبياء قبله

(خلاصة البحث)

خلق الله سبحانه وتعالى الناس ، وأصبغ عليهم نعما عديدة ، باختياره الأنبياء منهم ، وبهم أوضح الحقيقة من الباطل ، وأنار طريق الهداية ؛ الطريق الذي إذا ابتعه العبد نجى ، و يعيش في سعادة في هذه الدنيا و في الآخرة يكون من الفائزين.

ولقد دعى جميع الأنبياء إلى هذه الطريق، من آدم إلى محمد عليهم السلام، إن الدعوة التي دعوا إليها هي في جوهرها الدعوة نفسها وهي من نفس المصدر، ذلك دفعني إلى كتابة بعض الأسطر حول هذا الموضوع.

لقد تكلمت في هذا العمل عن تشابه الأنبياء بينهم في صفاتهم الشخصية والخصائص، و تشابههم في الصفات النبوية ، و تشابههم في القواعد الشرعية ؛ في دعوتهم للإيمان بإله واحد فقط ، وتشابههم في جوهر العبادة.

Sadik MEHMETI

DORËSHKRIMET ORIENTALE TË ILUMINUARA NË ARKIVIN E KOSOVËS DHE RUAJTJA E TYRE

Abstrakt

Në Arkivin e Kosovës, ruhen 63 kodekse ose 96 dorëshkrime në gjuhën arabe, turke dhe persiane. Këto dorëshkrime që ruan Arkivi i Kosovës, përbëjnë një koleksion të çmueshëm dhe antikuar, sepse, përveç të tjerash, tri prej tyre janë dorëshkrime unikale dhe pasurojnë listën botërore të dorëshkrimeve orientale.

Në mesin e këtyre dorëshkrimeve orientale që ruan Arkivi i Kosovës, nëntë (9) prej tyre dallohen për ilustrimet e tyre artistike, për kaligrafinë e bukur, arabeskat origjinale me koloritin e gërshetimeve të florës, ornamentet me motive të ndryshme në kapakët e dorëshkrimeve, me *"unvânet"* e shkruar me bojëra të ndryshme, pa harruar këtu ngjyrën e arit, që këtyre dorëshkrimeve u jep një bukuri të rrallë, dhe për ekspertët e kaligrafist dhe të artit aplikativ, paraqesin dokumentacion hulumtues të dorës së parë.

Duke u nisur nga ky fakt, kumtesa jonë synon të qartësojë dhe të vërë në pah vlerën e lartë historike-artistike që kanë këto dorëshkrime që ruhen në Arkivin e Kosovës.

Fjalët çelës: *Arkivi i Kosovës, dorëshkrimet orientale, iluminime, unvânet, kaligrafia, arabeskat, ornamentet*

* * *

Në Arkivin e Kosovës, sikurse e kemi thënë edhe herë të tjera[1], ruhet edhe fondi i dorëshkrimeve orientale në formën e veprave të plota të pabotuara, me gjuhë bazë arabishten, turqishten, persishten dhe gjuhën shqipe, me grafi arabe. Këto dorëshkrime përbëjnë një fond antikuar dhe me vlera kulturo historike, sepse tri prej tyre janë dorëshkrime të rralla dhe pasurojnë listën botërore të dorëshkrimeve orientale.

Numri i përgjithshëm i dorëshkrimeve orientale që ruhen në Arkivin e Kosovës arrin në 65 kodekse ose në 96 vepra dorëshkrim, kurse kronologjikisht përfshijnë pesë shekuj - XV-XX[2].

Në mesin e këtyre dorëshkrimeve që ruan Arkivi i Kosovës, nëntë (9) prej tyre dallohen për iluminimet e veçanta, për kaligrafinë e bukur, për arabeskat origjinale me koloritin e gërshetimeve të florës, për ornamentet me motive të ndryshme në kapakët e dorëshkrimeve, si dhe për *"unvânet"* (dekorimet) e shkruar me bojëra të ndryshme, pa harruar këtu ngjyrën e arit, që këtyre dorëshkrimeve u jep një bukuri të rrallë. Kështu, këto dorëshkrime të punuara nga artistë edhe vendorë dhe me kronologji të ndryshme, paraqesin shembuj të shkëlqyeshëm të kaligrafisë e të artit islam në veçanti dhe të artit botëror në përgjithësi.

Duhet thënë që në fillim se të gjitha dorëshkrimet orientale në Arkivin e Kosovës janë të shkruara vetëm në letër. Llojet e letrës janë nga më të ndryshmet, nga ajo më e thjeshta, e vrazhdë dhe më pak rezistuese, e deri tek ajo më cilësorja - e lëmuar, shkëlqyese dhe rezistuese ndaj viteve. Shumica e dorëshkrimeve kanë ruajtur po thuaj të pa ndryshuar pamjen dhe ngjyrën e letrës mbi të cilën janë shkruar, si dhe qartësinë dhe lexueshmërinë e shkrimit.

Për sa i takon bojës, në shumicën e dorëshkrimeve është përdorur boja e zezë *(myreqep),* e cila i përgjigjet cilësisë së tushit të sotëm. Kjo lloj boje ka ruajtur shkëlqimin e saj gjatë shumë shekujve. Për zbukurimin e

[1] Mr. Sadik Mehmeti, *Dorëshkrimet orientale në Arkivin e Kosovës*, (monografi), Prishtinë, 2008; Sadik Mehmeti, *Shënimet në dorëshkrimet orientale në Arkivin e Kosovës*, "Vjetari i Arkivit të Kosovës, nr. 29-30/2003, f. 503-526; *Dorëshkrimet orientale në Arkivat e Kosovës*, në: "Perla" Tiranë, 2009/2, f. 21-32 etj.

[2] Mr. Sadik Mehmeti, *Dorëshkrimet orientale në Arkivin e Kosovës*, Prishtinë, 2008, f. 33.

shkrimit, për titujt dhe nëntitujt në dorëshkrime, për kryeradhët, për të theksuar ajetet, hadithet, vendet e rëndësishme në tekst, apo për të kornizuar tekstin, është përdorur edhe boja e kuqe. Ndërsa *unvânet* (dekorimet) në hyrje të tekstit janë shkruar me bojëra të ndryshme, sipas ngjyrës së kuqe, ngjyrë rozë, ngjyrë e bardhë, ngjyrë e kaltër etj.

Shumica e dorëshkrimeve, dallohen për kaligrafinë e tyre të jashtëzakonshme dhe për ornamentet në kopertina; një pjesë e tyre janë të iluminuara, vetëm dorëshkrimi i enciklopedisë *"Ma'rifatnâme-i Hakkı"*[3] ka dhjetëra ilustrime jashtëzakonisht të bukura, kurse disa të tjera janë të lidhura dhe të zbukuruara në mënyrë artistike dhe me ornamente të mrekullueshme.



Kapakët me ornamente të dorëshkrimit "Mir'ât el-Usûl fî sherh Mirkât el-Vusûl"

[3] Është enciklopedi islame, që bënë fjalë për misticizmin, etikën dhe për shkencat tjera islame. E ka shkruar më 1170/1756 Sheyh Ibrâhîm Hakkı b. Darvîsh 'Uthmân al-Arzarûmî as-Sûfî al-Hanafî, vdiq më 1195/1780. Është në gjuhën turke dhe ka format 31x18.5 cm.; teksti 24x12 cm. Është i pavokalizuar. I paginuar dhe përmban 472 +20 fletë (954+40 faqe). Letra e verdhë; shkrimi me ngjyrë të zezë. Nuk dimë kush është kopjuesi dhe as vitin e kopjimit. Është lënë vakëf nga Enver Ibrahim beu i biri i Ali beut në vitin 1253/1837. Në faqen e parë është një shënim i vitit 1931, i bërë nga imami i xhamisë "Katër Llulla", haxhi Ahmedi, në të cilin shkruan se ai (Mulla Ahmedi) është emëruar imam më 1922. Më gjerësisht, shih: Mr. Sadik Mehmeti, *Dorëshkrimet orientale në Arkivin e Kosovës*, Prishtinë, 2008, f. 132-133.



Kapakët me ornamente me ngjyrë ari të dorëshkrimit "Anvâru at-tanzîl wa asrâru at-tavîl"

Duke pasur parasysh se deri në vitin 1727 në Perandorinë Osmane libri shpërndahej në formën e kulturës dorëshkrimore, pra duke u kopjuar dorë pas dore dhe tek në këtë vit, kur u hap shtypshkronja e parë shtetërore osmane, libri filloi të shtypej. Kjo ka bërë që nga ajo kohë, pra edhe në trojet shqiptare të shkruheshin shumë dorëshkrime, një pjesë e tyre e cila ka arritur deri në ditët tona. Ndonëse futja e shtypshkronjës së parë erdhi paksa me vonesë, kjo pati edhe një të mirë, sepse ndikoi në shkrimin dhe kopjimin në formë dorëshkrimore të mijëra e mijëra veprave, kjo në njërën anë. Kurse në anën tjetër, meqë përgatitja e një dorëshkrimi në formën e librit përbënte një proces të vështirë dhe kompleks, i cili duhej të kalonte nëpër disa faza, për këtë arsye në përgatitjen e një dorëshkrimi merrnin pjesë disa profesionistë e që janë, bukurshkruesi *(hattâti)* dekoruesi artistik dhe miniaturisti i dorëshkrimit *(ressâmi)* dhe libralidhësi

(mucellidi). Këto tri profesione kanë pasur edhe esnafët e tyre që kanë luajtur një rol të veçantë në jetën kulturore të shqiptarëve mysliman[4].

Këto tri zanate kanë pasur një traditë të aftësimit profesional nga mjeshtër të specializuar, në zanatin e bukurshkrimit dhe të iluminimit të dorëshkrimeve. Kurse studentët që aftësoheshin profesionalisht në këto fusha iu lëshohej edhe diploma nga mjeshtri i tyre. Secili nga këto tri zanate ka pasur lidhje bashkëpunimi të ngushtë me ndonjërin nga esnafet e mëdha. Bukurshkruesi (hattati) kanë bashkëpunuar me divitçinjtë dhe me kujuxhinjtë (për ngjyrën e arit) dhe me bojaxhinjtë (për mereqepin). Ndërsa libralidhësit kishin bashkëpunim me tabakët, sepse kopertinat e librave, respektivisht të dorëshkrimeve i bënin tërësisht apo pjesërisht nga lëkura.[5]

Ndër shqiptarët dhe nëpër kohë, janë dalluar mjaftë kaligrafistë dhe libralidhës që kanë vepruar dhe që kanë lënë dorëshkrime të tyre. Por meqë kjo nuk është tema e kumtesës tonë këtu, do t'i përmendim një herë tjetër[6].

Ndër dorëshkrimet e iluminuara që ruhen në Arkivin e Kosovës, është edhe një kopje e Kuranit që është i shkruar me shkrimin arab nes'h të trashë, shumë të bukur, i kornizuara me ngjyra të përziera me ar dhe me zbukurime po me ngjyrë ari. Në fillimin e kaptinës së dytë ka një iluminim të mrekullueshëm me lule të imëta të fushës, me ngjyrë të kaltër dhe të arit. Ka kopertina të dëmtuara, por të pasura me dekorime dhe ornamente me ar. Dhe, është kopjuar në vitin 1840[7]. Duhet thënë se librit të shenjtë të myslimanëve dhe librave që kanë të bëjnë me biografinë e profetit Muhamed, gjithmonë u është kushtuar kujdes më i madh dhe veprat e tilla rëndom përmbajnë iluminime. Por edhe komenteve të Kuranit u është kushtuar mjaftë kujdes, siç është ky që ruhet në Arkivin e Kosovës me titull *"Anvâru at-tanzîl wa asrâru at-tavîl"*, dhe i cili dallohet për kaligrafinë dhe dekorimet artistike me ngjyrë ari, dhe i cili daton nga viti 1665[8].

---

[4] Dr. Nehat Krasniqi, *Zhvillimi i kulturës shqiptare me ndikime orientale prej shekullit XVIII deri në fillimet e Rilindjes Kombëtare, Instituti Albanologjik,* Prishtinë, 2017, f. 140-141.

[5] Dr. Nehat Krasniqi, *Zhvillimi i kulturës shqiptare me ndikime orientale...,* po aty, f. 140.

[6] Të dhëna interesante dhe me shumë interes për kaligrafistët dhe libralidhësit shqiptarë në trojet tona, na jep për herë të parë Dr. Nehat Krasniqi në veprën e tij tashmë të përmendur *"Zhvillimi i kulturës shqiptare me ndikime orientale..."*, po aty, f. 141-147.

[7] Mr. Sadik Mehmeti, *Dorëshkrimet orientale...,* po aty, f. 44.

[8] Është në gjuhën arabe. Është komentimi i njohur i Kuranit nga 'Umar ibn Muhammad ibn 'Ali Abûl-hayr Nasiruddîn al-Baydâvî. Përmban 15 suret e para të komentimit të Kuranit

Faksimile faqes së parë të iluminuar
të dorëshkrimit "Anvâru at-tanzîl wa asrâru at-tavîl"

Një dorëshkrim tjetër që ruhet në Arkivin e Kosovës është edhe vepra *"Al-Vasîlatu al-Ahmediyya va adh-Dharî'atu as-sarmediyya fî sharhi at-Tarîkati al-Muhammadiyya"* e shkruar me shumë elegancë, përsosmëri

("Al-Fatiha" - "Al-Isra"). Ka format 27.5x14.5 cm. Teksti 20x9 cm. Ka të shënuar numrin e faqeve dhe përmbledh 606 faqe. Është i ruajtur mirë. Ka disa shënime në margjina, si p.sh. se është blerë 23 groshë. Kopjimin e këtij komentimi të Kuranit nga origjinali e ka bërë në dhjetëditëshin e parë të muajit Ramazan të vitit 1076/1665 Ali bin Jusuf, kadi në qytetin e Segedinit-ish-Beshiktashit. Dorëshkrimi ka qenë pronë e bibliotekës së Ahmed Hamdiut, siç shihet nga vula e tij, kurse më pas, më 1153/1740 ka qenë pronë e Abdylkadër ibn Ahmedit, kurse më 1161/1748 pronë e njëfarë Ibn Hysenit. Më gjerësisht, shih: Mr. Sadik Mehmeti, *Dorëshkrimet orientale...*, po aty, f. 48-49.

stilistike dhe korrekt, me shkrimin nes'h të imët, të shkruar nga një kaligraf i rrallë dhe i cili, në fillim të faqes së parë, ka një *unvân* të mrekullueshëm me lule të imëta fushe me ngjyrë të kaltër dhe të bardhë të praruar me ar, bërë nga një artist i spikatur. Edhe kopertinat i ka me ornamente të praruara me ar. I takon vitit 1790[9].



Faksimil i faqes së parë të iluminuar të dorëshkrimit "al-Vasîlatu al-Ahmadiyya wa adh-Dharî'atu as-sarmadiyya fî sharhi at-Tarîkati al-Muhammadiyya"

[9] Dorëshkrim në gjuhën arabe. Ka format 32x20 cm. Teksti 27x12 cm. Ka 448 faqe. Komentimin e kësaj vepre (dorëshkrimi konkret) e ka bërë shejh Haxhi Rexheb bin Ahmedi dhe e ka titulluar: *"al-Vasîlatu al-Ahmadiyya wa adh-Dharî'atu as-sarmadiyya fî sharhi at-Tarîkati al-Muhammadiyya"*, të cilin e ka mbaruar më 1087/1676, në qytetin Tire. Autor i veprës bazë është Muhammad Pir 'Ali al-Bargivî (929-981/1523-1573), dhe mban titullin *"at-Tarîkatu al-Muhammadiyya wa as-Sîratu al-Ahmadiyya"*, i shkruar më 980/1572. Kopjimin e dorëshkrimit konkret e ka bërë Ibrahim bin Haxhi Halili, më 1205/1790. Atë e ka filluar në Mekë, kurse e ka përfunduar në në Medinë. Në faqet 1 e 2 dhe në të fundit është vënë vula në të cilën shkruan se ky dorëshkrim ka qenë pronë e bibliotekës së Hysen efendiut, myfti i Prishtinës. Më gjerësisht, shih: Mr. Sadik Mehmeti, *Dorëshkrimet orientale...*, po aty, f.95-98.

Sikurse e thamë më sipër, një dorëshkrim që përmban shumë iluminime dhe dekorime artistike është edhe dorëshkrimi i veprës *"Ma'rifatnâme-i Hakkı"* e që ruhet në Arkivin e Kosovës.



Faksimile të iluminuar të dorëshkrimit të veprës "Ma'rifatnâme-i Hakkı"



Faksimile të iluminuar në brendi të dorëshkrimit të veprës "Ma'rifatnâme-i Hakkı"

Po ashtu janë mjaftë të bukura edhe dy *"Kânunnâm"-et* e vetme që ruhen në këtë arkiv, njëra e vitit 1673 dhe tjetra e vitit 1756 që kanë iluminime mjaftë të bukura[10].

Faksimil i faqes së parë të iluminuar
të dorëshkrimit të veprës "Kânunnâma"

Nga sa u tha më sipër mund të përfundojmë se dorëshkrimet orientale në përgjithësi dhe ato të iluminuara në veçanti, që ruhen në Arkivin e Kosovës, përmbajnë një lëndë tejet të vlefshme për studime albanologjike. Në këtë trashëgimi përveç të dhënave të tjera të rëndësishme për dijet al-

[10] Është në gjuhën turke. Ka format 23x14 cm. Teksti 16.5x7 cm. Është e shkruar me shkrimin ta'lik, të bukur, të ngatërruar, me penë të trashë. Është kopjuar në muajin muharrem të vitit 1084/1673, nga një autor anonim. Më gjerësisht, shih: Mr. Sadik Mehmeti, *Dorëshkrimet orientale...,* po aty, f. 134-136.

banologjike gjenden të dhëna me interes, edhe për kopjuesit, pronarët, kaligrafët, libërlidhësit, dhe për përgatitësit artisitk të këtyre dorëshkrimeve.

Por meqë këto dorëshkrime janë kaq të rëndësishme, atyre duhet siguruar vend/depo të sigurta me temperaturë dhe lagështi optimale. Vendi ku ruhet aktualisht koleksioni i dorëshkrimeve në Arkivin e Kosovës, është shumë larg kushteve dhe standardeve bashkëkohore që kërkohen. E pakta që mund të bëhet në këtë fazë është sigurimi i kutive nga letra, kimikisht e përshtatshme, respektivisht nga letra e deaciduar, për ruajtjen e dorëshkrimeve.

Është një e arritur e madhe e Arkivit të Kosovës, fakti se në vitin 2014 në bashkëpunim me Institutin "Yunus Emre" nga Turqia, ka bërë digjitalizimin e këtyre dorëshkrimeve, i cili këto materiale edhe ashtu të dëmtuara dhe njëherësh atraktive për përdorim dhe për ekspozita të ndryshme, do t'i ndalonte në një masë të madhe nga dëmtimi i tyre i mëtutjeshëm.

Meqë nuk ka ndonjë standard të veçantë ndërkombëtar të përshkrimit bibliografik të dorëshkrimeve orientale, është e domosdoshme që bibliografi të mbështetet në Standardin Ndërkombëtar të përshkrimit bibliografik të antikuarëve ISBD (A): International standard bibliographic description for older monographic publications (Antiquarian), të cilin e ka nxjerrë IFLA (International Federation of Library Associations and Institutions).[11]

Mungesa e një standardi ndërkombëtar të veçantë për përshkrimin bibliografik të dorëshkrimeve orientale, më ka detyruar personalisht që gjatë punës në Arkivin e Kosovës, të ndjek praktikën e katalogimit dhe përshkrimit të tyre sipas mënyrës së bërë në Bibliotekën e njohur të Gazi Husrev begut në Sarajevë.

Arkivi i Kosovës duhet urgjentisht që të krijojë një ambient të përshtatshëm për përdorimin e koleksionit të dorëshkrimeve të veçanta nga të interesuarit. Ky ambient duhet të pajiset me teknikën e nevojshme për përdorimin e tyre. Gjithashtu Arkivi duhet të hartojnë *rregullore* të veçantë për përdorimin e koleksionit të dorëshkrimeve, sepse dorëshkrimet

[11] Dr. Nehat Krasniqi, *Gjendja e koleksioneve të dorëshkrimeve arabike në Kosovë dhe sfidat bashkëkohore të trajtimit të tyre,* në: "Edukata Islame", nr112, Prishtinë, 2018, f. 98.

nuk mund të jepen në përdorim në mënyra dhe kushte të njëjta, sikurse jepen materialet e tjera bibliotekare. Këtë na detyron vlera materiale, dokumentare, historike kulturore dhe shkencore që kanë këto dorëshkrime, si në rrafshin kombëtar, po ashtu edhe në atë ndërkombëtar.

Dhe fare në fund, duhet thënë se dokumentet dhe dorëshkrimet orientale që ruhen në Arkivin e Kosovës me tërë kompleksivitetin e tyre, për historianët, orientalistët, ekspertët e paleografisë arabe, të kaligrafisë dhe të artit aplikativ, paraqesin dokumentacion hulumtues të dorës të parë; ato përbëjnë një fond të çmueshëm dhe antikuar.

Literatura:

1. Arkivi i Kosovës, *Koleksioni i Dorëshkrimeve Orientale.*
2. Dobraća, Kasim. *Katalog arapski, turskih i perzijskih rukopisa*, svezak prvi, Sarajevo, 1963.
3. Dobraća, Kasim. *Katalog arapski, turskih i perzijskih rukopisa*, svezak drugi, Sarajevo, 1979.
4. Krasniqi, Dr. Nehat. *Gjendja e koleksioneve të dorëshkrimeve arabike në Kosovë dhe sfidat bashkëkohore të trajtimit të tyre*, në: "Edukata Islame", nr112, Prishtinë, 2018, f. 83-101.
5. *Krasniqi,* Dr. Nehat. *Zhvillimi i kulturës shqiptare me ndikime orientale prej shekullit XVIII deri në fillimet e Rilindjes Kombëtare, Instituti Albanologjik, Prishtinë, 2017.*
6. Mehmeti, Mr. Sadik. *Dorëshkrimet orientale në Arkivin e Kosovës*, (monografi), Prishtinë, 2008.
7. Mehmeti, Sadik. *Shënimet në dorëshkrimet orientale në Arkivin e Kosovës*, "Vjetari i Arkivit të Kosovës, nr. 29–30/2003, f. 503–526.

Sadik MEHMETI

ILLUMINATED ORIENTAL MANUSCRIPTS IN THE ARCHIVE OF KOSOVA AND THEIR PRESERVATION

(Summary)

63 codexes and 96 manuscripts in Arabic, Turkish and Persian are preserved in the Archive of Kosova. These manuscripts are part of a valuable collection. Three of them are unique manuscripts and enrich the world list of Oriental manuscripts.

Nine of the manuscripts preserved in the Archive of Kosova are famous for their illustrations, beautiful calligraphy, original arabesques, ornaments with different motives on their covers, which give special beauty to these manuscripts, some of which were made by local artists, and are extraordinary examples of Islamic calligraphy and art in particular and world art in general. To art historians and experts of calligraphy and applied arts they represent a primary source for their research.

Bearing in mind the fact that the issue of illuminated Oriental manuscripts and their domestic authors has not been studied so far, this paper aims at emphasizing the historic and artistic value of these manuscripts preserved in the Archive of Kosova.

صادق مهميتي

المخطوطات الشرقية في أرشيف كوسوفا والحفاظ عليها

(خلاصة البحث)

في أرشيف كوسوفا ، يتم الاحتفاظ بـ ٦٣ مرقم أو ٩٦ مخطوطة باللغة العربية والتركية والفارسية. وهذه المخطوطات التي يحتفظ بها أرشيف كوسوفا هي مجموعة ثمينة وعتيقة لأنها ومن بين أمور أخرى، ثلاثة من هذه المخطوطات هي فريدة وتغني القائمة العالمية للمخطوطات الشرقية.

ومن بين هذه المخطوطات الشرقية التي تحفظ في أرشيف كوسوفا، تسعة (٩) منها تتميز برسمها الفني، وخطها الجميل، والأرابيسك الأصلية مع تلوين حلي النسيج والمزهر، وعناوين مزخرفة ذات دوافع مختلفة في أغلفة المخطوطات المكتوبة بالأحبار المختلفة، دون أن ننسى لون الذهب، والذي يعطي هذه المخطوطات الجمال النادر، والمؤلفة من قبل الفنانين المحليين أيضا،- تمثل أمثلة بارزة للخط في الفن الإسلامي بشكل خاص و الفن العالمي بشكل عام ، بينما تمثل لمؤرخي الفن ، وخاصة خبراء فن الخط والفن التطبيقي ، فإنها تقدم وثائق بحثية من الدرجة الأولى.

وانطلاقا من هذا الأمر، ونظرا إلى عدم وجود حتى الآن لدينا دراسة للمخطوطات الشرقية وكذلك للفنيين المحليين المؤلفين لهذه المخطوطات، ورقتنا هذه تهدف إلى توضيح وتسليط الضوء على القيمة التاريخية الكبير ة لهذه الأعمال الفنية التي تحتوي على هذه المخطوطات المخزنة في أرشيف كوسوفا.

Hatixhe AHMEDI

PERSONALITET I DITURISË FRYTËDHËNËSE DHE SINQERITETIT TË PASHËMBËLLT (Ali Jakup ef. Shkodra - 1913-1988)

Abstrakt

Në këtë punim do të bëhet fjalë për një personalitet të famshëm të trojeve tona, i cili sakrifikoi gjithçka vetëm e vetëm për të nxënë dituri dhe për t'u bërë alim me përmasa botërore, më saktësisht për Ali Jakup ef. Shkodrën. Energjia dhe elani i tij, e shtynë atë që të frekunetonte medrese me renome dhe myderrizë të shquar të vendeve të ndryshme, duke filluar nga medreseja në vendlindjen e tij, Gjilan, pastaj medresenë "Meddah në Shkup", Shkollën e Lartë e Sheriatit në Sarajevë dhe Universitetin e "Az-harit" në Egjipt. Pasi arriti grada të larta në dituri të ndryshme fetare, ai në tri dekadat e fundit të jetës së tij, u shpërngul në Stamboll, me ç'rast bashkëpunoi me personalitetet më të famshme fetare, të asaj kohe. Në këtë punim tonin, mendoj se kemi sjellë të dhëna të frytshme, duke u munduar të trajtojmë të gjitha etapat e jetës dhe të shkollimit të tij, qëndrimi dhe takimi me personalitet e shquara, sfidat, sakrificat, aktivitetet, meritat deri në përmbylljen e kapitullit të jetës së tij në Stamboll.

Fjalët kyçe: *Ali Jakupi, Gjilan, Az'har, Shejhu-l Islam, Stamboll etj.*

Hyrje

Të thuash se nga populli shqiptar kanë dalë dijetarë me renome, të cilët me dijen dhe punën e tyre kanë bërë emër dhe i kanë tejkaluan kufijtë lokalë të vendit ku jetuan dhe vepruan, tashmë nuk është ndonjë gjë e re, sepse këtë e kanë vënë në dukje dhe kanë shkruar shumë studiues. Porse ndriçimi i këtyre personaliteteve që kanë shkruar në gjuhët orientale dhe kanë lënë gjurmë të pashlyeshme në këto gjuhë, prapëseprapë, mbetet një obligim që duhet përmbushur.

Ndër ato personalitete dijetarësh, emri i të cilit përmendet edhe sot, me pietet, kudo që veproi, është edhe *Ali Jakup ef. Shkodra (1913-1988),* nga Desivojca e Dardanës (ish-Kamenica), me emrin e të cilit jam rritur, pa e ditur se kush është ai.

Ç'është e drejta, për Ali efendiun në familjen tonë është folur aq shumë dhe emri i tij lidhej ngushtë me emrin e axhës sonë të shquar, Hfz. Nexhatiun, saqë kam menduar se ai, me gjasë, do të ketë qenë ndonjë nga të afërmit tanë, që ishte shpërngulur në Turqi!

Më vonë, fillova të interesohesha për këtë "anëtarë të familjes" dhe të pyesja se kush ishte ai. Shumë herë e kam pyetur veten: a thua çfarë pune të hajrit kishte bërë ai, që të përmendej aq shpesh dhe me kaq respekt. Fillova të merrja shënime nga ata që pyesja dhe fillova të hulumtoja literaturën nëse ishte shkruar diçka për Ali efendiun.

Në vitin 2006, në "Kalendarin/Takvimin", nr. 37, f. 181/192, u botua një shkrim i z. Ramadan Shkodrës me titull "Ali efendi Jakupi (1913-1988) - një ndër alimët më të mëdhenj të shekullit XX", ku jepeshin të dhëna jetëshkrimore për Ali efendiun. Ky shkrim më nxiti edhe më tepër që të merresha me njohjen dhe ndriçimin e kësaj figure, sepse aty u binda se kishim të bënim më një dijetar të madh shqiptar, i cili me punën e tij, kishte bërë emër dhe nam në Stamboll dhe gjithandej në Turqi.

Më pastaj, më ranë në dorë edhe shumë materiale të tjera, si zëri për Ali ef. i botuar në "Islam Ansiklopedisi"[1] nga autori prof. Dr. Ekmeluddin Ihsanoglu. Po ashtu kam zhvilluar edhe shumë biseda me njerëz që e

[1] Encikopedia Islame, e cila është botim i Institutit për Hulumtime Islame (ISAM), - nën mbikqyrjen e Dijanetit të Republikës së Turqisë.

kanë njohur Ali efendiun dhe me nxënës të tij, që sot janë personalitetet të dalluara të dijes dhe të shkencës, si hfz. Avni Ahmedi, Prof. Dr. Ekmeledin Ihsanoglu, Dr. Necdet Yilmaz, Dr. Hikmet Atan, Ramadan Shkodra, të cilët gjej rastin t'i falënderoj botërisht për gatishmërinë e tyre që të më jepnin të dhëna dhe të më flisnin për Ali efendiun. Ky punim është hartuar mbi bazën e këtyre të dhënave dhe është një si shlyerje borxhi jo vetëm për Ali efendiun, por edhe për të gjithë ata që më kanë folur për të.

Por kush është në të vërtetë, ky dijetar, hoxhë, alim dhe personalitet i dalluar? Kush është Ali efendi Jakupi-Shkodra?

Familja dhe arsimimi

Ali Jakup ef. Shkodra u lind në fshatin Desivojcë të Komunës së Kamenicës në vitin 1913. Familja e tij kishte origjinë nga viset e Shqipërisë, respektivisht vinte nga fshati Kolgec i Malësisë së Shkodrës, atëherë kur paraprijësi i tetë gjeneratave të mëhershme të kësaj familjeje Ymer Beu, kishte ardhur nga andej dhe ishte vendosur në fushën e Desivojcës. Edhe sot kjo familje me krenari e mbajnë mbiemrin "Shkodra", si dëshmi e prejardhjes së tyre në një kohë e mot.

I ati i Ali ef., ishte Hysen efendiu, hoxhë me nam dhe hafëz i njohur i Anamoravës, i cili studimet i kishte përfunduar në Medresenë e famshme të Fatihut në Stamboll, aty ku më vonë, i biri i tij Ali ef. do të shërbente për shumë vite si profesor.

Nuk është thënë rastësisht se "Molla nën mollë bie", prandaj edhe me Ali ef. nuk kishte se si të ndodhte ndryshe, kur përveç të atit edhe gjyshi i tij Haxhi Jakup efendiu, ishte hoxhë dhe madje edhe myfti i kazasë, i cili kishte përfunduar Medresenë e atëhershme të Nishit. Haxhi Jakupi ishte një njeri që gjithmonë ishte përpjekur për të mirë, andaj edhe i kishte këshilluar të bijtë që të vazhdonin gjurmëve të të parëve të tyre. Pra si shumë oxhaqe të tjera të mëdha, edhe ky oxhak po vazhdonte të ndiqte traditën e hoxhallëkut dhe hafëzllëkut. Për gjyshin e tij, Ali ef. shpeshherë do të përsëriste: "Ka qenë njeri shumë i devotshëm, nga sinqeriteti, morali dhe dija që kishte ishte shndërruar në njeri të zgjedhur. E çmonin dhe e respektonin të gjithë, jo vetëm shqiptarët, por edhe njerëzit e nacionaliteteve të tjera që e njihnin".

Nga dera e madhe dhe e fisme e Shkodrajve të Desivojcës edhe xhaxhai i Ali efendiut ishte hoxhë dhe hafëz i shquar. Për më tepër, nga kjo derë kishin dalë edhe dy hafize të Kuranit, motrat e Ali efendiut, bijat e Hafëz Hysen efendiut. Me një fjalë, familja e Ali efendiut kishte traditë të hershme fetare, arsimore, e kulturore dhe vetëdije të lartë kombëtare. Asokohe familjet e tilla që kishin vazhduar shkollimin dhe kishin ndjekur hapat e gjyshërve të tyre, pothuaj numëroheshin në gishta, sepse luftërat, persekutimet dhe përndjekjet që i bëheshin popullit shqiptar, kishin bërë të vetën. Familjet që kishin ruajtur këto tradita meritojnë vlerësim dhe respekt, meqë kishin flijuar tepër, kishin dhënë shumë nga jeta dhe pasuria e tyre jetësore.

Kjo familje hoxhallarësh, sikurse pararendësit e tij, edhe Ali efendiun që nga fëmijëria e drejtoi dhe e dërgoi në shkollat e kohës.

Kështu, midis viteve 1919-1924, Ali ef. filloi të mësonte leximin e Kuranit dhe krahas kësaj ndiqte edhe mejtepin tek i ati i tij Hfz. Hysen efendiu. Që në mejtep, ai filloi të mësonte dhe të njihej me vjershat nga letërsia osmane, sidomos me poezitë e Mual-lim Naxhiut dhe të Rexhaizade Mahmud Ekremit, të cilat i mësonte përmendsh.

Ali efendiu më pastaj kreu edhe shkollën fillore në Gjilan, gjysmën në gjuhën shqipe, dhe pjesën tjetër, meqë u mbyll shkolla shqipe, dhe regjimi ishte i tillë, u detyrua që ta kryente në gjuhën serbokroate.

Në Medresenë e Gjilanit, Shkupit dhe në Sarajevë

Gjatë viteve 1924-1927 Ali ef. do t'i niste mësimet në "Medresenë Atik" të Gjilanit, tek alimët e njohur të asaj kohe, myderriz Abdurrahman ef. dhe mulla Kadri ef. Nga këta dy dijetarë të kësaj medreseje, Ali Jakup ef. kishte përforcuar mirë e mirë dituritë e shkencave bazike që predikoheshin në medresetë e fillimit të shekullit të XX-të, të cilat edhe përkundër çdo peripecie vazhdonin të mbanin edhe më tej të forta themelet e mëhershme të dijes, madje duke mos u dorëzuar deri në pikën e fundit.

Gjatë kohës sa ishte në Medresenë "Atik", Ali efendiu do të vijonte gjithashtu edhe një kurs privat të gjuhës frënge tek Hasan Faik efendiu.

I etur për dije dhe i pa dorëzuar përballë sakrificave që lyp rruga për dituri, me të përfunduar studimet në Medresenë "Atik" të Gjilanit, Ali ef.

në vitin 1927, do të shkonte në Shkup, në Medresenë "Meddah" tek alimi dhe patrioti i famshëm i asaj kohë Myderriz Hafëz Ataullah efendiu, i njohur në popull si "Ata Hoxha" ose "Ataullahu Shqiptar" për t'i vazhduar studimet. Krahas mësimeve që merrte te Ataullah ef., letërsinë dhe gramatikën e gjuhës turke do t'i ndiqte tek Sejfedin efendiu. Pas përfundimit të medresesë "Meddah", gjatë viteve 1928-1929 sërish kthehet në Gjilan dhe përfundon edhe dy vite shtesë të shkollës së mesme shtetërore të kohës. Por nuk përfundoi këtu shkollimi i Ali ef., synimi i tij ishte që të vijonte studimet në ndonjë qendër botërore të dijes dhe shkencës, mundësisht në Misirin e shumë shqiptarëve, pasardhës të Mehmet Ali pashës së famshëm, por Misiri për Ali ef. akoma ishte larg, shumë larg ...

Mirëpo, para se të shkonte në Egjipt, në vitin 1929, Ali efendiun e gjejmë në Sarajevë, ku me rekomandimin e anëtarit të Ylema Mexhlisit të asaj kohe, Shakir Mesihoviqit regjistrohet në Shkollën e Lartë të Sheriatit (Mekteb-i Nyvvab). Në vitin 1931 e jep provimin për gjykatës, por në vitin e tretë të studimeve (1932) detyrohet t'i ndërpresë studimet sepse i vdes i ati, dhe si i madhi i familjes që ishte, detyrohet që për një kohë të kthehet në Gjilan, për t'u përkujdesur për familjen e tij, e cila kishte humbur kryefamiljarin. Në Sarajevë gjithashtu përfiton shumë, sepse e mëson në formë të shkëlqyer gjuhën boshnjake, por edhe fiton dhe ngritet nga dijetarët reformatorët që ndiqnin sa frymën e lindjes po aq dhe atë perëndimore të përparimit dhe ecjes një hap më përpara, duke frymuar më lirshëm krahasuar me shoqëritë e tjera.

Ditët shkollore në Medresenë "Atik" e Gjilanit dhe më pastaj edhe regjistrimin e tij në Sarajevë, Ali Jakup efendiu i kujtonte dhe i përshkruante me mall:

"Në Gjilan ndodhej Medreseja e cila ishte e përbërë nga 13 dhoma, në të mësonin 80 nxënës. Në moshën 12 vjeçare fillova të vijoja mësimet për mësimin e gjuhës arabe, pra ishte periudha kohore diku rreth vitit 1925 kur fillova të ndiqja mësimet në këtë medrese. Kishte rend dhe rregull por edhe praktikim dhe shprehi të mira të fesë islame. Namazet i falnim në xhaminë e cila gjendej afër medresesë. Ishte bërë praktikë që çdo ditë pas namazit të sabahut të lexonim përafërsisht nga një xhyz të Ku'anit fisnik, ku secili nxënës veçohej në internat në dhomën e tij dhe aty e lexonte

xhyzin. Në këto dhoma vendoseshin varësisht nga kapaciteti i tyre nga 4, 5, 6, 7 ndonjëherë dhe nga 8 nxënës. Këta nxënës do të vazhdonin të lexonin dhe një xhyz tjetër edhe pas namazit të ikindisë, kështu që bëheshin dy xhuza në ditë, një pas namazit të sabahut dhe tjetri pas namazit të ikindisë. Ishte traditë që nxënësit të cilët ishin në klasët e larta, shpesh t'ua ripërsëritnin mësimet nxënësve të klasave më të ulëta, me një fjalë, më të mëdhenjtë i mësonin e i trajnonin më të vegjlit, ndërsa në fund, të gjithë me rend pyeteshin para myderrizit.

Mësimet e mia në Medresenë e Gjilanit zgjatën 4-5 vite. Në këtë Medrese e pata përfunduar "sarfin", "nahvin" dhe "iz-harin" (sintaksën dhe morfologjinë e gjuhës arabe). Pastaj vijova në shkollën tetëvjeçare dhe mësova edhe dy vite tjera në gjuhën serbokroate, pra ishte shkolla ku mësimi ligjërohej në gjuhën serbokroate. Në këtë kohë në Beograd zhvillohej ceremoni, ku po emërohej Reisu'l ulemaja i ri i Rijasetit të kohës. Në këtë ceremoni zakonisht merrnin pjesë edhe myslimanët e vendeve të ndryshme nga të gjitha trojet e Mbretërisë Jugosllave. Kësaj radhe do të merrte pjesë edhe një i afërm nga fisi i hallës sonë i quajtur Mulla Osman ef., që ishte shumë i shtyrë në moshë, por që akoma kryente detyrën e imamit dhe ishte ixhazetli. Në këtë kohë unë isha vetëm 16 vjeç. Iu luta shumë babait tim që të më jepte leje që edhe unë të shkoja me të në këtë ceremoni! Babai më dha lejen dhe kështu unë mora pjesë në ceremoninë e emërimit të Reis ul ulemasë.

Ndërsa po qëndronim në një kafe aty pranë, na ra në sy një burrë i pashëm, që linte përshtypje të mirë dhe kishte sifate të intelektualit me një qëndrim të denjë. U afruam dhe u njoftuam me të. Më vonë mësuam se ai në të vërtetë ishte një ndër anëtarët e Mexhlisit të Ylemave të Bosnjës dhe Hercegovinës, një personalitet i njohur i cili quhej Mesihoviq, ose më saktë Mesih efendiu. Fillova të flisja me të në gjuhën arabe. Isha ende i ri dhe kisha dëshirë që ta promovoja veten. Kur pa insistimin dhe interesimin tim Mesih efendiu, më pyeti:

- Në çfarë shkolle je duke mësuar? Dhe pasi i tregova fill e për pe, ai më tha:

- Të kisha preferuar që të regjistrohesh në "Shkollën Nyvvab" - "Shkollën e Lartë për Gjykatës të Sheriatit në Sarajevë", - më tha.

- Po a mund të regjistrohem? - e pyeta.

- Po mund të regjistrohesh aty, e për regjistrim do të të ndihmoj edhe unë, - më tha duke më premtuar.

Kur erdhi koha, atë vit më shkroi letër dhe më tha që të përgatitesha për provim për t'u regjistruar në "Mekteb-i Nyvvab", sepse regjistrimi ishte i kushtëzuar me dhënien e provimit pranues, ku nevojitej njohja e shkëlqyeshme e gjuhës arabe dhe përfundimi i shkollës së mesme. Për fatin tim jo të mirë, unë nuk e kisha të kryer shkollën e mesme katërvjeçare, në fakt unë e kisha të kryer Medresenë "Meddah", por ajo sipas ligjeve të atëhershme të Mbretërisë Jugosllave nuk njihej si e tillë. Për t'u regjistruar aty, për mua kishte vetëm një mundësi, vetëm në qoftë se do t'i jepja me korrespodencë disa provime të caktuara nga kjo shkollë. Por e gjithë kjo ishte e pamundur nëse nuk e dije gjuhën arabe, por unë kisha shumë besim në arabishten time që e zotëroja. Kështu, shkova dhe i dhashë të gjitha provimet e shkollës së mesme, të cilat m'i kishin kushtëzuar. U pranova në këtë shkollë dhe i përfundova tre vite të studimeve. Gjatë vitit të tretë të studimeve u sëmura pak, kurse nga familja më lajmëruan se më kishte vdekur babai, kështu që u detyrova që të kthehesha në Gjilan, ende pa e përfunduar vitin e tretë. Kjo ishte një kohë shumë e vështirë për mua, gjendja im u përkeqësua shumë, më duhej ta merrja rolin e udhëheqësit të familjes, sepse isha më i madhi në familje, por në të njëjtën kohë e doja shumë mësimin dhe nuk pranoja assesi të shkëputesha nga shkolla. Pas pushimit dhe pas vendosjes së disa gjërave në vendin e vet, mora rrugën për në Kajro..."

Mirëpo, para se Ali ef. të shkonte në Kajro dhe para se të prekte ëndrrën e tij dhe ta bënte realitet, atje ku do të kryente "Al-Azharin" e famshëm, ku do të takonte shumë dijetarë të botës islame, ndër ta edhe nga të fundmit shejhul islam të Perandorisë Osmane, Mustafa Sabri efendiun dhe ku do të punësohej e do të jepte kontributin e tij intelektual e do të bënte karrierë akademike, atij iu desh të bënte edhe një copë rrugë dhe të kalonte edhe disa vështirësi e peripeci, që rëndom i kalojnë të gjithë ata që mësyjnë kërkimin e diturisë...

Në Medresenë e Preshevës

Ndonëse kishte marrë mësim në medresenë e Gjilanit, në atë të "Meddahut" në Shkup dhe në Sarajevë, Ali ef. para se të piqeshin kushtet për t'u nisur për specializime në Kajro, gjatë verës së vitit 1932-1933 do të shkonte tek myderrizi i mirënjohur i Preshevës Hfz. Nexhati ef. Ahmedi, për të përsëritur dhe përforcuar mësimet që kishte marrë, sidomos ato të gjuhës. I përsëriti para myderrizit edhe një herë veprat e gjuhës arabe që asokohe mësoheshin në medrese, si "Bina", "Emsile", "Maksud", "Avamil", "Iz-har", "Izah" e deri në "Mulla Xhami" dhe librin mbi shkencën e logjikës "Isaguxhia". Mendonte se mos ndoshta nga këto lëndë i kishte ngelur ende diçka e panjohur dhe e pa mësuar në shkollimin e tij paraprak. Në anën tjetër, ai dëshiroi të përfitonte gjithashtu edhe nga dituria dhe metoda mësimore që praktikohej në Medresenë e Preshevës, prandaj edhe iu rrek mësimit me këmbëngulje, me ç'rast edhe e habiti për të mirë Myderriz Hfz.Nexhatiun, i cili pas kësaj, asnjëherë nuk do të pushonte së lavdëruari dhe veçuar nxënësin e tij më të dalluar që kishte pasur. Edhe cilësitë prej njeriut modest, të sinqertë dhe të butë që kishte Ali ef., mbetën të pashlyera në kujtesën e myderriz Nexhatiut, të familjes së tij dhe nxënësve të tjerë të kësaj medreseje. Reflektimi i shpejtë, dijet nga medresetë e Gjilanit dhe Shkupit, pastaj ajo e Sarajevës kishin ndikuar që Ali ef. ngado që shkonte t'i mahniste të gjithë me aftësitë e tij që zotëronte, dhe në këtë rast të mbetet gjithmonë emblemë e inteligjencës edhe në familjen e hoxhaefendilerëve dhe tek të gjithë talebet e medresesë së Preshevës të drejtuar nga myderrizi i njohur hfz. Nexhati.

Myderriz Nexhati efendiu gjithmonë do të përsëriste me mburrje: "Kam pasur shumë nxënës, por Ali ef. e kisha ndër më të zellshmit, më të ndershmit, më punëtorët. Nuk i interesonte asgjë tjetër, pos mësimit, erdhi të mësonte dhe duke më mahnitur e mbaroi atë që ishte zotuar. Derisa vinte tek shtëpia jonë, ai do ta kishte përsëritur kush e di sa herë mësimin dhe do të ishte përgatitur mirë e mirë për mësimin vijues. Ai ishte dhjetë herë i zgjuar e njëqind herë i ndershëm. Ishte shumë i ri për të pasur parime dhe qëndrime të tilla. Ishte i burrëruar para kohe. Erdhi në tempullin e diturisë dhe mori dijen që synonte. E meritoi dhe ma fitoi zemrën, andaj edhe ia pa hajrin dhe u bë alim i dalluar!"

Vite më vonë, mbase pas më shumë se dy dekadash, myderriz Nexhati ef. ishte nisur për të kryer obligimin e Haxhit dhe meqë duhej pajisur me vizë, qenë ndalur në Stamboll. Kur, për këtë kishte dëgjuar Ali ef., ky me karakterin e tij të pastër dhe shpirtin e tij njerëzor, por edhe cilësinë që kishte nga fëmijëria për të çmuar diturinë dhe dijetarët, duke mos harruar asnjëherë bamirësinë, turravrap, erdhi së bashku me shumë hoxhallarë dhe nxënës të tij, të cilët i kishte marrë me vete për ta takuar myderrizin, kolegun dhe mikun e tij. Me lot në sy, ju drejtohet kolegëve dhe studentëve të tij: "Shikoni, ky është shumë i nderuari myderrizi, hoxha dhe profesori im, që është fortë më i ngritur se unë!" Ndonëse asokohe Ali ef. kishte mbaruar gjithë ato shkolla, kishte kryer universitetin "Al-Azhar" të Kajros, kishte punuar në Bibliotekën e Aleksandrisë dhe të Kajros dhe ishte bërë i njohur për dijet e tij, ai prapëseprapë, për respekt dhe mirënjohje ende e konsideronte veten një student para Myderrizit të tij të dikurshëm. Këtë respekt dhe modesti, hfz. Nexhatiu e pranoi me lot në sy, por duke i thënë: "Ti më ke kaluar mua, o Ali efendi, ti shpërndave dituri në vende më të mëdha, garove me më të diturit, pavarësisht se nuk ke harruar asnjëherë se ishe student imi!" - "Hoxhaefendi dhe i nderuari Myderrizi im, këtë s'mund ta harroj kurrë për jetë, u jam mirënjohës ty dhe gjithë atyre që më kanë mësuar!"-iu përgjigj Ali ef. me gjithë respekt e përulje.

Kjo ngjarje dhe kjo fjalë e çmuar e Ali ef., kishte ngelur gjithmonë në kujtesën e hfz. Nexhatiut i cili do ta tregonte vazhdimisht sa herë binte biseda për Ali ef. dhe të arriturat e tij.

Për më tepër, sa herë që dikush shkonte në Stamboll ky e porosiste që të shkonte dhe ta vizitonte Ali ef., ndërsa ky i dyti asnjëherë nuk do të harronte t'i dërgonte ndonjë hedije, sidomos ndonjë libër të ri të rrallë, sepse e dinte se kjo ishte më e mira hedije për myderrizin e tij...

Në Çamëri

Në fund të vitit 1936, më në fund, Ali efendiu niset rrugës së shumë pritur, për në Kajro, rrugë kjo që kërkonte shumë përgatitje materiale, vështirësi dhe që kërkonte goxha ditë, mbase edhe javë të tëra, sepse problem paraqiste pajisja me vizë në Athinë. Pak ditë para se të ndërronte jetë Ali ef., në një intervistë dhënë dr. Halit Erenit, duke e kujtuar këtë kohë dhe këto vështirësi, kishte thënë:

"Së pari shkova në Athinë. Me të arritur vajta në Ambasadën e Egjiptit për të kërkuar vizë, por vizën nuk ma dhanë. U mendova dhe thashë: "Po tani, çfarë të bëjë?!" Paratë i kisha të numëruara, gati po më mbaronin, kurse në ambasadë më thanë se do të duhej të prisja dy muaj në mënyrë që, mbase edhe mund ta merrja vizën. I nxora dhe i numërove edhe një herë të hollat që më kishin ngelur dhe e pash se ishin shumë pak, gjithsej 12 sterlina, që për të qëndruar dy muaj me to në Athinë, as që bëhej fjalë. Mendohesha si të dilja nga kjo situatë dhe si të mund vazhdoj e të qëndroj edhe dy muaj për të fituar vizën. Vendi më i përshtatur për t'u menduar dhe për të folur me vetveten mu duk bregdeti, ndaj dhe shkova aty dhe fillova të endesha poshtë e përpjetë. Ndërsa po ecja ashtu në atë gjendje, e pashë një njeri me një qylah (kapelë) të zi në kokë. Nga gëzimi që e pashë atë thashë: O Allah! Ky duhet të jetë mysliman! Iu afrova dhe e përshëndeta me selam, të cilin ma ktheu.

- Prej nga jeni? - i thashë.

- "Unë jam çam!

- Jam një student, si do të bëhet halli im? - i thashë, duke ia shpjeguar gjendjen time në hollësi, dhe në fund e pyeta: - A mund të shkoj atje nga anët tuaja dhe të qëndroj disa ditë?

- Po, si jo, mund të shkosh!

- Po ju, për çfarë keni ardhur këtu, e pyeta me kureshtje?

- Jam tregtar dhe meqë është afër Kurban Bajrami, erdha të furnizohem me mall.

- Nëse unë shkoj atje tek viset tuaja, a munde të qëndroj disa ditë? - e pyeta sërish.

- Po, mund të shkosh dhe mund të qëndrosh atje.

Kur ne u takuam, ishte aty diku rreth kohës së iqindisë. Me vrap shkova dhe mora një biletë për anije, e cila kishte nisje në terminalin e mbrëmjes. U nisa vetëm në ato anë, edhe pse nuk e kisha të lehtë. Së pari arrita në Prevezë dhe më pas, në një vendbanim tjetër më të vogël. Atë natë bujta në hotel. Të nesërmen shkova tek myftiu i vendit dhe ia tregova gjendjen time. Ma gjetën një vend të posaçëm, respektivisht një hotel të besuar dhe aty qëndrova për njëfarë kohe..."

Në fakt, në rrëfimin e tij të gjatë për qëndrimin në tokat e Çamërisë, Ali ef. i tregon dy gjëra, e para se çami i mirë që e kishte takuar, quhej Kasim dhe e dyta se këtu kishte përjetuar një ngjarje ta pazakontë, aq sa kishte përfunduar edhe në gjykatë, me pretekstin se ishte një i huaj që kishte ardhur për qëllime të këqija spiunazhi. Kjo kishte marrë fund, kur ky kishte folur në gjuhën shqipe dhe kishte treguar se vjen nga një anë tjetër e Shqipërisë ku flitet shqip, por me një dialekt tjetër... Gjatë jetës së tij ai asnjëherë nuk do t'i harrojë banorët e Komotinit, të cilët do t'i vizitojë dhe do t'u shërbente për Ramazan si imam, në vitet në vazhdim, sa ishte studentë në Kajro...

Në Misirin e shqiptarëve

Kështu, pas gjithë këtyre peripecive dhe pasi banorët e këtyre anëve i kishin mbledhur një sasi të mirë të të hollave dhe pasi i kishte dalë viza, më 1936, anija me në të cilën gjendej Ali efendiu preki tokën e Aleksandrisë... Kajroja akoma nuk shihej, e pikërisht atë e synonte Ali efendiu, sepse nuk mund të bëheshe hoxhë i mirë, - thuhej gjithandej me të drejtë, - nëse nuk e njihje mirë dhe nuk arrije të zotëroje arabishten. E ku mund të mësohej arabishtja më mirë se në Universitetin e famshëm të "Al-Azharit" në Kajro.

Në Kajro Ali Jakup ef. do të zgjeronte horizontet e tij të dijes dhe njohurive. Në afatin rekord dhe me sukses të lartë, i mbaroi studimet në Fakultetin e Usulid-dinit.

Ali ef. në Egjipt shkoi për studime, por ishte caktim i Allahut që ai të mbetej për një kohë të gjatë atje, sepse për një person si ai, që zotëronte aq shumë dije dhe njihte gjithë ato gjuhë, shqip, turqisht, arabisht, osmanisht, serbokroatisht, persisht, frëngjisht, anglisht dhe rusisht, Biblioteka e famshme e Aleksandrisë dhe ajo e Kajros, kishte nevojë të patjetërsueshme.

Kajroja në këtë kohë, ashtu si edhe më herët, përveçqë ishte bërë qendër studimi, ajo njëkohësisht qe bërë edhe çerdhe strehimi dhe si një vendlindje e dytë për shumë shqiptarë, që nuk mund të ktheheshin në vendet e tyre. Njëjtë ndodhi edhe me Ali ef., i cili nuk mund të kthehej në vendlindjen e tij, sepse Kosova padrejtësisht dhe pa dëshirën e saj, u gjet nën sistemin komunist i cili njerëzit si Ali ef. nuk i shihte me sy të mirë.

Në vitin 1946 Ali ef. punësohet në Bibliotekën e famshme të Aleksandrisë, e më pastaj transferohet në Bibliotekën Qendrore Kombëtare të Kajros, e cila sot vepron në një institucion të përbashkët me Arkivin Shtetëror të Kajros. Ai në këtë vend të punës, arriti të shpaloste aftësitë dhe njohuritë e tij të thella të gjuhës osmane, për se më vonë do të emërohej si punonjës shkencor për transkriptimin e dorëshkrimeve osmane në këtë bibliotekë. Në këtë institucion punoi pothuaj një vit e gjysmë, dhe më vonë transferohet dhe punon në të njëjtën detyrë në Bibliotekën e Universitetit të Kajros, universitet ky, me renome ndërkombëtare. Këtu Ali ef. punoi deri në vitin 1957. Puna e palodhshme në Kajro, studimi në gjuhën arabe në një nga universitet më prestigjioze, kontaktet me figura dhe personalitete të ndryshme, të cilët ishin njohës dhe studiues të gjuhës osmane do t'i mundësonin Ali ef. të përfitonte shumë, sepse përvoja e gjatë e punës në këto biblioteka dhe kontaktet me dorëshkrime, libra e dokumente në gjuhë të ndryshme orientale, bënë që Ali ef. të bëhej një burim i pashtershëm i informacioneve dhe i dijes.

Takimi me personalitete të shquara në Kajro

Sikurse u tha, në këto vite, shumë të rinj ia kishin mësyrë Kajros për studime dhe jo vetëm për këtë, por edhe sepse atje gjenin përkrahje dhe siguri nga Diaspora shqiptare atje. Kështu, Kajroja ishte shndërruar në një qendër të studentëve shqiptarë, ndër ta edhe Tevfik ef. Islam-Nahi nga Gjakova (i vëllai i Hasan ef. Nahit), pastaj Qerim ef. Haxhiu nga Lushnja e Shqipërisë, Shuajb ef. Azizi nga Shkupi, Mumin ef. nga Sllupçani i Kumanovës, imami Vehbi Sylejman Gavoçi dhe Imam Vehbi Ismaili nga Shkodra, e shumë e shumë të tjerë, të cilët sikur edhe Ali Jakup ef. Shkodra kishin marrë rrugën e largët për të fituar dituri. Me të gjithë këta, Ali efendiu shoqërohej dhe kishte miqësi.

Ndër personalitete me të cilët qe shoqëruar dhe pati bashkëpunuar Ali ef., përveç këtyre të mësipërmeve, e që janë me rëndësi për interesimet tona, janë edhe: Shejhul islami i fundit - Mustafa Sabri efendiu, Ibrahim beu i biri i Mustafa Sabri ef., Ihsan ef. nga Jozgati i Turqisë, Muhammed Zahid-i Kevseriu, Hasan el-Benna, Ali Ulvi Kuruxhu, Hafëz Emin Saraç Hoxha nga Tokati, Mustafa Ruyun, ish-deputet në parlamentin osman nga Konja e Turqisë, Hamdi ef. nga Shqipëria, Hafëz Bedri Hamiti nga Shkupi, Fadil ef. Hashani nga Obiliqi, etj.

Shejhul islami i Perandorisë Osmane - Mustafa Sabri efendiu dhe raportet e tij me Ali efendiun

Nga tërë këta që u përmendën, Ali efendiu kishte pasur miqësi sidomos me shejhul islamin Mustafa Sabri efendiun, për të cilin thoshte: "Në ditën e dytë me të ardhur në Kajro e kam takuar Shejhul islamin - Mustafa Sabri efendiun. Në të vërtetë, qysh duke qenë në Gjilan, kur ëndërroja të vija në Kajro, shpresoja t'i takoja dy persona të cilët mi pati përshkruar e lavdëruar shumë Ataullah ef.: Shejhul islamin Mustafa Sabri ef. dhe poetin me origjinë shqiptare nga Sushica e Pejës Mehmet Akif Pejanin (Ersojin, v.j.). Mirëpo, një ditë ndërsa isha në Shkup, në faqen e parë të një gazete e lexova lajmin dëshpërues: "E humbëm Mehmet Akifin", mu ndal fryma, u mërzita shumë dhe thashë: "Nuk paska qenë e shkruar ta takoja Mehmet Akifin, edhe pse e parafytyroja atë takim...!"

Mustafa Sabri efendiu e donte shumë Ali Jakup efendiun, ai madje shpesh do t'i thoshte se ty të kam evlad shpirtëror. Ishte sjellja dhe përkushtimi i Ali efendiut ato që do ta afronin tek Shejhul islami, aq sa ai do ta dallonte atë nga të gjithë studentët e tjerë, qofshin ata edhe turq. Kjo kuptohej më së miri edhe nga fakti se si i quante studentët tjerë "veledi - biri im", kurse Ali ef. e thërriste me fjalët: "el-veledi-l aziz - djali im i dashur!, ose "yaverim - ndihmësi im, krahu im i djathtë!" Shejhul-islami ka shkruar shumë vepra, e pa dyshim njërën ndër madhështoret, e shkroi në moshë goxha të shtyrë, në katër vëllime *"Mevkifu-l-akli ve-l-ilmi ve-l - alemi min Rabbi-l-alemin ve Ibadihi-l murselin"*. Meqë mosha e kishte bërë të vetën, dora nuk i qe bindur Shejhul islamit, andaj edhe dorëshkrimi ishte jo lehtë i lexueshëm, gjë që paraqiste problem të theksuar për bo-

tuesin. Mirëpo, Ali efendiu, e rishkroi edhe një herë me dorë të vetë, krejt veprën me se vepra e Mustafa Sabri efendiut, e pa dritën e botimit. Në një shënim në margjina të këtij dorëshkrimi, Ali efendiu, kishte shkruar: "Derisa po e përshkruaj këtë vepër, kam nderin dhe kënaqësinë që kjo t'i jepet në shfrytëzim lexuesit dhe në të njëjtën kohë, të bëhet sebep, që edhe unë të fitoj shpërblimin e lutjes së mirë të Mësuesit tim të dashur!"

Ali efendiu e vizitonte pothuajse çdo ditë Shejhul-islamin, aq sa deklaronte: "Ndoshta nuk e teproj nëse them që unë isha njeriu më i afërt i Shejhul-islamit, sepse me të na lidhte dituria, edukata po edhe karakteri e parimet. Prandaj nuk më kalonte javë e të mos e takoja së paku tri herë, në mos edhe më shumë. Kohën nga koha e drekës e deri në orën dhjetë të mbrëmjes, e kalonim me debate shkencore, bile kur nuk shkoja dy ditë rresht, më thoshte: "Ku je biri im i dashur, ku je krahu im i djathtë, ka kohë që s'të kam parë?!" Ndërsa ndonjëherë kur nuk e shihja të arsyeshme të futesha në vizitat private të tij, më thoshte: "Ah, shqiptari inatçi!". Një herë kur Mbreti Zog e kishte vizituar Egjiptin, kishte shprehur dëshirën që të vizitonte edhe Mustafa Sabri efendiun. Shejhul-islami kishte bërë shumë këmbëngulje që edhe Ali efendiu të ishte prezent me të, gjatë këtij takimi, por Ali efendiu kishte refuzuar, duke thënë: "Mbreti është prijësi i një vendi, Shejhul-islami po ashtu, andaj ky takim është i një niveli tjetër, dhe unë nuk e kam vendin aty. Mbase, ju doni t'i shprehni ndonjë gjë privatisht Hirësisë së tij Mbretit Zog, kështu që nuk e shoh të arsyeshme praninë time aty. Edhe në këtë rast, Ali efendiut do t'i kujtohet që Shejhul-islami do t'i jetë drejtuar me "Shqiptari, inatçiu".

Ali ef. me Shejhul-islamin Mustafa Sabri efendiun qe shoqëruar ngushtë për 14 vjet, deri në vitin 1954 kur ai ndërroi jetë. Humbjen e Shejhul-islamit, Ali ef. e përjetoi shumë rëndë, dhe e përshkruan kështu: "Kur vdiq Shejhul-islami Mustafa Sabri efendiu, u mërzita dhe qava shumë. Së bashku me birin e tij Ibrahimin, e lëshuam në varr. Ndërkohë që po e vendosnim aty, ia putha tabanin e këmbës së tij të bekuar... Allahu e pastë mëshiruar, sepse shumë kam përfituar nga ai!"

Shoqëria dhe njohja e Ali efendiut me Shejhul-islamin, ju ka ndihmuar shumë studiuesve për të ndriçuar aspekte të jetës dhe veprës së këtij të fundit."

Në Bibliotekën Kombëtare të Kajros dhe në Bibliotekën e Universitetit të Kajros

Pas përfundimit të studimeve në vitin 1946, meqë Ali ef. ishte njohës i mirë i gjuhës osmane, punësohet për pakë kohë, sikur u tha, në Bibliotekën e Aleksandrisë, për të kaluar më pastaj në Bibliotekën Kombëtare në Kajro, dhe nga aty kalon si zyrtar i lartë në Bibliotekën e Madhe të Universitetit të Kajros, ku do të punonte për më shumë se një dekadë. Këtu edhe do ta mbyllë karrierën dhe qëndrimin e tij në Egjipt. Puna, përkushtimi, njohuritë dhe përvoja e Ali Jakup ef. në këto institucione, do ta bënte atë një ndër ato figura intelektuale shumë të respektuara në fushën e deshifrimit, transkriptimit, përkthimit dhe katalogimit të dorëshkrimeve dhe dokumenteve në gjuhën osmane. Andaj dhe sot e kësaj dite shumica e dorëshkrimeve dhe dokumenteve në gjuhën osmane të cilat ruhen në Bibliotekën Qendrore dhe në Arkivin Shtetëror të Kajros si dhe të gjitha dorëshkrimet e Bibliotekës së Universitetit të Kajros, përmbajnë firmën dhe shifrat e katalogimit me shënimet përkatëse që ua kishte bërë Ali ef. Jakupi i Kosovës. Pa përmendur këtu edhe ato dorëshkrime të trajtuara nga Ali ef. e që ishin në gjuhën ruse dhe serbe.

Shpërngulja në Turqi

Tre vjet pas vdekjes së Shejhul-islamit, pra në vitin 1957, Ali ef. kalon nga Kajroja në Turqi, saktësisht në Ankara, sepse në krye të Egjiptit erdhi Naseri (Xhemal Abdu-n-Naser), i cili shqiptarët nuk i shihte me sy të mirë dhe i konsideronte si përkrahës të mbretit Faruk, aq sa qëndrimi i tyre atje u bë i pamundshëm. Në të vërtetë, kur Ali Jakup ef. deshi të largohej nga Kajroja, sepse e vërejti shumë mirë se më nuk do të mund të qëndronte më gjatë, Biblioteka e Universitetit të Kajros aty ku punonte, nuk i dha leje, sepse i duhej asaj, por kur pa insistimin e vazhdueshëm dhe këmbëngulës të Ali efendiut, kjo çështje u mbyll.

Ç'është e drejta, pas rënies së dinastisë shqiptare në Egjipt, gjendja për shqiptarët por edhe për të gjithë studentët e Ballkanit u përkeqësua pamasë. Ata u gjenden kush si mundi. Disa prej tyre vazhduan ashtu në heshtje e nën trysni të punonin në institucionet ku gjendeshin, disa të tjerë

u larguan për në Arabinë Saudite, si Vahid ef. dhe Muharrem ef. Tahsini, disa të tjerë në Perëndim, si Hysen ef. Latifi, kurse disa në Amerikë, sikur Imam Vehbi Ismaili.

Kur qëndrimi i mëtutjeshëm u bë i pamundur dhe pozita e tyre u rëndua shumë, Ali ef. në konsultim me shokun e tij Tevfik ef. Islamin mori vendimin që të shpërngulej diku jashtë në Perëndim apo në Amerikë. Tevfik ef. i propozoi që të shkonte në Amerikë në mënyrë që përveç tjerash të kishte edhe një jetë më të mirë materiale. Por u bë si u bë, dhe Ali ef. pas shumë peripecive e pengesave arriti të vendosej në Ankara. Në korrikun e atij viti, Ali ef. u emërua përkthyes në Ambasadën e Egjiptit në Ankara. Aty punoi gati dy vite, derisa për shkaqe të ndryshme, të cilat nuk iu përshtatën natyrës dhe parimeve të tij njerëzore, në nëntor të vitit 1959 e ndërpreu marrëdhënien e punës. Në Ambasadë ai përkthente gazetat nga gjuha turke në gjuhën arabe. Pas largimit nga aty, ai kthehet në Stamboll dhe qëndron një vit në shtëpinë e Abdurrahman Gyrsesit. Ky vit, në kujtimet e Ali ef., kishte mbetur si viti më i gjatë dhe më me shumë vuajtje në jetën e tij, po edhe të kolegëve të tij dhe popullatës turke. Por siç thuhet në mësimet islame, se pas çdo vështirësie vjen lehtësimi, edhe viti 1960 solli freski dhe shpresë për Ali efendiun, pasi fitoi shtetësinë turke dhe zuri punë si kontabilist në fabrikën private të familjes së njohur të "Topbashëve" në Stamboll. Një vit më vonë u martua me zonjën nga familja e njohur e Stambollit, Muamere hanëmin, që hiqte prejardhje çerkeze- shqiptare. Derisa punonte në fabrikë, ai gjithashtu jepte mësim në tri xhami të mëdha të Stambollit: në xhaminë "Fatih", në xhaminë "Emir Buhari" dhe në xhaminë "Mesih Pasha". Aty, ai ua shpjegonte nxënësve veprën e tij më të preferuar "Ihjau Ulumid-din" të Imam Gazaliut, për të cilin autor thoshte: "Nuk ekziston asnjë psikolog në botë që e njeh njeriun më mirë se Imam Gazaliu; ai është psikologu i të gjitha kohëve!" Gjithashtu, në këto xhami ai studentëve ua shpjegonte edhe këto veprat: "Edebu-d-dunja ve-d-din", "Medariku-t-tenzil ve Divanu-l-Mutenebbi" dhe veprën e njohur të Ismail Hakki Burseviut "Ruhu-l-Bejan", dhe "Tefsirin e Ibni Kethirit". Ligjërimin në këto xhami Ali ef. do të vazhdonte ta kryente për më shumë se dy dekada. Krahas kësaj, ai punonte edhe në " Haseki Eğitim Merkezi - Qendrën Mësimore të Hasekisë", e

cila ishte pjesë e Dijanetit - Kryesisë së Bashkësisë Islame të Turqisë. Në këtë Qendër punoi gjatë viteve 1976-1980 dhe ligjëroi këto lëndë: tefsir (komentimin e Kuranit), apologjetikë (kelam) dhe letërsi (belag). Gjithashtu edhe pasi përfundonte orarin, mësonte nxënës të tjerë në shtëpinë e tij, atyre të cilëve nuk iu përshtatej orari dhe detyroheshin të shkonin e të mësonin gjatë kohës kur ishte e përshtatshme për ata. Ai shpesh thoshte se shumicës së nxënësve nuk ua mbante në mend emrat, por arrinte t'i njihte në saje të fizikut të tyre, që regjistrohej në mendjen time gjersa ju ligjëroja. Ka pasur raste kur nxënësi më është ankuar në rrugë se nuk arrinte të kuptonte, e kam kap për krahu dhe nga ai moment kemi shkuar në vendin tonë më të afërt qoftë në xhami, apo në shtëpinë time dhe i kam shpjeguar deri sa kam arritur që t'ia shpjegojë atij atë që nuk e kishte të qartë dhe t'ia bëja sa më lehtë e më të kuptueshme çështjen.

Kësisoj tek Ali Jakup efendiut mësuan shumë studentë, të cilët më vonë do të bëhen personalitetet të shquara të dijes dhe drejtues të institucioneve fetare dhe shtetërore në Turqi dhe jashtë saj, si p.sh. Dr. Ekmeleddin Ihsanoglu (këtë e mësoi që të vogël kur ishte në Kajro sepse ishte shok dhe mik i ngushtë i të atit të tij Ihsan efendi Jozgatit, ndërsa kur erdhi në Turqi, Ekmeleddinin e quajti fëmijë të tij shpirtëror), Dr. Hasan Kamil Yilmaz, Dr. Halit Eren dhe shumë e shumë të tjerë që kanë kryer dhe kanë ushtruar e ushtrojnë profesione të ndryshme, si mjek, farmacistë, inxhinierë, ekonomistë, pedagogë etj.

Personaliteti i Ali efendiut

Ata që e kanë njohur Ali ef., e përshkruajnë si njeri të devotshëm, të qetë, të urtë, të drejtë dhe korrekt. Kohën asnjëherë nuk e kalonte kot, por gjithnjë qëndronte mbi libra e dokumente. Ishte nga ata që nuk jepej pas luksit të kësaj bote dhe materiales. Me nxënësit ishte shumë i afërt dhe prindëror, aq sa u drejtohej atyre me fjalën përkëdhelëse "azizim - i dashuri im", ndërsa për nxënëset e tija gjithmonë do të përdorte shprehjen "kuzum - çupëza ime", kurse me kolegët e tij ishte shumë miqësor.

Personaliteti dhe madhështia e Ali efendiut nuk mund të përshkruhen as me fjalët më të mëdha, të cilat janë burim frymëzimi i literaturës që lexova për jetën e tij, të shoqëruar me një veprimtari të bujshme dhe me

plot suksese, që shërben si një model dhe burim inspirimi që duhet ndjekur.

Ai ishte dijetar, poliglot, shkencëtar, akademik, profesor që nuk kishte një të dytë në atë kohë.Të gjitha këto tipare, i kishte të shoqëruara me njerëzillëkun e tij të pashoq, me modestinë që zor se gjendet sot. Me sabrin e tij të gjatë, nga frytet e së cilit nuk do të mërzitej së mësuari kuadro, madje në kohëzgjatje deri sa ata nxënës e studentë do ta përfundonin një nivel shkollimi, qoftë atë të mesëm, ose shkallët e larta studimore, por që më vonë, respektivisht në ditët e sotme nga frytet e mësimeve dhe leksioneve të tij, në Turqi do të krijoheshin kuadro që do të ishin drejtues dhe udhëheqës të institucioneve më të larta, dekanë dhe profesorë fakultetesh, por që edhe tash tridhjetë e kusur vjet pas vdekjes së tij, kanë përshtypjet, kujtimet, dhe fjalët më të mira për më të dashurin Profesorin dhe Hoxhën e tyre të paharruar.

I ditur, i butë, i qetë, i durueshëm, bujar i pashoq, ai nuk e ndau vetëm diturinë me të tjerët, por edhe kafshatën e gojës. Ishte shumë i dhënë pas familjes dhe miqve. Ishte në gjendje të sakrifikonte edhe shëndetin e tij, për të mirën e shoqërisë ku jetoi, qoftë në Kajro ose në Turqi, Kjo më së miri kuptohet nga zelli, vullneti dhe korrektësia në redaktimin dhe botimin e katalogëve dhe udhërrëfyesve të Bibliotekës "Merzifonlu Koca Mustafa Paşa". Një punë e tillë, ishte e pamundur të realizohej për drejtuesit dhe përgjegjësit e kësaj biblioteke në krye me drejtorin Muammer Ülker dhe zëvendësdrejtorin Nevzat Kaya, të cilët ranë në hall dhe i treguan Ali efendisë për vështirësitë në të cilat gjendeshin. Hoxha shqiptar nuk përtoi aspak që t'ua redaktonte dhe t'i drejtonte e t'i rehatonte duke ua lexuar drejtë dhe duke ua përmirësuar qindra gabime që kishin bërë gjatë punës. Ndonëse Hoxha nga Kosova nuk ua bëri fjalën dy dhe u ndihmoi deri në fund pas asnjë kompensim, ky i dyti N. Kaya, për çudi, përtoi ta përmendte këtë fakt, madje edhe atëherë kur vizitoi Kosovën, madje ishte edhe në institucionin ku unë punoj, por mburrej, krenohej e lavdërohej se si i kishte rregulluar indekset dhe katalogët e dorëshkrimeve dhe dokumenteve të bibliotekës në fjalë, pa e thënë asnjë fjalë të vetme falënderimi e mirënjohje për bashkëkombasin tonë, Hoxhën e madh Ali efendi Jakupin!

Me një fjalë, nëse e studiojmë në rrënjë figurën e Ali Jakup ef. Shkodrës, para nesh do të na dalë një hoxhë model, të cilin duhet ta kenë shëmbëlltyrë studentët dhe hoxhallarët e sotëm.

Kalimi në botën tjetër

Pas një jete të bujshme dhe me aktivitete të shumta e të lloj-llojshme, në fillet e agimit të ditës 21 maj 1988, Ali efendiu e dorëzoi shpirtin e tij fisnik tek Krijuesi i Gjithëmëshirshëm. Namazin e xhenazes ia fali Hendekli Hafëz Abdurrahman Gursesi. Në namazin e xhenazes së tij erdhën pothuajse të gjithë nxënësit e tij, që t'ia thoshin lamtumirën e fundit Hoxhës së tyre. Tek secili prej tyre vërehej mërzia e cila shfaqej si ndikim dhe kujtim nga veprat e mira të Hoxhës së tyre. Pas namazit, për Hoxhën e tij, me lot në sy foli edhe Prof. Dr. Ekmeluddin Ihsanoglu, i cili tha se nuk e kam vetëm profesor por në të njëjtën kohë isha dhe si fëmijë shpirtëror i tij, dhe përkujtoi edhe një herë personalitetin e pashembullt të Ali efendiut. Namazi i xhenazes Ali ef. iu fal në xhaminë e madhe "Fatih" aty ku 20 vite me radhë ligjëroi si profesor, ndërsa në faljen e xhenazes së tij prezantuan shumë personalitete të shquara, si: presidenti i tanishëm i Republikës së Turqisë Rexhep Tayyip Erdogan, Profesor Necmettin Erbakan, Profesor Muhsin Yazicioglu, Selahattin Kaya, Dr. Halit Eren, hoxhallarët e mirënjohur Esat Cosan efendiu, Mahmut efendiu, Mustafa Uzun, Dr. Hikmet Atan, e shumë të tjerë.

Ali ef. u varros në varrezat Edirne Sakizagaci, ku edhe e ka varrin.

Nga nxënësit e tij ditë me radhë u lexua Kuran dhe u shpërnda sadaka për shpirtin e tij të bekuar.

Ali ef. kishte një bibliotekë shumë të pasur, të cilën e la amanet që t'i dhurohet Bibliotekës së Fakultetit të Shkencave Islame të Universitetit të Marmaras, ku edhe sot ruhet.

Si përfundim

Nuk gjej përfundim më të mirë se sa fjalët e njërit nga ish-nxënësit e Ali efendiut, Osman Ozturk, i cili me pikëllim të thellë dhe me një krenari të lartë, akoma pa u ndarë mirë nga trupi i bekuar i Ali efendiut, do të shprehej: "Do të vijë koha kur ne do të krenohemi se dikur ishim nxënës të Ali efendisë!"

Prandaj s'kam se si të mos krenohem edhe unë, që i përkas të njëjtit komb me Ali efendiun, i cili e nderoi prejardhjen dhe ia rriti vlerën dhe e lartësoi emrin e vendit ku u lind dhe u rrit. Si mos të jem e lumtur kur Ali efendiun e njoha fillimisht përmes fjalëve dhe kujtimeve të familjarëve të mi, e më pastaj edhe përmes librave dhe kujtimeve të ish-nxënësve të tij.

E njoha si një njeri, i cili nuk jetoi për veten, por për të tjerët, një njeri i cili jetoi jo për të sotmene tij, por për të ardhmen e të tjerëve; një njeri që zgjodhi të përhershmen dhe të amshueshmen.

Mehmet Akif Pejani, mbase nuk e ka ditur se në Kosovë e ka pasur një ashik i cili është djegur nga malli e dëshira për t'u takuar me të, dhe pavarësisht se nuk kish qenë e shkruar të ndodhte kjo, këto dy bejte të Mehmet Akifit tingëllojnë si të jenë shkruar për Ali efendi Jakupin:

"Të citohesh me mëshirë, kjo është e përhershmja,
Por që jetova i pa zë, e pa u ankuar, a thua kush do ta dijë!..."

Literatura e konsultuar:

- *Islam Ansiklopedisi,* botoi: Dijanetit të Republikës së Turqisë: zëri "Ali Yakup Cenkciler" i trajtuar nga Ekmeludin Ihsanoglu, kap. VII, f. 370-371. Stamboll, 1993.
- Ramadan Shkodra, "Ali efendi Jakupi (1913-1988) - një ndër alimët më të mëdhenj të shekullit XX", Takvimi 37/2006, f. 181-192, Prishtinë, Bashkësia Islame e Kosovës, viti 2006.
- Necdet Yilmaz, *Ali Yakup Cenkçiler Hatira Kitabi,* f. 16-17, bot. Erkam Yayinlari, Stamboll, 2005.
- Istanbul Tarih, periodiku, Shtator, 2016, Stamboll - Turqi.
- Dr. Beqir Ismaili: *Ejjam Halide - Fadiletush-Shejh Tevfik Ismail Jahja - El Mufekkir Kosovi - Mufettish ulumu-d-dinijje bi'l Ez'er sabikan,* botoi: Zyrja "Alba - Pres", Kairo, 2006.
- Kerime Tunçbilek, revista: "Dunya bizim", rubrika e portreve.
- Bisedë me Hafëz Avni Ahmedin (ld. 1939), Preshevë, ish-nxënës dhe përfundues i ixhazetit tek Myderriz Hafëz Nexhati ef. Ahmedi, nëntor 2018.
- Sami Frashëri, *Personalitetet shqiptare në "Kamus al-'Alam",* përktheu Mehdi Polisi, Logos A, Shkup 2010.
- Hasan Kaleshi, *Roli i shqiptarëve në letërsitë orientale,* në: "Seminari i Kulturës Shqiptare për të Huajt", nr. 2, Prishtinë 1976, f. 188-190.
- Nehat Krasniqi, *Zhvillimi i kulturës shqiptare me ndikime orientale prej shekullit XVIII deri në fillimet e Rilindjes Kombëtare,* Instituti Albanologjik, Prishtinë, 2018

Hatixhe AHMEDI

ALI JAKUP EFFENDI SHKODRA - 1913-1988, A DISTINGUISHED SCHOLAR AND PERSON OF HIGH MORAL INTEGRITY

(Summary)

In this paper we will present Ali Jakup effendi Shkodra, a distinguished personality, who sacrificed everything to obtain knowledge and to become a world-renowned alim. He attended famous madrassas and learned from distinguished muderris. He attended the madrassa in Gjilan, the Meddah Madrassa in Skopje, the Shariah High School in Sarajevo and the Al-Ahzar University in Egypt.

After he obtained great religious knowledge he moved to Istanbul where he spent the last three decades of his life cooperating with distinguished religious personalities of the time.

In this paper we will present different stages of his life and education, the challenges he faced, the sacrifices he made, his activities and his merits until the end of his life in Istanbul.

خديجة أحمدي

شخصية دينية علمية ذو إخلاص مثالي
(الشيخ العلامة علي يعقوب شكودرا ١٩١٣–١٩٨٨)

(خلاصة البحث)

سنتحدث في هذه الورقة عن شخصية شهيرة في مناطقنا، التي ضحت بكل غال ونفيس قي سبيل اكتساب المعرفة والعلم ليصبح عالما على المستوى العالمي ، هذه الشخصية هي العلامة الشيخ علي يعقوب شكودرا. إن اهتمامه وإصراره جعله يتابع التعليم في المدارس الدينية الشهيرة في مختلف البلدان وعلى يد كبار المشايخ والعلماء، لقد بدأ في مدرسة في مسقط رأسه في مدينة جيلان ثم تابع في التعليم في المدرسة الشرعية في مدنية سكوبيا ، ومن ثم في مدرسة الشريعة الثانوية في سراييفو، وتابع تعليمه الجامعي في جامعة الأزهر الشريف في مصر.

بعد تفوقه في مختلف العلوم الشرعية انتقل إلى إسطنبول في العقود الثلاثة الأخيرة من حياته، وتعاون وتواصل مع أشهر الشخصيات الدينية في ذلك الوقت.

وعرضنا في ورقتنا هذه، معلومات مفيدة، عن جميع مراحل حياته وتعليمه، ومواقفه واتصالاته مع العلماء والمشايخ المعاصرين، وكذلك التحديات ، والتضحيات ، والأنشطة ، والوقائع إلى مرحلة اختتام الفصل عن حياته في إسطنبول.

Sedat ISLAMI

ROLI I FESË NË NGRITJEN E NDËRGJEGJES PUBLIKE PËR RUAJTJEN E AMBIENTIT

Abstrakt

Degradimi i ambientit është një nga temat më të diskutuara viteve të fundit. Për shkak të rreziqeve që mund të sjellë për njerëzimin, degradimi i ambientit është shndërruar në një debat ku pjesëmarrës është e tërë shoqëria. Ndoshta edhe për shkak të rrezikut që ndiejmë të gjithë. Ky është edhe motivi i këtij punimi. Ajo që përbën dallim në këtë punim është qasja. Ndryshe nga diskutime tjera, feja fokusohet fillimisht në ndërgjegjësim, në mënyrë që duke rritur nivelin e përgjegjësisë, të shmang maksimalisht veprimet e gabuara. Punimi trajton çështjen e ambientit dhe përgjegjësinë tonë karshi tij dhe këtë nga tre aspekte të ndryshme: fillon me konceptin e përgjithshëm fetar për ambientin, vazhdon me përgjegjësinë e individit karshi ambientit dhe mënyrën e edukimit për ruajtjen e ambientit, dhe përfundon me disa rregulla dhe udhëzime për mënyrën e duhur të bashkëveprimit tonë me ambientin. Të gjeturat e punimit konfirmojnë rëndësinë e qasjes fetare në evitimin e dukurive negative, në përgjithësi, dhe kësaj të keqpërdorimit dhe degradimit të ambientit, në veçanti.

Fjalët kyçe: *ambienti, ndryshimi klimatik, feja islame, ndërgjegjësimi, përgjegjësia*

HYRJE

Zhvillimi industrial dhe teknologjik në tre shekujt e fundit ka çuar në ndryshime të mëdha, të cilat paralelisht me ngritjen e standardit të jetesës, kanë shkaktuar edhe një sërë sfidash, ndër të cilat edhe ruajtja e ambientit. Shfrytëzimi irracional i ambientit ka rezultuar me pasoja të shumta dhe të mëdha, të cilat krejt këtë zhvillim e kanë kthyer në një kërcënim të frikshëm për jetën njerëzore. Ndryshimi klimatik ka shkaktuar pasoja të mëdha, të cilat përveç dëmeve materiale numerikisht të pallogaritura, kanë marrë edhe shumë jetë njerëzish. E keqja është se, përderisa vazhdohet me këtë avaz të trajtimit të ambientit, pasojat në të ardhmen pritet të jenë edhe më të mëdha. Në vitin 2100 ngritja e temperaturave pritet të rritet edhe për 4.8 gradë celsius, e bashkë me to edhe fatkeqësitë natyrore. Kjo ka bërë që shkencëtarë të shumtë nga e mbarë bota të merren seriozisht me temën e ambientit. Që nga gjysma e dytë e shekullit të kaluar, janë mbajtur vazhdimisht takime e konferenca në të cilat është punuar për mënyra dhe metodat se si mund të evitohen këto pasoja. Në Francë, në vitin 2007, është mbajtur një takim i madh, në të cilin kanë marrë pjesë 500 shkencëtarë, të cilët, në përfundim, kanë dalë me tre të gjetura kryesore, ndër të cilat edhe ajo se fajtor kryesor i tërë kësaj që ka ndodhur dhe po ndodhë, është njeriu.

Së këndejmi ky punim në fokus ka njeriun dhe ndërgjegjësimin e tij karshi ambientit. Më saktë, ky punim, nga prizmi fetar islam, mëton që të kontribuojë në ngritjen e vetëdijes qytetare për ambientin duke u fokusuar në çështjen në vijim:

1. Çfarë na mëson Islami për ambientin?
2. Sa ndihmon feja në edukimin e njerëzve që ta ndiejnë përgjegjësinë e tyre karshi ruajtjes së ambientit?
3. Sa kontribuon feja në bashkëpunime të ndërsjella për ta ruajtur ambientin?

Rëndësia e këtij punimi duhet të shihet nga rëndësia që feja dhe mësimet e saj paraqesin për njerëzit. Ai nuk është thjesht një fjalë e thënë ose e shkruar më shumë por një mënyrë e rëndësishme edukimi karshi botës që na rrethon. Punimi ndahet në tre pjesë kryesore: në pjesën e parë diskutohet qëndrimi i fesë karshi ambientit, në pjesën e dytë diskutohet ndërlidhja e veprimtarisë së njeriut me ndryshimet në natyrë, ndërsa në pjesën e tretë ofrohen udhëzime për angazhimin e përbashkët për ambientin.

1. ÇFARË NËNKUPTON AMBIENTI PËR NJË BESIMTAR?

Për besimtarin mysliman, ambienti ka një rëndësi të veçantë. Ai lidhet me besimin po edhe me kulturën e tij.

1.1. Ndërlidhja e përkujdes së ambientit me besimin

Sa i përket besimit, ambienti, respektivisht përkujdesja për të, është degë e trungut të besimit. Pejgamberi Muhammed a.s. në kudër të degëve të besimit, klasifikoi edhe ruajtjen e ambientit. Sikur kjo të mos kishte rëndësi të veçantë, sigurisht se nuk do ta nënvizonte në kuadër të gjashtëdhjetë apo shtatëdhjetë e ca degëve të tij.

"Imani (besimi) përbëhet nga shtatëdhjetë e ca apo gjashtëdhjetë e ca degë, prej të cilave më me vlerë është dëshmia 'La ilahe il-la Allah' ndërsa më e ulëta është largimi i pengesës nga rruga. Edhe turpi është degë e besimit.[1]"

Përshkrimi i *'largimit të pengesës nga rruga'* si dega më e ultë, nuk nënkupton në asnjë rrethanë nënvlerësim të përkujdesjes për ambientin, përkundrazi. Vetë fakti se është klasifikuar në mesin e degëve të besimit, pa të cilën besimi nuk është i kompletuar, flet për këtë rëndësi. Nga këtu përshkrimi si *e ultë* mund të jetë bërë:

- në kuptimin figurativ për të krahasuar atë me degët e mëdha[2], që janë shtylla të besimit, pa të cilat nuk fiton identitet fetar, edhe ashtu, si vepër, bëhet fjalë për diçka të thjeshtë, pra për largimin e ndonjë guri apo druri të vogël që pengon lëvizjen dhe qarkullimin normal,
- nga aspekti figurativ (e larta, e ulëta) siç qëndron në disa versione tjera të hadithit[3].

Ndryshe, nëse kihen parasysh koncepti i përgjithshëm për ambientin, detaje nga i cili do të shpalosim këtu, dhe rëndësia e largimit të pengesa-

[1] Hadithin e shënon Muslimi, nr. 58.

[2] Shih: Muhammed bin Ismail San'ani, *Et-tenviru sherhu el-Xhami'i es-sagir,* (Rijad: Mektebetu Dar esselam, 2011), 4/511.

[3] Në versionin tjetër të hadithi, të shënuar nga Ahmedi në Musned, në vend të shprehjes *efdaluha* (më e mira), qëndron *a'laha* (më e larta).

ve nga rruga si një vepër që ka vlerën e lëmoshës, sepse është vepër prej të cilës përfiton vet individi dhe të tjerët, atëherë përkujdesja për ambientin, siç shprehet edhe Ibn Al'lani, del si një ndër degët më me vlerë të besimit[4].

Ambienti, në kuptim të krijimtarisë së Zotit, na e përkujton madhështinë e kësaj krijimtarie dhe fuqinë e madhe të Zotit. Në Kur'an, në disa kaptina, ambienti është trajtuar si pasqyrë që reflekton këtë madhështi dhe fuqi të Zotit.

﴿وَمِنْ آيَاتِهِ أَنَّكَ تَرَى الْأَرْضَ خَاشِعَةً فَإِذَا أَنزَلْنَا عَلَيْهَا الْمَاءَ اهْتَزَّتْ وَرَبَتْ ۚ إِنَّ الَّذِي أَحْيَاهَا لَمُحْيِي الْمَوْتَىٰ ۚ إِنَّهُ عَلَىٰ كُلِّ شَيْءٍ قَدِيرٌ﴾

"Ndër shenjat e Tij është edhe ringjallja e tokës. Ti e sheh tokën të thatë e të shkretë, por, kur zbresim shi mbi të, ajo lëviz dhe gjallërohet. Pa dyshim, Ai që e ngjall atë, i ngjall edhe të vdekurit. Ai është vërtet i pushtetshëm për çdo gjë." *(Fussilet: 39)*

Vehbe Zuhajli duke komentuar këtë ajet kur'anor shpjegon se si në të është marrë shembull gjelbërimi i tokës nga shiu pas tharjes së saj, me ringjalljen e njerëzve pas vdekjes. Pra, bëhet fjalë për dëshmi të fuqisë së Zotit[5].

﴿اللَّهُ الَّذِي خَلَقَ السَّمَاوَاتِ وَالْأَرْضَ وَأَنزَلَ مِنَ السَّمَاءِ مَاءً فَأَخْرَجَ بِهِ مِنَ الثَّمَرَاتِ رِزْقًا لَّكُمْ ۖ وَسَخَّرَ لَكُمُ الْفُلْكَ لِتَجْرِيَ فِي الْبَحْرِ بِأَمْرِهِ ۖ وَسَخَّرَ لَكُمُ الْأَنْهَارَ﴾

"Allahu është Ai që ka krijuar qiejt dhe Tokën. Ai lëshon ujë nga qielli e nëpërmjet tij nxjerr fruta si ushqim për ju. Ai i ka vënë në shërbimin tuaj anijet, që me lejen e Tij, ju të lundroni me ato nëpër dete. Ai i ka krijuar lumenjtë për dobinë tuaj." *(Ibrahim: 32)*

Ky ajet dhe dy ajetet vijuese (në kaptinën Ibrahim) numërojnë plot dhjetë mirësi të Zotit ndaj njeriut: (1) krijimin e qiejve; (2) krijimin e tokës për vendbanim; (3) zbritjen e shiut; (4) shërbimin me anijet që

[4] Shih: Muhammed bin Ali bin Muhammed bin Al'lan, *Delilu-l-falihine,* (Bejrut: Daru-l-ma'rifeh, ed. 4, 2004), 2/357.

[5] Vehbe Zuhajli, *Et-Tefsir el-Munir,* (Damask: Dar el-fikr el-muasir, ed. 2, v. 1418 h.), 24/236.

lundrojnë për të kaluar nga vendi në vend dhe për të shkëmbyer mallra; (5) shërbimin me lumenjtë, ujërat dhe peshqit e tyre; (6-7) përfitimin nga dielli dhe hëna; (8-9) përfitimin nga dita dhe nata, dhe (10) dhënien e çdo gjëje që na nevojitet[6]. Pra shihet se si elemente që përbëjnë ambientin dhe kanë lidhje me të, janë klasifikuar si mirësi të Tij ndaj nesh.

﴿أَلَمْ تَرَ أَنَّ اللَّهَ أَنزَلَ مِنَ السَّمَاءِ مَاءً فَأَخْرَجْنَا بِهِ ثَمَرَاتٍ مُّخْتَلِفًا أَلْوَانُهَا ۚ وَمِنَ الْجِبَالِ جُدَدٌ بِيضٌ وَحُمْرٌ مُّخْتَلِفٌ أَلْوَانُهَا وَغَرَابِيبُ سُودٌ﴾

"Vallë, a nuk e sheh ti se si Allahu e lëshon ujin prej qiellit dhe nëpërmjet tij krijon fruta llojesh e ngjyrash të ndryshme?! Nëpër male gjenden shtigje të bardha dhe të kuqe, ngjyrash të ndryshme dhe krejtësisht të zeza." *(Fatir: 27)*

Në këtë ajet, Allahu na tërheq vëmendjen rreth mundësisë së Tij për të krijuar gjëra të ndryshme prej një lënde, ujit (shiut) të lëshuar nga qielli. Kështu prej tij mbijnë pemët që na japin fruta të ndryshëm në shije, formë e ngjyrë. Po kështu ka krijuar edhe kodra me ngjyra të ndryshme[7].

Se ambienti vlerësohet shumë në Islam mësojmë edhe nga fakti se Zoti e sjell shembull krahasues për gjënë më të bukur, besimin. Në kaptinën Ibrahim, ajetet 24-25, Zoti e sjell pemën e mirë në shembull e besimit të vërtetë, besimit produktiv, besimit që kërkohet prej nesh:

﴿أَلَمْ تَرَ كَيْفَ ضَرَبَ اللَّهُ مَثَلًا كَلِمَةً طَيِّبَةً كَشَجَرَةٍ طَيِّبَةٍ أَصْلُهَا ثَابِتٌ وَفَرْعُهَا فِي السَّمَاءِ ﴿٢٤﴾ تُؤْتِي أُكُلَهَا كُلَّ حِينٍ بِإِذْنِ رَبِّهَا ۗ وَيَضْرِبُ اللَّهُ الْأَمْثَالَ لِلنَّاسِ لَعَلَّهُمْ يَتَذَكَّرُونَ﴾

"Vallë, a nuk e sheh se si Allahu e përqas fjalën e mirë me pemën e mirë, e cila rrënjën e ka të fortë në tokë, kurse degët nga qielli? Me lejen e Zotit të saj *(pema)* ***jep fruta në çdo kohë. Allahu u tregon shembuj njerëzve, që t'ua vënë veshin."***

Përshkrimi i pemës së sjellë për krahasim si *'pemë e mirë'* të jep përshtypjen -thotë Sha'raviu- se bëhet fjalë për çdo gjë që i pushon shqisat, pra për pamje të bukur, aromë të këndshme dhe shije të shijshme. Pastaj

[6] Po aty, 13/254-257.
[7] Po aty, 22/259-260.

përshkrimi tjetër si pemë që ka rrënjët thellë në tokë dhe shtatin lart në qiell tregon për tiparet e besimtarit të dashur dhe respektues për fenë e vet. Pastaj dhënia fruta çdoherë, tregon për rolin pozitiv të besimtarit në çdo kohë. Që një pemë të jetë e këtillë, ka nevojë që elementet me të cilat ushqehet të jenë të pastra: uji dhe ajri...[8]

Nga ky shpjegim i Sha'ravit, nxjerrim një mësim shtesë që ka të bëjë edhe me ruajtjen e ambientit. Krahasimi i besimit të fortë me këtë pemë të fortë, e cila për të qenë e tillë ka nevojë që uji dhe ajri, si dy elementet bazë të ushqimit të saj, na ofron me pak fjalë platformën e ruajtjes së ambientit dhe kultivimit të shëndoshë të tij.

E duke qenë se besimi i shëndoshë ka për shpërblim Xhennetin, atëherë përshkrimi i Xhennetit është bërë nga perspektiva e ambientit të bukur: lumenjve, pemëve, etj.

﴿مَّثَلُ الْجَنَّةِ الَّتِي وُعِدَ الْمُتَّقُونَ ۖ فِيهَا أَنْهَارٌ مِّن مَّاءٍ غَيْرِ آسِنٍ وَأَنْهَارٌ مِّن لَّبَنٍ لَّمْ يَتَغَيَّرْ طَعْمُهُ وَأَنْهَارٌ مِّنْ خَمْرٍ لَّذَّةٍ لِّلشَّارِبِينَ وَأَنْهَارٌ مِّنْ عَسَلٍ مُّصَفًّى ۖ وَلَهُمْ فِيهَا مِن كُلِّ الثَّمَرَاتِ وَمَغْفِرَةٌ مِّن رَّبِّهِمْ ۖ﴾

***"Shembulli i Xhenetit, që u premtohet të përkushtuarve** (ndaj Allahut): **një vend, ku ka lumenj me ujë të pandotur, lumenj qumështi me shije të pandryshuar, lumenj vere me shije të këndshme për ata që e pinë dhe lumenj prej mjalti të kulluar. Ata do të kenë aty lloj-lloj frutash dhe falje prej Zotit të tyre..."** (Muhammed: 15[9])*

Pejgamberi a.s. ka thënë: *"Në Xhennet ka një pemë hijen e të cilës kalorësi nuk mund ta përshkojë as për njëqind vite.[10]"*

Se sa është i rëndësishëm ky përshkrim fetar i Xhennetit dhe si reflekton në praktikën e besimtarëve do të shohim në pjesën vijuese.

---

[8] Muhammed Mutevel-li Sha'ravi, *Tefsir Esh-Sha'ravi*, (Kajro: Ahbar el-jevm, 1997), 12/7499-7500.

[9] Shih edhe: Bekare: 25; Zuhruf: 71; Rrahman: 52; 68; Vakiah: 20; 27-33; Murselat: 41-42; Nebe': 31-32.

[10] Hadithin e shënojnë Buhariu 3251 dhe Muslimi 2826.

1.2. Ndërlidhja e përkujdesjes së ambientit me kulturën dhe kodet

Ruajtja dhe përkujdesja për ambientin janë pjesë e besimit dhe kulturës së besimtarit. Nëse marrim parasysh rëndësinë që ka ambienti nga aspekti i besimit, atëherë lehtë mund të marrim me mend përkushtimin e besimtarëve për të. Pejgamberi a.s. insistonte që përkujdesja për ambientin të shndërrohej në kulturë. Sa për ta ilustruar këtë, do të fokusohem në disa thënie të Pejgamberit a.s. që ambientin na e shndërrojnë në një pjesë të kulturës me të cilën dallohemi:

1) Ishte vetë ai që shprehte hapur dashurinë për ambientin. Për kodrën e famshme të Uhudit thoshte: *"Uhudi është kodër që na do dhe e duam![11]"* Pra, ishte një lidhje emocionale me ambientin, e cila sigurisht se ka rëndësinë e vet pasi që është pikënisje për ruajtjen dhe zhvillimin e tij.
2) Porosia për rregullimin e ambientit shtëpiak, respektivisht oborrit. Në hadith qëndron: *"...pastroni oborret dhe dalloni nga hebrenjtë...[12]"* Ndërlidhja e këtij veprimi me traditën e hebrenjve, të cilët – siç lexohet në tekst- nuk janë kujdesur për oborret e tyre ka efekt kulturor, pra që të dallojmë në kuptim pozitiv, duke e shndërruar përkujdesjen për shtëpinë dhe oborrin si diçka me të cilën identifikohemi.

   Kjo porosi siç duket më së miri është jetësuar në periudhën e sundimit islam në Spanjë. Ishin të rralla shtëpitë që nuk ishin të rregulluara dhe të pakta ato që nuk kishin parqe. E ajo që vlen të përmendet këtu është se frymëzimi për këto parqe ishte përshkrimi kuranor dhe pejgamberik bërë kopshteve (të qytetërimeve të hershme dhe të Xhennetit)[13].
3) Porosia profetike për të shmangur ambientin nga dëmtimi gjatë luftërave. Ka urdhëruar që luftërat të zhvillohen jashtë qyteteve, të mos eskalojnë në djegie të shtëpive, të mbjellave, pemëve. Pra,

[11] Buhariu, 1481.

[12] Hadithi kuptimisht është i saktë.

[13] Shih: Dr. Ragib Serxhani '*Intisharu-l-hadaik fi-l-hadareti el-islamijjeh*', artikull i publikuar në portalin e tij https://islamstory.com më 17.05.2010. Shfletuar më 22.11.2018.

është shndërruar jo vetëm në besim e kulturë por edhe kod shtetëror. Se sa i rëndësishëm është ky kod mund të mësojmë sot kur luftërat janë të nënvizuara ndër shkaqet më kryesore të shkatërrimit të ambientit.

2. ROLI I FESË NË EDUKIMIN E BESIMTARIT KARSHI AMBIENTIT

2.1. Ndërlidhja e veprimeve të njeriut me natyrën

Njeriu, si halife[14] në tokë, është përgjegjës për mënyrën se si zhvillohet jeta dhe veprimtaria njerëzore në të. Nëse çdo gjë shkon sipas udhëzimeve hyjnore, njerëzit do të kenë jetë të begattë, ndryshe, do të sprovohen me fatkeqësi për të cilat fajin duhet ta kërkojnë vetëm tek vetja e tyre. Kjo për faktin se Zoti tokën e ka krijuar në gjendje të mirë dhe dobiprurëse për ne andaj edhe ka urdhëruar që të mos prishet ky rend.

﴿وَلَا تُفْسِدُوا فِي الْأَرْضِ بَعْدَ إِصْلَاحِهَا﴾

"Mos bëni çrregullime në tokë pas rregullimit të saj..." *(A'rafë: 56)*

Nga këtu, çfarëdo fatkeqësie që ndodhë dhe çfarëdo ndryshimi që shohim (gjithnjë për të keq), fajin e ka njeriu. Më qartë, në Kur'an dhe Sunnet gjejmë se veprat e njeriut kanë ndikim të drejtpërdrejtë në fenomenet natyrore. Ja disa prej këtyre teksteve:

﴿وَلَوْ أَنَّ أَهْلَ الْقُرَىٰ آمَنُوا وَاتَّقَوْا لَفَتَحْنَا عَلَيْهِم بَرَكَاتٍ مِّنَ السَّمَاءِ وَالْأَرْضِ وَلَٰكِن كَذَّبُوا فَأَخَذْنَاهُم بِمَا كَانُوا يَكْسِبُونَ﴾

"Sikur banorët e atyre qyteteve të besonin dhe të ruheshin prej gjynaheve, Ne do t'u dërgonim bekime nga qielli dhe toka, por ata mohuan, prandaj i dënuam për atë që bënë." *(A'rafë: 96)*

Siç shpjegojnë dijetarët, bekimet nga qielli nënkuptojnë shiun ndërsa bekimet nga toka mbirjen e tokës (pemëve, perimeve, të lashtave), andaj, nëse njerëzit besojnë, Zoti ua dërgon këto të mira, e nëse mohojnë, Zoti i

[14] Koncepti '*halife*' nënkupton detyrën e marrë nga Zoti për të organizuar jetën në tokë sipas mësimeve të Tij. Shih ajetet: Bekare, 30; En'amë, 165; Junus, 14; 73; Fatir, 39.

dënon duke e ndalur shiun dhe duke bërë që toka të thahet e të mos mbijë[15].

﴿ظَهَرَ الْفَسَادُ فِي الْبَرِّ وَالْبَحْرِ بِمَا كَسَبَتْ أَيْدِي النَّاسِ لِيُذِيقَهُم بَعْضَ الَّذِي عَمِلُوا لَعَلَّهُمْ يَرْجِعُونَ﴾

***"Shkatërrimi në tokë dhe në det është shfaqur si pasojë e punëve të këqija të njerëzve, kështu që** (Allahu) **do t'i bëjë "të shijojnë" pjesë nga ajo që kanë punuar, me qëllim që ata të kthehen** (në përmirësim)." (Rrum: 41)*

Komentuesi i njohur i Kur'anit, Ibn Kethiri, pasi që përmend disa mendime rreth interpretimit të "fesadit" (shkatërrimit), citon Ebu el-Alijen të ketë thënë: *"Kush e kundërshton Allahun në tokë, ai veç ka bërë shkatërrime në të, sepse përmirësimi i tokës dhe qiellit është i kushtëzuar me bindjen ndaj Zotit.[16]"* Edhe Jusuf Kardavi përmend disa prej mendimeve të dijetarëve përkitazi me interpretimin e *fesadit* duke shpjeguar se ai nuk ka të bëjë me prishje të vlerave por me shkatërrime konkrete, pra me pasoja të cilat shfaqen si rezultat i prishjes morale dhe shpirtërore[17].

Abdudaim Kehili, duke folur shkatërrimin e ambientit[18], këtë ajet e sheh jo vetëm si shpjegues të kësaj teorie por edhe si alternativë për zgjidhjen e problemit. Më qartë, ai në këtë ajet sheh pasojën, shkaku, dhe reflektimin:

- **"Shkatërrimi në tokë dhe në det..."** = pasoja
- **"...si pasojë e punëve të këqija të njerëzve..."** = veprat e njeriut,
- **"...kështu që** (Allahu) **do t'i bëjë "të shijojnë" pjesë nga ajo që kanë punuar, me qëllim që ata të kthehen** (në përmirësim)." = reflektimi.

---

[15] Shih një shpjegim të bukur dhe përmbledhës në: AbduRrahman bin Nasir Es-Sa'di, *Tejsiru-l-Kerimi-rr-rrahman fi tefsiri kelami-l-Mennan*, (Bejrut: Muessesetu-rr-rrisale, 2000), f.298.

[16] Ismail bin Umer bin Kethir, *Tefsiru el-Kur'ani el-Adhim*, ver. Sami bin Muhammed Selame, (Dar Tajjibe li-n-neshri ve-t-teuzië, ed. 2, 1999), 6/319-320.

[17] Shih: Jusuf Kardavi, Jusuf Kardavi, *Riajetu-l-bi'eti fi-l-Islam*, (Kajro: Dar esh-shuruk, 2001), f. 220-221.

[18] Abdudaim Kehil "*Dhuhur el-fesad fi-l-berri ve-l-bahr"*, publikuar më 2010 në http://www.kaheel7.com, shfletuar më 23.11.2018. Shih qasje të ngjashme edhe tek: Dr. Husni Hamdan Desuki Hamamae, "*El-insan ve fesadu-l-bi'eti ve islahuha*", artikull i publikuar në https://www.alukah.net më datë 13.05.2013. Shfletuar më datë 23.11.2018.

Pra, pse ndodhin këto gjëra, shkak jemi ne njerëzit që vazhdojmë përkundër alarmimit nga ana e shkencëtarëve e gjeologëve ta shkatërrojmë ambientin.

Pejgamberi Muhammed a.s. ka thënë: *"...nuk ndodhë të mashtrojnë në matje me litër e kandar e të mos sprovohen me thatësi, varfëri dhe padrejtësi të pushtetarit. Po kështu nuk ndodhë të refuzojnë dhënien e zekatit e të mos iu ndalet shiu, i cili, po të mos ishin kafshët (e pafajshme), nuk do t'iu binte (mbase kurrë)...."*[19]

Pra, mashtrimi në peshore është shkak për thatësi, varfëri dhe tirani të pushtetarëve, sikur që mosdhënia e zekatit është shkak për ndaljen e shiut.

Së këndejmi, veprat e njeriut kanë ndikim të drejtpërdrejtë në fenomenet natyrore, andaj atij i kërkohet që të reflektojë duke braktisur mëkatet dhe duke iu kthyer udhëzimeve të Zotit.

2.2. Nxitja për ruajtjen e ambientit

Edukimi nëpërmjet nxitjes dhe motivimit për të mirat dhe qortimit e ndëshkimit për të këqijat është formë dhe mënyrë edukimi e aprovuar fetarisht. Edhe në rastin e ambientit, gjejmë tekste të cilat në terma superior trajtojnë shpërblimin dhe ndëshkimin për përkujdesjen gjegjësisht shpërdorimin e ambientit. Dr. Kardavi, bazuar në këto tekste, thotë se në Islam nuk bëhet fjalë thjesht për ruajtjen (ar. *himaje*) të ambientit, por për përkujdesje dhe mirëmbajtje (ar. *riaje*) sepse e para nënkupton thjesht ruajtjen nga elementet e këqija ndërsa e dyta nënkupton përveç kësaj edhe angazhimin për zhvillimin dhe kultivimin e ambientit[20]. Tekstet në vazhdim na bindin shumë për këtë mendim të dr. Kardavit.

1) *"Një njeri hyri në Xhennet për shkak të një pengese që e pa në rrugë, të cilën e mori dhe e largoi".*[21]

   Një vepër e thjeshtë dhe e lehtë për ta bërë, por e cila ka shpërblim Xhennetin. Natyrisht, janë pasojat e saj, gjegjësisht efekti

[19] Hadithin e shënon Ibn Maxheh në *Sunen*, nr. 4019, Albani në *Sahihu-l-xhami*, nr. 3072, thotë se hadithi është i saktë.

[20] Shih: Jusuf Kardavi, *Riajetu-l-bi'eti fi-l-Islam*, op.cit, f. 7.

[21] Hadithin e shënon Imam Muslimi në *Sahih.*

dobiprurës i saj, i cili mundëson qarkullim të lehtë të njerëzve dhe kafshëve, andaj edhe ka këtë shpërblim të madh.

2) "*Kush e ngjallë një tokë, ajo i përket atij*".[22]
Në këtë hadith, besimtari nxitet që të mos i shndërrojë tokat pjellore në djerrina prej të cilave askush nuk përfiton. Nëse ai e gjen një tokë të tillë dhe e punon, atëherë ai bëhet pronar i saj. Pra, nëpërmjet nxitjes së përfitimit personal, nxitet në ruajtjen e ambientit. Këtu qartë mund të prekim konceptin e përkujdesjes dhe jo vetëm të ruajtjes.

3) "*Nëse dikë prej jush e zë kiameti, e në dorë ende ka ndonjë fidan (të hurmës apo diç tjetër) le të mos e lëshojë pa e mbjellë.*[23]
Një shembull tjetër i përkujdesjes për ambientin është dhe ky hadith. Pejgamberi a.s. nxit besimtarin që pavarësisht se do të ketë rastin apo jo të përfitojë personalisht nga pema e mbjellë, ta mbjell atë, sepse nëse i ikin frutat, shpërblimin për to e ka gjithsesi. Përveç kësaj, nxitja për mbjelljen e pemëve bëhet që prej të saj të përfitojë edhe bota shtazore, kafshët dhe shpezët, të cilat janë pjesë e rëndësishme e ambientit. Siç mund të shihet, koncepti islam për ambientin është gjithëpërfshirës. Këtë e vërejmë edhe në hadithin vijues:

4) "*Një njeri e fitoi Xhennetin për shkak se ia shoi etjen një qeni*".[24]
Pra, për shkak të një qeni, të cilit ia shoi etjen, ky njeri fitoi Xhennetin.

---

[22] Hadithin e shënon Imam Ahmedi në *Musned* ndërsa Albani në *Sahihu-l-xhami*, nr. 5974, e cilëson të saktë.

[23] Hadithin e shënon Imam Ahmedi në *Musned* ndërsa Albani në *Sahihu-l-xhami*, nr. 1424, e cilëson të saktë.

[24] Hadithin e shënojnë Imam Buhariu dhe Imam Muslimi në *Sahihët* e tyre.

2.3. Kërcënimi për keqpërdorimin e ambientit

Në pjesën paraprake përmendëm disa tekste të cilat na nxisin për përkujdesjen e ambientit. Në këtë pjesë në fokus do t'i kemi disa tekste tjera të cilat janë qortim i rëndë për ata që keqpërdorin ambientin.

1) *"Kush e pret një pemë, do të përfundojë në zjarr".*[25]
   Ky hadith është shpjeguar kështu në Sunen[26], d.t.th., kush e pret pa asnjë justifikim një pemë, nga hija e të cilës përfitojnë njerëzit ose kafshët, ai do ta ketë fundin e hidhur duke përfunduar në Xhehenem. Pra, për dëmtim të vetëm një pemë mund të kesh këtë dënim, atëherë a thua si është puna nëse dikush djeg pyje të tëra qëllimshëm siç po ndodhë kohëve të fundit apo prish shtretër lumenjsh?!
2) *"Keni frikë nga dy mallkueset! E cilat janë ato? Ai që kryen nevojën në rrugë apo në vend-hije për njerëzit".*[27]
   Ky hadith është një formë tjetër qortimi për ata që janë të pakujdesshëm karshi ambientit. Nëse dikush nga mungesa e etikës bën këto veprime të ulëta në vende publike të cilat frekuentohen nga njerëzit ose janë thjesht stacione pushimi e çlodhje dhe ka këtë vërejtje, paramendoni çfarë vërejtje do të ketë për ata që me ujëra të zeza rëndojnë jetën e qytetarëve në shtëpitë dhe lagjet e tyre.
3) *"Një grua shkoi në Xhehennem për shkak të një maceje që e mbyti".*[28]
   Ky hadith flet për rrezikun që ka dëmtimi i qëllimshëm i kafshëve. Për një mace, të cilën e ka ngujuar dhe nuk e ka ushqyer si dhe nuk e ka lënë të lirë të dalë për të gjetur ushqim, kjo grua humbi Xhennetin. Paramendojeni çfarë ndëshkimi mund të ketë ai njeri që mbyt kafshë, thjesht, pa ndonjë interes?!

---

[25] Hadithin e shënon Davudi në *Sunen* ndërsa Albani në *Sahihu-l-Xhami*, nr. 6476, e cilëson të saktë.

[26] Po aty.

[27] Hadithin e shënon Imam Muslimi në *Sahih.*

[28] Hadithin e shënojnë Buhariu dhe Muslimi.

3. SI TË KUJDESEMI PËR AMBIENTIN?

Nga perspektiva islame, toka dhe çfarë ka në të është përgatitur për njeriun[29]. Megjithëkëtë, kjo nuk i jep njeriut të drejtën e shpërdorimit. Njeriu është mbikëqyrës, jo pronar, andaj duhet të sillet sipas udhëzimeve dhe rekomandimeve të pronarit, Allahut. Gjegjësisht duhet:

1) Të aplikojmë kriterin e shfrytëzimit racional të çdo gjëje, siç na mëson Allahu në Kur'an[30].
2) Ndërmarrja e masave parandaluese, duke u bazuar në rregullin fetar: *"Largimi i të keqes është më parësor se sa sjellja e të mirave.[31]'* Pra, edhe nëse do të kishim ndonjë të mirë ta zëmë prej një projekti të caktuar, por që dëmet do të ishin më të mëdha, siç po ndodhë rëndom në kohën tonë, atëherë më mirë do të ishte të mos i realizojmë fare ato projekte për shkak të dëmeve që janë më të mëdha se dobitë.
3) Edukimi ambientalist[32], qoftë në shkolla, qoftë në xhami, duke i kushtuar më shumë dhe më shpesh kohë problemeve të kësaj natyre. Ne pamë më lart shembullin e një besimtari të ndërgjegjshëm në hadith: *"Një njeri hyri në Xhennet për shkak të një pengese që e pa në rrugë, të cilën e mori dhe e largoi[33]"* Duhet të angazhohemi për kultivim e vlerave shoqërore. Muhammedi a.s. ka thënë: "*Njeriu më i dashur tek Allahu është ai që është më i dobishmi për njerëzit.[34]"*
4) Themelimin e një task force i cili do t'i përkushtohej ruajtjes së ambientit.
5) Të gjithë për ambientin[35]. Duke qenë se pasojat e degradimit të ambientit na përfshijnë të gjithëve, atëherë përkujdesja për të duhet të na bëjë bashkë të gjithëve, në nivel qytetesh e shtetesh.

---

[29] Shih ajetet: Ibrahim: 32-33; Nahl: 14; Haxh: 36; 65; Lukman: 20, etj.

[30] Shih: A'rafë: 31; Furkan: 67.

[31] Shih artikullin e Dr. Mevlaj Mustada Berxhavi, *"Mevkif el-islam min el-abeth bi-l-bi'eh",* të publikuar në portalin https://www.alukah.net më datë 21.12.2011. Shfletuar më datë 23.11.2018.

[32] Shih: Jusuf Kardavi, *Riajetu-l-bi'eti fi-l-Islam*, op. cit, f. 234-236.

[33] Hadithin e shënon Imam Muslimi në *Sahih.*

[34] Hadithin e shënon Imam Muslimi në *Sahih.*

[35] Po aty, f. 239-240.

PËRFUNDIM

Në përfundim të këtij punimi, do të përmendim disa të gjetura dhe rekomandime:

1) Njeriu, edhe nga perspektiva fetare, është shkaktar kryesor pse ambienti ka degraduar. Mëkatet e njeriut, të shprehura në shpërdorimin e ambientit, janë shkak i fatkeqësive të shumta që godasin njerëzit.
2) Rëndësia e aplikimit të mësimeve fetare në vetëdijesimin qytetar, për këtë dhe çështje tjera me rëndësi shoqërore.
3) Qasja fetare, parasheh jo thjesht ruajtjen e ambientit por edhe kultivimin e tij.
4) Nevoja e bashkëpunimit të ndërsjellë ndërinstitucional, në mënyrë që të gjithë nga perspektivat përkatëse të japin kontributin për përkujdesjen për ambientin.
5) Edukimi ambientalist të përfshihet në kurrikula mësimore ndërsa në përmbajtje të ketë edhe qasjen fetare.

Literatura e konsultuar:

- Kur'ani Fisnik
- Kurani i madhërishëm, përktheu kuptimet e tij nga gjuha arabe: Prof. Hasan I. Nahi, (Tiranë: Instituti Shqiptar i Mendimit dhe i Qytetërimit Islam, 2006).
- Es-Sa'di, AbduRrahman bin Nasir, *Tejsiru-l-Kerimi-rr-rrahman fi tefsiri kelami-l-Mennan*, (Bejrut: Muessesetu-rr-rrisale, 2000).
- Ibn Al'lan, Muhammed bin Ali bin Muhammed, *Delilu-l-falihine*, (Bejrut: Daru-l-ma'rifeh, ed. 4, 2004).
- Ibn Kethir, Ismail bin Umer, *Tefsiru el-Kur'ani el-Adhim*, ver. Sami bin Muhammed Selame, (Dar Tajjibe li-n-neshri ve-t-teuzië, ed. 2, 1999).
- Kardavi, Jusuf, *Riajetu-l-bi'eti fi-l-Islam*, (Kajro: Dar esh-Shuruk, 2001)
- Muhammed Mutevel'li Sha'ravi, *Tefsir Esh-Sha'ravi*, (Kajro: Ahbar el-jevm, 1997).
- San'ani, Muhammed bin Ismail, *Et-Tenviru sherhu El-Xhami'i es-Sagir*, (Rijad: Mektebetu Dar esselam, 2011).
- Zuhajli, Vehbe, *Et-Tefsir el-Munir*, (Damask: Dar el-Fikr el-muasir, ed. 2, v. 1418 h.), 24/236.

Artikuj dhe punime online:

- Abdudaim Kehil *"Dhuhur el-fesad fi-l-berri ve-l-bahr"*, publikuar më 2010 në http://www.kaheel7.com, shfletuar më 23.11.2018.
- Dr. Husni Hamdan Desuki, *"El-insan ve fesadu-l-bi'eti ve islahuha"*, artikull i publikuar në https://www.alukah.net më datë 13.05.2013. Shfletuar më datë 23.11.2018.
- Dr. Mevlaj Mustada Berxhavi, *"Mevkif el-islam min el-abeth bi-l-bi'eh"*, të publikuar në portalin https://www.alukah.net më datë 21.12.2011. Shfletuar më datë 23.11.2018.
- Dr. Ragib Serxhani '*Intisharu-l-hadaik fi-l-hadareti el-islamijjeh*', artikull i publikuar në portalin e tij https://islamstory.com më 17.05.2010. Shfletuar më 22.11.2018.

Sedat ISLAMI

THE ROLE OF RELIGION IN RAISING PUBLIC AWARENESS ON THE NEED TO PROTECT THE ENVIRONMENT

(Summary)

Environmental degradation is one of the most discussed topics in recent years. Due to the threat it poses to mankind, the issue of environmental degradation is discussed by the whole society. Probably, the latter is due to the fact that we all feel threatened by it. Compared to the other approaches to this problem religion focuses on the need to raise awareness. Through increased responsibility it aims to reduce human impact on the environment.

This paper deals with the issue of the environment and our responsibility towards it from three different aspects: it begins with the general religious concept on the environment, the responsibility of the individual towards the environment and the ways to promote environmental protection and ends with certain rules and guidelines on how to interact with the environment. The findings in this paper confirm the importance of religion in the fight against negative phenomena in general and environmental degradation in particular.

سادات إسلامي

دور الدين في رفع الوعي العام للمسؤولية في المحافظة على البيئة

(خلاصة البحث)

التدهور البيئي هو أحد المواضيع التي نوقشت في السنوات الأخيرة. وبسبب الأخطار التي يمكن أن تحدثها الإنسانية ، فإن تدهور البيئة قد أصبح نقاشًا ينخرط فيه المجتمع بأكمله. ربما بسبب الخطر الذي نشعر به جميعًا. هذا هو أيضا الدافع لهذه الورقة. ما يصنع الفرق في هذه الورقة هو المدخل والمنهج. وخلافا للمناقشات أخرى، يركز الدين في المقام الأول على الوعي، من أجل زيادة مستوى المسؤولية، والحد الأقصى هو تجنب التصرفات الخاطئة. وتتناول هذه الورقة مسألة البيئة ومسؤوليتنا تجاهها وذلك من ثلاثة جوانب مختلفة: يبدأ مع مفهوم الديني العام للبيئة مع التواصل مع المسؤولية الفردية تجاه البيئة وطريقة التعليم في الحفاظ على البيئة، وتنتهي مع بعض القواعد والمبادئ التوجيهية للطريقة المناسبة لتفاعلنا مع البيئة. وتؤكد نتائج الدراسة على أهمية النهج الديني لتجنب الظواهر السلبية بشكل عام، وهذا الاعتداء والتدهور البيئي، على وجه الخصوص.

Ramadan SHKODRA

ORGANIZMI I JETËS FETARE ISLAME NË KOSOVË GJATË HISTORISË

Abstrakt

Organizimi i jetës fetare islame në Kosovë zë fill që nga koha e administrimit të Perandorisë Osmanë në këto anë. Gjatë asaj kohe organizimi i jetës fetare islame gjithandej Perandorisë ka qenë i rregulluar nëpërmjet autoritetit fetar dhe politik, sipas të cilit organizimin fetar islam dhe funksionet shtetërore i ka ushtruar një strukturë unike (Din ve Devle), kurse bashkësitë e tjera fetare kanë pasur organizimet e veta të veçanta.

Në këtë punim do të flasim për etapat historike nga aspekti administrativ nëpër të cilat ka kaluar Bashkësia Islame e Kosovës që nga koha e sundimit osman, e deri në ditët e sotme. Natyrisht, një segment të rëndësishëm, do t'ia kushtojmë organizimit të jetës fetare.

Fjalët kyçe: *Bashkësia Islame, jeta fetare, Perandoria Osmane* etj.

1.1. Organizmi i jetës fetare në trojet tona gjatë Perandorisë Osmane

Organizimi i jetës fetare islame në Kosovë zë fill që nga koha e administrimit të Perandorisë Osmanë në këto anë. Gjatë asaj kohe organizimi i jetës fetare islame gjithandej Perandorisë ka qenë i rregulluar nëpërmjet autoritetit fetar dhe politik, sipas të cilit, organizimin fetar islam dhe funksionet shtetërore i ka ushtruar një strukturë unike *(Din ve Devle)*, kurse bashkësitë e tjera fetare kanë pasur organizimet e veta të veçanta.

Në kuadër të Perandorisë Osmane, në kuptimin organizativ fetar-islam, të gjithë myslimanët në Ballkan kanë qenë pjesë përbërëse e Bashkësisë Unike Myslimane, në krye të së cilës ka qëndruar *sulltani* në funksionin e *kalifit*. Kompetencat dhe prerogativat e kalifit në kohën e qeverisjes së sulltan Muratit II (1421-1451), janë bartur në myftiun kryesor, kështu që nga atëherë, myftiu kryesor në kuadër të Perandorisë Osmane ka bartur titullin *shejhul-islam*, i cili edhe ishte autoriteti më i lartë fetar islam në gjithë perandorinë. Këtë post e kanë pasur edhe tre shqiptarë: Ali efendi Zembili (1503-1526), Ibrahim Bej efendi Ajvaz Pasha-zada (1719-1797) dhe Abdurrahman Nesip Efendiu (1842-1914). Ndërkaq, në nivelin lokal autoritetin qendror të shejhul-islamit e kanë pasur myftinjtë e rretheve[1].

1.2. Bashkësia Islame në Kosovë pas Perandorisë Osmane

Më shkuarjen e Perandorisë Osmanë nga trojet shqiptare, pra dhe nga Kosova, krijohen rrethana të reja shoqërore-politike të pafavorshme për shqiptarët dhe për bashkësinë e tyre fetare islame, sidomos në ato troje që u pushtuan nga okupatori sllav.

Bashkësia e Fesë Islame në Kosovë, siç quhej asokohe, që nga shkuarja e osmanëve, është angazhuar dhe ka luftuar të këtë autonominë fetare dhe të gëzonte të drejtat dhe statusin ë saj, por kjo nuk ishte e mundur dhe në ato rrethana dhe as që mund të ndodhte ndryshe.

[1] Dr. sc. Nehat Krasniqi, *Kontribute albanologjike*, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë 2011, f. 40-50.

Në rrethanat e krijuara pas vitit 1912 gjendja dhe pozita e institucioneve të BI-së ishte tejet e rëndë. Pos vështirësive të tjera, në këtë kohë ishin shkëputur të gjitha lidhjet me selinë e kryeqendrës në Stamboll. Pra, jeta e organizuar fetare islame në viset shqiptare, të pushtuara nga serbo-malazezët, mund të thuhet së ishte paralizuar fare. Vepronin vetëm imamët më entuziastë, të cilët organizonin kryesisht faljen e namazit dhe kryenin ceremonitë e varrimit të besimtarëve.[2] Gjendja vazhdoi të ishte e rëndë edhe pas marrëveshjes së Stambollit të marsit të vitit 1914, të lidhur ndërmjet Mbretërisë së Serbisë dhe Turqisë. Më këtë marrëveshje i garantoheshin të drejtat popullatës myslimane në viset e pushtuara[3]. Në pikën e 8-të, të marrëveshjes, qeveria serbe obligohej të njihte të drejtat e barabarta banorëve myslimanë, si edhe banorëve të tjerë.[4] Më këtë myslimanëve (shqiptarëve dhe besimtarëve të tjerë të fesë islame) u garantohej e drejta për kryerjen e të gjitha ceremonive fetare në mënyrë publike. Po ashtu, parashihej edhe respektimi i zakoneve të tyre. Institucionet fetare islame thuhej se gëzonin të parashtronin të drejtat e tyre për aftësimin e kuadrit fetar dhe organizimin e lirë, se pasuria e tyre do të njihej dhe respektohej. Kurrfarë pengesash nuk do t'u bëheshin bashkësive fetare islame dhe individëve që të mbanin lidhjet e tyre shpirtërore edhe me Bashkësitë islame jashtë kufijve të shtetit, siç ishte rasti me kryesinë e BI-së në Stamboll (shejh-ul-islamin). Myftinjtë përsëri do të zgjidheshin nëpër rrethe nëpërmjet zgjedhjeve elektorale. Kushtëzohej vetëm që personat që duhej te kryenin detyrën e myftiut, të ishin shtetas të Serbisë. Myftiun suprem do ta emëronte mbreti i Serbisë nga mesi i tre kandidatëve të propozuar. Qeveria serbe nëpërmjet delegacionit të vet, do ta sanksiononte emërimin e myftiut suprem në Stamboll te shejh-ul-islami[5], i cili do të lëshonte dekretin (menshuren dhe muraselen). Pas gjithë kësaj, myftiu suprem autorizohej që të bënte emërimin e myftinjve në Serbi.

---

[2] Prof. dr. Haki Kasumi, *Bashkësitë fetare shqiptare në Kosovë, Maqedoni dhe Mal të Zi*, "Segmente të gërshetuar historike", Prishtinë 2011, f.55.

[3] Po aty, f.5.

[4] Po aty f. 55.

[5] Dr. sc. Menduh Bamja, *Pozita kushtuese -juridike dhe faktike e bashkësive fetare në ish-Jugosllavi me vështrim të posaçëm të Bashkësisë Islame*, Prizren 2009, f. 75.

Nëpunësve të BI-së u besohej udhëheqja dhe kontrollimi i vakëfeve[6]. Myftinjtë pos obligimeve të tjera dhe mbikëqyrjes mbi këshillat e vakëfeve angazhoheshin edhe me disa punë të karakterit juridik në lidhje më çështjet e myslimanëve, si të kurorëzimeve, ndarjes së alimentacioneve, testamenteve, trashëgimive të pozitave etj.

Në fund, parashihej edhe njohja e shkollave fetare islame dhe e drejta e zhvillimit të mësimit në gjuhën turke, me kusht që mësimi të ishte në përputhje më programin zyrtar. Kjo marrëveshje u nënshkrua, por u zbatua vetëm pjesërisht dhe atë më shumë vonesë.

Kështu, nga mesi i vitit 1914 në Kosovë vepronin këto myftini të qarkut (në Prishtinë, Prizren dhe në Mitrovicë) dhe disa të tjera të rretheve. Gjithashtu vazhdonin të vepronin edhe vakëfet 'mearife' të rrethit dhe të vendit, në krye të të cilave gjendej myteveliu. Aktivitet të dendur zhvillonin edhe imamët e xhemateve.

Vazhdimin e punës të organeve të porsaformuara fetare islame në viset e pushtuara shqiptare e ndërpreu Lufta e Parë Botërore. Në rrethanat e krijuara, u bënë ndryshime dhe zhvillohej një veprimtari e dobët, e pa konsoliduar fare, ngase viset shqiptare ishin të copëtuar nga pushtues të ndryshëm[7].

Marrëveshjen e Stambollit të vitit 1914 Serbia e kishte anuluar në fillim të Luftës së Parë Botërore), ndonëse disa paragrafe të saj ishin në favor të komunitetit myslimanë. Pastaj theksohej së paragrafët e asaj marrëveshjeje ishin pikërisht në favor të shqiptarëve myslimanë, ndërsa për shqiptarët katolikë u tha se do të vlente konkordati i lidhur me Serbinë. Në vazhdim, delegacioni serb më dinakëri e tradhti, rrëfehej së në të ardhmen do të lejonte edhe hapjen e shkollave në gjuhën shqipe, pasi të normalizoheshin rrethanat. Veç tjerash, në përfundim të këtyre bisedimeve, u tha se mbretëria do t'u përmbahej vendimeve të marrëveshjes së arritur në Versajë, vetëm për viset e anektuara pas 10 janarit të vitit 1913. Kështu në mënyrë tinëzare e dinake, delegacioni serb mashtroi bashkëbiseduesit dhe në esencë u lirua nga përmbushja e obligimeve për popu-

[6] Haki Kasumi, *Gjendja dhe pozita e Bashkësisë Islame te shqiptarët nën pushtimin jugosllav më 1912-1945,* Segmente të gërshetuar historike, Prishtinë 2011, f. 26.

[7] Po aty, fq. 27.

llatën e nënshtruar, sidomos për shqiptarët. Në viset e pushtuara etnike shqiptare deri në vitin 1929, vepronin këto organe të BI-së: myftinjtë e qarkut dhe të rrethit, kuvendet e vakëfit, komisionet e vakëfit mearif, si dhe imamatet e xhematit[8]. Deri në këtë kohë nuk ishin formuar gjyqet e sheriatit.

Imamatet e xhematit ishin organe bazë të BI-së dhe nëpërmjet tyre organizohej dhe funksiononte jeta fetare. Deri në vitin 1928 u bënë disa reforma të imamateve të xhematit. Pas kësaj periudhe imamatet e xhematit ndaheshin në dy kategori: të qytetit dhe të fshatit. Në krye të imamatit të xhematit ishte imami-hoxha. Nga viti 1928 ekzistonin dy kategori të imamëve: imamët shtetërorë, që paguheshin më rrogë, dhe imami i fshatit, të cilin e paguanin besimtarët të cilëve u shpërbënte.

Përpjekjet për konsolidim të organeve administrative fetare të BI-së përjetuan goditje të rëndë në vitin 1929. Më vendosjen e diktaturës së 6 janarit u godit edhe BI, ajo në fakt humbi atë autonomi formale që e kishte. U bënë shumë ndryshime në strukturën udhëheqëse e profesionale fetare. Gjendja e popullatës shqiptare vinte duke u vështirësuar gjithnjë e më tepër, ndërsa mundësia e kundërvënies së politikës së pushtuesit zvogëlohej.

Me ndryshimet që pasuan pas vitit 1929, u formua Ulema Mexhlisi i Shkupit. Ulema Mexhlisi i Shkupit zëvendësoi Myftininë Supreme të Beogradit dhe ushtronte këto detyra:

- mbikëqyrte mbarëvajtjen e jetës fetare në përgjithësi (kulturore, arsimore etj.).
- kujdesej për zbatimin e normave të Islamit dhe zbatimin e rregullt të tyre nëpër institucionet e ndryshme fetare dhe shtetërore.
- angazhohej të forconte moralin fetar të besimtarët myslimanë,
- hartonte plan-programet për shkollat fetare islame si dhe për lëndën e mësim-besimit që zhvillohej në shkollat shtetërore.

[8] Po aty, f. 30.

Veç këtyre detyrave, Ulema Mexhlisi bënte emërimin e nëpunësve fetarë, mbikëqyrte punën e tyre dhe ushtronte pushtetin disiplinor mbi ta[9].

Gjatë vitit 1931 në Shkup u themelua Drejtorati i Vakëfeve mearife, që përfshinte 42 njësi administrative fetare, gjegjësisht komisione të Vakëfeve mearife të rretheve. Në Kosovë ekzistonin 11 komisione të Vakëfeve mearife të rretheve. Në këto rrethana u miratua edhe ligji për gjyqtarët dhe gjyqet e sheriatit (1929), kur edhe u suprimuan myftinjtë. Ekzistonin gjyqe të sheriatit të rrethit ose të shkallës së parë dhe gjyqe të shkallës së dytë apo gjyqet supreme të sheriatit. Këto gjyqe ishin afër gjyqeve shtetërore dhe kishin ngjashmëri.[10]

Gjyqet e sheriatit në viset shqiptare nuk ishin të rregulluara si duhet. Deri në vitin 1934 nuk kishte përfunduar formimi i gjyqeve të sheriatit në këto vise edhe pse, sikurse thuhej në dokumente të kohës, për to kishte shumë nevojë.

Gjyqet ekzistuese nuk kishin kuadër të arsimuar dhe më kualifikim përkatës. Kështu nga 40 gjyqtarë që vepronin vetëm 21 prej tyre kishte kualifikimin e duhur. Të tjerët ishin juristë dhe medresantë të viseve të ndryshme.

Më konsolidimin dhe forcimin e institucioneve dhe organeve të ndryshme fetare të BI-së gjendja dhe pozita e mjerë e besimtarëve shqiptarë mysliman u bë më e lehtë. Duhet theksuar se organet administrative fetare islame (imamatet e xhematit, komisionet e vakëfeve mearife dhe më vonë Ulema Mexhlisi i Shkupit) ishin të vetmet institucione dhe do t'i quanim organe popullore legale, për shqiptarët myslimanë të viseve të pushtuara, ku ata mund të komunikonin në gjuhën amtare. Fatkeqësisht, për rolin pozitiv të tyre në ruajtjen e identitetit kombëtar dhe të krijimit të mundësisë së rezistencës të organizuar shqiptare kundër pushtuesit, nuk është shkruar deri më sot.

Është i njohur aktiviteti dhe lufta politike e Ferat bej Dragës në Ulema Mexhlisin e Shkupit kundër tendencave dhe veprimeve shoviniste

[9] *"Glasnik"*, Vrhovno Islamsko Strarešnstvo Kraljevine Jugoslavije, Sarajevo 1933, br. 7. f.27-28.

[10] *"Glasnik"*, Sarajevo 1934, f. 166-195.

serbe, në mënyrë të veçantë, ai u angazhua kundër shpërnguljes së shqiptarëve.[11]

Gjendja dhe pozita e arsimit fetar në viset e pushtuara gjithashtu ishte shumë e rëndë. Në fillim të gjitha institucionet e arsimit fetar ishin të mbyllura, një pjesë e madhe e tyre ishte rrënuar dhe djegur. Deri në vitet e pasluftës së Parë Botërorë nuk ka funksionuar asnjë sibjan mejtep apo medrese. Edhe pas kësaj periudhe, gjendja nuk ndryshoi shumë. Përkundër përpjekjeve të shumta për hapjen e shkollave fetare, pas viteve të njëzeta të këtij shekulli, u lejua puna e një numri të vogël të sibjan mejtepeve.

Pushteti serb përcillte më kujdes policor punën e mejtepeve dhe të medreseve, gjë që vërehet në shumë dokumente. Kështu thuhej në një shkresë të ministrit të fesë dërguar Këshillit kryesor të ministrisë së arsimit në Beograd, të datës 7 shtator 1928: "Në viset jugore (shqiptare) çështja e arsimit fetar të myslimanëve është shumë e komplikuar... në këto vise ka afro 50 myftinj dhe 600 imam, prej të cilëve asnjëri nuk e njeh gjuhën serbe, të gjithë janë të edukuar në frymën armiqësorë ndaj vendit tonë."

Përkundër përzierës së madhe të pushtetit në punën e shkollave fetare, përpjekës për reformimin e tyre, mbylljen e herë pas hershme të tyre, në to u arritën rezultate të rëndësishme[12].

[11] Haki Kasumi, *Gjendja dhe pozita e Bashkësisë Islame te shqiptarët nën pushtimin jugosllav më 1912-1945,* Segmente të gërshetuar historike, Prishtinë 2011, f. 31.

[12] Po aty, f. 32.

1.3. Bashkësia e Islame e Kosovës pjesë e Komunitetit Mysliman Shqiptar

Pas pushtimit nga shtetet e Bllokut fashist (prill 1941), Jugosllavia e Vjetër u shpërbë dhe u copëtua, po ashtu edhe trevat shqiptare që ishin nën sundimin e saj. Pjesa më e madhe e Kosovës, së bashku me trevat veriperëndimore të Plavës, Gucisë, Rozhajës, Tutinit, Ulqinit, Tuzit, trevat lindore etnike shqiptare dhe pikërisht Tetova, Gostivari, Dibra, Kërçova e Struga u përfshinë në Zonën Italiane të pushtimit. Në bazë të Dekretit nr. 264 të Mëkëmbësit të mbretit, dt. 12 gusht 1941, këto territore iu bashkuan Shqipërisë. Kështu, me shtetin amë u bashkua një territor me një sipërfaqe prej 11.780 km katrorë me një popullsi prej 820.000 banorësh. Ndërsa pjesa tjetër e territorit të Kosovës u vu nën pushtimin bullgar dhe gjerman.[13]

Kosova nën administrimin italian u nda në tri rajone administrative (prefektura): Prishtinë, Prizren dhe Pejë. Të gjithë banorët e Kosovës së pushtuar nga Italia, në bazë të dekreteve tetor 1941 dhe shkurt 1942, u bënë shtetas të Shqipërisë.[14]

Kjo gjendje zgjati deri në mbrëmjen e 8 shtatorit 1943, kur Italia kapitulloi.[15]

Gjatë sundimit të tyre, italianët paraqiteshin si kujdestarë të secilës prej feve të shqiptarëve, dhe Islami për arsye të epërsisë numerike, në drejtimin italian të kulteve në Shqipëri, trajtohej, me një konsideratë oportune. Duke respektuar përpjesëtimet numerike, angazhimi më i madh i politikës fetare italiane në Shqipëri synonte, pra, të kënaqeshin kërkesat e përfaqësuesve myslimanë, të cilëve u referoheshin nga pikëpamja ideore "më se dy të tretat e popullsisë shqiptare", dhe, pas krijimit të Shqipërisë së Madhe, pothuaj 80% e saj.[16] Me fjalë të tjera, myslimanët shqiptarë gradoheshin në rangun e ruajtësve të ekuilibrave fetare shqiptare.[17]

---

[13] Dr. Muhamet Shatri, *Kosova në Luftën e Dytë Botërore*, Prishtinë, 1997, f. 19-20.

[14] Noel Malcolm, *Kosova - një histori e shkurtër*, Prishtinë, 1988, f. 304.

[15] Po aty, f. 316.

[16] Roberto Moroco dela Roka, *Kombësia dhe feja në Shqipëri 1920 - 1944*, Tiranë, 1994, f. 203.

[17] Po aty, f. 205.

Meqenëse territori i Kosovës që ishte nën pushtimin italian, i takonte Shqipërisë së Madhe, administrata e shtetit u bë sipas modelit të administratës së pushtetit okupues në Shqipëri. Prishtina që nga gushti 1941 u bë seli e prefekturës.

Kjo prefekturë kishte gjithsej 31 komuna, nënprefekturën e Gjilanit dhe nënprefekturën e Ferizajt. Sipërfaqja e kësaj prefekture ishte afro 2.310 km² dhe në të jetonin 200.000 banorë, ndërsa vetëm në territorin e Prishtinës jetonin afër 178.000 banorë. Kompetencat e prefekturës së Prishtinës ishin identike me kompetencat e 13 prefekturave të tjera, sa kishte gjithsej Shqipëria e Madhe.[18]

Pasi Prishtina u bë qendër e prefekturës, ajo u bë edhe qendër e institucioneve të shumta të prefekturës dhe të nënprefekturave, pra ajo u bë njëra prej tri qendrave kryesore të administratës pushtuese italiane në Kosovë (së bashku me Prizrenin dhe Pejën). Ajo ishte edhe qendra e njërës prej dy kryemyftinive sa ekzistonin atë kohë në Kosovë.

Italia, deri me kapitullimin e saj, dhe pastaj edhe Gjermania, me politikën e tyre për përvetësimin e popullit shqiptar dhe duke pasur parasysh të kaluarën historike të shqiptarëve nën kthetrat e Mbretërisë Jugosllave, në vendet kyç të administratës së institucioneve të Prishtinës, emëruan vetëm shqiptarët e rrethinës së Prishtinës apo të ardhur nga Shqipëria. Prandaj të gjithë nëpunësit e prefekturës së Prishtinës në këtë kohë ishin shqiptarë. Njësoj pothuajse ndodhi edhe me institucionet islame, në të cilat u emëruan personat më të aftë, patriotë që kishin dhënë prova të atdhedashurisë në vitet ndërmjet dy Luftërave Botërore e më herët.

Italianët, të kujdesshëm ndaj ndryshimeve politiko-fetare të shkaktuara nga krijimi i Shqipërisë së Madhe, ndërmorën në qershor 1941 një riorganizim të komunitetit mysliman, duke zëvendësuar Këshillin e Përgjithshëm të Bashkësisë, organizëm i Shqipërisë së "vogël", me një Këshill të Ylemave, pesë anëtarët e të cilit u emëruan që të gjithë nga mëkëmbësi italian, asokohe Francesco Xhakomoni (Jacomoni)[19].

---

[18] Mr. Izber Hoti, *Sistemi pushtues në Prishtinë dhe rrethinë 1941-1944*, "Kosova", nr. 7, Prishtinë, 1978, f. 351.

[19] Ismail Rexhepi - Sadik Mehmeti, *Institucionet islame dhe nëpunësit fetarë në Prishtinë me rrethinën më 1943-1944,* "Dituria Islame", nr. 136, f. 45-50.

Në këto kushte e në rrethane tashmë të reja u themelua edhe Bashkësia Unike Islame për trevat shqiptare më qendër në Tiranë.

Bashkimi i Kosovës dhe i territoreve të tjera shqiptarë më Shqipërinë politike, solli përfitime të mëdha ekonomike për të dyja pjesët shqiptare, të ndara nga vendimet e Konferencës së Ambasadorëve 1912-1913. Gjithashtu, në administratën e viseve shqiptare të bashkuara rishtas, u vendosën nëpunës shqiptarë, u hap një numër i konsiderueshëm shkollash në gjuhën shqipe, të mbyllura në vitin 1918. Në këto rrethana në viset shqiptare që iu bashkuan Shqipërisë, u lejuan gazeta shqipe, u lejua festimi i festave shqiptare, u realizua bashkimi i administratës së fesë myslimane etj.. Viset shqiptare të okupuar nga Italia e që iu bashkuan Shqipërisë atëkohë quheshin "Toka të çliruara"[20].

Myslimanët shqiptarë i shfrytëzuan me zgjuarsi kushtet e krijuara nga zhvillimi i luftës, sidomos ndryshimin e kufijve - forcuan lidhjet me myslimanët shqiptarë të Kosovës, të trojeve shqiptare të Malit të Zi, të trojeve shqiptare të Maqedonisë si dhe të popullsisë çame. Vajtje-ardhjet, bashkëpunimi i tyre, i forcoi tepër lidhjet dhe ndihmoi në ngritjen e ndërgjegjes kombëtare në ato zona. Një pjesë e literaturës islame në gjuhën shqipe, e panjohur më parë nga popullsia e zonave të pushtuara nga ish-Jugosllavia dhe Greqia, filloi të hynte në ato troje dhe të luante një rol të rëndësishëm në pikëpamje fetare[21].

Kjo ishte një mënyrë për të krijuar një hapësirë për të përfaqësuar myslimanët e territoreve të tjera, që deri në ato kohë ndodheshin jashtë kufijve të Shqipërisë londineze, territore, të cilat, me situatën e krijuar, iu bashkuan atdheut mëmë.

Krijimi i Këshillit të Ulemave në gjirin e të cilit kryetari, dy zëvendëskryetarët dhe dy anëtarët emëroheshin nga mëkëmbësi, lejonte që të mënjanoheshin procedurat elektorale, "institute të së kaluarës", të parashikuara nga Statuti i Bashkësisë Islame Shqiptare, në fuqi që nga viti 1929. Sipas dekretit që krijonte Këshillin e Ulemave, ky duhej të hartonte sa më parë "projektin e një statuti të ri për Bashkësinë e të gjithë myslimanëve të Shqipërisë, në përputhje më interesat e përgjithshme të shtetit

[20] Ali M. Basha, *Rrugëtimi i fesë islame në Shqipëri (1912-1967)*, Tiranë 2011, f. 292-293.
[21] Po aty, f. 298.

dhe më ato të elementit islam, si dhe kërkesat e reja që rridhnin nga bashkimi i të gjithë myslimanëve të Shqipërisë në një bashkësi të vetme".

Kryetari i ri i myslimanëve shqiptarë, në cilësinë e kryetarit të Këshillit të Ulemave, nga 16 qershori i vitit 1942, ishte Hafiz Sherif Langu, atdhetar që kishte marrë pjesë më 28 nëntor 1912 në ngritjen e Flamurit më rastin ë Shpalljes së Pavarësisë.[22]

Më 16 tetor 1943 mblidhet Kuvendi Kombëtar. Ftohen të marrin pjesë kryetari i Këshillit të Ulemave dhe kryemyftinjtë:

l) Muharrem Mullaj - kryemyfti i Tiranë,

2) Hafiz Sabri Bushati - kryemyfti i Shkodër;

3) Hasan Islami - kryemyfti i Prizren;

4) Rexhep Remziu - kryemyfti i Prishtinë.

Ftesa këtyre u ishte bërë nga Ibrahim Biçaku.[23]

Meqenëse me Bashkësinë Islame në Kosovë udhëhiqte Ulema Mexhlisi me seli në Shkup, paria islame në Kosovë, duke iu përgjigjur rrethanave të reja, riorganizohet dhe kështu, për këtë qëllim, mbajtën një Kongres më 22.XI.1941, në të cilin morën vendimet e duhura për t'i integruar e për t'i bërë pjesë përbërëse të Komunitet Mysliman të Shqipërisë edhe strukturat e Bashkësisë Islame të Kosovë. Në procesverbalin e mbajtur nga punimet e Kongresit të Prizrenit, thuhet:

"Mbas bisedimesh të zhvilluara, si program punimi u arrit në vija të përgjithshme:

1) Ky kongres ka për qëllim kryesor me i ardhe në ndihmë sa më mirë "Bashkimit Kombëtar";

2) Kongresi si interpret i popullit musliman kosovar, dëshiron me ndjekë qëllimin për me pasë, sa të jetë e mundur, të perfeksionueshëm një organizimin fetar për realizimin e parimeve të nalta islame;

3) Përderisa të stabilizohet gjendja juridike e vendeve të çlirueme, kongresi e mendon të nevojshme që administrimi fetar në këtë vend të dirizhohet prej një Myftiu të Përgjithshëm dhe i përbë-

[22] Po aty, f. 299.

[23] Po aty, f. 328.

rë prej 4 anëtarëve të zgjedhun nga ky kongres, me qendër funksionimi Prizrenin.

Këshilli në fjalë ka për kompetencë me zgjedhë sekretarin e përgjithshëm të Këshillit të Naltë të Sheriatit.

4) *Myftinia e Përgjithshme me Këshillin e Naltë të saj mund të mvaren në kryesinë e Komunitetit Musliman Shqiptar.*
5) *Këshilli i Naltë i Sheriatit ka me pasë kompetencë të plotë me u kujdesue për të gjitha problemet që kanë të bëjnë me organizatën fetare të këtyre vendeve, moralisht e materialisht, si: me i propozue, me emnue, me pushue, me trasferue, me i ndëshkue disiplinisht, me kërkue burime të ardhurash, me kontrollue e inspektue pasuni vakfnore si dhe personelin fetar, me vendosë mbi shpenzime ose shpërblime të nevojshme, me shqyrtue mënyrën e bashkimit më të plotë të organizatës fetare të këtushme me kryesinë e Komunitetit Musliman të Tiranës, duke harmonizue edhe dispozitat e Statutit dhe të rregulloreve në fuqi në këto vende në formën më të përshtatshme, për mirëvajtjen e fesë islame.*
6) *Këshilli i Naltë në fjalë ngarkohet me u interesue ngutësisht për rregullimin institucional të mësimit të besimit në të gjithë juridiksionin e vet, siç i ka hije kohës së sotme.*
7) *Në harmonizim me përmbajtjen e këtij programi, të gjitha kompetencat e "Ulema Mexhlis-it" si dhe ato të Drejtorisë së Vakfeve të Shkupit, i mveshen Këshillit të Naltë të Sheriatit në Prizren*[24].

Nga të dhënë që disponojmë, në Kongresin e parisë islame të Kosovës në Prizren morën pjesë: 1) Hafiz Abdullah Hiziri; 2) Asim Luzha; 3) Hasan Islami; 4) Hafiz Qemali (kundër); 5) Hafiz Vejseli; 6) Hasan Sulejmani; 7) lmer Mustafa; 8) Ahmet Latifi; 9) Mehmet Ademi. 10) Sulejman Jakupi; 11) Qemal Hamiti; 12) Rexhep Bajrami; 13) Rexhep Arifi; 14) Fetah Haxhi Abdullahu; 15) Beqir Bajrami; 16) Mehmet Haxhi

[24] Po aty, f. 330.

Hasani; 17) Bajram Shabani; 18) Bahtjar Neziri; 19) Salih Ramadani; 20) Xhemal Limani; 21) Faik Sherifi; 22) Hafiz Sadik Shporta; 23) Qemal Emini; 24) Qamil Hurshiti; 25) Beqir Hizri; 26) Sulejman Esati; 27) Abdyl Ahmeti; 28) Ejub Bajrami; 29) Maliq Sulejmani)[25].

Kongresi mori vendim që strukturat e Ulema Mexhlist tani e tutje t'i quante Këshilli i Naltë i Sheriatit me qendër në Prizren, si dhe emëroi strukturën e re drejtuese në krye me Hfz. Ali Krajën.

"Ne të nënshkruemit, pjesëtarë të Kongresit të Klerit Musliman të Kosovës, në konformitet me programin e punimeve, redaktue me datë 22.XI.1941, si përfaqësues të popullit musliman të Kosovës për me dirizhue veprimet e "Ulema Mexhlis-it", me cilësinë si Këshillë i Naltë i Sheriatit, me qendër në Prizren dhe me kompetencat që akordojnë ligjet në fuqi, me unanimitet votash, emërojmë personat e poshtëshënuar:

1) Z. Hafiz Ali Kraja nga Shkodra, Myfti të Përgjithshëm;

2) Z. Haxhi Iljazi, nga Prishtina, anëtar;

3) Z. Hasan Islami, nga Gjakova, anëtar;

4) Z. Hafiz Sulejmani, nga Tetova, anëtar;

5) Z. Abdullah Hëziri, nga Prizreni, anëtar.

Me qëllim të funksionimit sa më efikas, Kongresi për çdo anëtar të Këshilli i cili për çfarëdo arsye mund të mungonte në mbledhjet e Këshillit emërohen anëtarët rezervë-zëvendësues për secilin prej tyre

1) Z. Nusret Galibi me zëvendësue z. H. Ali Krajën;

2) Z. Asim Luzha me zëvendue z. Haxhi Iljazin;

3) Z. Sheh Hasani me zëvendësue z. Hasan Islamin;

4) Z. Haxhi Jahja Daci me zëvendësue z. Hafiz Sulejman Shehabin, dhe

5) Z. Idriz Hajrullai me zëvendësue Hafiz Abdullah Hëzirin[26].

[25] Po aty, f. 330 (Ali M. Basha, i referohet procesverbalit të mbajtur në Kuvendin e Prizrenit më datë 21 XI 1941. Dokumenti ruhet në AQSH, Ministria e Drejtësisë. Komisariati i Naltë Civil për Kosovë-Dibër-Strugë, viti 1941. Dosja 152 fleta 27).

[26] Po aty, f. 331

Me këtë rast, Kongresi ngarkon kryetarin e tij të përkohshëm, z. Hafiz Abdulla Hëzirin:

a) Për me paraqitë respektet e Kongresit, Mëkëmbësisë së Shkëlqyeshme Mbretërore dhe Komisariatit të Naltë Civil për Kosovë-Dibër-Strugë;

b) Për me paraqit kopjet e procesverbaleve autoriteteve administrative, duke kërkuar lehtësirat e rastit;

c) Për me lajmëruar pjesëtarët e Këshillit të Naltë të Sheriatit mbi sa më sipër[27]*.*

Organi kryesor i kësaj bashkësie ishte Këshilli i Ulemave të Komunitetit Mysliman. Bashkësinë Islame të Kosovës në këtë organ e përfaqësonin hafëz Bedri Hamiti dhë hafëz Sherif Langu, që para lufte ishin anëtar të Ulema Mexhlisit të Shkupit[28].

Kështu që nga viti 1941 Kryesia e Këshillit të Ylemave të Komunitetit Mysliman më seli në Tiranë, ushtronte pushtetin e vet gati në tërë hapësirën shqiptare. Më rregullat e reja administrative fetare u formuan edhe kryemyftinitë, myftinitë, nënmyftinitë dhë imamatët e xhematit. Në Kosovë, gjatë Luftës së Dytë Botërorë, kanë ekzistuar dy kryemyftini.

Kremyftinia e zonës së Prizrenit, që përfshinte zyrat e vakëfeve në Gjakovë, Therandë (ish - Suharekë), Rahovec dhe Sharr (ish-Dragash).

Kryemyftinia e zonës së Prishtinës përfshinte zyrat e vakëfeve në: Gjilan, Drenicë (Skenderaj) dhe në Ferizaj.

Peja për shkak të mungesës së buxhetit nuk u bë kryemyftini, por mbeti myftini. Megjithatë, myftinia e Pejës korrespondonte drejtpërsëdrejti më Tiranën. Ajo, sikurse edhe kryemyftinitë e tjera ishte e ngarkuar më të njëjtat detyra e të drejta dhe përfshinte zyrat e vakëfeve në: Burim (ish-Istog), Plavë e Guci, Rozhajë dhe në Tutin[29].

Gjatë kësaj përudhe, u bë edhe riemërimi i imamëve të xhemateve. Të gjitha dekretet e emërimit për nëpunësit fetarë islamë, lëshoheshin nga kryeqendra në Tiranë. Shumica e nëpunësve të mëparshëm fetarë e vazh-

[27] Po aty, f. 331.

[28] Ismail Rexhepi - Sadik Mehmeti, *Institucionet islame dhe nëpunësit fetarë në Prishtinë me rrethinën më 1943-1944*, "Dituria Islame", nr. 136, f. 45-50.

[29] Arkivi i Kosovës, *Fondi Kryemyftinia e Zonës së Prishtinës*, k. 20, dok. 246, 1943-1944.

duan punën pasi u bë riemërimi i tyre. Ata veprimtarinë fetare e gërshetuan edhe me çështjen kombëtare shqiptare. Kjo shihet nga dokumentacioni i shumtë i kësaj kohë ku, pos tjerash, thuhej: *"Imamët do të qëndrojnë kurdoherë në krye të detyrës që u është ngarkuar dhe njëkohësisht do të japin vaiz fetar dhe atdhetar"*[30].

Më qëllim të efikasitetit të veprimtarisë së saj, bëhet riorganizimi i saj administrativ, duke zgjeruar kompetencat e kryemyftinjve dhe duke barazuar statusin e nëpunësve fetarë shtetëror dhe privat. Të gjithë hoxhallarët dhe nëpunësit fetarë, shtetëror dhe fetarë që mund të ushtronin detyrat e veta, ishin të obliguar të posedonin dekretin e emërimit të Kryesisë të Këshillit të Ylemave të Komunitetit Mysliman në Tiranë, Para çdo dekretimi, kandidati ishte i obliguar të betohej në besnikëri ndaj fesë dhe atdheut

Teksti i betimit ishte i njëjtë për të gjithë dhe kishte përmbajtje fetare dhe kombëtare mjaft domethënëse.

"Betohem në emën të Perëndisë se do të jam besnik i shtetit Shqiptar, i Statutit, i Atdheut e se do të kryej detyrën t'eme me ndërgjegje të pastër Kombëtare, tue ruejt besnikrin kundër urdhnavet fetare dhe tue respektue plotësisht statutin e gjithë Rregulloret e Komunitetit."[31]

Dhënia e betimit para organeve kompetente atë kohë bëhej sipas nenit 26 të Statutit të Komunitetit Mysliman dhe atë duhej ta kryenin-jepnin të gjithë nëpunësit fetarë, përfshirë këtu edhe imamët dhe myezinët[32].

[30] AK. FKZP, dok. nr. 181.

[31] Teksti i betimi është marra nga Procesverbali i mbajtur më 20 tetor 1943 në Zyrat e KMSH në Tiranë me rastin e betimit të kryemyftiut të të Kryemyftinisë së Prizrenit, Hasan Islamit.

[32] AK. FKZP, dok. nr. 254.



KRYESIA E KËSHILLIT T'ULEMAVE
TË
KOMUNITETIT MYSLIMAN

Nr. _____ Dosje ____ Tiranë, me _____ 194_

Në [illegible] të shkresës Nr. _____ d. _____

LËNDA:

PROCESVERBAL-NDËRTIM

Sod me datën 20 Tetuer 1943 ditën e Mërkuer ora 9 pa-
ra dite,në prezencën t'onë Këshilli i Ulemave përbamë prej
Kryetarit H.Sherif Lahgut,Nënkryetarit Dervish Hilmi Isla-
mit e Këshilltarvet Sulejman Kadiut e H.Bedri Hanitit,Kry-
myftiu i Zonës Prizrendit,Z.Hasan Islami,u betue rregullis-
sht si mbas formulit t'artit 26 të Statutit të Komunite-
-tit Musliman si vijon:

"Betohem n'emën të Perëndisë se do të jemë bes"-
"nik i [illegible] Statutit,i Atdhetut e se do"
"të kryej detyrën t'eme me ndërgjegje të pastër"
"Kombtare,tue ruejt besnikrinë kuhdrejt urdhna"
"vat fetare dhe tue respektue plotsisht Statutin
"e gjithë Rregulloret e Komunitetit."

Për vërtetimi nënshkruen trupi i Këshillit dhe i be-
tuemi,Z.Hasan Islami.

KËSHILLTARI: KËSHILLTARI: N/KRYETARI: KRYETARI:

I betuemi:
Kryemyfti i Zonës Prizrendit:

A.Q.SH. F. 482 V. 1943 D. 15 a 26

Nr. 1. Faksimil e procesverbalit të betimit të kryemyftit të Prizrenit Hasan Islami

Në Prishtinë gjatë vitin 1943-1944 vepronin dy medrese, ajo e Pirinazirit me myderriz *Ahmed ef. Ajetin-Mardoçin* e famshëm, dhe ajo e sulltan Selimit me myderrizin e njohur *Haxhi Iljaz ef. Shasivarin*[33].

[33] Ismail Rexhepi - Sadik Mehmeti, *Institucionet islame dhe nëpunësit fetarë në Prishtinë me rrethinën më 1943-1944*, "Dituria Islame", nr. 136, f. 48.

Në dokumentet që ruhen në Arkivin e Kosovës[34] e që i përkasin kësaj periudhe, janë dhënë edhe emrat e xhamive të Prishtinës, disa prej të cilave, si pasojë e sistemit rrënues komunist, tashmë nuk ekzistojnë. Aty gjejmë të dhëna edhe për nëpunësit e Kryemyftinisë së Prishtinës dhe të Zyrës së Vakëfit, pastaj emrat e 9 imamëve, 2 vaizëve, 18 myezinëve, 3 kaimëve (mirëmbajtësve të xhamive), 3 mësuesve të fesë, 3 salevatxhive, 1 imami që kujdesej për llogaritjen e kohëve të namazit (irtifa), 5 tyrbedarëve, etj, së bashku me vendin ku shërbenin ata dhe vitin e lindjes së tyre, që ne e marrim si të dhënë të saktë, ngase viti i lindjes është "nxjerrun prej rregjistrave themeltar të imametnive të lagjeve"[35].

Kryemyfti i Zonës së Prishtinës do të emërohej myderrizi famëmadh, profesori i arabishtes në Medresenë "Isa Beu" të Shkupit, bashkëpunëtori i rilindësit dibran *Said Najdenit* dhe i *Hasan Prishtinës*, kurse më pas edhe i *Ferat bej Dragës* dhe i *Sheh Mehmet Sezait* të Prishtinës, një si nervi mendor i Organizatës Politike Kombëtare Shqiptare "Xhemijeti"-"Bashkimi", në vitet 1919-1925 dhe veprimtari i Komitetit të Kosovës, para dhe gjatë Luftës së Dytë Botërore dhe shok i ngushtë i *Mulla Idris Gjilanit*, - *z. Rexhep ef. Remziu* nga Mitrovica, i cili nga puna filloi më datën 29 nëntor 1943[36].

Kryemyftinia e Zonës së Prishtinës kishte këtë strukturë të nëpunësve gjatë vitit 1943-1944[37]

1. *Rexhep Remziu, Kryemyfti i Zonës së Prishtinës, i lindur më 1879, rroga mujore 420 franga shqiptare.*
2. *Hasan Beha(uddin) Leskoviku, Sekretar i Kryemyftinisë dhe Zyrës së Vakëfit të Prishtinës, i lindur më 1922, në Prishtinë, 270 fr. sh..*
3. *Shukri Ramadani, Kryetar (i administratës së) Zyrës së Vakëfit.*

---

[34] AK. FKZP, dok. nr. 611

[35] Po aty, dok. 611.

[36] Dr. Muhamet Pirraku, *Mulla Idris Gjilani dhe mbrojtja kombëtare e Kosovës Lindore 1941-1951*, Prishtinë, 1995, f. 29.

[37] Ismail Rexhepi - Sadik Mehmeti, *Institucionet islame dhe nëpunësit fetarë në Prishtinë me rrethinën më 1943-1944*, "Dituria Islame", nr. 136, f. 49.

4. *Xhafer Mehmeti, Arkëtar i Zyrës së Vakëfit, i lindur më 1886, rroga mujore 240 fr. sh..*
5. *Behxhet Sejfedini, shërbëtor i Zyrës së Vakëfit, i lindur më 1875/76, 160 fr. sh..*
6. *Sylejman Beqiri, shërbëtor i Zyrës.*
7. *Në kuadër të Kryemyftinisë së Prishtinës detyrën e Imamit ofiqarë[38] e ushtronin këtë imamë në këto xhemate:*
8. *Mahmud Rexhepi, i lindur më 1898, imam ofiqar i Imamatit të xhematit të Jusuf Çelebiut, rroga mujore 246 franga shqiptare.*
9. *Hajrullah Mehmedi, i lindur më 1886, Imamati i Alauddinit, 246 fr. sh..*
10. *Ali Rashid Bekteshi, i lindur më 1885, Imamati Ramadanije, 226.*
11. *Jamin Rexhepi, i lindur më 1878, Imamati Mehmed Beg Hatunije, 226.*
12. *Ishak Saidi, i lindur më 15 shtator 1897, Imamati Kaderije, 226.*
13. *Adem Fazliu, i lindur më 1874, Imamati i Bellaqevcit të Madh, 208.*
14. *Adem Ramadani, i lindur më 1880, Imamati i Sllatinës së Madhe, 188.*
15. *Osman Aliu, i lindur më 1883, Imamati i Milloshevës, 208.*
16. *Hasan Sadiku, i lindur më 1883, Imamati i Ribarit të Madh, 208.*
17. *Nazif Arif Rifati, i lindur më 1883, Imamati i Mramorit, 228.*
18. *Abdullah Rifati, i lindur më 1890, Imamati i Komoranit, 298.*
19. *Qazim Ahmeti, i lindur më 1889, Imamati i Janjevës, 188.*
20. *Hysen Rexhepi, i lindur më 1889, Imamati i Gllogocit, 140.*
21. *Rifat Salihu, (1885), Imamati i Sedllarit, 168.*
22. *Riza A. Mustafa, i lindur më 1901, Imamati i Prapashticës, 140.*
23. *Selman Ademi, i lindur më 1886, Imamati i Dobrajës, 140.*

[38] Po aty, f. 49.

Ndërsa Zyra e Vakëfit e Rrethit të Gjilanit më 1944 kishte 25 Këshilla të xhematit[39], 64 xhami (54 në gjendje të mirë, 10 të rrënuara dhe 1 gjysmë e rrënuar.[40] Nga numri i përgjithshëm i xhamive, 19 prej tyre kishin minare të punuar nga guri, 7 ishin me minare të punuar nga druri, ndërsa 28 xhami ishin pa minare.[41]

E veçanta e kësaj periudhe ka të bëjë më faktin së administrata e këtyre institucioneve bëhej ekskluzivisht në gjuhën shqipe. Në këtë kohë në Kosovë, në mënyrë të lirë dhe haptazi, shpërndahej literatura islame nga Shqipëria, si revistat: "Kultura Islame", "Zani i Naltë", "Mevludi" i Hafiz Ali Riza Ulqinakut, veprat e Hafiz Ibrahim Dalliut, veprat e Hafiz Ali Korçës, Haki Sharofit, Hafiz Abdullah Semblakut etj[42].

Jashtë kompetencës të kësaj Bashkësie nga territori i Kosovës, ngeli një pjesë e Gjilanit në veri të Pasjanit, një pjesës e rajonit të Kaçanikut dhe e Rrafshit të Siriniqit, që ishin nën pushtimin bullgar dhe rrethet e Mitrovicës, Vushtrrisë dhe të Llapit (Podujevës), që ishin nën pushtimin gjerman, ngelën nën kompetencën e Bashkësisë së Fesë Islamë të Serbisë[43].

Edhe qendrat e tjera fetare islame në Shkup, Tetovë, Gostivar e Kërçovë, si dhe ato në Podgoricë e Ulqin kishin lidhje dhe bashkëpunonin më kryeqendrën e re në Tiranë[44].

Duhet përmendur këtu se qëndrimi i parisë fetare islame në përgjithësi ishte kundër ideologjisë komuniste, e cila në këtë kohë bënte luftë për pushtet. Kundërshtimi shprehej hapur në shumicën e dokumenteve të kohës, kjo më së miri shihet në shkresën e myftiut të Prishtinës ku thuhet:

"... Ashtë e ditun ...së qoftë kleri dhe qoftë streha e tyre, që frymëzohen ata, janë të influencuam me ndjenja nacionaliste dhe patri-

[39] Mr. sc. Ali Riza Selmani, *Bashkësia Islame e rrethit të Gjilanit gjatë Luftës së Dytë Botërore*, Gjurmime historike për Gjilanin me rrethinë, "Drita e Jetës" Gjilan 2009, 110.

[40] Po aty, f. 111.

[41] Po aty. f. 111.

[42] *Bashkësia Islame e Republikës së Kosovës,* përgatitën Ramadan Shkodra - Sadik Mehmeti, Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës, Prishtinë 2013, f. 11.

[43] Dr. sc. Menduh Bamja, *Pozita kushtuese -juridike dhe faktike e bashkësive fetare në ish-Jugosllavi me vështrim të posaçëm të Bashkësisë Islame*, f. 239.

[44] Po aty, f. 240

otikë, gja të cilat janë tuj përhapun gjithënji, tuj pri ata në çdo vepër atdhetarie. Ashte e kjartë së këto strehna janë tue përgatitë personelin që u ven ballë vetë dhe tërheqin gjithë popullin kundër "komunizmit barbarë" dhe çdo ndjenje shkatërruese për Atdheun t'onë të dashur".[45]

Po ashtu si fushë e veprimtarisë së kësaj Bashkësie është edhe veprimtaria e saj kundër rrezikut nga ateizmi militant. Kështu në një letër të krymyftiut të Prishtinës, ndër të tjera theksohet: *"Shtojmë së në rast nevoje ma të ngushta do të jemi gadi gjithë kleri, pa asnji përjashtim të kryejmë detyrën t'onë të shenjtë për Atdheun."*[46]

- vijon -

[45] Dr. Haki Kasumi, *Bashkësitë fetare në Kosovë,* Prishtinë 1988, f. 13.

[46] Po aty, f. 13.

Ramadan SHKODRA

THE ORGANIZATION OF ISLAMIC RELIGIOUS LIFE IN KOSOVA BETWEEN THE XIV AND XXI CENTURY

(Summary)

The organization of Islamic religious life in Kosova dates back to the period of Ottoman Rule in this region. During that time the religious life throughout the empire was regulated by a religious and political authority, according to which religious organization and state functions were exercised by a single structure (Din ve Devle). Other religious communities had their specific organizations.

Within the Ottoman Empire, all the Muslims in the Balkans were part of a Single Muslim Community, which was chaired by the sultan, who also held the title of Caliph. During the rule of Sultan Murat II (1421-1451) the powers and prerogatives of the Caliph were transferred to the Grand Mufti. Ever since, the Grand Mufti held the title of Sheikh ul-Islam, who was the highest religious authority in the empire. This position was held by three Albanians as well: Ali efendi Zembili (1503-1526), Ibrahim Bej efendi Ajvaz Pasha-zada (1719-1797) and Abdurrahman Nesip Efendi (1842-1914). Provincial muftis served at the local level.

رمضان شكودرا

تنظيم الشؤون الدينية الإسلامية في كوسوفا خلال القرون ١٤–٢١

(خلاصة البحث)

يعود تاريخ تنظيم الحياة الدينية الإسلامية في كوسوفا إلى عهد إدارة الإمبراطورية العثمانية في هذه المناطق. وخلال تلك الفترة تم تنظيم الحياة الدينية الإسلامية في كل مكان من قبل الإمبراطورية العثمانية من خلال السلطة الدينية والسياسية، التي نصت على أن ممارسة مهام تنظيم الشؤون الدينية الإسلامية و تنظيم إدارة الدولة كان يتم من قبل إدارة فريدة واحدة تحت مفهوم "دين ودولة"، في حين كان للطوائف الدينية الأخرى تنظيمها الخاص بها.

داخل الإمبراطورية العثمانية، وفي مفهوم التنظيمي الديني الإسلامي، كان جميع المسلمين في البلقان جزءا لا يتجزأ من المجتمع المسلم الموحد، وعلى رأسه هو السلطان باعتباره خليفة. وتم في عهد حكم السلطان مراد الثاني (١٤٢١–١٤٥١) نقل صلاحيات واختصاصات الخليفة الدينية في ذلك الوقت إلى المفتي الرئيسي، و منذ ذلك الحين، يحصل المفتي العام في ظل الامبراطورية العثمانية على لقب شيخ الإسلام، والذي كان أعلى سلطة دينية إسلامية في الإمبراطورية بأكملها. وحمل هذا اللقب ثلاث مشايخ علماء من الألبان: وهم الشيخ علي أفندي زيمبيلي (١٥٠٣–١٥٢٦) ، والشيخ إبراهيم بيك أفندي آيفاز باشا زاده (١٧١٩–١٧٩٧)، عبد الرحمن نصيب أفندي (١٨٤٢–١٩١٤). وفي الوقت نفسه ، على الصعيد المحلي ، كان مفتو المناطق المحلية يقومون بإدارة السلطة الدينية المركزية لشيخ الإسلام.

Nuridin AHMETI

DISA TË DHËNA TË REJA PËR HOXHË KADRI PRISHTINËN (1878-1925)

Abstrakt

Muaji maj i vitit 1918 sipas një pjese të konsiderueshme të studiuesve vendorë, shënon edhe themelin e organizatës kombëtare e politike "Komiteti Mbrojtja Kombëtare e Kosovës" me seli në Shkodër.

Që nga themelimi kjo organizatë i bëri të ditura qëllimet e saja se është për çlirimin e tokave shqiptare të mbetura në Jugosllavinë e atëhershme dhe bashkimin e tyre më Shqipërinë.

Nga mesi i disa personaliteteve të kohës, për ta udhëhequr këtë organizatë iu besua intelektualit, teologut dhe publicistit Hoxhë Kadri Prishtina.

Për këtë figurë, janë shkruar disa kontribute nga studiues të ndryshëm, sidomos vendorë, të cilët kanë dhënë mendimin e tyre. Por, ne mendojmë se ende ka të dhëna që ndihmojnë në plotësimin e biografisë së këtij personaliteti me peshë të historisë tonë.

Andaj, duke mbështetur në literaturën e botuar që bën fjalë për Hoxhë Kadri Prishtinën dhe duke analizuar disa të dhëna të pa cituara nga autorë që kanë shkruar për këtë figurë historike, e pamë

të udhës të ofrojmë disa informacione shtesë, që e plotësojnë biografinë e personaliteti të madh..

Fjalë kyçe: *Hoxhë Kadri Prishtina, Komiteti Mbrojtja Kombëtare e Kosovës, Dajti, Ahmet Zogu, Jahja Lutfullah Prishtina etj.*

Hyrje

Një ndër personalitetet e shquara të historisë tonë kombëtare që është trajtuar pak nga historiografia shqiptare, është edhe hoxha, juristi, publicisti, veprimtari i çështjes kombëtare, udhëheqësi dhe themeluesi i Komitetit Mbrojtja Kombëtare e Kosovës, i njohur dhe i popullarizuar ndër masa e në dokumente-Hoxhë Kadri Prishtina.

Që nga viti 1965, kur më rastin e 40 vjetorit të vdekjes së Hoxhë Kadriut, u botua një kumtesë nga studiuesi Jup Kastrati[1] e deri me sot, kohë pas kohe janë publikuar shkrime po edhe monografi për Hoxhë Kadri Prishtinën.

Për më tepër, pas shkrimit të Jup Kastratit, për këtë personalitet u botuan tri monografi: ajo e studiuesit Eqber Skendi e botuar në Prishtinë më 1992,[2] monografia studiuesit dhe publicistit Qemajl Morina në vitin 2000 në Prishtinë[3] si dhe monografia e Pal Doçit në vitin 2005 në Tiranë.[4] Në këtë rast, nuk mund të mos përmendim edhe një shkrim të mbesës së Hoxhë Kadriut, studiueses Nevila Nika, ku bëhet fjalë për jetën dhe veprën e Hoxhë Kadriut, por jo edhe për ditët e fundit të jetës së këtij personaliteti.[5]

---

[1] Jup Kastrati, "Hoxha Kadriu-me rasën e 40-vjetorit të vdekjes", *Buletini shkencor*, nr. 3, IPDSH, Shkodër, 1965, f. 433-441.

[2] Eqber Skendi, *Hoxhë Kadriu*, Rilindja, Prishtinë, 1992.

[3] Qemajl Morina, *Hoxhë Kadri Prishtina-mendimtar islam*, DI, Prishtinë, 2000.

[4] Pal Doçi, *Hoxha Kadri Prishtina*, Geer, Tiranë, 2005.

[5] Nevila Nika, "Hoxhë Kadri Prishtina-kryetar i Komitetit "Mbrojtja Kombëtare e Kosovës", *Komiteti Mbrojtja Kombëtare e Kosovës*, (Përmbledhje kumtesash), ASHSH, IH–Tiranë, IH–Prishtinë, f. 2004, f. 150-162.

Dy monografitë e sipërpërmendura, ajo e Eqber Skëndit dhe e Pal Doçit, janë të fokusuara kryesisht në jetën dhe veprimtarinë kombëtare të Hoxhë Kadri Prishtinës, ndërsa monografia e tretë, ajo e Qemajl Morinës, merret kryesisht me idetë dhe mendimin islam të këtij personaliteti në revistën "Rruga e s'vërtetës", prandaj këtë vështrim, nuk e kemi përfshirë në analizën tonë të krahasimit.

Në harkun kohor 1965-2018, janë botuar edhe disa monografi për Komitetin Mbrojtja Kombëtare e Kosovës dhe po ashtu janë mbajtur edhe konferenca shkencore me temë bosht veprimtarinë e këtij Komiteti, që domethënë se brenda këtyre trajtimeve, është e kuptueshme që të hasim edhe ndonjë të dhënë të re biografike edhe për Hoxhë Kadri Prishtinën.[6]

Me gjithë këto shkrime e studime, një pyetje shtrohet pashmangshëm: A është ndriçuar dhe a është kompletuar sa duhet jetëshkrimi i këtij personaliteti të shquar, apo sikurse edhe për shumë personalitete të tjera kanë ngelur shumë gjëra për t'u thënë dhe pse jo edhe për t'u korrigjuar?

Këtë bindje ma përforcon edhe më shumë një shkrim-nekrolog për Hoxhë Kadri Prishtinën, i shkruar nga i vëllai i tij Jahja Lutfullah Prishtina, i botuar në gazetën "Dajti", Tiranë, më 12 shkurt 1925,[7] i cili nekrolog nuk u ribotua dhe as u citua nga ata që kanë shkruar për Hoxhë Kadri Prishtinën. Ky nekrolog dhe të dhënat që përmban ai, mendojmë se e plotësojnë dhe besa edhe korrigjojnë të dhënat jetëshkrimore për Hoxhë Kadri Prishtinën.

Ja përse mendojmë kështu:

---

[6] Lush Culaj, *Komiteti Mbrojtja Kombëtare e Kosovës 1918-1924*, IAP, Prishtinë, 1997; Hakif Bajrami, *Komiteti Mbrojtja Kombëtare e Kosovës dhe qeveritë e Tiranës për krimet serbe ndaj shqiptarëve 1918-1924*, Prishtinë, 2008.

[7] "Më 5 janar 1924 filloi të botohet gazeta "Dajti", e drejtuar nga Hafiz Ibrahim Dalliu, një prej figurave të rëndësishme të klerit mysliman në Tiranë. Që në numrin e parë "Dajti" u rendit krahas gazetës "Xhoka", duke e bërë të vetin programin antiqeveritar. Veçanërisht u shqua për rubrikën"Dajti në gaz", e cila botohej në faqe të parë dhe kishte për autor vetë kryeredaktorin e gazetës, publicistin Hafiz Dalliun. "Dajti" u botua deri në vitin 1925. Hamit Boriçi-Mark Marku, *Histori e shtypit shqiptarë nga fillimet deri në ditët tona*, Shblu, Tiranë, 2010, f. 190.

I vëllai për vëllanë

E para, sepse ky nekrolog është shkruar nga i vëllai i Hoxhë Kadri Prishtinës, Jahja Lutfullah Prishtina, që del të ketë qenë i ngritur nga aspekti intelektual. Dhe sigurisht që askush më mirë se vëllai nuk e njeh të vëllanë. Kur kësaj ia shtojmë edhe faktin se autori i këtij shkrimi, pra vëllai i Hoxhë Kadri Prishtinës, Jahjai do ta ketë konsultuar edhe arkivin dhe të dhënat e familjes si dhe do t'i ketë pasur të freskëta kujtimet dhe bisedat e familjes, atëherë këto të dhëna marrin peshë dhe bëhen edhe më të besueshme.

E dyta, ky nekrolog, u botua më 12 shkurt 1925, pra tre javë pasi kishte ndërruar jetë Hoxhë Kadriu, i cili u varros më 20 janar të vitit 1925. Mbase pikërisht kjo edhe i jep rëndësi këtij shkrimi.

E treta, ky nekrolog u botua në të përdyjavshmen "Dajti", drejtues i së cilës ishte atdhetari e intelektuali, Hafiz Ibrahim Dalliu, i cili do ta ketë botuar këtë shkrim nga njohja që kishte me Hoxhë Kadriun dhe vëllanë e tij Jahjain, sepse ishte kolegë në profesion dhe në politikë, edhe pse jo gjithmonë janë pajtuar, por mbi të gjitha do ta ketë botuar për respektin që kishte për jetën dhe veprën e këtij patrioti, intelektuali e veprimtari të shquar.

Pa u zgjatur shumë për gazetën "Dajti" dhe kryeredaktorin e saj Hafiz Ibrahim Dalliun, do të mjaftohemi vetëm me disa të dhëna nga një dokument, i cili sipas nesh, tregon qartë për rëndësinë dhe politikat redaktuese, si dhe ndikimin që kjo gazetë ka pasur jo vetëm në Shqipëri ku edhe botohej, por edhe jashtë saj, sidomos në Kosovë. Në këtë dokument, të përpiluar nga Legata serbe në Tiranë më 28 nëntor të vitit 1924, drejtuar Ministrisë së Punëve të Brendshme të Mbretërisë Serbe-Kroate-Sllovene-drejtorisë së Sigurimit Publik, seksionit të Mbrojtjes Shtetërore, thuhet: "Gazeta "Dajti", në faqen e parë të numrit të vet të dt., 7 të këtij moti, boton artikullin në të cilin jepet: "Pasqyrë e shkurtër e veprave çnjerëzore serbe në Kosovë, në rrethet: Gjakovë, Pejë, Prizren, Vushtrri, Prishtinë, Kaçanik, Lipjan, Ferizaj dhe Preshevë..., Shënimet janë marrë nga Arkivi i Komitetit të Kosovës". E njoftojmë Seksionin për sa më sipër me lutje

që të ndalohet hyrja dhe shpërndarja e kësaj gazete në Mbretërinë tonë"[8]- përfundon dokumenti.

Por t'i kthehemi çështjes që e kemi marrë në shqyrtim. Edhe pse gazeta "Dajti" dhe redaktori i saj nuk pajtoheshin me politikat e Ahmet Zogut dhe qeverisjen e tij, megjithatë kishin lejuar të botohej një shkrim, pra nekrologu për Hoxhë Kadri Prishtinën, në të cilin flitej mirë dhe madje falënderohej Ahmet Zogu. Kjo tregon, përveç të tjerash, se sa i respektuar dhe i nderuar ka qenë Hoxhë Kadri Prishtina në mesin e kolegëve dhe veprimtarëve të tjerë. Kjo e bënë këtë nekrolog dhe të dhënat e tij, edhe më të besueshëm dhe, për mendimin tonë, edhe më të rëndësishëm për t'u konsultuar nga ata që merren me jetëshkrimin e Hoxhë Kadriut.

Kjo bëhet e domosdoshme edhe për dy arsye të tjera. *E para,* sepse deri me tani nuk na ka rënë ta shohim të jetë përmendur ky shkrim/nekrolog, në asnjërën nga monografitë dhe shkrimet e botuara për jetën dhe veprën e Hoxhë Kadri Prishtinës dhe *e dyta*, që është edhe më kryesorja, disa të dhëna të këtij nekrologu për Hoxhë Kadriun, nuk përputhen, për të mos thënë janë krejt të ndryshme, më të dhënat që na janë ofruar deri më tani në kontributet shkrimore për këtë personalitetet.

Përmbajtja e nekrologut

Shkrimi, sikurse u tha, është i titulluar si "Nekrologji" dhe është shkruar nga i vëllai i Hoxhë Kadri Prishtinës, Jahja Lutfullah Prishtina, i cili nuk harron t'i falënderojë që në fillim të gjithë ata që ndihmuan Hoxhë Kadri Prishtinën dhe familjen e tij në ditët e fundit të jetës. Më tutje, aty flitet edhe për vajtje-ardhjet e Hoxhë Kadriut për shërim në Vjenë, pastaj për ceremoninë e varrimit të tij etj.

Për të qenë më konkret në këtë që dëshirojmë ta parashtrojmë, do të mundohemi t'i ballafaqojmë të dhënat që ofron ky nekrolog me ato që na ofron literatura e botuar deri tash në gjuhën shqipe për Hoxhë Kadriun.

Në pjesën e parë të shkrimit të Jahja Lutfullahut thuhet se "Të ndyerit Hoxha Kadri nasht nji mot ma parë ja filluen disa ethe të lehta e të pa

[8] Hakif Bajrami, *Dëbimi dhe shpërngulja e shqiptarëve në Turqi*, SHKSHSHTV, Prishtinë, 1996, f. 79.

pritshme, nga vazhdim i të cilave i erdhi nji dobësi jo e rreptë po e kadalshme. Doktorët e kshilluen qi të shkonte n'Europë. Për këtë arsyë në kohen e Kabinetit Z. Shevqët Vëralcit,[9] me vendim t'asamblesë, ju dhanë 150 napoleona prej të cilëvet 40 ja la familjes për ushqim e me tjerat vojti në Vjenë. Atje si u vizitue u shtrue në senatorjumin Vinervald të Vienës, ku paguante nji napolon në ditë. Këtu ndejti dy muejë e gjymsë pastaj duel nga mungimi i të hollavet dhe u kthye në Shqipni".[10] Sipas studiuesit, Kastriot Dervishi, i cili i referohet gazetës zyrtare të kohës, Kuvendi Kushtetues i asaj kohe në Shqipëri mblidhet më 31 maj të vitit 1924, në mbrëmje, sepse në këtë ditë, vritet nga kryengritësit në Shkodër kapiteni Ferit Frashëri në objektin e Prefekturës së këtij qyteti dhe përveç vendimeve të tjera që marrin në këtë mbledhje, deputetët "me propozim të deputetit Syrja Pojanit, u dhanë 3 mijë franga ari për shëndetin e Hoxha Kadriut"[11]- konstaton studiuesi Dervishi.

Nga data 16 qershor deri më 24 dhjetor të vitit 1924, në Shqipëri vjen Qeveria me Fan Nolin në krye. Siç del nga nekrologu, Hoxhë Kadri Prishtina i drejtohet edhe kabinetit të Nolit, sepse kishte akoma nevojë për qëndrim në Vjenë, por nuk kishte marrë asnjë përgjigje. Autori i shkrimit, Jahja Lutfullahu e përshkruan një kërkesë të tillë në këtë mënyrë: "Mbasi kishte nevojë për mjekim dhe për disa kohë ju drejtue kabinetit Fan Nolit i cili e shtynte tyke i thanë sot nesër do të bisedohet, sa qi kështu, kaloj koha e smundjes hyni mbë nji fazë ma të rend".[12]

Në dy monografitë për Hoxhë Kadriun të përmendura për të satën herë, fundi i jetës së Hoxhë Kadriut, në përgjithësi përshkruhet me një diskurs antizogistë. Autori Eqber Skendi shkruan: *"Më 20 janar 1925, i vrarë nga luftërat, dhembjet dhe dramat e kombit, në moshën 47 vjeçare, në ditët me të ftohta të janarit shqiptar nën regjimin gjakatar zogollian, pushoi së jetuari... Për në banesën e fundit..., e përcollën një grup i vogël njerëzish. Ceremonia e përmortjes ishte e thjeshtë. Në shtypin e kohës*

[9] Qeveria e Shefqet Vërlacit (3 mars-27 maj 1924)-Kastriot Dervishi, *Historia e Shtetit Shqiptar 1912-2005*, ShB, 55, Tiranë, 2006, f. 205.

[10] Jahja Lutfullah, "Nekrologji", *Dajti*, nr. 65, 12 shkurt,Tiranë, 1925, f. 2.

[11] Kastriot Dervishi, *Vep. e cit.,* f. 213.

[12] *Dajti*, nr. 65, 12 shkurt,Tiranë, 1925, f. 2.

ndodhi ajo që pritej, pati heshtje."[13] Ngjashëm si Eqber Skendi, shkruan edhe autori tjetër Pal Doçi.[14]

Pavarësisht diskursit antizogistë që autorët shprehin në librat e tyre për ditët e fundit të jetës së Hoxhë Kadriut dhe të cilët shkruajnë për një varrim të thjeshtë dhe mos pjesëmarrje të njerëzve në këtë varim, i vëllai i Hoxhë Kadriut, Jahjai e thotë një version tjetër që bjen në kundërshtim me autorët e sipërpërmendur, kur shkruan: "Mbë anë tjetër miku i sinqertë dhe shoku i tij Shk. e tij A. Zogu, i cili e çmonte dituninë dhe ushqeute nji simpathi të veçantë për të, po sa e kishte ndëgjue kthimin e tij e kishte marrë vesh qi kishte edhe ma nevojë për mjekin; prej Beligradit ja zgjati doren fisnike dhe e siguroj për ç'do mjekim në Europë vetëm qi të ia shpëtonte jetën e tij prej rrezikut. Po për fat të keqëm mbë atë kohë gjendja shëndetësore, në të cilën kishte mëri i ndyeri Hoxhë Kadri, e pengonte të luejë prej vendi e tyke shpresue se do të bante ma mirë e humbi fare fuqinë dhe, s'mujti m'u nis për Evropë e kështu mbeti e u dergj në shtëpi të tij në Tiranë. Në kohën e fundit kur ishte tuke vdekun si nji vetetim mërrini në Tiranë shpëtimtar' i atdheut dhe dashamiri i ditunis Shk. e Tij A.Zogu i cili, n'ato 5 e 10 ditë të fundit qi i ndyeri Hoxha ishte tuke i kaluë, pa ndonji za, i ndihmoi me të holla e me ç'do mënyrë ashtu edhe ditën e vorrimit. Me këto vepra njerzore të pa shoqe Shk. e tij ja gëzoj shpirtin e të ndyerit Hoxha Kadri dhe mu bashk me familjen e tij na bani mirë njohtësa për jetë e të detyruem me ja paraqitë falënderimet t'ona ma të për unjta. Ashtu ju falem nderit edhe Zotnive Asamblstëvet, Hoxhallarevet, shehlervet, ushtarvet, nxansvet e krejt popullit qi na nderruen tyke marrë pjesë në ceremoninë e xhenazes"[15]- shkruante në mes tjerash Jahja Lutfullahu i vëllai i Hoxhë Kadriut. Për të qenë sa më të saktë për atë që u tha, po e (ri) botojmë në tërësi shkrimin e vëllait të Hoxhë Kadriut, pa shtuar dhe larguar asgjë.

[13] Eqber Skendi, *Vep. e cit.,* f. 213-214.

[14] Pal Doçi, *Vep. e cit.,* f. 152-153.

[15] *Dajti*, nr. 65, 12 shkurt,Tiranë, 1925, f. 2.

"Sëmundja dhe jeta qi kaloji i ndyeri Hoxha Kadri. Të ndyerit Hoxha Kadri nasht nji mot ma parë ja filluen disa ethe të lehta e të pa pritshme, nga vazhdim i të cilave i erdhi nji dobësi jo e rreptë po e kadalshme. Doktorët e kshilluen qi të shkonte n'Europë. Për këtë arsyë në kohen e Kabinetit Z. Shevqët Vëralcit, me vendim t'asamblesë, ju dhanë 150 napoleona prej të cilëvet 40 ja la familjes për ushqim e me tjerat vojti në Vjenë. Atje si u vizitue u shtrue në senatorjumin Vinervald të Vienës, ku paguante nji napolon në ditë. Këtu ndejti dy muejë e gjymsë pastaj duel nga mungimi i të hollavet dhe u kthye në Shqipni.

Por mbasi kishte nevojë për mjekim dhe për disa kohë ju drejtue kabinetit Fan Nolit i cili e shtynte tyke i thanë sot nesër do të bisedohet, sa qi kështu, kaloj koha e smundjes hyni mbë nji fazë ma të rendë.

Mbë anë tjetër miku i sinqertë dhe shoku i tij Shk. e tij A. Zogu i cili e çmonte dituninë dhe ushqeute nji simpathi të veçantë për të, po sa e kishte ndëgjue kthimin e tij e kishte marrë vesh qi kishte edhe ma nevojë për mjekin; prej Beligradit ja zgjati doren fisnike dhe e siguroj për ç'do mjekim në Europë vetëm qi të ia shpëtonte jetën e tij prej rrezikut. Po për fat të keqëm mbë atë kohë gjendja shëndetësore, në të cilën kishte mëri i ndyeri Hoxhë Kadri, e pengonte të luejë prej vendi e tyke shpresue se do të bante ma mirë e humbi fare fuqinë dhe, s'mujti m'u nis për Evropë e kështu mbeti e u dergj në shtëpi të tij në Tiranë.

Në kohën e fundit kur ishte tuke vdekun si nji vetetim mërrini në Tiranë shpëtimtar' i atdheut dhe dashamiri i ditunis Shk. e Tij A.Zogu i cili, n'ato 5 e 10 ditë të fundit qi i ndyeri Hoxha ishte tuke i kaluë pa ndonji za i ndihmoi me të holla e me ç'do mënyrë ashtu edhe ditën e vorrimit.



NEKROLOGJI

Sëmundja dhe jeta qi kalojti i ndyeri Hoxha Kadri.

Të ndyerit Hoxha Kadri nasht nji mot mâ parë ja filluen disa éthe të lehta e të pa pritshme, nga vazhdim i të cilavet i erdhi nji dobsi jo e rrepte por e kadalshme. Doktorët e kshilluen qi të shkonte n'Europë. Për këtë arsyë në kohen e Kabinetit Z. Shevqët Vërlacit, me vendim t'asamblesë, ju dhanë 150 napoleona prej të cilvet 40 ja la familjes për ushqim e me tjerat vojti në Vjenë. Atje si u vizitue u shtrue në senatorjumin Vinervald të Vienës, ku paguente nji napoleon në ditë. Këtu ndejti dy muejë e giymsë pastaj duel nga mungim'i të hollavet dhe u kthye në Shqipni.

Por mbasi kishte nevojë për mjekim edhe për disa kohë ju drejtue kabinetit Fan Nolit i cili e shtynte tyke i thanë sot nesër do të bisedohet, sa qi kështu, kaloj koha e semundjes hyni mbë nji fazë ma të randë.

Mbë anë tjetër miku i sinqert dhe shoku i tij Shk. e tij A. Zogu i cili e çmonte dituninë e tij dhe ushqeute nji simpathi të veçant për te, po sa e kishte ndëgjue kihimin e tij e kishte marrë vesh qi kishte edhe ma nevojë për mjekin; prej Beligradit ja zgjati doren fisnike dhe e siguroj për ç'do mjekim në Europë vetëm qi të ia shpëtonte jetën e tij prej rrezikut. Po për fat të keqë mbë atë kohë gjendja shëndetsore, në të cilën kishte mëri i ndyeri Hoxha Kadri, e pengonte të lueje prej vendi e tyke shpresue se do të bânte ma mirë e humbi fare fuqinë dhe s'mujti m'u nis për Evropë e kështu mbeti e u dergj në shtëpi të tij në Tiranë.

Në kohën e fundit kur ishte tuke vdekun si nji vetetim mër ni në Tiranë shpetimtar' i atdheut dhe dashamiri i dituris Shk. e Tij A. Zogu i cili, n'ato 5 a 10 ditë të fundit qi i ndyeri Hoxha ishte tuke i kaluë pa ndonji za i ndihmoi me të holla e me ç'do mënyrë ashtu edhe ditën e vorrimit.

Me Këto vepra njerzore të pa shoqe Shk. e tij ja gëzoj shpirtin e të ndyerit Hoxha Kadri dhe mue bashk me familjen e tij na bani mirë njohtësa për jetë e të detyruem me ja paraqitë falenderimet t'ona ma të për unjta. Ashtu ju falem nderit edhe Zotnive Asamblistëvet, Hoxhallarvet, shehlervet, ushtarvet, nxansvet e krejt popullit qi na nderruen tyke marrë pjesë në ceremoninë e xhenazes.

JAHJA LUTFULLA
I vllaj i të ndyerit Hoxha Kadri

Me këto vepra njerzore të pa shoqe Shk. e tij ja gëzoj shpirtin e të ndyerit Hoxha Kadri dhe mu bashk me familjen e tij na bani mirë njohtësa për jetë e të detyruem me ja paraqitë falënderimet t'ona ma të për unjta. Ashtu ju falem nderit edhe Zotnive Asamblstëvet, Hoxhallarevet, shehlervet, ushtaret, nxansvet e krejt popullit qi na nderruen tyke marrë pjesë në ceremoninë e xhenazes. ***JAHJA LUTFULLAH****, i vllaj i të ndyerit Hoxha Kadri".*[16]

[16] *Dajti*, nr. 65, 12 shkurt,Tiranë, 1925, f. 2.

Përfundim

Duke e lexuar shkrimin e lartcekur dhe literaturën që u shkrua për Hoxhë Kadri Prishtinën, mund të thuhet se të dhënat e ofruara, veçanërisht nga dy autorët e monografive për ditët e fundit të Hoxhë Kadriut bien ndesh, sidomos kur është fjala për qëndrimin e Ahmet Zogut ndaj Hoxhë Kadriut.

Hoxhë Kadri Prishtina, kishte vajtur për shërim në Austri, dhe siç e potencon edhe i vëllai, atje qëndroi për afro dy muaj e gjysmë dhe më pas kthehet nga Vjena në Tiranë, që i bie se Hoxhë Kadriu shkoi në shërim nga Tirana dhe u kthye nga Vjena, në Tiranë në rrethana shumë të tendosura politike në Shqipëri. Ishte kjo koha e Lëvizjes së Qershorit apo siç njihet në literaturën tonë tradicionale historiografike, si "Revolucioni Demokratik i Nolit në Shqipëri".

Nekrologu, u botua në gazetën "Dajti" afro një muaj pasi ishte varrosur Hoxhë Kadriu dhe afro dy muaj pas rikthimit të Ahmet Zogut në Shqipëri nga Beogradi, rrjedhimisht fjalët miradije që i vëllai Jahja Lutfullahu, i thotë për Ahmet Zogun në këtë shkrim, mbetën për tu hulumtuar edhe më tej, se a kishte ndikim Zogu dhe pushteti i tij në këtë shkrim, apo ai shkroi nga dëshira e vet. Por, sa i përket "Dajti"-t si gazetë, aty ku edhe u botuar shkrimi i të vëllait të Hoxhë Kadriut, politika redaktoriale e saj, sipas njohësve të historisë së shtypit shqiptarë ishte anti-Zogiste[17] dhe këtë politik e vazhdoi edhe pas kthimit të Ahmet Zogut në Shqipëri.

Pavarësisht, mos citimit të këtij shkrimi nga autorët që kanë shkruar për Hoxhë Kadriun, një shkrim i tillë ofron informacione interesante, që sadopak hedhin dritë edhe për disa detaje në fundin e jetës së Hoxhë Kadriut në njëqindvjetorin e themelimit të Komitetit Mbrojtja Kombëtare e Kosovës, të cilin komitet ai edhe e udhëhoqi.

[17] Hamit Boriçi, *Një shekull e gjysmë publicistikë shqiptare(1848-1997)*, Tiranë, 1997, f. 85.

Burimet dhe literatura:

- *Dajti*, nr. 65, 12 shkurt, Tiranë, 1925.
- Eqber Skendi, *Hoxhë Kadriu,* Rilindja, Prishtinë, 1992.
- Hakif Bajrami, Dëbimi dhe shpërngulja e shqiptarëve në Turqi, SHKSHSHTV, Prishtinë, 1996.
- Hakif Bajrami, Komiteti Mbrojtja Kombëtare e Kosovës dhe qeveritë e Tiranës për krimet serbe ndaj shqiptarëve 1918-1924, Prishtinë, 2008.
- Hamit Boriçi, Një shekull e gjysmë publicistikë shqiptare (1848-1997), Tiranë, 1997.
- Hamit Boriçi-Mark Marku, Histori e shtypit shqiptarë nga fillimet deri në ditët tona, Shblu, Tiranë, 2010.
- Jahja Lutfullah, "Nekrologji", *Dajti,* nr. 65, 12 shkurt,Tiranë, 1925.
- Jup Kastrati, "Hoxha Kadriu-me rasën e 40-vjetorit të vdekjes", *Buletini shkencor*, nr. 3, IPDSH, Shkodër, 1965.
- Kastriot Dervishi, *Historia e Shtetit Shqiptar 1912-2005*, ShB, 55, Tiranë, 2006.
- Lush Culaj, Komiteti Mbrojtja Kombëtare e Kosovës 1918-1924, IAP, Prishtinë, 1997.
- Nevila Nika, "Hoxhë Kadri Prishtina-kryetar i Komitetit "Mbrojtja Kombëtare e Kosovës", *Komiteti Mbrojtja Kombëtare e Kosovës*, (Përmbledhje kumtesash), ASHSH, IH-Tiranë, IH-Prishtinë, f. 2004.
- Pal Doçi, *Hoxha Kadri Prishtina*, Geer, Tiranë, 2005.
- Qemajl Morina, *Hoxhë Kadri Prishtina - mendimtar islam,* DI, Prishtinë, 2000.

Nuridin AHMETI

NEW FACTS ABOUT HOXHE KADRI PRISHTINA

(Summary)

According to a considerable number of local scholars the Committe for the National Defence of Kosova, which was a national and political organization, was established in Shkodra in May 1918.

Since its establishment the Committee proclaimed its objective to liberate the Albanian lands under Yugoslav rule and their union with Albania. Among many distinguished personalities, Hoxhe Kadri Prishtina, who was a distinguished intellectual, theologian and publicist, was chosen its leader. Many papers have been written about Hoxhe Kadri Prishtina. Yet, we believe that there are still things to be said about this distinguished personality from our history.

نورالدين أحمدي

بعض المعلومات الحديثة حول الشيخ قدري بريشتينا

(خلاصة البحث)

يشير شهر مايو ١٩١٨، وفقا لجزء كبير من العلماء المحليين، إلى تأسيس منظمة وطنية وسياسية "اللجنة الوطنية للحماية في كوسوفا"، ومقرها في مدينة شكودرا.

منذ تأسيسها أوضحت هذه المنظمة أن أهدافها هي تحرير ما تبقى من الأراضي الألبانية في يوغوسلافيا آنذاك واتحادها مع ألبانيا.

ومن بين بعض الشخصيات في ذلك الوقت، لقيادة هذه المنظمة تم اختيار المثقف، الشيخ ، الدعاية الشيخ قدري بريشتينا.

حول هذه الشخصية، تم كتابة بعض المساهمات من قبل مختلف العلماء، وخاصة المحليين، والذين قدموا آراءهم حوله. لكننا نعتقد أنه لا تزال هناك بيانات تساعد على ملء سيرة هذه الشخصية الهامة في تاريخنا.

Mrika LIMANI

"PIRKEI AVOT" - Mësimet rabinike dhe hadithet e Pejgamberit a.s. nga këndvështrimi i studimeve krahasimtare

Abstrakt

Punimi shtjellon mësimet rabinike të periudhës mishnaike, të kapitullit të katërt të Pirkei Avot, të cilat përmbajnë analogji që synojnë të pasqyrojnë një jetesë të drejtë dhe të mirë të një besimtari hebre. Brenda këtij konteksti, mësimet rabinike të paraqitura në kapitullin e katërt, bëjnë thirrje për një jetë të thjeshtë dhe modeste, me përulësi, po në të njëjtën kohë duke ushqyer një adhurim të lartë për Zotin. Në këtë kontekst, meqë kapitulli është pothuajse i zhveshur nga konceptet teologjike, analogjitë midis ideve dhe koncepteve të paraqitura në këtë kapitull nuk është vështirë të tërhiqen mes haditheve të Pejgamberit a.s. - të cilat ngjashëm thërresin (grishin) për një jetë modeste. Punimi synon të shtjellojë para së gjithash kontekstin historik të përpilimit të këtij kapitulli, në të njëjtën kohë duke tërhequr paralele mes mësimeve rabinike dhe atyre islame kurdoherë që ato janë evidente.

Fjalët kyçe: *Pirkei Avot, mësimet rabinike, Mishnah, Islami, hadithet.*

Një grumbull traktatesh judaike, që në lexim të parë japin fare pak kontekst të asaj se çfarë po ndodh, të cilat definojnë madje dhe organizojnë jetën shoqërore dhe fetare judaike, quhen Mishnah dhe e përbëjnë Talmudin. Mishnah është e përbërë nga gjashtë urdhra që flasin për aspekte të ndryshme jetësore, të cilat qasen në tematika të përditshme e dilema morale-etike, që synojnë të ndihmojnë besimtarin e thjeshtë të jetojë një jetë të drejtë. Mishnah paraqet traditat dhe ligjet gojore judaike (apo Tora-s gojore), të cilat sipas disa mësimeve judaike, besohet se iu dhanë Moisiut në Malin e Sinait së bashku me Tora-n[1] e shkruar,[2] të cilat në rrezik të shuarjes u shkruan - si pasojë e persekutimeve të cilave iu nënshtruan farisenjtë gjatë Periudhës së Dytë të Tempullit, që pësoi apeksin me shkatërrimin e Tempullit të Dytë në Jerusalem në vitin 70 (536 p.e.s - 70 e.s.) - por të cilat nuk u përmblodhën në një kompilim tekstual të plotë deri në vitin 217 nga rabini Yehudan HaNasi, shkruar në gjuhën e cila është folur pas periudhës biblike.[3]

Vetë ekzistenca në shkrim e ligjeve mishnaike si përgjigje ndaj shtypjes dhe përndjekjes, jep kontekst të mjaftueshëm historik rreth gjendjes së farisenjve në Tokën e Shenjtë[4] - e mëtutje shpjegon edhe një hap tjetër të zhvillimit të shoqërisë judaike. Mishnah paraqet një kapërcim traditash edhe në një aspekt tjetër adaptimin e narrativës kronologjike në bazë të tematikës, e cila gjithashtu shënon pikën historike ku feja judaike po përjetonte një krizë.[5] Përkundër Midrash-it që i paraprin Mishnah e që ndjekë kronologjinë biblike - shpeshherë akronike, por edhe atematike - Mishnah në përgjithësi paraqitet si tekst më i koordinuar. Mishnah së bashku me Gemara përbëjnë Talmudin, ku Gemara është komentimi dhe analiza mbi Mishnah. Ekzistojnë dy forma të Gemara-s, ai i përpiluar në Tokën e Shenjtë gjatë viteve 350-400, dhe ai në Babiloni gjatë viteve

[1] Me fjalën Tora, nënkuptohet emërtimi kuranor Tevrat-in (Shënim yni, M.L)

[2] Lawrence H. Schiffman, *From Text to Tradition: A History of Second Temple and Rabbinic Judaism* (Hoboken, N.J.: Ktav Pub. House, 1991), 179.

[3] David Prebor, "The Restricted Semantic Field of Property in Mishnaic Hebrew," *Journal of Semitic Studies* 58, no. 1 (April 1, 2013): 116–51, doi:10.1093/jss/fgs037.

[4] Schiffman, *From Text to Tradition: A History of Second Temple and Rabbinic Judaism*, 194.

[5] Peter Ortag, *Jüdische Kultur Und Geschicte. Ein Überblick* (Brandenburgische Landeszentrale für politische Bildung, 2003), 20.

500. Si pasojë, ekzistojnë dy Talmude - Talmudi Judaik[6] dhe Talmudi Babilonian.[7] Në të dy rastet Gemara paraqitet si komentim dhe në këtë kontekst jo si autoritet fetar. Mishnah njëkohësisht konsiderohet baza e literaturës rabinike.[8]

Në këtë rast, qendra e analizës sonë është *Pirkei Avot*. Kjo nuk është pjesë e Tora-s së shkruar, por përmbledhje mendimesh, thëniesh dhe ligjëratash të rabinëve, të cilët ishin përgjegjës për vendosjen në shkrim të ligjit të pasuar në mënyrë gojore. Në këtë kontekst, Mishnah ka autoritet sekondar krahas Tora-s. Si pasojë, kapitujt na japin një pikëpamje më të relaksuar të mendimeve që kishin këta rabinë, dhe mbi të gjitha arsyetimin për ligjet mishanike, të cilat mësohen dhe ndiqen nga praktikuesit e judaizmit edhe sot.

Fjala Avot ka kuptimin e 'etërve', andaj *Pirkei Avot* do të thotë 'Kapitujt e Etërve' ose 'Kapitujt e principeve bazike'. Pirkei Avot është një grumbullim i mësimeve etike dhe maksimave të lëna nga rabinët e periudhës Mishnaike. Termi *Mishnah* i referohet ligjit judaik të pasuar në mënyrë gojore ndërmjet gjeneratave, kundrejt Tora-s, që ndryshe njihet si ligji Moisanik.[9] Në këtë kontekst, ligjet mishnaike plotësojnë ligjet e shkruara. Pirkei Avot është në përbërje të gjashtë urdhëresave të Mishnah, e cila bën pjesë në urdhërin e Nezikinit - urdhrin e katërt.[10]

Mësimet e rabinëve mishnaikë janë karakteristike ngaqë në vete përmbajnë elemente ligjëratash që në botëkuptimin e sotëm mund të konsiderohen shekullare. E rikujtojmë këtu mësimin e rabinit Shammai dhe

[6] Schiffman, *From Text to Tradition: A History of Second Temple and Rabbinic Judaism*, 227.
[7] Ibid., 231.
[8] Prebor, "The Restricted Semantic Field of Property in Mishnaic Hebrew," 45.
[9] Në këtë kontekst duhet të theksohet që Libri i Shenjtë i besimtarëve judaikë është *TaNaKh,* një akronim i tri grupeve të teksteve që e përbëjnë atë: Torah, Neviim, dhe Ketuvim. Pirkei Avot nuk është libër i shenjtë, por pasqyron traditën dhe mësimet hebreje të pasuar në mënyrë gojore përgjatë gjeneratave krahas Biblës Hebraike, të cilat u vendosën në shkrim, ose ndryshe që njihet si Torah Orale. Herbert Danby, *The Mishnah: Translated from the Hebrew with Introduction and Brief Explanatory Notes* (Peabody, Mass.: Hendrickson Publishers, 2011), 17.
[10] Ibid., 22.

Hillel,[11] kur një johebre kishte shkuar për të pyetur të parin t'ia mësojë të gjithë Tora-n brenda kohës sa ai mund të qëndrojë me një këmbë. I revoltuar nga një kërkesë qesharake, rabini Shammai e kishte larguar duke e ndjekur me një shkop. I njëjti johebre kishte shkuar te rabini Hillel për ta pyetur për të njëjtën gjë, e ky i dyti i ishte përgjigjur: "Çfarë urren ti, mos ua bëj të tjerëve. Kjo është e tërë Tora, të tjerat janë vetëm komente".[12] Në këtë rast është evidente filozofia gjithëpërfshirëse e shkollës së Hillelit, e cila duket të jetë prezente përgjatë gjithë ligjeve rabinike mishnaike, që përpos të tjerave, flet shumë edhe për rrethanat politike dhe shoqërore të periudhës kur ligjet në fjalë filluan të shkruhen.[13] Mësimet e Hillelit në tërësi karakterizohen nga përmbajtja paqësore.[14]

Një aspekt tjetër interesant që shfaqet gjatë leximit të Pirkei Avot janë ngjashmëritë e qasjeve jetësore e fetare judaike me ato islame. Këto ngjashmëri shfaqen posaçërisht në kontekstin e ligjeve dhe traditave, ku të dy fetë abrahamike ndjekin rregulla me rigorozitet pothuaj të ngjashëm, temë kjo e cila është qendrore sa i përket përmbajtjes së Mishnah. Kjo është një temë mbi të cilën shumë studiues të religjioneve pajtohen, dhe madje ishte njëra ndër tematikat me interes e studimeve të sefardikut që veproi në Egjipt e Spanjë, i njohur si Moshe ben Maimon (1135-1204), emri i latinizuar i së cilit është Maimonides, i cili edhe sot konsiderohet

[11] Shkollat e Hillelit dhe Shammai konsiderohen si dy rryma të mendimit të kundërta të mësimit mishanik, që i përkojnë periudhës prej shekullit të I-rë p.e.s. deri në shekullin e I-rë të erës sonë. Ekzistojnë gjithsej 316 çështje mbi të cilat shkollat në fjalë kanë debatuar, kështu duke e krijuar edhe ndasinë e ligjeve judaike nga një në dy. Shih Isaak Markus. Jost, *Geschichte des Judenthums und seiner Sekten 3 3* (Leipzig: Dörffling und Franke, 1859), 262-70. Njëra prej debateve kryesore në mes të dy shkollave është çështja e së vërtetës, ku qasja e shkollës së Hillelit ishte: 'Gënjeshtra nuk është kurrë e lejuar, përpos për të vënë paqe midis dy njerëzve'. Shih Yitzhak. Buxbaum, *The Life and Teachings of Hillel* (Northvale, N.J.: Jason Aronson, 1994), 84.

[12] Hilleli njihet për çështjen e aplikimit të së ashtuquajturës Rregullës së Artë. Buxbaum, *The Life and Teachings of Hillel*, 96–100.

[13] Mësimet e rabinëve Hillel, Shammai dhe Yochanan Ben Zakai janë qendrore në kapitullin e dytë të Pirkei Avot. Shih Danby, *The Mishnah: Translated from the Hebrew with Introduction and Brief Explanatory Notes*, 447–49.

[14] Buxbaum, *The Life and Teachings of Hillel*, 78.

figurë qendrore e studimeve hebraike.[15] Shkrimet e Miamonides dallojnë nga ato teologjike, të natyrës kabalistike, komentime mbi etikën dhe shtyllat e besimit judaik, deri te publikimet me përmbajtje mjekësore. Me relavancë për diskutimin tonë është komentimi i Maimonides për Pirkei Avot, gjegjësisht *Shemonah Perakim*, ku autori i dha një kahje më filozofike interpretimit të Tora-s gojore, me ndikime të dallueshme orientale.[16] Qasja e Maimonides ndryshoi botëkuptimin tradicional për Mishnah, duke e shndërruar atë një objekt studimi më të thellë filozofik, krahas atij të ngurtit ligjor, që i dha shtysë studimeve laike dhe moderne për Tora-n gojore.

Kapitulli i katërt i Pirkei Avot është zgjedhur si pikënisje për këtë studim dhe kjo për disa arsye: Kapitulli është pothuajse plotësisht i zhveshur nga aspekte të natyrës teologjike dhe është më tepër i përqendruar te aspektet etike dhe mësimet për jetesë të mbarë siç janë ligjëruar nga rabinët mishnaikë. Vlerësojmë se me të drejtë dhe në mënyrë të qëllimshme, analiza në vijim është plotësisht e reduktuar nga debatet e natyrës teologjike që shfaqen sa herë vijnë në diskutim konceptet teologjike të religjioneve abrahamike. Arsyeja e dytë pse ky kapitull është marrë si pikënisje studimi, është ngaqë përgjatë leximit të tij ka qenë e pamundur të mos vrojtohen ngjashmëritë midis disa koncepteve të pranishme në Pirkei Avot dhe disa mësimeve islame të paraqitura në hadithe. Në anën tjetër, jemi shumë të vetëdijshëm që paralelet e tërhequra mund të perceptohen si anekdotike, por gjithashtu duhet të theksohet se i qëndrojmë besnikë një fryme pozitive të studimeve ndërfetare,[17] e në bazë të të cilave i parashtrojmë vrojtimet tona modeste sa i përket kapitullit të katërt të Pirkei Avot. Gjithashtu jemi të vëmendshëm që analiza në fjalë merr si material

[15] Në lidhje me interpretimin e Mishnah, Maimonidesi kishte përpiluar *Mishneh Tora*, vepër e cila edhe sot konsiderohet relevante me komentet rreth Tora-s. Shih Moses. Maimonides, *The Mishneh Tora 1. 1.* (Jerusalem [u.a.]: Feldheim, 1974).

[16] Moses Maimonides, Leonard S. Kravitz, and Kerry M. Olitzky, *Shemonah perakim: A treatise on the soul* (New York, N.Y.: UAHC Press, 1999).

[17] Një publikim i bërë pas 11 shtatorit të 2001, që shërbeu pjesërisht si frymëzim për këtë punim, i cili jep këtë frymë të ngjashme në diskurset akademike ndërfetare, që mbështet dialogun dhe bisedimet për cytjen e marrëdhënieve paqësore midis islamit dhe judaizmit ishte ai i Bradford E. Hinze and Irfan A. Omar, *Heirs of Abraham: The Future of Muslim, Jewish, and Christian Relations* (Maryknoll, N.Y.: Orbis Books, 2005).

studimi një pjesë tejet të shkurtër të Mishnah, gjë e cila edhe më tutje e redukton analizën brenda kornizave të ngushta të studimit.

Kapitulli i katërt i Pirkei Avot

Vargjet e paraqitura më poshtë bëjnë pjesë në kapitullin e katërt të Pirkei Avot, vargje të cilat janë të përkthyera nga gjuha angleze, bazuar në Mishnah, përkthyer nga Herbert Dernby nga hebraishtja.

1. Ben Zoma thotë: Kush është i urti? Ai që mëson nga të gjithë njerëzit, siç thuhet, "Kam marrë njohuri nga të gjithë mësuesit e mi" (Psalmet 119:99). Kush është i fuqishmi? Ai që mposht impulsin e tij, siç thuhet, "ngadalësia krahas hidhërimit është më i mirë se një njeri i fuqishëm dhe se sundimtari i shpirtit është më i mirë se pushtuesi i një qytetit." (Fjalët e Urta 16:32). Kush është i pasuri? Ai që është i lumtur me atë çfarë ka, siç thuhet, "Kur ushqehesh prej punës së duarve, do të jesh i lumtur, dhe çdo gjë do të jetë në rregull me ty" (Psalmet 128:2). "Do të jesh i lumtur" në këtë botë, dhe "çdo gjë do të jetë në rregull me ty" në botën që do të vijë. Kush është i nderuar? Ai që i nderon qeniet e krijuara, siç thuhet, "Për ata që më nderojnë Mua, do t'i nderoj; për ata që më urrejnë Mua, nuk do të kem konsideratë të lartë".[18]
2. Ben Azai thotë: "Shko të kryesh një urdhëresë të lehtë para se ta bësh të vështirën, dhe largohu nga mëkati; meqë një urdhëresë të çon te tjetra, e mëkati të çon të mëkati tjetër; meqë shpërblimi për një urdhëresë është urdhëresa tjetër, e shpërblimi për një mëkat është mëkati tjetër."[19]
3. Ai do të thotë: "Mos e ul vetën më, dhe mos iu shmang asgjëje. Sepse nuk ka njeri të cilit ora nuk do t'i vijë, e nuk ka gjësend që nuk e ka vendin e vet."[20]
4. Rabini Levitas, një njeri i Yavnehit, thotë: "Të jesh shumë, shumë i thjeshtë në shpirt, sepse shpresa e njeriut janë krimbat". Rabini

[18] Danby, *The Mishnah: Translated from the Hebrew with Introduction and Brief Explanatory Notes*, 453.
[19] Ibid.
[20] Ibid.

Yochanan ben Beroka thotë: "Kushdo që përdhos Emrin e Qiellit në fshehtësi, ata do ta ndëshkojnë haptazi. Nuk ka dallim midis së paqëllimshmes dhe së qëllimshmes kur vjen fjala te përdhosja e Emrit."[21]

5. Rabini Yishmael, i biri, thotë: "Atij që studion Tora-n në mënyrë që t'ua mësojë të tjerëve, do t'i jepet mundësia edhe të studiojë po edhe të mësojë. Atij që mëson që ta praktikojë atë, do t'i jepet mundësia ta studiojë, ta mësojë, ta vëzhgojë dhe ta praktikojë. Rabini Tzadok thotë: Mos e bëni (fjala është për Tora-n) kurorë për ta ngritur veten, po as shtizë për të vrarë të tjerët. E kështu Hillel thoshte: Ai që e vë në përdorim kurorën e pason atë tutje. Këtu e mësoni që kushdo që përfiton nga fjalët e Tora-s e largon veten nga kjo botë."[22]

Një paralele karakteristike e tërheqim nga hadithi që thotë: 'I Dërguari i Allahut (bekimet e Allahut qofshin me të dhe familjen e tij) ka thënë: *'Më i miri nga ju është ai që mëson Kuranin dhe ua mëson të tjerëve'*. Këtu vërehet qasja e njëjtë kur është fjala për leximin e Librave të Shenjtë dhe rëndësinë e tyre qendrore në jetën e një besimtari.[23]

1. Rabini Yosi[24] thotë: "Kushdo që e nderon Tora-n - trupi i tij do të nderohet nga të gjitha qeniet e krijuara. Kushdo që e përdhos Tora-n, trupi i tij do të përdhoset nga të gjitha qeniet e krijuara."[25]
2. Rabini Yishmael, i biri, thotë: "Ai që e përmban veten nga gjykimi - e largon veten nga hasmëria, vjedhja, dhe betimi i rrejshëm. Ai që është i pavëmendshëm kur jep gjykime ligjore është i paditur, i lig, dhe mendjemadh në shpirt."[26]

[21] Ibid.
[22] Ibid.
[23] Sahih Buhari, Al-Amali nga Shaykh at-Tusi, Vëllimi I-rë, 5.
[24] Viti 140-65 p.e.s.
[25] Danby, *The Mishnah: Translated from the Hebrew with Introduction and Brief Explanatory Notes*, 453.
[26] Ibid., 454.

Një ngjashmëri filozofie e rrymës së Hillelit e hasim sërish te hadithet e përmbledhura nga Buhariu, ku shkruan:

'(...) e kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut teksa thotë: "Gjërat e ligjshme (hallall) dhe të paligjshme (haram) janë të qarta, mirëpo midis tyre ka gjëra të dyshimta për të cilat shumë njerëz pak dinë. Kështu që, kushdo që e kursen veten nga këto dyshime e shpëton besimin e tij dhe nderin e tij. Dhe kushdo që zhytet në këto dyshime, është si bariu që i çon gjënë e tij te kullotat e tjetërkujt". (...) "Të jeni të vëmendshëm! Ka një pjesë trupi e cila po që se shndërrohet në të mirë, i gjithë trupi do të shndërrohet në të mirë, por nëse prishet, i gjithë trupi prishet e ajo është zemra."[27]

1. Ai do të thoshte: "Mos gjykoni veçmas, sepse s'ka gjykatës të vetëm përpos Njërit (Zotit). Dhe mos thoni, 'Pranoni mendimin tim', sepse ato janë të lejuara e jo ti.[28]
2. Rabini Yonatan thotë: Kushdo që përfshin Tora-n kur është në varfëri, fundi i tij do të jetë i pasur. Kushdo që e shpërfill Tora-n në pasuri, fundi i tij do të jetë i varfër."[29]
3. Rabini Meir thotë: "Zvogëlo tregtinë dhe angazhohu në Tora-n. Të jesh i thjeshtë në shpirt para të gjithëve. Nëse e shpërfill Tora-n, shumë arsye për ta shpërfillur do të paraqiten tek ti (është fjala për mallkim). E, nëse punon në Tora (nënkuptohet sipas fjalës së Zotit) do të ketë shpërblim të majmë për ty."[30]
4. Rabini Eliezer ben Yaakov thotë: "Atij që e kryen vetëm edhe një urdhëresë të vetme i duhet vetëm një mbrojtës. Atij që kryen një mëkat të vetëm i duhet vetëm një paditës. Pendesa dhe veprat e mira janë sikur një mburojë kundrejt ndëshkimit. Rabini Yochanan këpucëtari thotë: Çdo mbledhje që bëhet për Qiellin, fundi do ta ketë të përjetshëm. Dhe çdo mbledhje që nuk bëhet për hir të Qiellit, fundin nuk e ka larg."[31]

---

[27] Sahih Buhari, An-Numan bin Bashir, Vëllimi 1, Libri 2, numër 49.

[28] Danby, *The Mishnah: Translated from the Hebrew with Introduction and Brief Explanatory Notes*, 454.

[29] Ibid.

[30] Ibid.

[31] Ibid.

Edhe pse me një gjuhë më pak të drejtpërdrejtë kur jemi te çështja e trajtimit të mëkateve në kuptimin e shpagimit ose ndëshkimit për to, e vërejmë një karakteristikë sa u përket mësimeve rabinike kur bie fjala te përmbushja e urdhëresave hyjnore dhe se si përmbushja e të paktën një të tille do t'i sigurojë mëkatuesit mbrojtje. Në anën tjetër, te hadithi që do ta citojmë më poshtë, edhe pse i përkthyer pjesërisht, e shohim të njëjtën filozofi sa i përket ndëshkimit - të dy vargjet theksojnë kufizimin e gjykimit njerëzor dhe e vënë atë peshë mbi Zotin.

(…) I Dërguari shtoi tutje: *"Kushdo prej jush që e përmbush betimin e tij, do të shpërblehet nga Allahu. E kushdo tjetër që mëkaton dhe e merr ndëshkimin në këtë botë, do t'i shlyhet mëkati. Dhe nëse ai bën mëkat, dhe Allahu ia mbulon atë, atëherë është e Tij nëse do ta gjykojë për atë mëkat. (…)*[32]

1. Rabini Elazar ben Shamua thotë: "Le të jetë nderi i nxënësit tënd i dashur për ty aq sa nderi yt, dhe nderi i mikut tënd si përkulja e mësuesit tënd, dhe përkulja e mësuesit tënd si përkulja e Qiellit."[33]
2. Rabini Judah do të thoshte: "Të jesh i kujdesshëm me mësimet e tua, sepse një gabim në mësim është i barabartë me një shkelje urdhërese të qëllimshme. Rabini Shimon do të thoshte: Ekzistojnë tri kurora - Kurora e Tora-s, kurora e grixhës[34] dhe kurora e sundimit - por kurora e emrit të mirë është mbi të gjitha."[35]
3. Rabini Nehorai do të thoshte: "Shpërngulu nëse duhet për Tora-n; mos thuaj se do të përndjek, apo se miqtë e tu do të ndihmojnë ta rikthesh. Mos u mbështet në botëkuptimet e tua."[36]

Një paralele tjetër që synojmë ta tërheqim këtu është theksi i veçantë që i vihet mësimit komunal. Edhe pse hadithi në vijim parashtron nevojën

[32] Sahih Buhari, Ubada bin As-Samit, Vëllimi I, Libri 2, numër 17.

[33] Danby, *The Mishnah: Translated from the Hebrew with Introduction and Brief Explanatory Notes*, 454.

[34] Në tekstin në gjuhë angleze fjala e përdorur është 'priesthood', por është përkthyer me fjalën grixhë për të nënkuptuar përgjegjësinë fetare më tepër sesa si identifikues klerik.

[35] Danby, *The Mishnah: Translated from the Hebrew with Introduction and Brief Explanatory Notes*, 454.

[36] Ibid.

më kuintesenciale për të ndjekur Zotin, krahas vargut të 14-të ku theks i vihet Toras, analogjia mbështetet te udhëheqësia komunale që synon të forcojë grupin respektiv besimtar.[37] Një tjetër aspekt interesant që parashtrojnë si vargu i mësipërm, po edhe hadithi i mëposhtëm, është theksi që i vihet ushqyerjes së besimit - leximi i Tora-s në vetvete është ritualistik, siç është ngjashëm dhe besimi dhe falja te Allahu.

(…) "Mos i shpërfill fjalët e Allahut dhe mos kërko udhëzim nga askush tjetër përpos Tij, se atëherë padyshim se do humbësh rrugën."[38]

Një tjetër ngjashmëri e hasim te vargu i 15-të i kapitullit të 4-të i Pirkei Avot dhe në hadithet e mbledhura nga Buhariu, ku Abdullah bin Amr tregon për të Dërguarin a.s.:

Një person e pyeti të Dërguarin e Allahut: Çfarë vepra brenda Islamit e bëjnë atë të mirë? Ai iu përgjigj: *'Të ushqesh të varfrit dhe të përshëndesësh ata të cilët i njeh, por edhe ata të cilët nuk i njeh.*[39]

1. Rabini Yannai do të thoshte: "Ne nuk kemi mirëkuptim për qetësinë e të ligjve, por as për vuajtjet e të mirëve.

Rabini Matya, i biri i Charash-it, do të thoshte: Ta përshëndetësh i pari çdo njeri. Bëhu bisht i luanëve, më mirë se të bëhesh koka e dhelprave."[40]

Edhe pse shumë kundërthënës, mesazhi i rabinit Yannai flet për durimin gjatë vështirësive si një proces nëpër të cilin çdo besimtar duhet të kalojë. Në këtë kontekst e krahasojmë edhe hadithin e shkurtë, por kuptimplotë të transmetuar nga Ebu Hurejra:

'Nëse Allahu ka qëllime të mira për dikë, atëherë Ai do ta sprovojë atë.'[41]

---

[37] Sa i përkët rëndësisë qendrore që i vihej mësimit të Tora-s në periudhën mishnaike, vërtetojnë edhe mësimet rabinike gjatë kësaj periudhe. Madje ka edhe vlerësime të tilla që thonë se mësimi i Tora-s ishte prioritar krahas përkushtimit ndaj familjes sipas Talmudit. Për më tepër shih Alan J. Avery-Peck and Jacob Neusner, *The Mishnah in Contemporary Perspective*, 2006, 258.

[38] Sahihu-l Buhari, Uyun Akhbar ar-Ridha, Vëllimi II, faqe 57.

[39] Sahihu-l Buhari, Abdullah bin'Amr, Vëllimi I, Libri 2, numër 27.

[40] Danby, *The Mishnah: Translated from the Hebrew with Introduction and Brief Explanatory Notes*, 454.

[41] Sahihu-l Buhari, Abu Huraira, numër 5321.

Dy vargjet e Pirkei Avot që pasojnë kanë në fokus çështjen e jetës përtej vdekjes, ngjashmëri universale për fetë monoteiste në një formë a tjetër, të cilat në këtë aspekt nuk mëtojnë më shumë shpjegim.

1. Rabini Yaakov do të thoshte: "Kjo botë është e krahasueshme me paradhomën e Botës që do të vijë. Bëhu gati në paradhomë, në mënyrë që të hysh në dhomën e ballove.[42]
2. Ai gjithashtu thoshte: "Një moment i vetëm i pendesës dhe veprave të mira në këtë botë është më e madhe se e gjithë Bota që do të vijë. Dhe një çast bekimi në Botën që do të vijë është më i madh se e krejt bota e tanishme."[43]

Një ngjashmëri me dy vargjet pasuese të Pirkei Avot e hasim te hadithi i transmetuar nga Tirmidhiu:

"Mos shpreh kënaqësi në fatkeqësinë e vëllait tënd, sepse Allahu do të shfaqë mirësi mbi të e fatkeqësi mbi ty."[44]

1. Rabini Shimon, i biri i Elazarit,[45] do të thoshte: "Mos e merr me të mirë shokun në kulm të hidhërimit të tij; mos e ngushëllo përderisa nuk e ka përfunduar veprën e tij; mos e pyet për betimin në çast kur e bën atë; dhe mos lakmo ta shohësh atë në çast të rënies së tij."[46]
2. Samueli i Riu[47] do të thoshte: "Kur armiku yt bie, mos u gëzo; kur ngec, mos e lejo zemrën të të gëzohet. Sepse Zoti sheh dhe sytë e Tij nuk do të kënaqen e Ai do ta drejtojë hidhërimin e Tij nga ti." (Fjalët e Urta 24:17-18)[48]

---

[42] Danby, *The Mishnah: Translated from the Hebrew with Introduction and Brief Explanatory Notes*, 454.

[43] Ibid.

[44] Sunen et-Tirmidhij, 4/662.

[45] Fundi i shekullit të II-të.

[46] Danby, *The Mishnah: Translated from the Hebrew with Introduction and Brief Explanatory Notes*, 455.

[47] Fundi i shekullit të I-rë.

[48] Danby, *The Mishnah: Translated from the Hebrew with Introduction and Brief Explanatory Notes*, 455.

Tri vargjet pasuese të kapitullit të katërt të Pirkei Avot, në mënyrë shumë të drejtpërdrejtë flasin për rëndësinë thelbësore të mësimit të Tora-s si një akt ritualistik por edhe definues për devotshmërinë e një besimtari.

1. Elisha, i biri i Avuyah-it,[49] do të thoshte: "Ai që e mëson Tora-n në fëmijëri, me çfarë mund të krahasohet? Me ngjyrën e shkruar në fletë të re. Ai që e mëson Tora-n në moshë të thyer, me çfarë mund të krahasohet? Me ngjyrën e shkruar në fletë të fshirë. (Ku janë fshirë shkrimet) Rabini Yossei, i biri i Judaf nga Kfar Habavli, do të thoshte: Ai që e mëson Tora-n nga të rinjtë, me çfarë është i krahasueshëm? Me atë që ushqehet me rrush të papjekur dhe me atë që pi verë të pafermentuar. Ai që mëson Tora-n nga të vjetrit, me çfarë është i krahasueshëm? Me atë që ushqehet me rrush të pjekur dhe që pi verë të vjetruar. Rabini Meir tha: Mos e këqyr anijen, por atë çfarë përmban ajo. Ka anije të reja që janë të mbushura me verë të vjetër dhe anije të vjetra që nuk kanë as verë të re."[50]
2. Rabini Elazar HaKapor[51] do të thoshte: Lakmia, epshi dhe nderi e çojnë njeriun nga kjo botë.[52]
3. Ai gjithashtu do të thoshte: "Ata që lindin do të vdesin dhe të vdekurit do të jetojnë. Të gjallët do të gjykohen, do të mësojnë, do të kuptojnë që Ai është Zoti, Ai është i pari, Ai është krijuesi, Ai është kuptuesi, Ai është gjykuesi, Ai është dëshmitari, Ai është arbitri, Ai do të gjykojë. I bekuar është Ai, se para Tij nuk ka të këqija, nuk ka harresa, nuk ka preferenca, as ryshfete; ta dish se çdo gjë është e përllogaritur. Mos të të bindë zemra se varri është shpëtimi yt, sepse kundër vullnetit tënd, ti je krijuar; kundër vullnetit tënd, ti do të jetosh; kundër vullnetit tënd, ti do të vdesësh, dhe kundër vullnetit tënd, je i caktuar të kallëzosh para mbretit, mbretit të mbretërve, të Shenjtit, qoftë i bekuar Ai."[53]

---

[49] Viti 90-150.

[50] Danby, *The Mishnah: Translated from the Hebrew with Introduction and Brief Explanatory Notes*, 455.

[51] Bashkëkohanik i Juda Patriarkut.

[52] Danby, *The Mishnah: Translated from the Hebrew with Introduction and Brief Explanatory Notes*, 455.

[53] Ibid.

Vargu përmbyllës i kapitullit të katërt të Pirkei Avot pa dyshim përmban natyrën më mistike po edhe teologjike të të gjithë kapitullit, i cili në kombinim me kapitujt e tjerë të Pirkei Avot nuk duket aspak anakronik, meqë qëllimi përmbyllës i kapitujve është i atillë që të vërë theksin te koncepti i besimit monoteistik.

Vargjet e paraqitura më sipër qartësojnë qasjen parabolike të rabinëve në ilustrimin e situatave apo rrethanave në atë mënyrë që të përçojnë kuptimin më mirë te besimtarët judaikë. Kjo metodë e shkrimit është karakteristike për shkrimet rabinike të Mishnah, por edhe për ato *Midrash,* stil ky që quhet dhe *mashal.*[54] Këto pjesë të Mishnah janë posaçërisht interesante për studiuesit e hebraizmit, sepse në mënyrë të drejtpërdrejtë flasin për zhvillimin e mendësisë kulturore, shoqërore, dhe mendësisë etike hebraike përgjatë shekujve - e në veçanti gjatë periudhës së përkufizimit së identitetit hebraik. Si e tillë, Mishnah ka shërbyer në mënyrë aktive për t'i mbrojtur dhe ruajtur traditat hebraike, të cilat tradita në mënyrë fluide kanë marrë, por edhe i kanë dhënë kulturës botërore, qoftë bashkëkohanike, por qoftë edhe asaj të hershme. Në vazhdën e këtyre vrojtimeve, gjithashtu është vërejtur një filozofi e përbashkët etike-shoqërore, e cila i ka përcjellë zhvillimet e feve monoteiste për t'u kalitur dhe definuar në identitete fetare më vonë, përballë ngjarjeve dhe situatave historike.

[54] Për më tepër shih David Stern, *Parables in Midrash: Narrative and Exegesis in Rabbinic Literature* (Cambridge, Mass.: Harvard University Press, 1991).

Mrika LIMANI

'PIRKEI AVOT' – RABBINIC TEACHINGS AND THE HADITHS OF THE PROPHET – A COMPARATIVE STUDY

(Summary)

This paper analyses the rabbinic teachings during the Mishnaic period from the 4th chapter of the Pirkei Avot (Ethics of the Fathers). These teachings call for a simple and modest life, humbleness, while nurturing high admiration for God. Within this context, since this chapter is almost totally free of theological concepts, it is not difficult to find analogies between the concepts and ideas presented in it and the hadiths of the prophet, which similarly call for a simple life.

The paper tries to provide the historical context of this chapter by drawing paralells between rabbinic and Islamic teachings whenever they are evident.

مريكا ليماني

بيركاي آفوت – التعاليم الحاخامية اليهودية وأحاديث الرسول صلى الله عليه وسلم من منظور دراسة مقارنة

(خلاصة البحث)

تشرح الورقة الدروس الحاخامية في الفترة المشناقية للفصل الرابع من "بيركاي أفوت" ، والتي تحتوي على مقارنات تهدف إلى إظهار حياة عادلة وحميدة لمؤمن يهودي. في هذا السياق ، تدعو التعاليم الحاخامية الواردة في الفصل الرابع إلى حياة بسيطة ومتواضعة ، بكل تواضع ، بينما تغذي في نفس الوقت عبادة عالية لله. في هذا السياق ، بما أن الفصل خالي من تقريبًا من المفاهيم اللاهوتية ، فإن المقارنة بين الأفكار والمفاهيم الواردة في هذا الفصل ليست صعبة بين أحاديث النبي صلى الله عليه وسلم. – التي تدعو بالمثل لحياة متواضعة. تسعى الورقة إلى صياغة السياق التاريخي لتجميع هذا الفصل أولاً وقبل كل شيء ، وفي نفس الوقت رسم متوازي بين التعاليم الحاخامية والإسلامية ، كلما كانت واضحة.

Besnik JAHA

UTOPIA DHE FEJA
(Ndikimi i fesë në letërsi)

Abstrakt

Utopia është një fenomen, që fillimisht ka nisur me krijimin e neologjizmit nga fjala greke *topos,* duke ia shtuar një *u* para, për t'u bërë *u-topos*, e që ka kuptimin e një vendi, shoqërie a komuniteti që kanë cilësi të përsosura dhe, me një fjalë, janë shoqëri ideale, por që, në fund të fundit, nuk ekziston.

Është pikërisht elementi i mosekzistencës që utopinë e lë në hapësirën e mendimit, fiksionit e imagjinatës. Prandaj, nëse jo në realitet, në fiksionalitet utopia e ka gjetur mjaft mirë vendin e saj, edhe pse burimin e ka nga religjioni.

Mirëpo, meqë kemi një numër të madh religjionesh, dhe secili dallon nga tjetri, edhe utopitë fetare dallojnë. Prandaj, mbi bazë të kuantitetit dhe karakteristikave të veçanta të secilit besim, utopitë fetare mund të jetë dy llojesh: Intra-fetare (brenda-fetare), dhe; Ndër-fetare (ndërmjet feve).

Fjalët kyçe: *utopi, letërsi, fe, distopi, shoqëri, reale, fiksionale.*

Utopia

Derisa *topos*[1] në greqisht ka kuptimin e një *vendi*, përkatësisht vendi që ekziston, *u-topos* na mbetet e kundërta, pra vendi që nuk ekziston.

Utopia është një fenomen, që fillimisht ka nisur me krijimin e neologjizmit nga fjala greke *topos*, duke ia shtuar një *u* para, për t'u bërë *u-topos,* e që ka kuptimin e një vendi, shoqërie a komuniteti që kanë cilësi të përsosura dhe, me një fjalë, janë shoqëri ideale, por që, në fund të fundit, nuk ekziston. Mirëpo, me kalimin e kohës kuptimi i utopisë është ngushtuar, dhe tani si term zakonisht përshkruan një shoqëri joekzistente.

Është pikërisht elementi i mosekzistencës që utopinë e lë në hapësirën e mendimit, fiksionit e imagjinatës. Prandaj, nëse jo në realitet, në fiksionalitet utopia e ka gjetur mjaft mirë vendin e saj, edhe pse burimin e ka nga religjioni.

Utopia[2] e Tomas Morit (Thomas More), vepra fundamentale e kësaj forme të mendimit, është një vepër fiksionale dhe e filozofisë politike, e që në letërsi edhe bëhet formë e shkrimit që flet për shoqërinë ideale.

Sipas Fehmi Aganit, *me titullin e veprës së vet, Mori i dha emrin jo vetëm një gjinie të literaturës, por edhe një qëndrimi politik dhe një drejtimi të teorive, të njohur me emrin e utopisë dhe të utopizmit, dhe të diskualifikuar shpesh, edhe pa të drejtë, si një gjë ireale dhe e parealizueshme*[3]*.*

Vepra e Tomas Morit mbetet pika themelore e mbështetjes dhe e hetimit të fenomenit, ani që ky fenomen do të shfaqet i tejkohshëm, duke shkuar kah e kaluara dhe kah e tashmja; të gjitha vendeve.[4]

Madje, Mori *u-topinë* e quan edhe *eu-topia* (që ka kuptimin vend i mirë), e që i vë në garë neologjizmat:

- *u-topia* - vendi që nuk është, dhe;
- *eu-topia* - vendi i mirë.

---

[1] *Topos* (τόπος, greqisht "vend", nga *tópos koinós*, vend i përbashkët).

[2] Vepra "Utopia" e Tomas Morit është botuar në vitin 1516 në latinisht. Është një tregim që përshkruan një shoqëri imagjinare, që jeton në një ishull dhe respekton zakonet e veta fetare, sociale dhe politike.

[3] Tomas Mori, *"Utopia",* Rilindja, Prishtinë, 1978, f. 22.

[4] Sabri Hamiti, "Utopia letrare", ASHAK, Prishtinë, 2013, f. 17.

Kështu që kjo, në njëfarë forme, është edhe një konstatim i ekzistencës ose jo të fenomenit: *eu-topia u-topia - vendi i mirë nuk është askund.* Nga ky bashkim fjalësh krijohet edhe koncepti se një vend i tillë nuk ekziston askund, prandaj edhe mbetet vetëm në imagjinatën tonë dhe në botën fiksionale.

Nëse thellohemi më shumë në arsyet e ekzistimit të këtij fenomeni (burime se nga mund të ketë ardhur), të këtij mendimi apo të kësaj ideje, se vendi ideal që nuk është askund duhet të jetë gjithkund, rruga na çon te Parajsa e humbur (Xheneti i humbur), Edeni i Ademit dhe Havasë (Adamit dhe Evës). Pra, kështu prihemi më shumë drejt universalitetit: se ky fenomen ishte më herët, dhe duhet të jetë edhe më vonë, përkatësisht krahas *u-topisë* (vendit që nuk ekziston, as-kundit) duhet ta krijojmë *u-kroninë* (kohën që nuk ekziston as-kohën), mungesën e kohës, e që çon në përjetësinë. Pra, mendimi utopik niset nga një realitet aktual (real), dhe shtrihet në dy kohë të tjera: të kaluarën, që e merr si model, dhe; të ardhmen, që e sheh si ideal (ireal).

Kjo dëshmon se utopinë dhe utopizmin e prodhon një e tashme dhe, më saktë, grindja ndërmjet *reales* dhe *ireales.*[5]

Çdo gjë e imagjinuar është më e bukur se ajo që ekziston, ajo që është reale. Prandaj edhe pohimi i utopisë, ireales, në njëfarë forme është mohim i reales. Në fund të fundit, njeriu dhe bota gjithmonë kanë nevojë për të imagjinuar idealen, të përsosurën, edhe nëse (përkatësisht edhe pse) nuk arrihet kurrë. Përndryshe, pse njeriu do të zgjohej nga gjumi, imagjinonte, apo edhe ëndërronte?!

Në këtë kontekst, nuk është rastësi pse një tregim fiksional që flet për një shoqëri ideale gjithmonë ka efekt te lexuesi, që edhe gjatë leximit ndodh të përhumbet e të bëhet pjesë e asaj shoqërie (një sy që sheh nga lart nëpërmjet fokalizatorit), por edhe në jetën reale imiton sjelljen e personave të asaj shoqërie ideale (utopike). Në këtë pikë kemi kalimin e utopisë fiksionale në utopi sociale, edhe pse, siç e thamë edhe më sipër, utopia si filozofi synon të jetë universale në kohë, e që nënkuptohet se e tillë pretendon të jetë edhe në hapësirë: pra, gjithmonë dhe gjithkund.

[5] Po aty, f. 17.

Mirëpo, në një shoqëri ideale (utopike), ku sistemi është i rëndësishëm dhe jo individi, utopia shndërrohet në *distopi* (vend i dhunës, vend i keq). Thënë troç, kur individi s'ka rëndësi para sistemit, atëherë kemi distopi.

Sipas Sabri Hamitit, *kur tregimi utopik tenton të zbatohet në jetën reale, kalon në distopi (vend i keq), në kundër-utopi, apo në utopi negative, sipas interpretimeve të vona. Projekti i shoqërisë së lumtur bëhet realitet i shoqërisë së dhunës*.[6]

Zakonisht kështu ka ndodhur me çdo projekt "ideal", e që si i tillë nuk ka pasur asnjë lidhje përtejtokësore (hyjnore). Kur projekti i krijuar nga mendja e njeriut është vënë në praktikë/zbatim, në vend se ta bëjë vendin/jetën më të dashur, atë e ka shndërruar në një ferr ku nuk ekziston liria individuale, dhe ku nuk paramendohet që individi ta kundërshtojë sistemin e vendosur shoqëror.

Sido që të jetë, duke qenë se utopitë lindin në shoqëritë që kanë kaluar nëpër kriza të mëdha dhe revolucione, mund të themi se edhe diktaturat gjithmonë kanë lindur nga projektet "ideale" - utopike, pra fillimisht si një plan utopik, por që më vonë janë ndërruar dhe janë bërë distopi.

Utopia dhe religjioni – Utopia fetare

Utopizmi në letërsinë botërore dhe atë shqipe lidhet drejtpërdrejt me religjionin. Derisa utopia nënkupton një vend ideal, që në fakt nuk ekziston, përveç në konceptin teologjik (parajsa ku jetoi Ademi/Adami dhe Havaja/Eva, pastaj edhe parajsa/Xheneti që pret të mirët pasi të kalojnë në botën tjetër/të vdesin), dhe duke pasur parasysh se shumica e veprave letrare në letërsinë botërore dhe shqipe (në fakt të parat vepra letrare në letërsinë botërore dhe shqipe) drejtpërdrejt lidhen me religjionin, përfundimi se utopizmi është i lidhur drejtpërdrejt me religjionin po që del të jetë më se i saktë.

Megjithatë, këtu do të përmendim vetëm lidhjen e utopisë me religjionin, pa u futur në interpretime të thella fetare, si dhe llojet e utopive fetare.

[6] Po aty, 20.

Meqë kemi një numër të madh religjionesh, dhe secili dallon nga tjetri, edhe utopitë fetare dallojnë. Prandaj, mbi bazë të kuantitetit dhe karakteristikave të veçanta të secilit besim, utopitë fetare mund të jetë dy llojesh:

- *Intra-fetare (brenda-fetare),* dhe;
- *Ndër-fetare (ndërmjet feve).*

Utopitë intra-fetare

Fetë ndërtohen mbi ideale. Secila fe ka idealet e veta, ideale që thërrasin në bërjen e botës vend ideal. Përndryshe, fetë nuk do të kishin asnjë pasues. Ndërsa, utopitë brenda-fetare janë utopi që bazohen në idealet fetare. Pasuesit e secilit religjion të përhapur sot me shumicë në shoqërinë njerëzore janë të prirë të besojnë në mundësinë e religjionit të tyre që të krijojë utopi. Për shembull, mendimet e besimit hebraik, katolik dhe islam për Edenin dhe Xhenetin mund të shihen si modele të utopizmit.

Nëse kërkojmë diçka të ngjashme në hinduizëm apo budizëm, të parët kanë mokshan[7], ndërsa budistët nirvanën[8]. Ndonëse, për dallim nga besimet abrahamike, në hinduizëm dhe budizëm utopia nuk është vend, por është gjendje e mendjes që arrihet përmes meditimit, në mënyrë që të realizohet ndriçimi i mendjes/njohja; njohja e vetes dhe e çdo gjëje. Në momentin e arritjes së kësaj realizohet dalja nga cikli i jetës dhe vdekjes, e që prapë na çon në konceptin utopik.

Utopitë ndër-fetare

Utopitë ndërfetare janë ato utopi që mund t'i hasim njëkohësisht në disa fe, apo qoftë vetëm diçka nga karakteristikat e tyre. Në planin global, ato janë të ngjashme me multikulturalizmin. Njësoj sikurse në multikulturalizëm kulturat e botës punojnë bashkërisht për krijimin e një shoqërie sa më të gjerë dhe të bazuar në vlerat e përbashkëta, ashtu edhe në utopitë

[7] Moksha, i quajtur edhe vimoksha, është term që në hinduizëm dhe filozofinë hindase i referohet formave të ndryshme të emancipimit, çlirimit, dhe lirimin.

[8] Nirvana është term që, nëse e përkthejmë fjalë për fjalë, do të thotë "lulëzim jashtë". Ky term është shumë i lidhur me budizmin, dhe paraqet gjendjen e fundit të lirimit dhe çlirimit.

ndër-fetare synohet që bashkërisht të realizohet utopia. Pra, merret një ide apo mendim i njohur fetar (një citat kuranor ose biblik apo nga Tora), dhe përdoret prej shumë njerëzve si pikëpamje e tyre e përbashkët brenda një komuniteti/shoqërie.

Në një plan më të zgjeruar kjo formë shkon deri në nivelin sa udhëheqësit fetarë vendosin në një anë/lënë anash dallimet e tyre, dhe pranojnë të përbashkëtat, për ta bërë një jetë sa më me paqe e harmoni, duke synuar bashkimin e të gjitha feve me njëra-tjetrën, por gjithmonë duke ruajtur origjinalitetin e secilës.

Megjithatë, utopitë tjera të këtij lloji shkojnë edhe më tej, sa krijojnë një fe ku njerëzit bëjnë bashkë, sipas tyre, vetëm të mirat e çdo feje.

Feja dhe Zoti mund të përdoret si një faktor që motivon njerëzit që besojnë, që pas dështimeve dhe situatave të vështira të ngrihen dhe të vazhdojnë. Kjo po që çon në krijimin e një utopie reale.

Utopia në letërsi

Pavarësisht se vepra e parë utipoke *"Utopia"* e Tomas Morit (Thomas More-it) njihet si e para e këtij lloji, ajo prapëseprapë ka lidhje me burime më të hershme të veprave me prirje të tillë, siç janë dialogët e Platonit, respektivisht për *"Shtetin"* dhe *"Ligjet"*, si dhe dialogët për *"Atlantidën"*. Aty diskutimi shtrihet në plan të rregullimit të strukturës shoqërore. Pra, utopizmi si ide ka ekzistuar edhe shumë më herët se viti 1516 (kur është botuar *"Utopia"* e Tomas Morit), apo edhe 427-347 p.e.s. (kur jetoi Platoni).

Për shembull, nëse marrin veprën *"Epi i Gilgameshit"*, aty gjejmë një lidhje intertekstuale me veprat fetare, *Talmudin, Biblën* dhe *Kuranin*, përkatësisht Utnapishtimi është pejgamberi Nuh/Noa. Prandaj, derisa *"Epi i Gilgameshit"* është e para vepër letrare botërore e njohur, mund të nxjerrim një përfundim se, përveç për Nuhun (Noan), shoqëritë e hershme njerëzore mund të kenë shkruar edhe për ndonjë prej pejgamberëve të tjerë, e të cilët shoqërinë njerëzore janë munduar ta rregullojnë në strukturë dhe ligje, edhe duke premtuar se, po që se bëhen të mirë në këtë jetë, pas vdekjes do ta përjetojnë/(për)fitojnë Parajsën (Xhenetin), e që është vendi më i mirë dhe më i bukur.

Këtë përfundim mund ta mbështesim edhe me referenca aktuale nga librat e shenjtë, Kuran, Bibël dhe Talmud, në të cilët shënon se secili pejgamber ka pasur për mision një thirrje/detyrë të tillë. Kjo dëshmi flet edhe për ndikimin e fesë në letërsi.

Megjithatë, pavarësisht se utopizimi ka burimin në religjion, është letërsia ajo që ka ofruar edhe forma tjera të utopisë. Nëse *"Atlantida"* e Platonit është e para vepër letrare me bazë utopike, *"Utopia"* e Tomas Morit tanimë është utopia vetë.

Sidoqoftë, derisa veçoritë e një vepre utopike i kemi përmendur më sipër, këtu do të ndalemi e të përmendim disa nga veçoritë e romanit utopik.

Si e para veçori e romanit utopik mund të renditet ideja utopike. Pa këtë element nuk do të mund të vazhdohej më tutje. Ndërsa elementet tjera, që në një apo formë tjetër janë të lidhura me elementin e parë, mund t'i përmendnim si një tërësi e elementeve themelore të prozës, përkatësisht: subjekti, karakteret, narratori, narracioni, modeli fabulativ (syzheu), niveli tematik (që është ideja, bota ose realiteti prozaik), dhe koha.

Një roman utopik do të ishte kur subjekti, që ndërlidhet me autorin, karakterin dhe narratorin, kompetencën e tij nuk do ta bartte te narratori, por do ta ruante pjesërisht, ose do të krijonte një narrator të gjithëdijshëm, apo kur karakteret do të kishin botëkuptime, veprime dhe ligjërime që i shkojnë idesë utopike, përkatësisht respektimit të rregullit dhe ligjit etj. Gjithashtu, një roman utopik mund të jetë edhe kur bota dhe realiteti prozaik janë aq të ngjashëm me realitetin konkret, sa vetëm ideja se nuk është reale bën që utopikja të ekzistojë mes tyre. Pra, kur autori krijon një vepër që i ngjan realitetit jetësor, ai në veprën e tij rregullon dhe respekton sistemin dhe ligjet që ka shoqëria, dhe kështu krijon një utopi/koncept utopik. Në këtë pikë është një paradoks. Edhe pse secili mundohet të realizojë utopiken, prapëseprapë, në thellësinë e vetes së tij vetë ai është që nuk mund ta durojë, për arsye se njeriu, si i tillë që është, lodhet nga monotonia, e zakonshmja dhe e përsëritshmja.

Elementi prozaik, që më së paku ka rëndësi në një vepër utopike, roman qoftë ose jo, është koha, e cila edhe mund të mos përcaktohet fare.

Për ta kuptuar më mirë utopizmin dhe utopinë, do të marrim një shembull nga *"Utopia"* e Tomas Morit, ku në pjesën e dytë, e cila edhe është pjesa kryesore e veprës, kemi të paraqitur vendin ideal, ku qytetarët, secili, e di obligimin dhe punën e tij.

Në krye të familjes është më i vjetri. Gratë dëgjojnë burrat, fëmijët prindërit, të rinjtë dëgjojnë të vjetrit. Të gjithë marrin mallin që duhet. Hanë dreka të përbashkëta. Gratë i ushqejnë foshnjat me tambël gjiri. Fëmijët shërbejnë në dreka, të cilat shtrohen në ndeja e biseda, ku ka lexime, rrëfime, madje edhe muzikë. Për dallim, në fshatra, familjet hanë në shtëpitë e veta.[9]

Si vepra të njohura utopike mund të përmenden edhe: *"Qyteti i Diellit"* i Tomazo Kampanelës, *"Atlantida e Re"* e Frensis Bejkënit, *"Bagëti e Bujqësia"* e Naim Frashërit, *"Shqipëria ç'ka qenë, ç'është e ç'do të bëhetë?"* e Sami Frashërit etj.

Shkrimtarët, duke përmbysur konceptin utopik, në veprat e tyre kanë krijuar edhe konceptin distopik-distopinë, e që ndryshe njihet edhe si kakotopi, që është shndërrimi i vendit të mirë në vend të keq.

Distopia/Kakotopia

Distopia ekziston atëherë kur vendi i synuar të bëhet i mirë bëhet i keq. Kjo zakonisht ndodh duke kufizuar lirinë e njeriut, të cilën liri njeriu e ka si esencë të jetës së tij.

Sidoqoftë, më sipër vetëm se u tha se një distopi ndryshe njihet edhe si kakotopi, që nënkupton një shoqëri të padëshirueshme dhe të frikshme.

Kakotopia (cacotopia: κακό, caco = keq) në aspektin gjuhësor ka kuptimin e diçkaje të keqe, jo të këndshme apo negative.

Ndërsa në aspektin terminologjik ka kuptimin e një bashkësie të imagjinuar apo një shoqërie që është e padëshirueshme apo e frikshme.[10]

Kakotopia si term për herë të parë është shpikur dhe përdorur nga Jeremy Bentham. Ky term për herë të parë u shfaq si një term i vetëm në

[9] Sabri Hamiti, "Utopia letrare", ASHAK, Prishtinë, 2013, f. 40.

[10] Definition of "dystopia". Merriam-Webster. Merriam-Webster, Inc. 2012. Gjithashtu edhe në: Definition of "dystopia". Oxford Dictionaries. Oxford University Press. 2012.

tekstin e tij *"Plan of Parliamentary Reform",* në vitin 1818.[11] Edhe sipas OED (Oxford English Dictionary), cacotopia ka po këtë kuptim.

Në aspekt letrar dystopia, apo kakotopia, është një zhanër i shkrimit imagjinar që përdoret për të shqyrtuar dhe strukturuar politikat shoqërore në "një errësirë, makth të botës."

Termi distopi, ose kakotopia, është përcaktues i një shoqërie të karakterizuar nga varfëria, mjerimi ose shtypja, ndërsa zakonisht përdoret për temat nga fushat fiktive apo zhanret spekulative fiktive.[12]

Në kuptimin më të zmadhuar, distopia ka të bëjë me një kritikë ndaj një tradite negative aktuale, norme shoqërore apo sistemi politik.

Ndërsa, si përkufizim më i shkurtër dhe më logjik mund të konsiderohet edhe ky: "Distopia-kakotopia është anti-utopia".

Letërsia distopike është shkruar me qëllim të frikësimit të lexuesve. Veprat e letërsisë distopike ecin në një linjë të mirë në mes të evokimit të ndjenjës së frikës dhe nxitjes së ndjenjës së një ndjenje të kotë. Nuk është e mundur që të kemi një shoqëri tërësisht të përsosur. Prandaj, duke treguar rezultatet e tmerrshme të asaj që mund të ndodhë nëse synojmë përsosmërinë shoqërore dhe përmirësimin e shoqërisë, distopia na trondit si lexues, pra që t'i pranojnë të metat e njerëzimit si të meta esenciale dhe të papërmirësueshme.[13] Me një fjalë, të kemi frikë nga të metat, dhe ta shohim si të kotë angazhimin për eliminimin e tyre.

Sipas filozofit britanik John Stuart Mill, hera e parë e përdorimit të termit *distopi* është në fillim të 1868. Megjithatë, koncepti nuk u bë popullor deri kur J. Max Patrick e përdori atë në vitin 1952, për të kategorizuar librin e Joseph Hall *"Mundus Alter et Idem"*.

Sidoqoftë, letërsia distopike apo kakotopike, filloi të zhvillohet si një zhanër i veçantë letrar në fund të shekullit të XIX, pasi shkrimtarët filluan të publikojnë letra anti-utopike, duke sulmuar veprat utopike, megjithëse kjo formë shkrimi nuk zuri vend deri në shekullin XX. Vepra të dukshme në këtë periudhë përfshijnë utopinë shumë të popullarizuar të Edward Be-

[11] Notes and Queries, Cacotopia: An eighteenth-century appearance in news from the dead, 2011, f. 391.

[12] https://www.questia.com/library/literature/literary-themes-and-topics/dystopian-literature

[13] Po aty.

llamy *"Looking Backward"* (1888), si dhe *"Looking Further Forward"* (1890) të Richard Michaelis.

Thënë me një fjalë, veprat letrare distopike, apo kakotopike, janë vepra që kryesisht kanë lindur nga shoqëritë që kanë vuajtur nën *thundrën e hekurt*[14] të sundimit totalitar.

Letërsia distopike/antiutopike

Derisa dis-topia ishte një vend i keq, vepra letrare që trajton një temë të tillë është vepër distopike-kakotopike apo antiutopike.

Një distopi, që ndryshe njihet edhe si kakotopi (cacotopia)[15] është një shoqëri/bashkësi fiktive/e imagjinuar, e cila nuk është e pëlqyeshme nga askush brenda shoqërisë, dhe që njëkohësisht është e gotike-frikshme.

Romani "Ne" i autorit rus Jevgenij Zamjatin (Евге́ний Замятин) është antiutopia e parë në fushën e letërsisë e të teorive shoqërore, njëherësh kryevepër letrare e autorit dhe vepër klasike e antiutopisë.[16]

Antiutopia, në njëfarë forme, është e kundërta e utopisë. Nëse utopia lindke si kërkesë për ndryshim, për ta ndyshuar një realitet negativ, antiutopia është vetë negativja, një vend i keq që duhet ndërruar. Nëse e para është perfektja, e dyta është e kundërta. Nëse e para është e arritura, e dyta është ajo që ka qenë para saj. Kështu që, në këtë rast dyta është para të parës, ndërsa e para vjen pas të dytës. Antiutopia është një antonim i utopisë.

Pra, një vepër antiutopoke flet për një shoqëri jo të mirë, e cila jeton në një vend jo të mirë. Rastet që shoqëritë e tilla të shfaqen në veprave artistike janë të shumta, sidomos në prozat që flasin për të ardhmen, pra që vendosen përpara në kohë.

---

[14] Shkrimtari amerikan, Jack London, ka një vepër distopike po me titullin "Thundra e hekurt" (The Iron Heel), të botuar në vitin 1908, në të cilën flet kryesisht për ndryshimet në të ardhmen në aspektin shoqëror dhe politik në vitet e '60-ta dhe '70-ta.

[15] Cacotopia (κακό, caco = keq) ishte një term i përdorur nga Jeremy Bentham, në veprat e tij të shekullit XIX.

[16] Sabri Hamiti, "Utopia letrare", ASHAK, Prishtinë, 2013, f. 97.

Distopitë shpesh karakterizohen nga dehmanizimi[17], qeveritë totalitare, katastrofat mjedisore, ose karakteristikat tjera të lidhura me një rënie kataklizmike në shoqëri.[18]

Prandaj, secila vepër letrare që e vë ngjarjen në një vend jo të mirë, në një vend që karakterizohet me dehumanizimin, mohimin e njerëzores te të tjerët, pastaj me totalitarizmin, katastrofat apo kataklizmet, etj., mund të themi se është vepër letrare distopike/antiutopike.

Si vepra të këtij lloji, për shembull, mund të përmendim: "Ne" e Evgjenij Zamjatinit, "1984" e Xhorxh Oruellit, "Utopia e një burri të lodhur" e Horhe Luis Borhes, "Pallati i Ëndrrave" e Ismail Kadaresë, "Dueli" e Agron Tufës, "Boshi" e Besnik Mustafait, "Oh" e Anton Pashkut, "Zazen" e Ag Apollonit etj.

[17] Dehmanizimi ose dehumanizimi nënkupton mohimin e "njerëzimit" apo njerëzores te njerëzit e tjerë.

[18] http://en.wikipedia.org/wiki/Dystopia#cite_note-Merriam-2.

Besnik JAHA

UTOPIA AND RELIGION
The influence of religion on literature

(Summary)

The word Utopia is a neologism derived from the Greek word topos and it means a place, society or community in which everything is perfect, respectively an ideal society, which in fact does not exist.

Its inexistence places it in the realm of fiction and imagination. Thus, rather than in reality, utopia has found its place in fiction. Utopism in world and Albanian literature is directly linked to religion.

Intra-religious utopias are based on religious ideals. Inter-religious utopias are those which can be found simultaneously in different religions, even when having to do only with certain characteristics of theirs.

بسنيك ياها

يوتوبيا والدين (أثر الدين في الأدب)

(خلاصة البحث)

أوتوبيا (utopia) المدينة الفاضلة هي ظاهرة بدأت أصلا مع خلق الكلمة المدرجة من الكلمة اليونانية topos، بإضافة إلى حرف u قبلها لتصبح u topos، بمعنى بلد أو مجتمع أو مجتمع لديه جودة الكمال ، وبكلمة واحدة، هي المجتمعات المثالية، والتي في نهاية الأمر،غير موجودة.

إنه بالضبط هذا العنصر أي عدم وجودها هو الذي يترك اليوتوبيا في فضاء التفكير والخيال والتخيل. لذلك ، إن لم يكن لها وجود في الواقع ، فإن اليوتوبيا وجدت مكانها جيدًا في الخيالية ، على الرغم من أن مصدرها للدين.

ترتبط اليوتوبيا في الأدب العالمي و الأدب الألباني ارتباطًا مباشرًا بالدين.

اليوتوبيا الدينية هي اليوتوبيا المبنية على المثل الدينية. اليوتوبيا بين الأشخاص هي تلك اليوتوبيا التي قد نواجهها في وقت واحد في بعض الأديان ، أو مجرد واحدة من خصائصها.

Alban DOBRUNA

RIORGANIZIMI I KOMUNITETIT MYSLIMAN SHQIPTAR MË 1942

Abstrakt: Në prill të vitit 1941, shtetet e bllokut fashist sulmuan Jugosllavinë duke e shpërbërë dhe copëtuar atë. Fatin e Jugosllavisë e përjetuan edhe trevat shqiptare që ishin nën sundimin e saj. Forcat pushtuese vendosën që qeverisja lokale në rajonet e populluara me shqiptarë duhej drejtuar nga shqiptarët, ku në kuadër të kësaj u realizua bashkimi i komuniteteve islame në një komunitetet të vetëm me qendër në Tiranë. Me ndryshimet e lartpërmendur u bë edhe ndarja e re administrative e Bashkësisë Islame në Kosovë, pra ajo nën okupimin italian u lidhë me kryeqendrën e re në Tiranë. Mund të konstatojmë se ndryshimet dhe zhvillimet gjatë kësaj periudhe historike ushtruan ndikimin e tyre kulturor, ekonomik, fetar dhe kombëtar tek popullsia shqiptare në përgjithësi dhe sidomos te komuniteti fetar i besimit islam.

Fjalët kyçe: *Lufta e Dytë Botërore, Trevat shqiptare, Komuniteti Mysliman Shqiptar.*

Pushtimin fashist të Shqipërisë në vitin 1939, strukturat e fesë islame, si pjesë integrale e shoqërisë, diferencimin e forcave që u bënë në vend e ndjeu shpejtë. Kështu, kreu i fesë islame, dr. Behxhet Shapati, mbajti anën e politikës italiane duke u vënë në shërbim të saj[1]. Në një intervistë të dhënë gazetës *"Corriere della Sera"*, më 1 maj 1939, ai hidhte dritë për arsyet që ushqenin këtë qëndrim të tij, pasi vinte në dukje marrëdhëniet e këqija që, sipas tij, kishin ekzistuar me Mbretin Zog[2]. Por, kjo nuk ishte e vërtetë, sepse Qeveria e Zogut në dy kongreset e fundit kishte mbështetur Komunitetin Mysliman, duke e institucionalizuar dhe pranuar statutin e tij më 1925 dhe në vitin 1929[3]. Veç kësaj, Qeveria mbretërore nuk kishte kursyer ndihmat e duhura për realizimin e aktiviteteve të këtij komuniteti. Mbreti Zog, kishte ndjekur një politikë të vendosjes së harmonisë në interes të komuniteteve fetare dhe shtetit[4], dhe kishte influencuar për krijimin e një parie fetare kombëtare, ku sipas dekretligjit të vitit

[1] *Arkivi Qendror i Shqipërisë* (më tej: *AQSH),* f. 482, v. 1940, d.103, fl.11-12; Mesazhi i Kryetarit të Komunitetit Mysliman, *Që myslimanët të jenë bijë të denjë të Perandorisë Fashiste,* Tiranë, 1940-XIX; "Ngjarjet me rëndësi të Prillit", *Zani i naltë*, Tiranë: Organ i Komitetit Mysliman Shqiptar, viti XIV, Prill 1939-Sefer 1357, nr. 4, f. 126; "Telegram urimi Madhnisë së Tij Victor Emanuelle II Mbret i Italisë e i Shqipnisë dhe perandor i Etiopisë", *Zani i naltë*, Tiranë: Organ i Komitetit Mysliman Shqiptar, viti XIV, Prill 1939-Sefer 1357, nr. 4, f. 97; "Përshpirtje solemne fetare në kujtim të të rënëve shqiptarë; Mëkëmbësi i Mbretit dhe autoritetet më të larta marrin pjesë në këtë ceremoni", *Kultura islame,* Tiranë: Organ i Komunitetit Mysliman Shqiptar,viti III, Kallnuer-shkurt-Mars1942-XX (Dhilhixhe-Muharrem-Sefer 1361), nr. 5, f. 182; Sadik Beka, "Reportazh mbi vizitën e kryetarit të Komunitetit Mysliman Shqiptar në Kosovë", *Kultura Islame,* Tiranë: Organ i Komunitetit Mysliman Shqiptar,viti III, Kallnuer-shkurt-Mars1942-XX (Dhilhixhe-Muharrem-Sefer 1361), nr. 5, f.182-183.

[2] Xhelal Gjeçovi, "Kleri mysliman dhe çështja kombëtare në vitet e Luftës së Dytë Botërore", *Studime historike,* nr. 3-4, Viti LX (XLIII), Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë; Instituti i Historisë, 2006, f. 173.

[3] Valentina Duka, "Institucionet fetare gjatë mbretërimit të Ahmet Zogut: një vështrim të legjislacionit të kohës (1928-1939)", Tiranë: Komuniteti Mysliman i Shqipërisë, Bashkësia Islame e Kosovës, Bashkësia Fetare Islame e Maqedonisë, *Kontributi i prijësve myslimanë në formësimin e vetëdijes dhe identitetit kombëtar,* Aktet e Konferencës shkencore, më 28-29 shtator 2012, f. 83-85; Siri Hoxha, "Veprimtaria e Komunitetit Mysliman Shqiptar në vitet '20 të shek. XX, në plan kombëtar e shoqëror", *Zani i naltë,* Tiranë, Botues: Komuniteti Mysliman i Shqipërisë, Viti III(XVII), 2014, nr. 9 (162), f. 122-126.

[4] Nertila Ljarja, "Pavarësia e Shqipërisë dhe krijimi i një shteti laik (1912-1939)", Tiranë, Qendra e Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë, *100 vjet pavarësi,* Aktet e Konferencës shkencore ndërkombëtare, më 26-27 nëntor 2012, Vëllimi II, Botimet albanologjike, f. 83.

1929, nuk duhej të merrnin subvencione nga jashtë dhe nuk duhej, - përveç lidhjeve kulturore dhe shpirtërore, - të kishin asnjë lidhje me institucione, organizata dhe persona të huaj. Shapati lavdëronte politikën italiane, kurse ideologjinë fashiste e konsideronte të afërt me parimet e fesë islame[5], ndonëse të njëjtën gjë e kishte bërë edhe me politikën e Zogut, kur kishte ardhur në krye të Komunitetit Mysliman në fillim të viteve '30 të shek. XX[6]. Gjithashtu B. Shapati botoi një shkrim në revistën "Kultura islame", që ishte organ i Komunitetit Mysliman dhe artikujt e botuar në të ishin nën kontrollin e Komunitetit[7], ku vinte shenjën e barazimit ndërmjet islamit dhe fashizmit[8]. Në këtë shkrim, më shumë ka tendenca të demonstrimit të një servilizmi ndaj politikës italiane se diçka konkrete, për shkak se në tërë shkrimin, Shapati mundohet të gjejë pika të përbashkëta midis fesë islame dhe ideologjisë fashiste, ndërkohë që bëhej fjalë për disa norma morale të cilat ishin universale, si p.sh. Kur'ani thotë: "Zoti ju urdhëron të zbatoni drejtësinë", kurse Musolini thoshte se: "forca duhej përherë të jetë e shoqëruar nga drejtësia"[9]. Mirëpo, në këtë periudhë, udhëheqësia fetare myslimane u pozicionua si mbarë popullsia shqiptare në përgjithësi. Një pjesë e vogël e tyre iu përshtatën rrethanave të krijuara dhe u vunë në shërbim të politikës zyrtare, por shumica dërrmuese e tyre, ashtu si mbarë popullsia shqiptare, i pritën me indiferencë, ose u rreshtuan

[5] Behxhet Shapati, "Gjendja e djeshme dhe e sotshme e elementit Shqiptar Mysliman në Shqipëri", *Tomori,* 3 prill 1940- XVIII, f. 4; Roberto Marocco, *Kombi dhe feja në Shqipëri.....,* f.199; Viron Koka, "Ideologjia reaksionare e klerit në vitet '30 të shekullit XX", *Studime historike,* Tiranë, Universiteti Shtetëror i Tiranës, Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë, nr. 3, viti XXII (V), 1968, f. 75; Behxhet Shapati, "Gjendja e djeshme dhe e sotshme e elementit shqiptar mysliman në Shqipni", *Kultura islame,* Tiranë, Organ i Komitetit Mysliman Shqiptar, viti I, Fruer-Mars 1940-XVIII (Muh-Safer, 1358), nr. 6-7, f. 204; "Mbledhja e Këshillit të Përgjithshëm të Komitetit Mysliman", *Kultura islame,* Tiranë, Organ i Komitetit Mysliman Shqiptar, viti I, Maj 1940-XVIII (Rebiyl-ahar 1359), nr. 9, f. 363; Behxhet Shapati, "Thirrje shqiptarëve mysliman", *Kultura islame,* Tiranë, Organ i Komitetit Mysliman Shqiptar, viti I, Nandor 1940-XIX (Shavval 1359), nr. 15, f. 58.

[6] *AQSH,* f. 482, v. 1931, d. 19, fl. 2; Letër e Behxhet Shapatit, Ministrit të Oborrit Mbretnuer, Tiranë, 31. XI. 1931.

[7] *AQSH,* f. 482, v. 1942, d. 5, fl. 123; Vendim i Komunitetit Mysliman; Këshilli i Përhershëm Ulemave, Tiranë, 23. VI. 1942.

[8] Behxhet Shapati, "Islami dhe Fashizmi", *Kultura islame,* Tiranë, Organ i Komitetit Mysliman Shqiptar, Viti I, Fruer-Mars 1940-XVIII (Muh-Safer, 1356), nr. 6-7, f. 243.

[9] *Po aty,* f. 249.

ndërmjet kundërshtarëve të këtyre ndryshimeve[10]. Parë në kontekstin e kohës, në Kosovë fashizmi arriti të përfitonte mjaftë përkrahje nga patriotë dhe nacionalistë, të cilët nuk besonin në vëllazërim-bashkimin e popujve të proklamuar në mënyrë artificial nga Partia Komuniste Jugosllave dhe ajo në Shqipëri; ata e kishin kuptuar faktin se shqiptarët nuk mund të çliroheshin nga serbo-sllavët, pa mbështetjen e një force ndërkombëtare[11].

Mirëpo, karriera e Behxhet Shapatit në hierarkinë e Komunitetit Mysliman nuk do të zgjaste shumë. Italianët, të kujdesshëm ndaj ndryshimeve politiko-fetare, të shkaktuara nga gjendja e re që ishte krijuar, në qershor 1942 e zëvendësuan Shapatin me hafëz Sherif Langun[12], edhe pse ai, pra Shapati, siç shkruante Jakomoni në raportin e tij dërguar Romës: *"Sado që i kryente detyrat duke më kënaqur, nuk gëzonte, megjithatë në këtë mjedis islam, për shkaqe personale, atë kredi që unë e mendoj të nevojshëm për një personalitet në funksion aq të lartë"*[13]. Në këtë frymë, italianët ndërmorën një riorganizim të Komunitetit Mysliman në Shqipëri duke e zëvendësuar Këshillin e Përgjithshëm të Bashkësisë me një Këshill të Ulemave, të përbërë prej pesë anëtarëve: Hafiz Sherif Langu, kryetar; Hafiz Ali Korça, nënkryetar; Sheh Qazim Hoxha, nënkryetar; Hafiz Bedri Hamiti, këshilltar; Myderriz Sulejman Kadiu, këshilltar, që të gjithë të emëruar nga mëkëmbësi[14]. Kjo mënyrë ofronte mundësi të krijimit të një hapësire për të përfaqësuar myslimanët e territoreve të tjera, të cilat deri në ato kohë ndodheshin jashtë kufijve të Shqipërisë londineze[15]. Gjatë

[10] Lefter Nasi, *"Aspekte nga kontributi i ulemasë shqiptare kundër gjenocidit serbomadh në Kosovë",* Prishtinë, Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës, *Feja, kultura dhe tradita islame ndër shqiptarët,* (Simpozium ndërkombëtar), më 15, 16, 17 tetor 1992, 1995, f. 479.

[11] Fahrush Rexhepi, "Roli i ulemasë në rrjedhat shoqërore politike të periudhës së shpalljes së pavarësisë", Tiranë, Komuniteti Mysliman i Shqipërisë, Bashkësia Islame e Kosovës, Bashkësia Fetare Islame e Maqedonisë, *Kontributi i prijësve myslimanë në formësimin e vetëdijes dhe identitetit kombëtar:* Aktet e Konferencës shkencore, më 28-29 shtator 2012, f. 43.

[12] *AQSH,* f. 482, v. 1943, d. 5, fl. 37; Këshilli i Ylemave të Komunitetit Mysliman Shqiptar. Vendim nr. 7, Tiranë, 5.I.1944.

[13] Ali M. Basha, *Rrugëtimi i Fesë Islame në Shqipëri (1912-1967),* Tiranë: 2011, f. 298.

[14] "Reforma e Statutit së Komunitetit Mysliman Shqiptar; "Pushteti i Këshillit t'Ulemasë", *Kultura islame,* Tiranë, Organ i Komitetit Mysliman Shqiptar, viti III, Qershor-korrik 1942-XX (Xhemadiiewel-Xhemadilahar 1361), nr. 10-11, f. 289-290.

[15] Ali M. Basha, *Rrugëtimi i Fesë Islame në Shqipëri…,* f. 298.

muajit qershor të vitit 1942, po ashtu, disa prijës myslimanë të Kosovës kishin shprehur pakënaqësinë lidhur me gjendjen e lënë pas dore të organizimit fetar të shkaktuar nga lufta dhe nga cirkonstancat (gjendje financiare) e përgjithshme e kohës, prandaj ata i kërkonin Qeverisë Mbretërore që një pjesë të kohës ta rezervonte edhe për nevojat fetare[16]. Për këtë arsye, Këshilli i Ulemave, duhej të hartonte sa më parë projektin e një statuti të ri për Bashkësinë e të gjithë myslimanëve të Shqipërisë, në përputhje me interesat e shtetit dhe ato të elementit islam. Mirëpo, ky Këshill vendosi që statutet dhe rregulloret përkatëse të ish-regjimit jugosllav të mbesin në fuqi për ato vise të liruara në bazë të dispozitave të tyre derisa të bëhet e të aprovohet statuti i ri[17]. Problem në vete paraqiste fakti se zyrat e komunitetit mysliman të "Tokave të Lirume" nuk kishin vula dhe disa i përdornin ato të ish-regjimit jugosllav, andaj me një vendim u vendos që: forma e vulave zyrtare të Komunitetit Mysliman për "Tokat e Lirume", të jenë në formën e atyre vulave që përdornin zyrat e Komunitetit Mysliman të Shqipërisë së vjetër (para pushtimit të Shqipërisë më 1939 dhe të Jugosllavisë më 1941 - A. D.). Me një fjalë, të përdoreshin vulat që ishin në gjuhën shqipe, me emrin e zyrës të shkruar rreth e rrotull saj, dhe me një xhami me një minare në mes. Emrat e zyrave, sipas hierarkisë dhe siç ishin paraparë me buxhet, ishin: Kryemyftinia, Myftinia, Nënmyftinia, Imametnia, po ashtu edhe zyrat e Vakfit. Shpenzimet për këtë qëllim do të përballoheshin nga fondet relative, prandaj Këshilli i Ulemave ngarkoi Drejtorinë e Përgjithshme të Vakfeve për zbatimin e këtij vendimi si dhe për shlyerjen e obligimeve financiare dhe për dërgimin e vulave në çdo vend[18].

Rëndësia e këtyre masave administrative, konsiston në mesazhin që transmetonin ato për profilizimin ideor dhe politik të ulemasë shqiptare, duke ju shërbyer myslimanëve shqiptarë të Kosovës, të trojeve të tjera

[16] *Tokat e liruara 1941-1944,* Vëllimi II (qershor-gusht), Përzgjedhjen, përkthimin dhe redaktimi: Qerim Lita, Shkup-Prishtinë-Tiranë, Logos-A, 2016, f. 77. Letër e imamëve të Gjakovës e të rretheve drejtuar Shkëlqesisë s'tijë Mustafa Kruja-kryeministër.

[17] *AQSH,* f. 482, v. 1942, d.5, fl. 175; Vendim i Komuniteti Mysliman; Këshilli Ulemave, Tiranë, 10.VIII.1942.

[18] *AQSH,* f. 482, v. 1942, d. 5, fl. 304; Vendim i Komuniteti Mysliman; Këshilli Ulemave, Tiranë, 29. XII. 1942.

shqiptare, të Mali të Zi, Maqedonisë si dhe të Çamërisë, me parimin themelor që feja gjithnjë duhet të jenë përkrah popullit, duke mos u shkëputur nga problemet e mëdha të kombit dhe nga nevojat e tij. Me një fjalë, duke i parë problemet e fesë të lidhura ngushtë me problemet e kombit dhe të vendit.

Me rastin e zgjedhjes së tij si kryetar i Këshillit të Ulemave, hfz. Sherif Langu, më 18 qershor 1942, nga Radio Tirana, iu drejtoi shqiptarëve myslimanë përshëndetjet e tij, dhe ndër të tjerash, ai u shpreh: *"Tue fillue detyrën e randë qi na u ngarkue nga Shkëlqesa Mëkambësi i Përgjithshëm për ma drejtue veprimet e Komunitetit Mysliman Shqiptar, e pashë për detyrë me u sjellë gjithë bijvet Myslimanë të Shqipnisë një përshëndetje atnore n'emën të Këshillit t'Ylemavet, që kam nderin të Kryesoj dhe me ndriçue opinionin Publik mbi vijat e përgjithshme t'udhës qi kemi me ndjekë në të kryemit e misionit qi muerrëm përsipër"*[19]. Më pastaj ai në vija të përgjithshme paraqiti objektivat e tij të përmbledhura në gjashtë pika, si ato të pikës së parë mbi moralin, të dytës dhe të tretës mbi zhvillimin kombëtar, mbi sigurimin e atdheut dhe për respektimin e feve të tjera; e katërta sipas tij dhe më e rëndësishmja ishte kujdesi që me anë të shkrimeve t'u ndihmohej në ngritjen shpirtërore vëllezërve të "Tokave të Lirume", toka të cilat pas prillit të vitit 1941, - si rezultat i sulmit të shteteve të bllokut fashist mbi Jugosllavinë dhe shpërbërjen dhe copëtimin e saj, - iu bashkuan Shqipërisë[20]. Fatin e Jugosllavisë e përjetuan edhe trevat shqiptare që ishin nën sundimin e saj. Pjesa më e madhe e Kosovës, së bashku me trevat veriperëndimore nën pushtimin e Malit të Zi, si trevat lindore etnike shqiptare (Maqedoninë e sotme - A. B.), u përfshinë në

[19] "Përshëndetje shqiptarëve myslimanë nga kryetari i Ulemave", *Kultura islame*, Tiranë, Organ i Komitetit Mysliman Shqiptar, viti III, Qershor-korrik 1942-XX (Xhemadiiewel-Xhemadilahar 1361), nr. 10-11, f. 291.

[20] Muhamet Shatri, *Kosova në Luftën e Dytë Botërore,* Prishtinë, Instituti i Historisë-Prishtinë, 1997, f. 17; Lefter Nasi, "Kosova dhe problemi kombëtar në vitet 1941-1943", *Kosova*, Prishtinë, Instituti i Historisë- Prishtinë, nr. 28, 2006, f. 213; Fehmi Rexhepi,"Lufta e shqiptarëve për vetëvendosje e bashkim kombëtar gjatë Luftës së Dytë Botërore", Prishtinë, Instituti i Historisë "Ali Hadri"-Prishtinë, Qendra e Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë-Tiranë, *Shqiptarët gjatë Luftës së Dytë Botërore*, [Përmbledhje studimesh], 2014, f. 136.

Zonën Italiane të pushtimit[21]. Kurse pika e pestë dhe e gjashtë bënte fjalë për zhvillimin e edukatës, kulturës fetare dhe autoritetit shpirtëror në kuadër të shoqërisë shqiptare[22].

Pikat e shprehura nga Sh. Langut ishin më tepër dëshira që ai ia kishte vënë vetës si qëllim t'i realizonte, sepse edhe ai ishte i vetëdijshëm për rrugën e vështirë dhe gjendjen në të cilën ndodheshin trevat shqiptare nën pushtimin dhe administrimin e qeverisë fashiste dhe pa përkrahjen e saj vështirë se mund të kryente misionin të cilin e kishte marrë mbi vete, sidomos kur dihej se sunduesit e rinj kishin kontroll dhe dominim mbi pavarësinë e institucioneve fetare dhe shtetërore dhe veten e shihnin si mbrojtës të njësisë midis dy kombeve në një mbretëri.

Sidoqoftë, Këshilli i Ulemave u angazhua në ndihmën dhe kapërcimin e sfidave të myslimanëve shqiptarë në "Tokat e Lirume", si rrjedhojë e ndryshimeve të thella dhe të gjithanshme që ndodhën në trevat shqiptare pas pushtimit dhe shtrirjes së administrimit fashist. Kështu, ky Këshill në mbledhjen e datës 18.VII.1942, vendosi për dhënien e lejes së ndërtimit të një xhamie të re në fshatin Rregie e Vogël (mbase Reçicë e Vogël - A. D.) të rrethit të Tetovës[23]. Po ashtu, me një vendim të tij të datës 1. VIII. 1942, Këshilli i Ulemave, emëroi Ismail Omerbashën inspektor i Drejtorisë së Përgjithshme të Vakfeve për "Tokat e Lirume", një njeri qe kishte qenë nëpunës i vakfit në Kosovës dhe zëvendësdrejtor i vakfeve të atyre viseve[24]. Pas njëzet e gjashtë ditëve po ky Këshill ia dërgoi këtij zyrtari një raport të Ministrisë së Drejtësisë me të cilin e informonte se pasuria e vakfit mysliman në Kosovë nuk administrohej siç duhet dhe bëheshin abuzime, prandaj i kërkohej këtij që të merr masat e duhura për rregullimin dhe kontrollimin, e kështu të ndaloheshin njëherë e përgjithmonë të tilla abuzime nëse konstatoheshin ato, duke ia raportuar përfu-

[21] *AQSH*, f. 266, Ministria e Tokave të Lirume, fl. 1-25; Kuadri i Personelit të N/Prefekturave, Dragash, Rahovec, Suharekë, Gjakovë, Istog, Drenicë, Plavë, Guci, Rozhaj, Gjilan, Ferizaj, Tetovë, Gostivar, Kërçovë, Strugë, Rekë, Carisver (Prespë e Madhe).

[22] Përshëndetje shqiptarëve myslimanë nga kryetari i Ulemave"..., f. 291.

[23] *AQSH,* f. 482, v.1942, d.5, fl. 163; Vendim i Komuniteti Mysliman; Këshilli Ulemave, Tiranë, 18. VII. 1942.

[24] *AQSH*, f. 482, v.1942, d.5, fl. 171; Vendim i Komuniteti Mysliman; Këshilli Ulemave, Tiranë, 1. VIII. 1942.

ndimet këtij Këshilli[25]. Në këto rrethana, Këshilli i Ulemave, pas riorganizimit u përpoq që të udhëhiqte institucionet që ishin nën administrimin dhe vartësinë e tij, të ishte sa më korrekt dhe transparent në strukturën ekonomike, politike, kulturore, u interesua që xhamia si faktor me ndikim, ku përveç lutjeve, përkatësisht faljes së pesë kohëve të namazit, arsimimit, edukimit, vendtakimit dhe vend për konsultime, të shërbente edhe në formësimin dhe mbrojtjen e Komunitetit Mysliman, misioni i së cilit ishte gërshetimi i vlerave shpirtërore dhe materiale. Për këtë arsye, kryetari Sh. Langu, për të krijuar një pasqyrë sa më të qartë në kuadrin e administrimit të përbashkët të Komunitetit Mysliman Shqiptar në një njësi të vetme, kërkoi informacione të hollësishme mbi gjendjen e popullsisë myslimane, për xhamitë dhe teqetë e "Tokave të Liruara"[26]. Në bazë të informacioneve të regjistruara, Gjilani rezulton të kishte shtëpi myslimane 8357, meshkuj 33101, femra 30682, gjithsej 63 783[27]; kishte 7 teqe të tarikateve të ndryshme, 1 rifai, 1 kaderi, 2 bektashi dhe 3 sadi[28]. Gjilani, sipas raportit në fjalë, në këtë kohë kishte 64 xhami[29]. Gostivari kishte shtëpi myslimane 5 532, meshkuj 18777, femra 18009, gjithsej 36786; kishte 2 teqe, 1 të tarikatit bektashi dhe 1 të tarikatit halveti; kishte 53

[25] AQSH, f. 482, v.1942, d.5, fl. 195; Vendim i Komuniteti Mysliman; Këshilli Ulemave, Tiranë, 27. VIII. 1942.

[26] *AQSH,* f. 482, v. 1944, d. 80, f. 16; Letër e Zav. Inspektori i Kryesisë së Këshillit t'Ylemave, Tiranë, 27. VI. 1944.

[27] *Po aty,* fl. 17.

[28] Mirëpo sipas mendimit tonë tarikati bektashi mund t'i jetë ngatërruar hartuesit të kësaj statistike me tarikatin halveti, sepse sipas hulumtimeve në terren dhe konsultimit të literaturës relevante, në qytetin e Gjilanit është tyrbja e tarikatit halveti me tri varret e tre shehlerëve, dy prej të varrosurve janë Sheh Salihu dhe Sheh Rrahimi, ndërsa i treti është Sheh Ymeri nga Gjilani dhe ndodhet jashtë saj; Kadri Halimi, *Studime etnologjike,* Prishtinë, Instituti Albanologjik i Prishtinës, 1994, f. 84. Po ashtu teqeja dhe tyrbja e dytë e tarikatit halveti është ndërtuar në vitet njëzeta të shek. XIX, nga myderrizi i parë i xhamisë "Atik", Hasan Ahmet Arapoglu, i ndihmuar nga Ibrahim Dindari, në lokacionin e lagjes së quajtur "Arap Mëhalla"; Aliriza Selmani, *Gjilani qendër e Anamoravës nga themelimi deri në gjysmën e parë të shekullit XX,* Gjilan, Lidhja e Historianëve të Kosovës "Ali Hadri", 2015, f. 141. Me sa duket, tarikati halveti në këtë anë ka ardhur duke u ngushtuar, për shkak të shpërnguljes së popullatës shqiptare myslimane për në Turqi pas pushtimit serb më 1912 dhe valës së shpërnguljeve pas Luftës së Dytë Botërore.

[29] *AQSH,* f. 482, v. 1944, d. 80, f. 19; Letër e Zav. Inspektori i Kryesisë së Këshillit t'Ylemave, Tiranë, 27. VI. 1944.

xhami[30]. Dibra kishte shtëpi myslimane 2795, meshkuj 6837, femra 6158, gjithsej 12995; kishte 2 teqe, 1 të tarikatit kaderi dhe 1 të tarikatit halveti; kishte 33 xhami[31]. Gjakova kishte shtëpi myslimane 4848, meshkuj 18307, femra 16578, gjithsej 34885 frymë; kishte 14 teqe të tarikateve të ndryshme, 2 rifai, 3 kaderi, 1 bektashi, 3 halveti, 1 nakshibendi dhe 4 sadi; kishte 39 xhami. Kërçova kishte shtëpi myslimane 3367, meshkuj 18307, femra 16578, gjithsej 34885; kishte 3 teqe, që të tri të tarikatit halveti; kishte 32 xhami. Rahoveci kishte shtëpi myslimane 4763, meshkuj 18317, femra 16 833 gjithsej 35 150; kishte 3 teqe, 1 rifai, 1 halveti, 1 melami; kishte 29 xhami. Peja kishte shtëpi myslimane 6135, meshkuj 24373, femra 22454 gjithsej 46827; kishte 3 teqe, 1 rifai, 1 kaderi, 1 melami; kishte 41 xhami. Prizreni kishte shtëpi myslimane 9963, meshkuj 37058, femra 36372, gjithsej 73430; kishte 11 teqe, 3 teqe kaderi, 4 halveti, 1 sinani, 2 nakshibendi, 1 sadi; kishte 106 xhami. Prishtina kishte shtëpi myslimane 5164, meshkuj 19341, femra 17882 gjithsej 37223; 1 teqe kaderi; 38 xhami. Skenderaj kishte shtëpi myslimane 3051, meshkuj 13173, femra 11881 gjithsej 25054; kishte 10 xhami. Struga kishte shtëpi myslimane 2569, meshkuj 8353, femra 7572, gjithsej 15925; kishte 1 teqe të tarikatit halveti; kishte 25 xhami. Tetova kishte 8675 shtëpi myslimane, meshkuj 28884, femra 28426, gjithsej 57310; kishte 84 xhami. Ulqini kishte 1406 shtëpi myslimane, meshkuj 6878, femra 3619 gjithsej 10497; kishte 24 xhami; Ferizajt kishte 3744 shtëpi myslimane, meshkuj 14824, femra 14416, gjithsej 29240; kishte 29 xhami[32].

Shikuar nga perspektiva e kohës, Hafiz Sherif Langu si kryetar i Këshillit të Ulemave, dëshironte të krijonte një fizionomi më të qartë rreth strukturës së popullsisë dhe objekteve të kultit islam në territoret e "Tokave të Lirume" që më parë ishin të administruar nga Jugosllavia, sepse objektet e kultit dhe shërbimet e tyre ishin më afër me proceset e jetës së përditshme të pjesëtarëve të komunitetit të tyre.

---

[30] *Po aty,* fl. 17-19.

[31] *AQSH,* f. 482, v. 1944, d. 80, fl. 17-19; Letër e Zav. Inspektori i Kryesisë së Këshillit t'Ylemave, Tiranë, 27. VI. 1944.

[32] *AQSH,* f. 482, v. 1944, d. 80, fl.17-19; Letër e Zav. Inspektori i Kryesisë së Këshillit t'Ylemave, Tiranë, 27. VI. 1944.

Andaj, në rrethanat e luftës dhe pasojat e saj tragjike për popullin shqiptar, kryetari i Komunitetit Mysliman, iu drejtua presidentit të Kryqit të Kuq Ndërkombëtar me qendër në Bern me një lutje që të njoftonte qendrat e Gjysmëhënës së Kuqe turke, egjiptase, persiane, irakiane, indiane si dhe Komitetin Panarab, për dy ngjarje tragjike që kishin goditur trevat shqiptare: e para, për bombardimin tragjik të Pejës më 13 gusht 1944, që shkaktoi një numër të madh viktimash midis popullsisë myslimane shqiptare, pasi caku i sulmeve nga ana e forcave ajrore të aleatëve anglo-amerikanë kanë qenë lagjet myslimane, dhe, e dyta, për masakrat e çetave të armatosura greke të Zervës të kryera në Çamëri, të cilët kishin shfarosur popullsinë civile shqiptare të Paramithisë dhe krahinave përreth. Disa qindra shqiptarë myslimanë, ndër të cilët Myftiu i Paramithisë dhe shumë nga paria, ishin masakruar pa mëshirë. Shumë katunde e xhami ishin plaçkitur e djegur dhe popullsia civile, e tmerruar nga rreziku i çetave të armatosura të gjeneral Zervës, kishin lënë vendin. Afro njëzetmijë refugjatë kishin kaluar lumin Kalama duke kërkuar mbrojtje, por edhe duke vuajtur nga mungesa e ushqimeve dhe të kushteve elementare për jetë. Hafiz Sherif Langu shpreh indinjatën e tij për sulmet ajrore, sidomos kur ato shkaktohen nga ana e Perandorisë Britanike, e cila midis popullsisë së vetë ka edhe myslimanë të lidhur me fatin e saj, dhe e cila u ka premtuar ndihmë dhe mbrojtje myslimanëve të ç'do vendi dhe në ç'do rrethanë. Po ashtu, në letrën e tij Sh. Langu ndanë dhimbjen e thellë të popullsisë myslimane të Shqipërisë, duke parë me keqardhje se si fuqitë ballkanike vazhdojnë të kryejnë masakra, të cilat janë frymëzuara nga urrejtja fetare dhe racial. Këto akte terrorizmi goditen gra dhe fëmijë dhe kështu zgjatën martirologun (martirizimin A. D.) tridhjetëvjeçar që populli mysliman shqiptar i Kosovës dhe Çamërisë ka vuajtur nën sundimin serb dhe grek që prej luftërave ballkanike e këndej.

Kryetari i Komunitetit Mysliman në letrën e tij, radhit listën e vuajtjeve të shumë viktimave, që kanë rënë në ngjarjet tragjike, dhe si më të dallueshmen përmend masakrimin e afro 5000 myslimanëve në janar të vitit 1943 në krahinën e Bihorit midis Malit të Zi dhe Shqipërisë të shkaktuara prej sulmeve agresive të çetave serbo-malazeze, si dhe sulmet e herë pas

hershme të krahinave shqiptare në Kosovës, qoftë nga ajri prej ajrorëve aleatë, qoftë nga toka prej çetave serbo-malazeze të ç'do tendence[33].

Me këtë telegram, kryetari i Komunitetit Mysliman Shqiptar, Hafiz Sherif Langu, kishte si qëllim që zhvillimet e rënda të luftës të mos shtriheshin mbi popullsinë e pambrojtur dhe mbi qytetet që nuk përbëjnë asnjë objektiv ushtarak, duke besuar se sulmet të tilla ajrore nga aleatet anglo-amerikan janë kryer të shtyra nga vendet fqinje armiqësore. Kështu, ai kishte bindjen se ky organ i Kombeve të Bashkuara (pra Kryqi i Kuq Ndërkombëtar), me mendimin dhe influencën e tij do të ketë impaktin e vetë pranë komandave të tyre përkatëse me qëllim që aktet të këtij lloji të mos përdorën kundër popullit shqiptar.

Në përfundim të Luftës së Dytë Botërore në Komunitetin Mysliman Shqiptar, kanë vepruar dhe janë përpjekur një mori predikuesish ku luajtën një rol të rëndësishëm në "Tokat e Lirume", në riorganizimin e institucioneve fetare islame në rrethanat e krijuar gjatë kësaj periudhe, me ndryshimin e strukturës politike, ekonomike, kulturore dhe shoqërore, ku ulemaja, hoxhë e fetarë të shquar u përpoqën në forcimin e marrëdhënieve të mira ndër besimtarët islamë, të ngritura mbi respektimin e bazave fetare, me synimin të edukojnë pjesëtarët e saj që të jenë të vlefshëm për shoqërinë, fenë dhe atdheun.

[33] *AQSH,* f. 482, v.1944, d. 33, fl. 1-2; Telegrami i dërguar nga kryetari i Komunitetit Mysliman Shqiptar, Kryqit të Kuq Ndërkombëtar rreth bombardimit të Pejës.

Alban DOBRUNA

THE REORGANIZATION OF THE ALBANIAN MUSLIM COMMUNITY IN 1942

(Summary)

In April 1941 the axis powers attacked and divided Yugoslavia. The Albanian lands, which were under Yugoslav rule, experienced the same. Local governance in the areas inhabited by Albanians was left to Albanians. Within this context, the Islamic communities merged into a single one with its seat in Tirana. As part of the aforementioned changes a new administrative division of the Islamic Community of Kosova took place. Thus, under Italian rule, the ICK became part of the Islamic community whose seat was in Tirana. We can conclude that the changes and developments that occured during this period of time had a cultural, economic, religious and national impact on the Albanian population in general and the Islamic religious community in particular.

ألبان دوبرونا

إعادة تنظيم المشيخة الإسلامية الألبانية في ١٩٤٢

(خلاصة البحث)

في أبريل ١٩٤١ ، هاجمت الدول الفاشيّة يوغوسلافيا وقامت بتفكيكها وتقطيعها. وقد عانت مصير يوغوسلافيا أيضا الأراضي الألبانية الخاضعة لحكمها. قررت القوات الغازية أن الحكومة المحلية في المناطق المأهولة بالسكان الألبان يجب أن يديرها ألبان ، حيث تم جمع وتوحيد الطوائف الإسلامية في مشيخة واحدة مقرها في مدينة تيرانا. مع التغييرات المذكورة أعلاه، أصبح التقسيم الإداري الجديد للمشيخة الإسلامية في كوسوفا، التي كانت تحت الاحتلال الإيطالي ، أصبحت مرتبطًة بالعاصمة الجديدة في تيرانا. ويمكننا أن نستنتج أن التغيرات والتطورات التي حدثت خلال هذه الفترة التاريخية أثرت بنفوذها الثقافي والاقتصادي والديني والوطني على السكان الألبان بشكل عام وعلى المجتمع الديني الإسلامي على وجه الخصوص.

Hysen MATOSHI

MONOGRAFI PËR KULTURËN SHQIPTARE ME NDIKIME ORIENTALE

(Dr. Nehat Krasniqi, Zhvillimi i kulturës shqiptare me ndikime orientale prej shekullit XVIII deri në fillimet e Rilindjes Kombëtare, botoi Instituti Albanologjik, Prishtinë, 2017, f. 578.)



Studimet lidhur me periudhën osmane te shqiptarët kanë qenë të pakta në të kaluarën dhe të tilla vijojnë të jenë edhe sot. Janë dy faktorë përcaktues për mungesën e kontributeve që hedhin dritë mbi këtë periudhë pesëshekullore të historisë shqiptare dhe mbi vlerat e kulturore që nxori në dritë kombi ynë gjatë saj. Së pari, mungesa e kuadrove që i njohin mirë osmanishten, persishten, turqishten, alfabetin arab e përgjithësisht kontekstin kulturor të kohës; dhe, së dyti, si pengesë në këtë drejtim është shfaqur paragjykimi i rëndë që i është bërë kësaj periudhe, veçmas në planin e arritjeve kulturore. Mosnjohja e një pjese të rëndësishme të së kaluarës sonë dhe të vlerave kulturore të saj, ka krijuar bindjen se bëhet fjalë për

një periudhë të errët e të pafrytshme në të gjitha drejtimet.

Megjithatë, edhe në të kaluarën, ka pasur përpjekje për një njohje sa më të plotë të zhvillimeve, të personaliteteve dhe të vlerave kulturore të periudhës osmane në historinë tonë. Osmanologët tanë kanë bërë përpjekje të kohëpaskohshme për ta kthyer vëmendjen te kjo pjesë e lënë pas dore e të kaluarës dhe e trashëgimisë sonë kulturore dhe te mungesa e theksuar e studimit të saj institucional e në kuadër të këtyre makroprojekteve shkencore, Dr. Nehat Krasniqi është njëri ndër emrat tanë të paktë, por të dalluar në fushën e osmanistikës. Kontributet e tij, qofshin ato të karakterit historiografik, qofshin të karakterit kulturologjik e letrar, janë të shumta, por edhe domethënëse në planin e rezultateve risimtare shkencore. Monografia e tij *"Zhvillimi i kulturës shqiptare me ndikime orientale prej shekullit XVIII deri në fillimet e Rilindjes Kombëtare"* është rezultat i një pune disavjeçare të kërkimeve në fonde të ndryshme arkivore të trashëgimisë sonë në osmanishte dhe veçmas të asaj trashëgimie jo të paktë të shkruar në gjuhën shqipe me alfabet arab. Duhet thënë se, para disa vitesh, ai kishte doktoruar me këtë temë. Mirëpo, kjo monografi nuk është thjesht një tezë doktorature. Puna në të dhe funksionimi i saj si një sintezë e dijeve të fituara gjatë niveleve të shkollimit, si një sintezë e dijeve dhe përvojave të përfituara nga leximi e studimi i gjithë kësaj trashëgimie përgjatë më shumë se tri dekadave të kërkimeve në këtë fushë, e bëjnë monografinë në fjalë të dallueshme si një vepër që shkruhet gjatë gjithë jetës, që plotësohet dita-ditës me të dhëna për fakte të reja kulturore të botës shqiptare të periudhës osmane, por edhe për dëshmi të shkrimit të shqipes me alfabetin arab. Pra, fjala është për një punë shumëvjeçare, për një projekt jetësor që hedh dritë mbi trashëgiminë kulturore të botës shqiptare në një periudhë prej afro dy shekujsh.

Fillimisht autori, dr. Nehat Krasniqi, nëpërmjet fakteve, qartëson pozitën e shqiptarëve në kuadër të Perandorisë Osmane, flet për rolin e rëndësishëm që luajtën ata në kuadër të saj, duke qenë bartës të rëndësishëm të funksioneve dhe autoritete të shquara perandorake në jetën shoqërore, politike, ekonomike, fetare, arsimore, kulturore etj. gjatë gjithë shekujve të ekzistimit të saj. Një pjesë e këtyre fakteve janë pohuar edhe më parë, veçmas ato lidhur me pozitat e rëndësishme qeverisëse që mbanin shqiptarët, por ka mbetur disi nën hije kontributi i tyre dhënë sferave arsimore, kulturore, të dijes etj. Në mos tjetër, besoj se këto fjali të dr. Nehat Krasniqit do të nxisin mendjet e shumë studiuesve tanë, albanologë, që të hulumtojnë për personalitete të shquara shqiptare të kësaj periudhe: "Në këto veprimtari ata arrinin të fitonin më shumë pasuri dhe ofiqe e pozita të larta, përfshirë këtu edhe pozitën e kryeministrit të Perando-

risë Osmane (Sadriazam). Deri në pavarësimin e Shqipërisë nga Porta e Lartë (1912) në këtë pozitë të lartë shtetërore osmane, kanë arritur të ngrihen 40 shqiptarë, në pozitën e shejhul-islamit 5 shqiptarë, në pozitën e admiralit të flotës detare osmane (Kapudan-derya) 14 shqiptarë, në pozitën e kryekontabilistit (bashdefterdar) 10 shqiptarë. Nga gjiri i popullit shqiptar dolën po ashtu rreth 400 poetë e shkrimtarë, shumë myderrizë, myftilerë, kadilerë, vezirë, pashallarë, valilerë, bejlerbejlerë, myteselimë etj." Është krejtësisht e pakuptimtë që një komb i vogël nga këta 400 poetë e shkrimtarë të njohë vetëm disa prej tyre, t'iu bëjë vend vetëm një numri të vogël (disa dhjetëra sish) prej tyre në historinë e kulturës sonë. Kur kësaj i shtojmë edhe faktin se një pjesë e këtyre autorëve janë madje të shekullit XVI, rëndësia e tyre për historinë tonë kombëtare merr peshë në dimensionin e shtrirjes kohore.

Në aspektin strukturor, kjo monografi përbëhet nga 8 krerë, që trajtojnë përmbajtje tematike të veçanta, por që, megjithatë, inkorporohen natyrshëm në makrotërësinë e saj. Fillimisht autori, në kreun e parë, e qartëson sfondin historik të ndikimeve orientale, si rezultat i depërtimit osman në hapësirat shqiptare, pastaj edhe i islamizimit dhe integrimit të shqiptarëve në jetën shoqërore e kulturore osmane. Nëpërmjet faktografisë, janë qartësuar shumë procese historiko-kulturore që kanë ndodhur dhe të cilat në shkencën tonë jo gjithnjë janë trajtuar pa paragjykime e në një prizëm të njëmendtë argumentues dhe të paanshëm shkencor. Duke e pasur të qartë këtë sfond, lexuesi a studiuesi do ta akceptojë e ta njohë më drejt kulturën shqiptare me ndikime orientale.

Pasi ka qartësuar në vija të përgjithshme proceset jetike për lindjen e këtij krahu të kulturës shqiptare, në kreun vijues, autori është përqendruar në mënyrë më të përafërt me rrjedhat ekonomike, shoqërore e politike të shekullit XVIII, gjë që në aspektin kohor përbën fokusin e studimit të tij për kulturën shqiptare me ndikime orientale. Forcimi i feudalëve vendës dhe krijimi i pashallëqeve e forcimi i autoritetit të tyre në raport me pushtetin qendror, i dha një rol më të madh fisnikërisë (oxhakërisë) shqiptare. Ky proces, krahas marrëdhënieve, gjithnjë e më të pranishme ekonomike-tregtare me Evropën, erdhi pothuajse njëkohshëm me njëfarë vetjakësie që u reflektua edhe në planin kulturor, përkatësisht me lindjen e alamiados shqiptare. Ndaj, mund të thuhet se, autori, me të drejtë, i ka parë këto zhvillimeve të aspekteve ekonomike, shoqërore e politike të ndërlidhura ngushtësisht me ato kulturore.

Njëri ndër paragjykimet më të mëdha në planin e zhvillimit kulturor e arsimor të shqiptarëve gjatë sundimit të Perandorisë Osmane ka të bëjë me gjoja mungesën e plotë të shkollave dhe të shkollimit. Dr. Nehat Krasniqi, edhe në këtë pikëpamje, është treguar i vëmend-

shëm duke sjellë të dhëna, por edhe konstatime, lidhur me sistemin arsimor që u përhap në këto troje pas islamizimit të pjesës më të madhe të popullsisë shqiptare. Hapja e shkollave me karakter islam, në të cilat duhet thënë se mësoheshin edhe lëndë të tjera - jofetare (gramatika dhe sintaksa arabe, persishtja, retorika, stilistika, logjika, matematika, bazat e mësimdhënies, gjeometria, kaligrafia etj.) u bë pothuajse paralelisht me ngritjen e xhamive, ngase shkollat ose ekzistonin në kuadër të xhamive, ose në një kompleks të përbashkët me to, përkatësisht pranë tyre. Me interes të veçantë është edhe trajtimi që iu bëhet bibliotekave, qofshin ato publike, qofshin private, duke i trajtuar si burim të rëndësishëm të formimit kulturor e arsimor të popullatës. Të dhënat në kreun e tretë janë me interes dhe përfshijnë si strukturën e shkollave (mejtepeve, medreseve), ashtu edhe përhapjen e tyre në hapësirën shqiptare.

Kreu i katërt, i titulluar "Kontributi i fisnikërisë vendëse për zhvillimin e kulturës shqiptare me frymë orientale islame", shqyrton rolin e madh që e luajti oxhakëria shqiptare për zhvillimin e arsimit dhe të kulturës në trojet tona etnike. Ky kontribut i autorit për të nxjerrë në pah rolin e elitës shoqërore, politike, ekonomike, ushtarake etj. të kohës shkon disi ndesh me perceptimin që, në historiografinë tonë, gjatë kohë i është bërë kulturës si një veprimtari që buronte nga masat e gjera popullore. Familjet fisnike shqiptare, të cilat i ruajtën privilegjet edhe në kontekstin e ri të sundimit osman dhe të përqafimit masiv të islamit nga popullata shqiptare, patën ndikim të fuqishëm në të gjitha proceset e jetës përgjatë pesë shekujve. Një numër i madh shkollash dhe bibliotekash u hapën dhe u vakëfuan pikërisht nga kjo strukturë prijëse e qeverisëse. Madje, kishte ndër anëtarët e këtyre familjeve edhe autoritete të kulturës, letërsisë, fesë dhe dijes, ndërsa një numër i konsiderueshëm i poetëve, shkrimtarëve e dijetarëve të dalluar ishin mecenë të këtyre familjeve elitare. Në këtë kontekst trajtimi, autori i monografisë e vë theksin te këto familje që u shquan edhe në planin kulturor në pjesë të ndryshme të hapësirës etnike shqiptare: Bushalinjtë e Shkodrës, Rrotllat e Prizrenit, Kurtpashajt (Kryezinjtë) e Gjakovës, Mahmutbegollët e Pejës, Gjinollët e Prishtinës - Gjilanit, Rexheppashajt (Derallët) e Tetovës, Bargjinollët e Tiranës, Alihajdarbegollët (Alltunët) e Kavajës, Vlorajt (Velabishtët) e Vlorës - Beratit, Asllanpashajt e Libohovës - Gjirokastrës, Abdurrahmanpashajt e Peqinit, Ali Pashë Tepelena (si individ i cili nuk trashëgoi ndonjë privilegj familjar dhe po ashtu nuk u la të tillë as pasardhësve), Alipashajt e Ulqinit dhe Shabanpashajt e Gucisë. Them me bindje se, përtej dimensionit kulturor, të dhënat për familjet e oxhakërisë shqiptare të kësaj periudhe mund t'iu shërbejnë autorëve të historisë së përgjithshme shqiptare, e cila jo

gjithnjë është shkruar duke i pasur parasysh këto fakte shumë të rëndësishme.

Një vëmendje e veçantë në planin e shqyrtimit kulturor të kësaj periudhe i është kushtuar edhe gjuhës së shkruar shqipe dhe përgjithësisht zhvillimit të gjuhësisë shqiptare. Është identifikuar si karakteristik fenomeni i përfshirjes së orientalizmave në gjuhën e shkruar shqipe, por theksi është vënë edhe te kontributet më me peshë për sa i përket leksikografisë shqiptare të kësaj periudhe. Njohja dhe studimi më i plotë i orientalizmave në gjuhën shqipe, numri i të cilëve është më se 4600, nuk përbën thjesht vetëm një aspekt historik gjuhësor, por gjithashtu edhe një çështje aktuale për shqipen.

Pjesa më esenciale në rrafshin përfshirjes së lëndës studimore dhe në atë të shqyrtimit të përimtuar të monografisë *"Zhvillimi i kulturës shqiptare me ndikime orientale prej shekullit XVIII deri në fillimet e Rilindjes Kombëtare"* përbëhet nga kreu i gjashtë, i cili zë afërsisht një të tretën e shtjellimit të gjithëmbarshëm. "Letërsia shqiptare me ndikime orientale" është një sintezë e prezantimit të vlerave letrare shqiptare edhe përtej kufijve kohorë të kësaj monografie. Kështu, disa nga autorët shqiptarë që i paraprijnë periudhës së trajtuar janë: Isa "Mesihi" Prishtina, Behari Prishtina, vëllezërit Azmi, Levhi dhe Nuhi nga Prishtina, vëllezërit Nehari, Suzi dhe Sa'ji nga Prizreni, Haki Muhamed Prizreni, Mu'min Prizreni, Nihadi Çelebi Prizreni, Ummi Sinan Prizreni, Shem'i Mustafa Prizreni, Texhel-li Abdylkadër Prizreni, Ahmet pashë Dukagjini, Jahja bej Dukagjini, Ahmet bej Dukagjini, Mustafa Sani bej Dukagjini, Osman bej Dukagjini, Fasih Ahmed Dede Dukagjini, Mehmed efendi Peja, Tului Ibrahim Tetova etj.

Dy janë tërësitë që trajtohen në këtë kapitull: poezia e Divanit e shkruar nga autorë shqiptarë, përkatësisht letërsia e shkruar nga autorë shqiptarë por në gjuhët orientale dhe letërsia me përbërës islamë e orientalë e shkruar në gjuhën shqipe - përkatësisht alamiadoja shqiptare. Një vëmendje e madhe i është kushtuar shpjegimit lidhur me metrikën e kësaj poezie, por edhe llojeve të lëvruara poetike, me ç'rast janë dhënë shpjegimet përkatëse dhe shembujt e duhur. Sa u përket llojeve të letërsisë shqiptare të divanit, autori veçon: gazelin, kasiden, mesnevinë, rubainë, mystezatin, musemmatin, ilaçinë, nefesin, natin, tarihin etj.

Përfaqësuesit shqiptarë të letërsisë së divanit janë të shumtë, por gjithsesi deri tani jo fort të njohur për opinionin e gjerë kulturor e shkencor. Merita e studiuesit Nehat Krasniqi është se e kthen vëmendjen tek autorët e këtij krahu, sikundër janë: Mehmed "Fenni" Dede Vlora, Tahir Muhamed Efendi Shkupi, Murteza "Raxhi" Shkodra, Mehmed "Nazirzade" Delvina, "Haxhi" Mehmed Janina, Esad Hoxha (Hoxha Mehmed-Esad Janina), Hasan "Zylali" Efendi

Delvina, Abdullah Pashë Qypërliu, "Hasim" Esad Pashë Qypërliu, "Ahmedi" Shkodra, Sheh Sylejman "Axhiza" Shkodra, "Kashif" Muhamed Tetova, Murteza "Safi" Shkodra, Fadil Elbasani, Ibrahim "Hanif" Shkupi, Begzade "Nuri" Prishtina, Sheh Rexhep "Lisani" Tirana, Sheh Selim "Halimi" Tirana, Hasan "Hadim" Tirana, Ibrahim "Halili" Pasha Shkodra, Mehmed "Asaf" Pashë Shkodra, Mustafa "Sherifi" Pashë Shkodra, Ibrahim Qemaludin "Shemimi" Dedeja, Hajdar "Hatemi" Baba Kruja, Shaban "Hulusi" bej Toptani, Ahmed "Hikmeti" Kruja, Jakup "Mejli" Prishtina, Hysejn Efendi Prishtina, Ahmed Kurd Pashë Gjakova, Osman "Vasif" Bej Elbasani - Enderuni, Xhafer "Sadik" Pashë Peqini, Ibrahim "Fehmi" bej Peqini, Selim "Sirri" Pashë Tepelena, "Tevfik" Kavaja dhe Ismail Dedeja. Merret vesh, këta autorë të periudhës që merr në shqyrtim studiuesi Nehat Krasniqi kanë edhe pararendësit e shumtë të tyre, për të cilët thamë diçka edhe më lart, por, gjithashtu, edhe pasuesit e kësaj tradite letrare, e cila vijon madje deri kah mesi i shekullit XX.

Lindjen e letërsisë shqipe alamiado autori i monografisë e sheh në fazën kulmore të përhapjes së fesë dhe të kulturës islame në qendrat urbane shqiptare, gjë që, në aspektin kohor, përputhet me gjysmën e dytë të shekullit XVII dhe fillimin e shekullit XVIII. Lindja e kësaj letërsie, të shkruar me alfabet arab, por në gjuhën shqipe, është parë në ndërlidhje me forcimin e rolit të gjithëmbarshëm të fisnikërisë shqiptare.

Duke e kontestuar mendimin e gjertanishëm mbizotërues në historitë tona të letërsisë, sipas të cilit alamiadoja shqipe fillon me Muçi Zaden (ai nxjerr edhe dy autorë të mëhershëm), përkatësisht vjershën 'Imzot mas na lër pa kahve' që daton më 1725, Nehat Krasniqi ofron dëshmi për mundësinë objektive të zhvendosjes së këtij kufiri, në gjysmën e dytë të shek. XVII, ndonëse shpreh bindjen se vetëm hulumtimi i plotë i trashëgimisë së alamiados shqipe mund të japë një përgjigje definitive për fillimet e saj. Zgjidhja e drejtë shkencore lidhur me "çështjen e zanafillës dhe përgjithësisht të historisë së letërsisë shqipe alamiado - sipas tij - do të mbetet e hapur, derisa të mos hulumtohen dhe studiohen të gjitha koleksionet e dorëshkrimeve orientale islame, jo vetëm në Shqipëri e Kosovë, por edhe jashtë, si në Turqi, Austri, Itali, Bosnjë, Kroaci, Francë e gjetiu."

Letërsia shqipe alamiado është një rrumbullakim i karakterit etnik kulturor në planin gjuhësor dhe një avancim në planin tematik e tipologjik krahasuar me fazën pararendëse të letërsisë me ndikime islame dhe përgjithësisht me fazat e mëhershme të zhvillimit të kulturës shqiptare. Njohja e kësaj letërsie është kusht për të njohur dimensionin e vërtetë të zhvillimit të letërsisë shqipe, e cila pikërisht me këta autorë u pasurua, veç

tjerash, edhe me llojin e veprave të njëmendta narrative.

Alamiadistët shqiptarë të kësaj periudhe, të përfshirë në veprën e Nehat Krasniqit, sipas shfaqjes së tyre kronologjike në letërsinë shqipe, janë: Muçe (Mustafa) Libohova, Muço (Mustafa) Gega, Muçi-zade (i biri i Muçit), Hysejn Shkodra, Ibrahim "Nezim" Bej Frakulla - Berati, Ismail Pashë Velabishti - Vlora, Mehmet Ishkiu (Ashiku), Mulla Beqiri, Sheh Sylejman Baba Rahoveci, Mulla Dervish Peja, Tahir efendi Boshnjaku - Gjakova, Mulla Hysen Dobraçi, Mulla Sali Pata, Sheh Ahmet Elbasani, Ibrahim Elbasani, Sylejman Pashë Vërlaci - Elbasani, Ismail Floqi, Elmaz Gjirokastriti, Myslim Hoxha, Haxhi Ymer "Suzi" Kashari - Tirana, Haxhi Et'hem Bej "Shehidi" - "Vefaji", Sheh Sylejman Temani, Demir Vlonjati, Sadeddin Omer efendiu, Asllan bej Puçe, Tahir Nesibiu, Hasan Zyko Kamberi, Muhamed Çami - Kyçyku, Abdullah Sylejman Konispoli, Haxhi Çiçkoja, Abdalli Mulla Fejzo - Sheh Fejza, Hysen Bitri dhe Zejnel Bastari.

Interes të veçantë për trashëgiminë kulturore islame dhe orientale përbëjnë edhe objektet e ndërtuara fetare dhe ato urbanistike. Ndonëse në një numër jo aq të madh, edhe sot ndeshim objektet të kësaj periudhe, të cilat i kanë mbijetuar si funksionale ose si të pjesshme dhëmbit të kohës. Autori i monografisë, duke e njohur vlerën dhe rëndësinë që kanë pasur për zhvillimin e gjithëmbarshëm të kulturës shqiptare me ndikime islame-orientale, ua ka kushtuar një vëmendje të veçantë atyre. Kështu, në mënyrë sistematike, ka prezantuar të dhëna për objektet fetare-kulturore të kësaj kohe, sikundër janë: xhamitë, medresetë, mejtepet, bibliotekat, teqetë; por edhe për objektet profane, siç janë: bezistanet, hanet, karavansarajet, urat, kullat e sahatit, hamamet dhe imaretet.

Një përpjekje autori i monografisë e ka bërë edhe sa i përket trajtimit të përbërësve orientalë në kulturën tonë popullore, si formë e krijimtarisë kolektive. Ndonëse një materie tejet e gjerë, kërkimi është orientuar kryesisht në folklor dhe në besimet popullore. Më parë se një aspekt kulturor i shqyrtuar katërçipërisht, mund të thuhet se kjo lëndë veç sa është hedhur në lëmë të diskutimit shkencor.

I vetëdijshëm se për aspekte të ndryshme kulturore të periudhës së trajtuar është e pamundshme të nxirret një përfundim unik dhe funksional në planin sintetizues, autori, me të drejtë, është përcaktuar për e nxjerrjen e disa përfundimeve.

Duke marrë parasysh periudhën e gjatë studimore, rëndësinë e madhe dhe polidimensionalitetin e saj, dr. Nehat Krasniqit i është dashur të gjurmojë nëpër burime të shumta të pabotuara, por edhe të botuara, arkivore, dorëshkrime e koleksione dorëshkrimesh të vjetra si dhe literaturë shkencore. Baza burimore është mjaft e gjerë, ndërsa literatura e shumëllojshme, si në planin gjuhësor, ashtu edhe në atë të qasjeve të ndryshme.

Përgjithësisht mund të thuhet se monografia *Zhvillimi i kulturës shqiptare me ndikime orientale prej shekullit XVIII deri në fillimet e Rilindjes Kombëtare"* e dr. Nehat Krasniqit është një kontribut i çmueshëm për historinë e kulturës shqiptare, për përbërësit e saj islamë dhe orientalë, për letërsinë shqipe dhe për autorë të shumtë të kësaj periudhe - shumica prej tyre pak të njohur në opinionin tonë shkencor, për shkrimet në gjuhën shqipe, për faktorët shtytës të zhvillimit të kulturës shqiptare, për trashëgiminë materiale fetare dhe jofetare etj. Me një fjalë kjo periudhë, sa u përket zhvillimeve kulturore, në saje të kësaj pune madhore, besojmë se do të paragjykohet gjithnjë e më pak dhe se do të vlerësohet gjithnjë e më shumë si pjesë integrale dhe e rëndësishme e kulturës së gjithëmbarshme shqiptare.

Vepra dallohet për një bazë të gjerë burimore dhe për të dhëna të shumta e të vjela me kujdes përgjatë gjithë veprimtarisë shkencore të gjertanishme të autorit. Numri i madh i përfaqësuesve shqiptarë të poezisë së divanit, të shkruar në gjuhët orientale, por edhe numri i madh i alamiadistëve shqiptarë, si dhe të dhënat e shumta biografike e bibliografike për ta, e bëjnë monografinë e dr. Nehat Krasniqit një vepër bazë për një histori më të plotë të kulturës shqiptare dhe veçmas të letërsisë shqipe. Një fakt tjetër i rëndësishëm ka të bëjë me edhe me qëndrimin kritik të autorit si ndaj materialit studimor, ashtu edhe ndaj përfundimeve të studiuesve të tjerë të kësaj periudhe dhe të këtij krahu kulturor të botës shqiptare. Kontestimet e arritjeve të studiuesve të tjerë janë produkt i gjetjes së fakteve të reja, interpretimeve të gjithanshme dhe argumentimeve të qarta shkencore. Mund të themi se bëhet fjalë për një vepër që nxjerr në pah të dhëna të reja historike e kulturore dhe qasje të reja në raport me to. Me këtë vepër, të shkruar me një gjuhë të rrjedhshme dhe shtjellim të qartë logjik, historia e kulturës shqiptare bëhet më e plotë dhe, rrjedhimisht, edhe interesimi studimor për t'u marrë me periudhën në fjalë bëhet më i madh.

NJË VEPËR ME INTERES PËR HISTORINË E QYTETËRIMIT ISLAM

(Prof. dr. Qazim Qazimi, *Histori e qytetërimit islam*, botoi: Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës, Prishtinë, 2018, f. 604)

Dihet mirëfilli se shoqëria njerëzore ka një histori të gjatë dhe të mbushur me histori qytetërimesh, dhe secili nga këto qytetërime është ngritur mbi bazën e një besimi, prandaj feja dhe qytetërimi kanë një marrëdhënie ekzistenciale midis tyre. Kështu është edhe me qytetërimin islam, i cili është i ngritur mbi bazën e mësimeve të fesë islame. Së këndejmi, qytetërimi islam ka histori, por për dallim nga shumë qytetërime të tjera, ai nuk ka kaluar në histori, as nuk ka njohur ndërprerje, por është prore dinamik, vital, aktual e prodhues.



Prandaj njohja dhe pasurimi i njohurive të publikut të gjerë shqiptar me këtë qytetërim të përbotshëm, është po aq e rëndësishme dhe bashkëkohore, sa edhe njohja e fesë islame. Nga ana tjetër, kur kësaj ia shtojmë edhe faktin se pjesë e këtij qytetërimi, e rrjedhimisht edhe fesë islame, u bënë dhe janë edhe shqiptarët, atëherë njohja, mësimi dhe studimi i historisë së këtij qytetërimi bëhet edhe i domosdoshëm.

Këtë synim, përveç të tjerash, e ka edhe libri *"Histori e qytetërimit islam"* i

prof. dr. Qazim Qazimit, i cili publikut dhe lexuesit shqiptarë i ofron të dhëna dhe fakte të bollshme për një njohje me të thellë të qytetërimit islam dhe, sikurse e thotë dhe vetë autori, pse jo edhe për të korrigjuar disa vlerësimeve të deritanishme ndër ne, për kulturën dhe qytetërimin islam.

Dhe jo vetëm kaq! Feja islame si bazë e qytetërimit islam, nuk u paraqit në një kohë të pacaktuar, të panjohur, inekzistente dhe mitologjike, që në shtresimet e saj do të mund të fshihte ose të maskonte parametrat dhe mësimet e saj origjinale, por ajo u paraqit në një kohë të caktuar, të saktë, reale dhe konkrete për evidencën historike të hulumtimeve. Feja islame, në fakt konfirmon vazhdimësinë e njerëzimit dhe përjashton çdo lloj ekskluziviteti, prandaj dhe duke pasur parasysh këtë, qytetërimet dhe popujt e lashtë para atij islam, siç janë babilonasit, sumerët, fenikasit, egjiptianët e vjetër etj., janë trajtuar dhe kanë zënë vend të merituar në librin e Profesor Qazimit. Këto qytetërime të veçanta dhe të lashta, si paraprijëse të qytetërimit islam, nga Profesor Qazimi janë analizuar në bazë të një larmie tematikash specifike, siç janë elementët bazë për krijimin dhe mbijetesën e tyre, tiparet e sistemeve të tyre politike e sociale, themelimi dhe zhvillimi i botëkuptimeve të tyre filozofike dhe fetare, krijimi dhe transmetimi i njohurive teknike dhe shkencore, dhe, së fundmi, edhe shkuarja e tyre në histori.

Duke i lexuar këto tematika, lexuesit i mundësohet që të zbulojë dhe të nënvizojë tiparet e ngjashme, por edhe veçoritë dalluese midis qytetërimeve të brezave të ndryshëm të njerëzimit të rajoneve të ndryshme të botës, madje edhe shpesh herë të nënvizoj faktin se si ato kanë shkëmbyer elemente të veçanta dhe kanë influencuar njëra-tjetrën.

Këto tematika janë trajtuar në katër kapitujt e parë të librit *"Histori e qytetërimit islam"* të autorit Q. Qazimi, kurse nga kapitulli i pestë dhe deri në kapitullin e gjashtëmbëdhjetë dhe të fundit, nis dhe bëhet fjalë për historinë e qytetërimit islam, fillet, kronologjinë e periudhave, kulmimin, karakteristikat, veçoritë dhe tiparet dalluese të tij etj..

Natyrisht, përgatitja e një punimi mbi historinë e Qytetërimit islam, siç kuptohet nga vetë titulli, paraqet vështirësi të mëdha për nga vetë gjerësia dhe thellësia e materialit, por edhe për nga shtrirja kohore dhe hapësinore e tij. Këtë e ka pasur parasysh edhe vetë autori, profesor Qazimi, por ai ka arritur me sukses që të sjellë një këndvështrim të përgjithshëm historik dhe të përzgjedhë elementët me pikantë të kulturës shpirtërore dhe materiale të popujve në epoka të ndryshme historike dhe në vatra të ndryshme ndërkontinentale, që janë bërë pjesë e qytetërimit islam.

Sigurisht, këtu nuk janë harruar edhe shqiptarët, të cilët jo vetëm se u bënë pjesë e qytetërimit islam, por ata dhanë edhe kontributin e tyre në ngritjen dhe

fuqizimin e këtij qytetërimi dhe plotësuan mozaikun e tij.

Prandaj dhe autori Qazimi, në kapitujt ku flitet për qytetërimin islam pas ardhjes së tij tek shqiptarët, ka paraqitur shkurt disa linja përmbledhëse të kulturës dhe qytetërimit shqiptar islam, dhe më këtë sikur autori ka dashur që arritjet e kulturës dhe qytetërimit islam shqiptar t'i vejë krahas me të arriturat e popujve të tjerë në kuadër të këtij qytetërimi, e rrjedhimisht edhe të qytetërimit botëror. Dhe mund të themi se kjo është ndër ato vepra të rralla ku arritjet e kulturës dhe qytetërimit islam shqiptar vihen në të njëjtën tablo me ato islame-botërore.

Ajo që bjerë në sy gjatë leximit të veprës *"Histori e qytetërimit islam"* të Profesor Q. Qazimit është edhe fakti se një sërë ngjarjesh historike mbi popujt e hershëm, mbi fatet dhe fundin e tyre, po edhe për periudhat e më vonshme, kundrohen dhe shpjegohen, krahas të tjerave, edhe me argumente kuranore. Kjo mbase vjen nga njohuritë dhe nga një pjesë e përgatitjes profesionale e Profesor Qazimit. Dhe kjo sado që duket me sfond teologjik, aq edhe i jep vlerë këtij botimi dhe e bënë atë më të plotë, më interesant dhe më bindës, sepse që të kuptosh historinë e njerëzimit, veç tjerash, duhet të kesh edhe njohuri të thelluara mbi fetë.

Në anën tjetër, literatura e përdorur, me një llojllojshmëri burimesh bibliografike në gjuhë të ndryshme, i kanë mundësuar Profesor Q. Qazimit gërshetimin e qasjeve të ndryshme, kurse faksimilet, ilustrimet, hartat dhe fotografitë e bollshme të pasqyruara, dhe të cilat herë-herë flasin më shumë se sa teksti, dhe se sa vetë fjalët, i japin një vlerë shtesë këtij botimi dhe kësaj vepre.

Prandaj, mendojmë dhe jemi të bindur se botimi në fjalë i veprës *"Histori e qytetërimit islam"* e autorit prof. dr. Qazim Qazimi, jo vetëm duhet të përfshihet në kurrikulat e fakulteteve tona islame, por ai i shërben shumë mirë edhe publikut të gjerë për kulturë të përgjithshme.

Themi kështu edhe për faktin se ky botim, është shkruar në gjuhë shqipe të pastër, të thjeshtë, të qartë dhe të kuptueshme nga kushdo.

Dhe themi kështu përsëri sepse, - dhe kjo është më e rëndësishme, - ky botim i përshtatet në mënyrë perfekte periudhës kohore në të cilën po jetojmë, ku shkëmbimi politik, kulturor e profesional ka arritur në një mundësi të tejskajshme përmes teknologjisë, kurse diversiteti brenda shoqërisë e bën akoma më të domosdoshme njohjen dhe studimin e qytetërimeve dhe kulturave botërore, pra edhe atë islame, sa kohë që kjo e fundit, pra kultura dhe qytetërimi islam, janë edhe pjesë e identitetit tonë kombëtar dhe etnik.

Në përmbyllje të këtij shkrimi, nuk mund të mos i themi edhe dy gjëra dhe t'i shprehim dy konsiderata.

E para, autorin, profesorin dhe pedagogun tonë të nderuar Qazim Qazimin

ta përgëzojmë për kontributin e tij të dhënë për dekada jo vetëm në fushën e edukimit dhe arsimimit, por edhe në atë të fjalës së shkruar, më se i ka shërbyer dhe po i shërben merituesheëm kulturës dhe qytetërimit shqiptar islam.

Dhe *e dyta,* një mirënjohje edhe për botuesin - *Kryesinë e Bashkësisë Islame të Kosovës* dhe shtëpinë e saj botuese *"Dituria Islame",* për botimin kaq dinjitoz dhe reprezentativ të këtij libri dhe për pasurimin e bibliotekës sonë më një vepër me vlerë nga fusha e historisë së qytetërimeve.

Sadik Mehmeti
Ramadan Shkodra

PËRMBAJTJA

PAÇ BEKIMIN E ALLAHUT, USHTRI E KOSOVËS! 5

Sabri BAJGORA
VEHBE ZUHAJLI DHE TEFSIRI I TIJ
"ET-TEFSIRU-L MUNIR" 7

Belkasim EL-GALI
NJOHJA E ALLAHUT, SIPAS MATURIDIUT (معرفة الله) 39

Ejup HAZIRI
SHPREHJA E OPINIONIT -VËSHTRIM RETROSPEKTIV- ... 57

Taxhedin BISLIMI
KONCEPTI I FET'HI DUREJNIT MBI AUTORËSINË Studim krahasimtar në jurisprudencën Islame 79

Bali SADIKU
LIDHJA E THIRRJES SË MUHAMEDIT A.S. ME THIRRJEN E PEJGAMBERËVE PARA TIJ 91

Sadik MEHMETI
DORËSHKRIMET ORIENTALE TË ILUMINUARA
NË ARKIVIN E KOSOVËS DHE RUAJTJA E TYRE 111

Hatixhe AHMEDI
PERSONALITET I DITURISË FRYTËDHËNËSE
DHE SINQERITETIT TË PASHËMBËLLT
(Ali Jakup ef. Shkodra - 1913-1988) 125

Sedat ISLAMI
ROLI I FESË NË NGRITJEN E NDËRGJEGJES PUBLIKE PËR RUAJTJEN E AMBIENTIT 147

Ramadan SHKODRA
ORGANIZMI I JETËS FETARE ISLAME
NË KOSOVË GJATË HISTORISË 163

Nuridin AHMETI
DISA TË DHËNA TË REJA
PËR HOXHË KADRI PRISHTINËN (1878-1925)..... 185

Mrika LIMANI
"PIRKEI AVOT" - Mësimet rabinike dhe hadithet
e Pejgamberit a.s. nga këndvështrimi i studimeve krahasimtare.... 197

Besnik JAHA
UTOPIA DHE FEJA (Ndikimi i fesë në letërsi)..... 211

Alban DOBRUNA
RIORGANIZIMI I KOMUNITETIT MYSLIMAN
SHQIPTAR MË 1942 223

Hysen MATOSHI
MONOGRAFI PËR KULTURËN SHQIPTARE
ME NDIKIME ORIENTALE 235

NJË VEPËR ME INTERES PËR HISTORINË
E QYTETËRIMIT ISLAM 243

PËRMBAJTJA..... 247